

# **SHKENCA E FORENZIKËS DHE ROLI I SAJ NË PROCEDURË PENALE (Një vështrim i posaçëm mbi praktikat dhe veçantitë e saj në Kosovë)**

Blerim Olluri

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të doktoratës në shkencat juridike,  
me profil-e drejta penale, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor :

Prof. Ass. Dr. Irakli Koçollari

Numri i fjalëve: 57,515

Tiranë, Qershor 2016

## **Deklarata e autorësisë**

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimin e kam shkruar unë vetë, nuk është prezantuar asnjëherë para një komisioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri apo në pjesë të veçanta. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

## Abstrakti

Ky punim doktrate me titull: shkenca e forenzikes dhe roli i sajë në procedurë penale-një vështrim i posaçëm mbi praktikat dhe veçantitë e saj në Kosovë, ka për synim të hulumtojë historikun e zhvillimit të shkencës së forenzikës, kuptimin e shkencës së forenzikës, rëndësinë e shkencës së forenzikës në procedure penale, si dhe të krahasojë dhe analizojë dispozitat ligjore në lidhje me ekspertizën në procedurë penale.

Punimi ka trajtuar edhe zhvillimet e kohës së fundit të shkencës së forenzike, që po merr një vend përherë e më të rëndësishëm në vendimet e drejtësisë kudo në botë. Shkenca e forenzikës në shumicën e vendeve ndërkombëtare trajtohet si shkencë e veçantë. Ajo sot ka rol shumë të rëndësishëm në zbardhjen e veprave penale, zbulimin e (autorëve) kryerësve të tyre apo përjashtimin dhe vërtetimin e pafajësisë të të dyshuarve si autorë të mundshëm. Por jo vetëm kaq, ajo sot po gjen zbatim edhe në çështje civile si: përcaktimi i atësisë përmes analizës së ADN-së, ekzaminimet grafologjike të dorëshkrimeve etj.

Punimi ofron edhe një kontribut në studimin, analizimin dhe krahasimin e metodave shkencore bashkëkohore në gjetjen, identifikimin, krahasimin, analizën, testimin dhe interpretimin e rezultateve të ekspertizave forenzike.

Në këtë punim, theks të veçantë i është kushtuar historikut, themelimit, organizmit, statistikave dhe proceseve shkencore të agjencisë së Kosovës për forenzikë. Agjenci kjo e cila po konsiderohet një ndër Agjencitë më të avancuara dhe më kredibile në rajon.

Për të studiuar dhe analizuar proceset shkencore forenzike, në veçanti ato të agjencisë së Kosovës për forenzikë, janë përdorur metoda historike, metoda përshkruese, metoda e analizës së përmbajtjes, metoda shpjeguese dhe metoda statistikore.

Rezultatet e studimit konfirmojë faktin se shkenca e forenzikës, ka rol të rëndësishëm dhe shumë domethënës në procedurë penale.

Fusha: E drejta penale

Fjalët kyçe: Shkenca e forenzikës, ekspertiza, eksperti, procedura penale, agjencia e Kosovës për forenzikë.

## **Abstract**

This dissertation work titled: Science of Forensic and its role in justice – one special look in practices and its peculiarities in Kosovo, was designed to explore the meaning of forensic science the importance of forensic science, and history of development of forensic science.

Recently forensics is taking increasingly important place in judicial decisions around the world. Forensic science in most international countries is treated as especial science.

Forensics today has a very important role in solving crimes, discovers or excludes their offenders (authors) and suspect confirmation innocence as a potential author.

But not only that, forensics today also applies in civil matters such as: determination of paternity through DNA analyses examination of handwriting and graphologists etc.

This study provides a contribution to the study, analysis and comparison of modern scientific methods in locating, identifying, comparison analysing, testing and interpretation of forensic results expertise.

In this study, particular emphasis will be given to the history of establishment, organizing, statistics and scientific process of Kosovo Forensic Agency. This Agency which is considered one of the most advanced agencies and credible in the region.

To study and analyse scientific forensic process, in particular those of Kosovo Agency for Forensics are used historical methods, descriptive methods, content analysis methods, explanatory and statistical methods.

Study results confirm that forensic science has a very important and very significant role in criminal procedure.

Areas: Criminal Law

Key words: Forensic Science, Expertise, Expert, Penal Procedure, Kosovo Agency for Forensic.

## **Dedikimi dhe Falënderimi**

Punimi shkencor i paraqitur në këtë disertacion vjen si rezultat i punës individuale, mirëpo edhe në saje të mbështetjes dhe të respektit të disa personave të rëndësishëm.

Së pari dëshiroj të shpreh falënderimin dhe mirënjohjen time të veçantë për përkrahjen dhe për ndihmën e pakursyer të udhëheqësit tim Prof. Ass. Irakli Koçollari.

Së dyti dëshiroj të falënderoj Universitetin AAB për përkrahjen financiare dhe morale, e posaçërisht rektorin Prof. Dr. Lulëzim Tafa.

Dëshiroj po ashtu të shpreh falënderimin tim të posaçëm për përkrahjen nga personeli i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë: Xhemajl Ademaj, Milazim Tahirukaj, Blerim Krasniqi, Sokol Dedaj, Sadije Hamzaj, Fatmir Ademaj, Arben Gashi, Avni Dragobuzhda dhe Besim Shala.

Dhe në fund, por sigurisht të parët, dëshiroj të falënderoj pafundësisht prindërit e mi, familjen time Donin, Jonin dhe në veçanti gruan time Figrenen.

## **Përmbajtja**

|                                                                    |           |
|--------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Abstrakti .....</b>                                             | <b>II</b> |
| <b>Lista e shkurtimeve dhe e fjalorit .....</b>                    | <b>4</b>  |
| <b>Kapitulli I: Hyrje e përgjithshme .....</b>                     | <b>6</b>  |
| 1.1. Hyrje .....                                                   | 6         |
| 1.2. Hipoteza .....                                                | 8         |
| 1.3. Qëllimi i studimit .....                                      | 9         |
| 1.4. Pyetjet kërkimore .....                                       | 10        |
| <b>Kapitulli II: Hyrje në shkencën e forenzikës .....</b>          | <b>11</b> |
| 2.1. Nocioni i shkencës së forenzikës .....                        | 11        |
| 2.2. Zhvillimi i shkencës së forenzikës .....                      | 12        |
| 2.3. Shërbimet forenzike dhe organizimi .....                      | 13        |
| 2.4. Bashkëpunimi ndërkombëtar në shkencat forenzike.....          | 15        |
| 2.5. Disiplinat e shkencës së forenzikës.....                      | 16        |
| 2.6. Laboratori forenzik .....                                     | 18        |
| <b>Kapitulli III: Forenzika në vendin të ngjarjes .....</b>        | <b>19</b> |
| 3.1.Vendi i ngjarjes .....                                         | 19        |
| 3.2. Ruajtja e vendit të ngjarjes dhe veprimet fillestare .....    | 21        |
| 3.3. Metodat e këqyrjes së vendit të ngjarjes .....                | 23        |
| 3.4. Dokumenti që hartohet për këqyrjen e vendit të ngjarjes ..... | 24        |
| 3.5. Rindërtimi i vendit të ngjarjes dhe eksperimenti .....        | 31        |
| <b>Kapitulli IV: Ekspertiza forenzike .....</b>                    | <b>35</b> |

|                                                                                |            |
|--------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 4.1. Ekspertiza si nocion .....                                                | 35         |
| 4.2. Ekspertiza traseologjike .....                                            | 36         |
| 4.3. Ekspertiza daktiloskopike .....                                           | 46         |
| 4.4. Ekspertiza balistike .....                                                | 62         |
| 4.5. Ekspertiza e dokumenteve .....                                            | 67         |
| 4.6. Ekspertiza e drogave dhe substancave psikotrope .....                     | 77         |
| 4.7. Analiza e AND-së .....                                                    | 88         |
| <b>Kapitulli V: Ekspertiza në procedurë penale: .....</b>                      | <b>94</b>  |
| 5.1. Objekti i ekspertizës .....                                               | 96         |
| 5.2. Caktimi i ekspertit .....                                                 | 97         |
| 5.3. Mendimi dhe konstatimi i ekspertit .....                                  | 99         |
| 5.4. Afati i kryerjes së ekspertizës .....                                     | 102        |
| 5.5. Përfundimi i ekspertit .....                                              | 103        |
| 5.6. Superekspertiza .....                                                     | 104        |
| 5.7. Rastet kur ekspertiza është e detyrueshme .....                           | 105        |
| 5.8. Analizat molekulare e gjenetike, analiza e ADN-së .....                   | 106        |
| <b>Kapitulli VI: Forenzika në Kosovë: .....</b>                                | <b>109</b> |
| 6.1. Aspekte ligjore: themelimi, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi ..... | 110        |
| 6.2. Sistemet informative forenzike .....                                      | 127        |
| 6.3. Standardizimi ndërkombëtar i metodave shkencore .....                     | 134        |
| 6.4. Përformanca gjatë viteve 2012-2014 (analizë krahasimore) .....            | 136        |
| <b>Kapitulli VII: Përmbledhje me konkluzione dhe rekomandime .....</b>         | <b>145</b> |

|                           |            |
|---------------------------|------------|
| 7.1. Përmbledhje .....    | 146        |
| 7.2. Konkluzione.....     | 150        |
| 7.3. Rekomandime.....     | 152        |
| <b>Bibliografia .....</b> | <b>154</b> |



## **Lista e shkurtimeve dhe e fjalorit**

|         |                                                                                                                                   |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| AAFS    | American Academy of Forensic Science: Akademia Amerikane e Shkencës së Forenzikës                                                 |
| ADN     | Acidi Deoksiribunokleik                                                                                                           |
| AFIS    | Automated Fingerprint Identification System: Sistemi për Identifikim Autoamtik të Gishtërinjve                                    |
| AFSN    | Asian Forensic Sciences Network: Rrjeti Aziatik i Shkencës së Forenzikës                                                          |
| AICEF   | Latin American Academy of Criminalistics and Forensic Studies: Akademia Latino-Amerikane për Kriminalistikë dhe studime Forenzike |
| AKF     | Agjencia e Kosovës për Forenzikë                                                                                                  |
| ASCLD   | American Society of Crime Lab Directors: Shoqata Amerikane e Drejtorëve të Laboratorëve të Krimit.                                |
| ATFE    | Bureau of Alcohol, Tobacco, Firearms and Explosives: Byroja për Alkool, Duhan, Armë Zjarri dhe Eksploziv                          |
| AUTOCAD | Auto computer-aided design: Dizajni automatik kompjuterik                                                                         |
| BAFS    | British Academy of Forensic Sciences: Akademia Britaneze e Shkencave të Forenzikës                                                |
| CODIS   | Combined DNA Index System: Sistemi për indeksim të kombinuar të ADN-së                                                            |
| CSFS    | Canadian Society of Forensic Science: Shoqata Kanadeze e Shkencës së Forenzikës                                                   |
| DEA     | Drug Enforcement Administration: Administrimi i zbatimit të barnave (drogës)                                                      |
| DFO     | 1,8-Diazafluoren-9-one: 1.8-Diazo flur-9-një                                                                                      |
| EAFS    | European Academy of Forensic Science: Akademia Evropiane e Shkencës së Forenzikës                                                 |
| ENFSI   | European Network of Forensic Science Institutes: Rrjeti Evropian i Instituteve të Shkencës së Forenzikës                          |
| ESDA    | Electrostatic Detection Apparatus: Aparatura për detektim elektrostatik                                                           |
| FBI     | Federal Byro of Investigation: Byroja Federale për Hetime                                                                         |
| GCMS    | Gas chromatography–mass spectrometry: Kromatografia e gaztë me spektrometër të masës                                              |
| GCR     | Gunshot residue: Mbetje baruti nga arma                                                                                           |

|           |                                                                                                                                                            |
|-----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| IAFI      | International Association of Forensic Institutes: Asociacioni Ndërkombëtar i Instituteve të Forenzikës                                                     |
| IAI       | International Association for Identification: Asociacionin Ndërkombëtar për Identifikim                                                                    |
| IBIS      | Integrated Ballistic Identification System: Sistemi i Integruar për Identifikim Balistik                                                                   |
| ICITAP    | International Criminal Investigative Training Assistance: Programi për asistencë në trajnime për hetime kriminale                                          |
| ISO 17025 | International Organization for Standardization 17025: Organizata Ndërkombëtare për Standardizim 17025                                                      |
| LIMS      | Laboratory information management system: Sistemi për menaxhimin e informacioneve laboratorike                                                             |
| LSMS      | Liquid chromatography–mass spectrometry: Kromatografia e lëngët me spektrometër të masës.                                                                  |
| Mollazhim | Procesi i ndërtimit të gjurmës me guri dental apo silikon                                                                                                  |
| PCR       | The polymerase chain reaction: Reaksioni zingjiror i polimerëve                                                                                            |
| SEM       | Scanning electronic Microscope: Mikroskopi elektronik skanues                                                                                              |
| SMANZFL   | Senior Managers of Australian and New Zealand Forensic Laboratories: Udhëheqësit e lartë të Laboratorëve të Forenzikës të Australisë dhe të Zelandës së Re |
| THC       | Tetrahydrocannabinol: Tetrahidrokanabinoli                                                                                                                 |
| TLC       | Thin Layer Chromatography: Kromatografia në shtresë të hollë                                                                                               |
| UNMIK     | United Nation Mission in Kosovo: Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë                                                                                  |
| VSC 6000  | Video Spectral Comparator 6000: Komperatori video spektral 6000                                                                                            |
| WHO       | World Health Organisation: Organizata Botërore e Shëndetit                                                                                                 |

## **Kapitulli I: Hyrje e përgjithshme**

### **1.1. Hyrje**

Në një shoqëri që beson në parimet e demokracisë dhe në sundimin e ligjit, parim themelor është që çdo person i dyshuar dhe që akuzohet për një vepër penale të konsiderohet i pafajshëm përderisa të vërtetohet fajësia e tij, bazuar në prova materiale apo shkencore. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë dhe i shkencës ka bërë të mundur integrimin e metodave shkencore në hetimin, në zbulimin dhe në parandalimin e veprave penale, si mbështetje me rëndësi vendimtare, duke i ofruar gjyqësorit konkluzione të bazuara në të dhëna shkencore. Provat e mbledhura, ekspertizat dhe konkluzionet e nxjerra shkencore nga ekspertët e forenzikës dhe interpretimi i tyre objektiv ka përparësinë e të qenit më të pranueshme për gjykatat në procedurë penale. Teknikat e shkencës së forenzikës janë përgjithësisht të pranueshme edhe nga perspektiva e të drejtave të njeriut, duke qenë relativisht joinvazive në krahasim me metodat e mëparshme. Sigurisht, është e rëndësishme që ekspertizat forenzike të kenë kredibilitetin e duhur, dhe kjo është e mundur vetëm me një standardizim, me një sistem cilësor, me një personel profesional të kualifikuar, objektiv, të paanshëm dhe me qasje në metoda e pajisje moderne laboratorike.

Prokurori i Përgjithshëm i Kalifornisë, Bill Lockyer, laboratorin e forenzikës e konsideron tepër të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë. Ai thotë se: “Laboratorët e forenzikës janë vendimtarë për sistemin tonë të drejtësisë. Shkencëtarët forenzikë në laboratorët kriminalistikë të Kalifornisë ofrojnë informacione të rëndësishme për hetimin dhe procedimin e krimit përmes ekspertizës shkencore të provës fizike. Ofertat e tyre, kryer me standardet më të larta të objektivitetit, të integritetit dhe të kualitetit shkencor i japin zë “dëshmitarit të heshtur”, provës fizike dhe kontribuojnë në kauzën e drejtësisë”. (Lockyer, 2003).

Shkenca e forenzikës, në kuptimin penal, sot po zë vend të rëndësishëm në zbardhjen e veprave penale, sidomos atyre që konsiderohen vepra të rënda penale, në identifikimin e kryerësit të veprës penale, në identifikimin e materialit të dyshimtë etj. Kjo shkencë ka rëndësi dhe zë vend të veçantë edhe në çështje civile, siç është grafologjia (nënshkrimet dhe dorëshkrimet) apo përcaktimi i atësisë përmes analizës së ADN-së. Gaenssen, Harris dhe Lee, në librin e tyre, ndër vlerat kryesore të shkencës së forenzikës theksojnë: “Mbështetjen apo disprovimin e deklaratës së dëshmitarit, të viktimës apo të dyshimit; në identifikimin e substancës apo të materialit; në

identifikimin e personit, në ofrimin e informacioneve hetimore; në vendosjen e lidhjeve apo të përjashtimeve”. Gaensslen, Harris dhe Lee (2008: 8-10).

Më 1949, Charles O’Hara dhe James Osterburg, autorë të shquar të kriminalistikës, shkruan: “Pozitat aktuale të kriminalistikës midis shkencave të tjera mund të krahasohen me ato të kimisë në shekullin e nëntëmbëdhjetë”. (Seferstein, 2007: 574).

Shërbimet forenzike sot janë një ndër përfituesit kryesorë të zhvillimeve teknologjike shkencore. Metodatat analitike kromatografike dhe spektrometrike tanimë kanë ndikim të jashtëzakonshëm në metodologjinë shkencore forenzike. Profilizimi i ADN-së për një kohë shumë të shkurtër ka filluar të aplikohet gjerësisht nga laboratorët forenzike. Spektrometria e masës po ashtu është duke shënuar një evolucion në zbatimin e saj në shkencat forenzike. Mikroskopi elektronik me skaner po gjen zbatim të gjerë në identifikime dhe analiza forenzike.

Sot vendet e zhvilluara evropiane, SHBA etj. po investojnë shuma të konsiderueshme parash për shërbimet forenzike dhe në shkencën e forenzikës. Po cila është arsyeja që shtynë këto vende të zhvilluara të investojnë shuma kaq të mëdha mjeteve për shërbimet forenzike dhe për vetë shkencën e forenzikës. Përgjigjen e kësaj pyetje mund ta gjejmë në të drejtën e avancuar penale, e cila rëndësi të veçantë i kushton “provimit të fajësisë përmes provës materiale”. Në këtë rrafsh shkenca e forenzikës përmes metodave bashkëkohore shkencore jep përgjigje në pyetjet e parashtruara në procedurë siç janë identifikimi i personit përmes ADN-së apo gjurmës së gishtit, identifikimi i mjeteve të përdorura për kryerjen e veprës penale, identifikimi i substancave narkotike, ekzaminimi i dokumenteve dhe i dorëshkrimeve, përcaktimi i materies toksike. etj. Andaj përkrahja financiare për shërbimet forenzike është esenciale.

Trajnimi i vazhdueshëm i personelit duke filluar nga këqyrja e vendit të ngjarjes e deri te ekspertët e ADN -së nga njohës dhe autorë të shumtë po konsiderohet i domosdoshëm. Këqyrja profesionale e vendit të ngjarjes është esenciale për një ekspertizë forenzike cilësore të provës fizike.

Akreditimi i laboratorëve forenzikë është kërkesë imediate e palës që urdhëron ekspertizën. Gjyqësori, prokurori, mbrojtësi, i padituri dhe paditësi në vendet e zhvilluara perëndimore preferojnë që lëndët e tyre për ekspertizë t’i dërgojnë në laboratorët e akredituar me standarde ndërkombëtare.

Forenzika e fillon procesin e saj të punës si instrumenti i parë që në veprimet e para procedurale në rastet e një vepre penale. Atë fillimisht e hasim në ekzaminimin e vendit të ngjarjes ku përmes metodave shkencore kryhet këqyrja e vendit të ngjarjes si dokumentimi, fotografimi, skicimi dhe regjistrimi i gjurmëve dhe të dhënave të tjera si pjesë e vendit të ngjarjes e më pastaj ekspertiza e gjurmëve apo e provave materiale në laboratorin forenzik. Lidhur me këtë temë do të flasim më gjerësisht në kapitullin e dytë, të tretë dhe të katërt, ku do të trajtojmë këqyrjen e vendit të ngjarjes, provën materiale dhe disa lloje të ekspertizës forenzike.

Laboratorët forenzikë në nivel shtetëror operojnë me rreth njëqind punëtorë me buxhet vjetor prej disa miliona eurosh. Investimet e tilla janë tregues për rëndësinë dhe rolin që kanë laboratorët e forenzikës.

## **1.2. Hipoteza**

E drejta e procedurës penale ka për detyrë vërtetimin e drejtë të fakteve dhe të rrethanave nëpërmjet të cilave vërtetohet gjendja faktike në bazë të së cilës aplikohet e drejta materiale nga ana e gjykatës dhe shqiptohet sanksioni penal. Në vërtetimin e fakteve juridike dhe të rrethanave të tjera të cilat kontribuojnë në konstatimin e gjendjes faktike, marrin pjesë disa subjekte të parapara në të drejtën e procedurës penale. Natyrisht gjykata është subjekt kryesor, e cila ka për detyrë që në bazë të njohurive të saja juridike, profesionale ta konstatoj gjendjen e fakteve. Por, jo vetëm gjykata, por edhe subjekti kompetent i cili është i detyruar ta udhëheqë dhe ta zbatojë hetimin për ndonjë vepër penale dhe kryesinë e saj. Kështu, gjykata apo subjekti i cili i zbaton hetimet nuk posedojnë njohuri të mjaftueshme profesionale të cilat janë te nevojshme për të dhënë përgjigje në shumë pyetje, të cilat imponohen përgjatë procedurës penale, andaj shtrohet nevoja për ekspertë të natyrave të ndryshme shkencore. Mendimi dhe konstatimi i ekspertëve në procedurën penale vlerësohet si provë në marrëdhënie me provat e tjera verbale dhe materiale. Mirëpo, shumë praktikientë dhe teoricientë të së drejtës procedurale konsiderojnë se gjyqtari duhet të posedojë njohuri themelore, në mënyrë që të vlerësojë se a është i nevojshëm angazhimi i ekspertit dhe a mund ta udhëzojë atë për të dhënë përgjigje për gjetjen e së vërtetës në procedurën penale.

Në kuadër të këtij studimi doktoral, temat kyçe të cilat janë analizuar dhe studiuar janë:

- Qasja ndërkombëtare mbi shkencën e forenzikës, llojet e ekspertizës forenzike dhe roli i sajë në procedurë penale.
- Ekspertizat forenzike dhe llojet e tyre.
- Procedura penale e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, dispozitat për ekspertizë.
- Autoriteti ligjorë për administrimin e të dhënave të ADN-së në Kosovë. Procedura penale e Kosovës, përcakton ministrisë së drejtësisë për mbajtjen e regjistrit (bazën e të dhënave) të profilit të ADN-së, përderisa ministria e punëve të brendshme-agjencia e Kosovës për forenzikë ka në funksion këtë regjistër të ADN-së (baza e të dhënave CODIS), donacion i FBI-së.
- Funksionimi dhe organizmi i agjencisë së Kosovës për forenzikë.

### **1.3. Qëllimi i studimit**

Ky studim doktoral bazohet në “qasjen moderne të autorëve të njohur ndërkombëtarë mbi rolin dhe rëndësinë e shkencës së forenzikës në procedurë penale”. Këta autorë rolin e shkencës së forenzikës në procedure penale e përkufizojnë si: “mbështetje apo disprovim i deklaratës së dëshmitarit, viktimës apo të dyshimit; mbështetje në identifikimin e substancës apo të materialit; mbështetje në identifikimin e personit, mbështetje në ofrimin e informacioneve hetimore; mbështetje në vendosjen e lidhjeve apo të përjashtimeve etj.”

Ky studim doktoral ka për synim këto objektiva kryesore:

1. Zgjerimin e njohurive mbi procedurën shkencore për ekspertizë forenzike.
2. Ofrimin e informacionit për gjyqësorin, prokurorin, hetuesin, kriminalistin, etj. për ekspertizën forenzike, metodat shkencore forenzike, rolin dhe rëndësinë e sajë në procedurë penale.
3. Studimin dhe krahasimin e dispozitave ligjore për ekspertim në procedurë penale (objekt krahasimi: procedura penale e Shqipërisë, e Kosovës dhe e Maqedonisë).
4. Studimin dhe analizën e dispozitave ligjore mbi kushtet dhe procedurat e regjistrit të ADN-së në Republikën e Kosovës.
5. Studimin dhe dhe analizën e legjislacionit dhe procedurave shkencore forenzike në Kosovë.

Në këtë studim theks të veçantë do t'i kushtohet historikut, legjislacionit dhe veprimtarisë së agjencisë së Kosovës për forenzikë.

Temat kyçe që do të shtjellohen në këtë punim janë: hyrje në shkencën e forenzikës, forenzika në vendin e ngjarjes, ekspertiza forenzike në procedurë penale, forenzika në Kosovë: aspekte ligjore. Në fund do të bëhet një përmbledhje e studimit me konkluzione dhe rekomandime.

#### **1.4. Pyetjet kërkimore**

Ky studim doktoral, bazuar në të dhëna primare dhe sekondare do të studiojë, analizojë dhe krahasojë rëndësinë dhe rolin e shkencës së forenzikës në procedurë penale.

Mbi këtë koncept, janë ngritur pyetjet kërkimore si në vijim:

1. Cili është roli i shkencës së forenzikës në procedurë penale?
2. Cilat janë metodat e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe cilat janë metodat e ekspertimit të provës materiale?
3. Si rregullohet ekspertiza në procedure penale të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë?
4. Kur kërkohet super ekspertiza dhe a e zgjidh çështjen super ekspertiza?
5. Kush urdhëron ekspertizën forenzike në procedurë penale?
6. Kush është autoriteti ligjorë për mbajtjen e të dhënave të ADN-së në Kosovë?
7. Cilat janë trendët zhvillimit dhe legjislacioni i forenzikës në Kosovë?
8. Si është rregulluar organizimi dhe funksionimi i agjencisë së Kosovës për forenzikë?
9. Kush është standardi ndërkombëtarë për ekspertime forenzike?

Punimi doktoral do të jetë i fokusuar në temat kyçe si në vijim: hyrje në shkencën e forenzikës, forenzika në vendin e ngjarjes, ekspertiza forenzike dhe llojet e sajë, ekspertiza në procedure penale, forenzika në Kosovë. Në fund do të bëhet një përmbledhje e studimit me konkluzione dhe rekomandime.

## Kapitulli II: Hyrje në shkencën e forenzikës

### 2.1. Nacioni i shkencës së forenzikës

Me shkencë të forenzikës kuptojmë aplikimin e shkencave të ndryshme në shërbim të zbatimit të ligjit. Shkenca e forenzikës me aplikimin e këtyre shkencave (shkencat natyrore, shkencat mjekësore apo shkencat inxhinierike) ofron një sqarim, një interpretim dhe një qartësim të detajuar të çështjeve, të cilat për gjyqësorin mund të jenë të panjohura apo pak të njohura. Metodat shkencore forenzike ofrojnë një spektër të gjerë mundësish për dhënien e përgjigjeve në pyetjet që mund të parashtrihen nga zbatuesit e ligjit, nga ndjekësit penal, nga mbrojtësit penal si dhe nga ndarësit e drejtësisë. Gaensslen, Harris dhe Lee në librin e tyre shkencën e forenzikës e përkufizojnë si “Shkencë që aplikohet për probleme ligjore ndërsa forenzikën si art i debateve dhe i diskurseve argumentuese”. (Gaensslen, Harris, Lee, 2008: 7). Bell në librin e saj “Shkencën e forenzikës, në kuptimin e saj më të thjeshtë dhe më të vjetër, e përkufizon si debat publik” (Bell, 2004). Në këtë kontekst ky term ende përdoret për përshkrimin e klubeve të debateve në shkolla të larta dhe në universitete”. Sidoqoftë, përdorimi më i shpeshtë modern i termit ndërlidhet me sistemet ligjore, si shqyrtim formal publik në gjykatë. Shkenca e forenzikës kryesisht mund të konsiderohet si aplikim i shkencës për çështje ligjore. Ngjashëm edhe Saferrstein shkencën e forenzikës e përkufizon si “Shkenca e forenzikës, në kuptimin e gjerë, është aplikimi i shkencës për çështje ligjore” (Saferrstein, 2014: 4). Ndërsa ligji për agjencinë e Kosovës për forenzikë, shkencën e forenzikës e përkufizon si “Aplikimi i shkencave (kimi, biologji, fizikë, mjekësi, matematikë, inxhinieri etj.) për gjetjen, për identifikimin, për individualizimin, për analizimin dhe për vlerësimin e dëshmive fizike (provave materiale) për çështje ligjore penale dhe civile”. (Ligji për agjencinë e Kosovës për forenzikë nr.04/L-064, 2011: 3).

Disa autorë mendojnë se forenzika nuk duhet të konsiderohet shkencë, sepse ajo përdor metodat dhe teknikat e shkencave të tjera, siç janë: kimia, fizika, biologjia, mjekësia, matematika etj. Është i pamohueshëm argumenti se shkenca e forenzikës aplikon metoda shkencore të shkencave të tjera, siç i theksuam më lartë, por se është po ashtu i pamohueshëm argumenti se në kohët e fundit po zhvillohet një metodologji dhe një teknologji e veçantë vetëm për qëllime forenzike si: SEM, AFIS, IBIS, , VSC 6000, PCR-ADN etj. Ky argument demanton mendimin e autorëve që mendojnë se forenzika nuk duhet të njihet si shkencë në vetë.



Pra forenzika është: “Shkencë e cila merret me studimin dhe aplikimin e metodologjive, të ligjësisë, të teknikave dhe të mjeteve që kanë në përdorim shkencat e tjera për interesa të zbulimit, të vlerësimit apo të dokumentimit të provave, të cilat duhet t’i ofrohen drejtësisë për të provuar ose për të përjashtuar përgjegjësitë ligjore të individëve që dyshohen ose pandehen se janë autorë veprash penale apo kundërvajtjesh të ndryshme”.

Në kohë të fundit një nga disiplinat e shkencës së forenzikës e cila po zë vend të rëndësishëm në zbardhjen e veprave penale, në identifikimin e kryerësve të veprave penale, në përcaktimin e fajësisë, në përcaktimin e atësisë etj. është ADN-ja për të cilën do të flasim më vonë në kapitullin e katërt.

## **2.2. Zhvillimi i shkencës së forenzikës**

Lindja dhe zhvillimi i shkencës së forenzikës lidhet me kushtëzimet dhe nevojat e dala nga kohërat në të cilat kanë kaluar shoqëritë e ndryshme. Këto nevoja e forcuan aplikimin e metodave klasike të ndryshme në përpunimin dhe në identifikimin e gjurmëve të mbetura nga kriminelët gjatë kryerjes së veprave penale. Më pas ato filluan të zhvillohen dhe të marrin karakter shkencor.

Lindja dhe zhvillimi i shkencës së forenzikës, deri më tani e njohur si shkenca e kriminalistikës, është kushtëzuar nga kërkesat e kohës për luftimin e kriminalitetit me metoda dhe me teknikë shkencore. Në kohërat e lashta janë aplikuar metoda të ndryshme me qëllim të identifikimit të personave, të zbardhjes së veprave penale dhe të vërtetimit të fajësisë apo të pafajësisë. “Sot besohet shumë se Sir Artur Conan Doyle kishte një ndikim të konsiderueshëm në popullarizimin e metodave shkencore të zbulimit të krimit nëpërmjet personazhit të tijë imagjinar Shorlock Holmes.” (Saferstein 2014: 5).

Bazuar në termin "Eureka" vlerësohet se historia e konsideron Arkimedin (287-212 pes), njeriu që qëndron pas thirrjes "Eureka", si baba të shkencës së kriminalistikës. Ai ishte ngazëllyer kur kishte gjetur se një kurore nuk është bërë prej ari, siç është pretenduar në mënyrë të gabuar nga dendësia e saj dhe dukshmëria. Pas Arkimedit kemi aplikim tjetër të hershëm të shkencës së kriminalistikës nga Soleiman, një tregtar arab i shekullit të 7-të. Ai përdori shenjat e gishtërinjve si një dëshmi të vlefshmërisë në mes të debitorëve dhe huadhënësve.

Në vitet 700, një kinez gjithashtu përdori konceptin e gjurmës së gishtit. Në Vitet 1000, Quintilian, një prokuror në gjykatat romane përdori një metodë të ngjashme për të zgjidhur

autorësinë e vrasjeve. Dokumenti i parë që përmend përdorimin e kriminalistikës në çështjet ligjore është libri XI Yuan Lu Ji, përkthyer si "Rastet e mbledhura të padrejtësisë korrigjohen", shkruar në vitin 1248 nga autori kinez Ci Song.. Ndër metodat dhe teknikat më të vjetra që janë aplikuar në identifikime kriminalistike është ekspertiza e dokumenteve në kohën e Karlit të Madh, në Francë në vitet 1300.

Në shekullin e 18, shumë studiues kryen punë të rëndësishme në shkencën e kriminalistikës. Kimisti suedez Carl Wilhelm Scheele dhe kimisti gjerman Valentin Ross udhëhoqën në këtë drejtim. Anglia, gjithashtu, zbardhi një numër të rasteve të vrasjeve me përdorimin e shkencës së kriminalistikës, p.sh në vitin 1784 në Lancaster, John Toms u dënua për vrasje, kur një copë e shqyer e një gazete e gjetur në një armë përputhej me mbeturinat e letrës në xhepin e tij.

Në shekullin e 20-të hovi i shkencës së kriminalistikës nuk kishte të ndalur. Ishte koha kur u themelua Byroja Federale e Hetimeve (FBI). FBI vuri në përdorim dhe e publikoi sistemin e saj automatik për identifikimin e gjurmëve të gishtërinjve (AFIS), me skanerin e parë të kompjuterizuar. Me ardhjen e kompjuterit, nuk kishte kthim mbrapa. Sot nuk ka zbardhje të krimit pa zbatimin e shkencës së forenzikës. Kudo që ndodh krimi, shkenca e forenzikës është aty.

Në fillim të shekullit 19, shkencat natyrore filluan të zhvillohen me shpejtësi. Drejtësia ishte gjithmonë në kërkim të provave të paanshme. Në të njëjtën kohë, Sir Arthur Conan Doyle, me anë të personazhit të tij imagjinar Sherlock Holmes, i popullarizoi metodat shkencore në zbulimin e krimit.

Gjatë luftës së parë Botërore, periudha I-rë, Locard korri sukses në aplikimin e metodave shkencore në hetimet penale, gjë që shërbeu si një nismë për formimin e laboratorëve të policisë në Berlin, në Vjenë, në Suedi, në Finlandë dhe në Holandë. Kjo u pasua nga formimi i një laboratorit të forenzikës në Los Anxhelos, në Departamentin e Policisë në SHBA në vitin 1923. Në vitin 1932 FBI e ndërtoj një laborator kombëtar, i cili ofroi shërbime të forenzikës për të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit në Shtetet e Bashkuara.

### **2.3. Shërbimet forenzike dhe organizimi**

Në shumicën e shteteve evropiane shërbimet forenzike ofrohen nga laboratorët forenzikë në kuadër të forcave policore, të ministrisë së punëve të brendshme apo të ministrisë së drejtësisë. Në parim nuk ekziston ndonjë rregull se kush duhet të administrojë shërbimet forenzike.

Shumica e vendeve evropiane si Gjermania, Franca, Spanja, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia, Shqipëria, Danimarka, Finlanda, Norvegjia, Suedia, Zvicra, Polonia, Portugalia, Lituania, Bullgaria, Sllovakia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia shërbimet forenzike administrohen në kuadër të forcave policore. Ndërsa vendet evropiane si Holanda, Rumania, Armenia, Belgjika shërbimet forenzike administrohen në kuadër të ministrisë së drejtësisë. Në vendin tonë ekspertizat forenzike administrohen në kuadër të agjencisë së Kosovës për forenzikë. Agjenci kjo e themeluar me ligj të veçantë. Për më shumë lidhur me organizimin, veprimtarinë dhe funksionimin e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë do të flasim në kapitullin e gjashtë.

“Në SHBA operojnë mbi 300 laboratorë qeveritarë. Ato menaxhohen nga agjencitë federale si FBI, ATFE, Shërbimi sekret, DEA etj (Gaensslen, Harris, Lee, 2008: 15)”. Ndër laboratorët më të avancuar në SHBA konsiderohet Laboratori i FBI-së. Ky laborator është i strukturuar si divizion në kuadër të Agjencisë Federale FBI, i cili mbulon një spektër të gjerë të shërbimeve forenzike, kryen më shumë se 1 milion ekzaminime në vit (Saferstein 2014: 9). Ndërsa një vend i vogël si Mbretëria e Bashkuar ka themeluar 11 laboratorë rajonalë në pjesë të ndryshme. Një zhvillim tjetër ishte krijimi i qendrës kërkimore në Aldermaston në vitin 1966. Japonia në Tokio ka një institut të madh kombëtar për kërkime shkencore forenzike dhe disa laboratorë rajonalë. Gjermania Perëndimore ka ngritur mbi 21 laboratorë forenzikë, Italia 13, Franca 4, dhe Zvicra 4. Në Kanada, shërbimet forenzike kryhen nga tre institucione të krijuara nga qeveria: gjashtë laboratorë mbretërorë të Policisë Kanadeze të Kalorësisë (policia mbretërore kanadeze me kuaj), Qendra e shkencës së forenzikës në Toronto dhe Instituti i Shkencës së Mjekësisë dhe i Policisë Ligjore në Montreal. Të gjitha bashkë, më shumë se njëqind vende të botës kanë të paktën pajisje laboratorike që ofrojnë shërbime në fushën e shkencës së forenzikës (Saferstein 2014: 13).

Në Shqipëri shërbimi forenzik kryesisht kryhet nga policia shkencore në nivel qendror të Policisë së Shtetit, e organizuar në nivel instituti, me disiplinat shkencore të daktiloskopisë, balistikës, grafologjisë, ADN-së, narkotikëve, ekzaminimit të kompjuterëve dhe të formim-administrimit të provave. Instituti i policisë shkencore i Shqipërisë nuk ka arritur standardin ndërkombëtarë ISO 17025. (vizitë zyrtare e delegacionit nga institucionet e Kosovës në Institutin e policisë Shkencore të Shqipërisë, datë 30.03.2015).

Në shumicën e vendeve evropiane dhe në SHBA, laboratorët forenzikë mbulojnë shumicën e ekspertizave si këqyrjen e vendngjarjes, ekspertizat kriminalistike (grafologji, daktiloskopi, balistikë, gjurmë këpucësh, gjurmë veglash e gomash, ekzaminim-restaurim i numrit identifikues

të automjetit), ekspertiza kimiko-biologjike (analiza të ADN-së, analiza të substancave narkotike, analiza të eksplozivit, analiza të mbetjeve të barutit), ekspertiza të teknologjisë informative (ekzaminim i kompjuterit, ekzaminim i zërit dhe i xhirimeve, ekzaminim i fotografisë). Ndërsa pjesa e tjetër e ekspertizave kryhen nga njësitë mjeko-ligjore si: ekzaminime të trupit dhe të lëndimeve, autopsi, toksikologji, odontologji, antropologji, toksikologji, psikiatri forenzike etj.

Kryesisht ekspertizat forenzike ofrohen nga institutet shkencore apo njësitë organizative në kuadër të policisë shtetërore të shtrira me sektorë në rajone apo qarqe policore. Një institut i shkencës së forenzikës, zakonisht ka këtë skemë organizative: Sektori i balistikës; Sektori i gjurmëve të gishtërinjve; Sektori i dokumenteve; Sektori i ADN-s; Sektori i drogave; Sektori i toksikologjisë; Sektori i forenzikës së teknologjisë informative; Sektori i fotografisë, i zërit dhe i xhirimeve.

#### **2.4. Bashkëpunimi ndërkombëtar në shkencat forenzike**

Rol të rëndësishëm në zhvillimin e shkencës së forenzikës, sidomos të procedurave shkencore, të teknologjisë shkencore, të kualifikimit dhe të rikualifikimit të shkencëtareve forenzikë, pa dyshim luan bashkëpunimi dhe komunikimi ndërkombëtar. Janë të njohura një numër organizmash ndërkombëtarë që mundësojnë një komunikim shkencor dhe praktik si: ENFSI, AAFS, EAFS, AICEF, ASCLD, AAFS, IAFI, SMANZFL, AFSN, BAFS, CSFS, IAFS. Një ndër organizmat më të avancuar konsiderohet ENFSI-i, andaj në vazhdim do të paraqesim strukturën, organizimin, funksionin dhe përgjegjësitë e këtij rrejtë evropian të shkencës së forenzikës. ENFSI aktualisht ka të anëtarësuar 64 laboratorë nga vende të ndryshme të Evropës. Në kuadër të ENFSI funksionojnë 16 grupe punuese shkencore: Imazhi digjital, ADN, dokumentet, narkotikët, eksplozivët, fibrat, gjurmët e gishtërinjve, armët e zjarrit, hetimi i zjarre vënieve dhe e eksplozivëve, forenzika e teknologjisë informative, forenzika e zërit dhe e audiove, dorëshkrimet, gjurmët, ngjyra dhe xhami, analizat e aksidenteve në trafik, vendi i ngjarjes. ENFSI fillet e para të themelimit i ka në vitin 1992. Në atë kohë udhëheqësit e laboratorëve qeveritarë të vendeve të Evropës përëndimore u pajtuan të mbajnë takime të rregullta për diskutim të temave me interes të përbashkët. Kushtetuta e parë e ENFSI-it u miratua në vitin 2004. Që nga viti 2004 e deri në vitin 2012 Instituti i Forenzikës së Holandës, vullnetarisht ishte nikoqir i Sekretariatit të ENFSI-it. Nga viti 2013 Sekretariati i ENFSI-it kaloi

nën administrimin e Polonisë. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti evropian është shkëmbimi i njohurive, shkëmbimi i përvojave dhe arritja e marrëveshjeve të përbashkëta në fushën e shkencës së forenzikës.

ENFSI në kuadër të organizimit të tij ka këto disiplina shkencore:

Gjurmët e dheut, të kafshëve dhe të bimëve, imazhi digjital, hetimi i zjarrit dhe i eksplozivëve, ADN, dokumentet, forenzika e teknologjisë informative, analiza forenzike e zërit dhe e audiove, narkotikët, dorëshkrimet, eksplozivët, gjurmët, fibrat, ngjyra dhe xhami, gjurmët e gishtërinjve, analiza e aksidenteve në rrugë, armët e zjarrit dhe vendi i ngjarjes, tekstili dhe flokët. (www.enfsi.eu/, parë më 24 qershor 2015).

Një prezantim më i detajuar i disa disiplinave të shkencës së forenzikës, kryesisht atyre kriminalistike, është bërë në kapitullin e pestë të këtij studimi.

## **2.5. Disiplinat e shkencës së forenzikës**

“Shkenca e forenzikës përbëhet nga një spektër i gjerë i shkencave të ndryshme. Të gjitha apo shumica prej tyre gjejnë zbatim në sistemin penal apo civil.” (Gaensslen, Harris, Lee, 2008: 19). Sot termi forenzikë përdoret nga shumë disiplina të ndryshme shkencore.

Në vijim do të paraqesim disa nga llojet e disiplinave të shkencës së Forenzikës:

Antropologjia forenzike është shkencë e cila merret me studimin e skeletit njerëzor. Antropologu është një shkencëtar i specializuar për ekzaminimin e mbetjeve skeletore. Antropologjia merret me studimin dhe përcaktimin e identitetit apo të origjinës së njeriut sipas mbetjeve skeletore.

Balistika forenzike merret me studimin e mekanizimit të armës së zjarrit, si mjet i mundshëm ose jo i kryerjes së veprës penale, të lëvizjes së predhës përbrenda armës së zjarrit dhe jashtë saj, të trajektores së fluturimit të predhës, të përcaktimit (të identifikimit) dhe të klasifikimit të llojit, të modelit dhe të origjinës së armës dhe të gëzhgjës/ predhës, të përcaktimit të distancës së qitjes. Balistika merret edhe me përcaktimin e prezencës së barutit-GSR në dorën apo në teshat e dorasit apo të viktimës.

Biologjia forenzike merret me studimin dhe analizën e dëshmimeve, siç janë gjaku, sperma, pështyma, fijet e flokut, eshtrat, djersa, etj. me qëllim të përcaktimit të origjinës së dëshmisë, të identifikimit të personave apo të kufomave të paidentifikuara. Serologjia forenzike kryesisht merret me përcaktimin nëse gjaku është i njeriut apo jo. Në kuadër të biologjisë forenzike hyn edhe analiza e ADN-së.

Patologjia forenzike merret me përcaktimin e shkakut dhe të mënyrës së vdekjes. Eksperti i patologjisë forenzike është një doktor i mjekësisë i specializuar në patologji.

Daktiloscopia merret me studimin dhe analizën e gjurmëve të gishtërinjve me qëllim të identifikimit të personave përmes gjurmës së vijave papilare dhe identifikimin e personave të paidentifikuar, siç janë kufomat. Daktiloscopia aplikon metoda të ndryshme kimike për nxitjen/zhvillimin e gjurmëve të padukshme në vendin e ngjarjes apo në laborator.

Entomologjia forenzike është degë e biologjisë e cila merret me studimin e insekteve. Entomologjia forenzike merret me përcaktimin e kohës së vdekjes në bazë të insekteve. Siç dihet pas vdekjes, trupi i njeriut fillon të atakohet nga insekte dhe bakterie të ndryshme. Secili lloj i insektit ka jetëgjatësinë e vetë, në këtë kuptim eksperti i entomologjisë mund të përcaktojë përafërsisht kohën e vdekjes.

Odontologjia forenzike merret me përcaktimin e mbetjeve njerëzore dentale përmes rrezeve x dhe krahasimin/përcaktimin përmes dhëmbëve dhe/apo kafshimeve. Secili njeri ka strukturë të veçantë të dhëmbëve, në këtë kuptim eksperti i odontologjisë forenzike përmes ekzaminimit të formës dhe të strukturës së dhëmbëve mund të përcaktojë prejardhjen e tyre.

Psikiatria dhe psikologjia forenzike merren me përcaktimin e kapacitetit mendor (mental) për identifikimin e përgjegjësisë, të aftësisë për të marrë vendime, për të gjykuar apo me përcaktimin e profilit psikologjik të individit mbi fajësi apo pafajësi. Psikiatri forenzik dhe psikologu forenzik kryejnë punë të njëjta.

Toksikologjia forenzike merret me përcaktimin e materies toksike (helm, drogë, alkool), të llojit, të përbërjes, të sasisë dhe të ndikimit të saj në organizmin e njeriut, si mjete të mundshme për kryerjen e veprës penale.

Traseologjia forenzike merret me studimin e objekteve apo të mjeteve në bazë të gjurmëve të mbetura të këmbëve, të gomave, të mjeteve (vegla për thyerje) etj. përmes krahasimit fizik për identifikimin e objektit si mjet i mundshëm për kryerjen e veprës penale.

Inxhinieria forenzike merret me përcaktimin e shkakut, të mënyrës dhe të pasojave të incidenteve mekanike apo elektrike, të avarive të ndryshme, të incidenteve të ndryshme, apo të aksidenteve në komunikacion.

Forenzika e zërit/audiove dhe videove merret me përcaktimin e origjinës së zërit/audiove dhe videove. Kjo disiplinë merret edhe me ekzaminimin e imazhit digjital.

Forenzike e kompjuterëve merret me ekzaminimin dhe me analizimin e të dhënave kompjuterike, me ekzaminimin e rrjetit kompjuterik dhe të internetit dhe me ekzaminimin e pajisjeve elektronike.

Forenzika e dokumenteve dhe e dorëshkrimeve merret me përcaktimin e origjinës dhe të origjinalitetit të dokumentit apo të dorëshkrimit përmes metodave krahasuese, duke aplikuar teknologji të avancuar, si: VSC, spektrometër Raman, ESDA etj.

## **2.6. Laboratori forenzik**

Provati, dëshmitë dhe materialet e tjera të gjetura në vendin e ngjarjes procedohen në laboratorin e forenzikës për ekspertizë. Laboratori forenzik mund të përkufizohet si një qendër e specializuar ku kryhen ekspertiza, testime, analiza, krahasime të provave fizike apo kërkime shkencore për të ndihmuar në zbardhjen e ndonjë çështjeje penale apo civile. Ai është një format i organizuar ku kryhen ekspertiza forenzike bazuar në metoda dhe në teknika të njohura shkencore. “Laboratori shkencorë i Forenzikës siq i njohim ne sot kan filluar të zhvillohen gjatë shekullit të XX-të” (Gaensslen, Harris, Lee, 2008: 13). Laboratori forenzik kryen ekspertizën sipas urdhëresës së gjyqtarit, të prokurorit apo të organit tjetër për zbatim të ligjit. Laboratori forenzik ka për detyrë të kryej ekspertizën e dëshmimeve për të arritur deri te mendimi apo konkluzioni mbi bazën e pyetjeve të parashtruara në urdhëresë të prokurorit apo të gjyqtarit kompetentë. Ekspertizën e kryen eksperti i kualifikuar dhe me përvojë të dëshmuar. Në parim ekspertizën e kryen eksperti i caktuar nga gjykata kompetente, e nëse ekziston instituti profesional apo organi publik, ekspertiza i besohet atij, i cili e cakton ekspertin apo grupin e ekspertëve, për kryerje të ekspertizës. Prova e dërguar për ekspertizë duhet të sigurohet dhe të transportohet sipas një sistemi të unifikuar administrativ, siç janë sistemet bashkëkohore për laboratorë forenzik. Ky sistem quhet sistemi LIMS, nga gjuha Angleze, “laboratory information management system”- sistemi për menaxhim informativ laboratorik, i cili mundëson dhe siguron administrim të unifikuar të provave materiale përmes aplikacionit softuerik. I tërë procesi i ekspertizës monitorohet dhe menaxhohet nëpërmjet këtij sistemi, duke filluar nga pranimi, regjistrimi, kodifikimi, ndarja e rasteve, plotësimi i formave teknike dhe administrative, shkrimi dhe interpretimi i rezultateve laboratorike, verifikimi dhe rishikimi i ekspertimit, njoftimi i palëve, monitorimi i përformancës së personelit dhe nga gjenerimi automatik i statistikave etj. Më shumë lidhur me këtë sistem do të flasim në kapitullin e gjashtë.

## Kapitulli III: Forenzika në vendin të ngjarjes

### 3.1. Vendi i ngjarjes

Vendi ku ka ndodhur krimi thirret vendi i ngjarjes. Në literaturat e ndryshme kombëtare e ndërkombëtare hasim në definicione të ndryshme për vendin e ngjarjes. Kështu Miftari, Shishani dhe Kotri vendin e ngjarjes e përkufizojnë kështu: “Vendi i ngjarjes është vendi ku ka ndodhur krimi, në të cilin mund të ekzistojnë gjurmët dhe provat materiale të mundshme lidhur me atë rast dhe ku duhet bërë hetime, që të sqarohen rrethanat e ndodhjes dhe mbi këto rrethana, të caktohen shkaqet dhe mekanizmat e ndodhjes, pasojat dhe autori i tyre”. (Miftari, Shishani, Kotri, 2010: 90). Nisur nga ky përkufizim, vendi i ngjarjes është vendi ku është kryer vepra, dhe vendi ku është shkaktuar pasoja, madje edhe vendi ku është planifikuar kryerja e veprës penale. Në kodin penal të Republikës së Kosovës, në nenin 10 lidhur me vendin e ngjarjes parashihet:

1. Vepra penale kryhet në vendin ku kryerësi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë ashtu si dhe në vendin ku është shkaktuar pasoja.
2. Vepra penale është tentuar në vendin ku kryerësi ka vepruar si dhe në vendin ku kryerësi ka dashur që të shkaktohet pasoja. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 10, 2013: 4).

Vendi i ngjarjes duhet kuptuar si një vend ku ka ndodhur një ngjarje, ku ka ndodhur një ndryshim si pasojë e asaj ngjarjeje, në të cilin apo rreth të cilit mund të ketë mundësi të pranisë së gjurmëve, të shenjave apo të ndryshimeve të tjera që kanë lidhje me atë ngjarje. Pra, vendin e ngjarjes duhet kuptuar si një vend ku ka mundësi reale për të gjetur gjurmë dhe prova materiale që kanë lidhje me atë ngjarje të ndodhur. Kur flasim për vendin e ngjarjes duhet të kuptojmë shumë mirë këtë fjali të thjeshtë por mjaft domethënëse, pra së pari duhet të dimë se çka është “vendi” dhe pastaj ta dimë se çka ose kush është “ngjarja”. Nëse e zbërthejmë këtë fjali mirë atëherë kuptojmë se me termin “vend”, kuptojmë vendin se ku saktësisht ka ndodhur ajo ngjarje, apo ku saktësisht është shkaktuar pasoja, ndërsa me termin “ngjarje” kuptojmë atë ndodhi, atë ndryshim të ndodhur në një mjedis të caktuar e cila quhet ngjarje. Pra, për ta kuptuar mirë e drejt termin “vend i ngjarjes”, duhet bërë lidhjen e ngushtë të këtyre dy termeve, vendi që nënkupton lokacionin konkret ku është zhvilluar ngjarja, dhe ngjarja që nënkupton vetë veprën penale, saktësisht kryerjen e veprës penale. Disa autorë mendojnë se jo të gjithë vendet e ngjarjes mund



të jenë si pasojë e veprës penale. Kështu veprat e ndryshme penale si: “jaka e bardhë”, vozitja nën ndikim të alkoolit, prostitucioni, aktivitete ilegale kriminale me përdorim të internetit, marrja me substanca të kontrolluara, madje edhe disa vepra të imta të vjedhjes mund të mos kenë vend të ngjarjes.

Llojet e vendit të ngjarjes janë të shumta dhe autorët e ndryshëm i ndajnë në disa lloje. Nëse marrim parasysh hapësirën ku ka ndodhur një vepër penale vendet e ngjarjes i ndajmë në vende të ngjarjes të mbyllura dhe vende të ngjarjes të hapura.

Vende të ngjarjes të mbyllura konsiderohen ato vende kur vepra është kryer në një hapësirë fizikisht të mbyllur që nënkupton një shtëpi, një objekt banimi, një ndërtesë, godinë etj.

Vende të ngjarjes të hapura janë ato vende kur vepra penale është kryer në një ambient të hapur e këto janë raste kur vepra penale është kryer në natyrë, në rrugë, në oborr shtëpie, në parking etj. Një numër i autorëve si kategori të veçantë të vendit të ngjarjes e konsiderojnë vendin e ngjarjes në veturë. Pra, këta autorë në rastet kur vepra penale kryhet vetëm në veturë (sulmet seksuale, vrasje, etj.) vetëm veturën e konsiderojnë si vend të ngjarjes. Sa i përket lokacionit se ku gjenden provat material, vendet e ngjarjes ndahen në vende të ngjarjes primare dhe sekondare.

Vende primare të ngjarjes konsiderohen ato vende ku dyshohet se është kryer vepra penale dhe ku gjenden provat kryesore apo ato të cilat vërtetojnë se pikërisht aty është kryer vepra penale. Po ashtu vendi primar i ngjarjes mund të konsiderohet edhe ai vend i cili është këqyrur i pari, pavarësisht nëse aty janë gjetur provat kryesore lidhur me rastin.

Vende sekondare të ngjarjes konsiderohen ato lokacione në të cilat janë gjetur prova materiale, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të lidhura me vendin primar të ngjarjes. Këto janë raste kur në një distancë të afërt, por edhe të largët, gjenden prova materiale, të cilat kryerësi i ka lënë gjatë largimit të tij nga vendi i ngjarjes (rruga e ikjes, te pikat kryesore të vendit të ngjarjes).

Këqyrja e vendit të ngjarjes ka rëndësi të madhe për arritjen e sukseseve në punën e ekspertit. Gjithashtu, rëndësi ka fakti se ai është terreni ku besohet se ka ndodhur akti kriminal dhe si i tillë, në të duhet të kenë mbetur gjurmë apo prova materiale, që kanë të bëjnë me krimin, me mekanizmin e kryerjes së tij, me mënyrën e kryerjes, me mjetin e kryerjes, me autorin apo me autorët e mundshëm, me prova këto materiale (gjurmë, mjete, instrumente, mekanizma, dokumente etj.), të cilat mund të çojnë drejt dokumentimit ligjor të aktit kriminal apo të zbulimit të autorit. Latifi në librin e tij, këqyrjen e vendit të ngjarjes e konsideron si veprim hetimor: “Këqyrja e vendit të ngjarjes është një veprim hetimor, me anë të cilit organi procedues

percepton drejtpërsëdrejti mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson prova materiale dhe sqaron rrethana që kanë rëndësi për çështjen (Latifi, 2009: 171). Gjatë procesit të këqyrjes, ekspertët zbulojnë, fiksojnë dhe mbledhin prova që kanë rëndësi të veçantë për të përcaktuar rrethanat dhe mbi këtë çështje shpjegohen mekanizmat e ngjarjes. Prandaj, që këqyrja të jetë sa më efikase, ekipi i cili e realizon atë, duhet të jetë i kujdesshëm që gjatë këqyrjes të zbulojë, të fiksojë dhe të mbledhë të gjitha gjurmët dhe provat materiale që hasin në vendin e ngjarjes. Aktet kriminale ndodhin në kohë të ndryshme, pra ato mund të ndodhin edhe natën dhe ekipit të këqyrjes i duhet të procedojë atë vend. Nëse është e mundur që këqyrja e vendit të ngjarjes të shtyhet deri sa të agojë dita, ajo mund të bëhet, sepse këqyrja gjatë ditës, në kushte të mjaftueshme të dritës natyrore është më efikas dhe me shumë sukses, në të kundërtën kur pritja mund të çojë deri te dëmtimi apo kontaminimi i vendit të ngjarjes, të provave apo të gjurmëve, atëherë këqyrja duhet të fillojë menjëherë duke përdorur ndriçim artificial, siç janë reflektorët ndriçues.

### **3.2. Ruajtja e vendit të ngjarjes dhe veprimet fillestare**

Ruajtja e vendit të ngjarjes është një nga punët më të rëndësishme që bënë dhe duhet ta bëjë grupi hetimor. Me ruajtjen e vendit të ngjarjes kuptojmë ruajtjen dhe sigurimin e vendit të ngjarjes, në kushte dhe gjendje të njëjtë fizike, ashtu siç e ka lënë kryerësi me rastin e kryerjes së veprës penale. E gjithë kjo bëhet për t'u siguruar se gjendja në atë vend është pothuajse e njëjtë, në atë gjendje që ka qenë kur kryerësi i veprës ka ikur, ka dalur apo e ka lëshuar atë vend. Veseli për sigurimin e vendit të ngjarjes në librin e tij thekson : “Marrja e masave për ruajtjen e vendit të ngjarjes ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e gjurmëve dhe të provave materiale dhe nuk lejohet asnjëri të shkelë në atë vend para ardhjes së grupit hetimor”. (Veseli, 2009: 173). Ndërsa, Fisher në librin e tij sigurimin e vendit të ngjarjes e ndërlikon me veprimet e zyrtarit të parë policor në vendin e ngjarjes. “Pas arritjes në vendin e ngjarjes, zyrtari policor, duhet të ndërmarrë hapa konkret për mbrojtjen e vendit të ngjarjes nga ata të cilët nuk janë direkt të përfshirë në hetime, të përfshirë oficerët e tjerë, mbikëqyrësit dhe personelin komandues, shtypin, kalimtarët e rastit, familjarët.”. (Fisher, 2004: 58). Ruajtja e vendit të ngjarjes fillon nga polici i parë që arrin në atë vend, për të vazhduar pastaj me të gjitha grupet e tjera që vijnë në atë vend për të hetuar. Të gjithë këta zyrtarë, pavarësisht punës së tyre duhet të kenë në konsideratë të vazhdueshme aspektin e ruajtjes dhe të sigurimit të vendit të ngjarjes. Vendi i ngjarjes mund të ruhet edhe nga

njerëzit e tjerë që arrijnë aty para organit procedues, si p.sh. familjarët e viktimave, vetë viktimat, fqinjët, personat që rastësisht gjenden aty, etj. Ne do të paraqesim tani aspektin kronologjik të ruajtjes së vendit të ngjarjes, duke filluar nga e para dhe duke ndjekur rrjedhën sipas kohës kur merret informacioni, deri tek përfundimi i këqyrjes së atij vendi të ngjarjes. Së pari, organi i procedurës duhet të sigurohet se a kemi të bëjmë me vepër penale apo jo. Duke u siguruar se në atë vend me të vërtetë ka ndodhur krimi, ata menjëherë duhet të sigurohen nëse kryerësi i veprës ka ikur nga ai vend dhe viktimës t'i afrohet ndihma e parë, nëse ai është ende gjallë apo me shenja jete. Nuk duhet harruar faktin se vetëm njëherë gjurmët dhe provat materiale mund të vendosen në pozitën e dytë. Këto renditen aty vetëm kur kemi të bëjmë me viktimen dhe të njëjtës duhet dhënë ndihmën e parë. Në të gjitha rastet e tjera gjurmët dhe provat materiale janë të parat që duhet t'u kushtohet vëmendje dhe përkushtim i veçantë. Nëse kryerësi është ende aty, është e natyrshme se ndaj tij merren masat sipas ligjit dhe procedurave përkatëse. Pasi të jenë siguruar se vepra ka ndodhur, kryerësi ka ikur dhe se viktimat nuk ka nevojë për ndihmën e parë apo nuk gjendet aty fare, atëherë njësitet patrulluese apo oficerët e parë që arrijnë aty, duhet filluar me veprime konkrete rreth sigurimit të vendit të ngjarjes. Këto veprime përfshijnë: caktimin e perimetrit të brendshëm dhe të perimetrit të jashtëm të vendit të ngjarjes.

*Perimetri i brendshëm:* Me perimetër të brendshëm nënkuptojmë tërë hapësirën që është e rrethuar me shirit mbrojtës, nga kufiri deri në qendër. Për ta caktuar këtë perimetër përdoret shiriti rrethues, i cili cakton kufirin e vendit të ngjarjes, që ne e quajtmë perimetër të brendshëm dhe pikërisht këtu ndahet perimetri i brendshëm dhe perimetri i jashtëm.

*Perimetri i jashtëm:* Me perimetër të jashtëm nënkuptojmë pjesën nga shiriti rrethues i perimetrit të brendshëm e tutje. Vlen të theksohet se në këtë perimetër, pra në perimetrin e jashtëm, kjo hapësirë mund të shfrytëzohet nga mediat, personeli komandues, dëshmitarët etj., dhe me një fjalë kjo zonë quhet qendra komanduese, e cila do të vi në shprehje më vonë kur në atë vend do të arrijnë ekipet e tjera që merren më konkretisht me këqyrjen e vendit të ngjarjes. Që të jemi më të saktë dhe më të kuptueshëm me ruajtjen e vendit të ngjarjes kuptojmë edhe rrethimin e tërë sipërfaqes për të cilën ne mendojmë se mund të ketë gjurmë dhe prova materiale që do të na lidheshin me atë ngjarje dhe të njëjtat do të na orientonin në rrugën e duhur në aspektin e hetimit dhe të zbulimit të kryerësit të asaj veprë.

Myftari, Shishani dhe Kotori në librin e tyre lidhur me ndikimin e njerëzve që mund të kenë në prova theksojnë: “Provat u nënshtrohen edhe ndikimit të njerëzve që kanë interes t'i ndryshojnë,

t'i zhdukin apo t'i fshehin me qëllim që të mos zbulohet e vërteta dhe autori".(Myftari, Shishani dhe Kotri, 2010: 97). Prandaj, nisur nga kjo që u tha më lart mund të konstatojmë se ruajtja e vendit të ngjarjes duhet të fillojë sa më shpejtë në kuptimin e ruajtjes dhe të sigurimit të gjurmëve dhe të provave materiale që gjenden brenda atij vendi derisa aty të arrijnë ekipet e këqyrjes së vendit të ngjarjes.

Pra, me siguri të vendit të ngjarjes nënkuptojmë ruajtjen e vendit të ngjarjes në të njëjtat kushte fizike dhe kimike ashtu siç është lënë nga kryerësi i veprës penale. Sigurimin e vendit të ngjarjes e bën zyrtari i parë policor i cili arrin aty. Sigurimi fillon nga pika qendrore dhe zgjerohet në drejtim të perimetrit për aq sa grupi hetimor konsideron se ka prova materiale të mbetura si pasojë e veprës penale. Ndërsa hierarkia e përgjegjësisë në vendin e ngjarjes ka këtë rrethim: polici i parë, krim teknik, hetuesi dhe prokurori. Pra, fillimisht përgjegjësia për sigurimin e vendit të ngjarjes bie mbi policin e parë i cili arrin në vendin e ngjarjes. Hetuesi me ekipin e krim teknikeve me të arritur në vend të ngjarjes merr përgjegjësinë nga polici i parë. Prokurori është zyrtari me përgjegjësi më të lartë, i cili varësisht prej rastit dhe njohurive që posedon mund ta udhëheqë këqyrjen e vendit të ngjarjes.

### **3.3. Metodën e këqyrjes së vendit të ngjarjes**

Shkencëtarëve kriminalistë amerikanë, kërkimin e provave materiale, në procesin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, e konsiderojnë si hap të parë për një procedim të rregullt penal, që nga hetimi e deri në gjykim. Sipas tyre ky kërkim ka për qëllim:

1. Të identifikojë çdo provë materiale, e cila në disa raste mund të jetë e rëndësishme edhe disa vjet pas zbulimit të saj.
2. Të përshkruajë vendin ku është gjetur dhe kushtet e zbulimit të saj.
3. Të vërtetojë se prova materiale, nga koha e zbulimit të saj e gjer në kohën e paraqitjes në gjyq, ka qenë e ruajtur mirë, ose ka pësuar ndryshime.

Ata rekomandojnë që çdo provë materiale të fotografohet me metodën shkallëzuese, të përshkruhet, të pakëtohet dhe të mbyllet në mënyrë të sigurt (me plikë plastike), duke bërë shënimet përkatëse në etiketë dhe duke u nënshkruar nga zyrtari i ngarkuar. Këto janë kushte të domosdoshme për ruajtjen e provës materiale, dërgimin sa më shpejt për ekzaminim në laboratorin për ekzaminim. Ademaj në librin e tij referon 5 metoda për kërkimin e provave

materiale në vendngjarje: metodën spirale, metodën brezore, metodën rrjetore, metodën katrore dhe metodën e rrumbullakët.

Metoda spirale : “Kjo metodë përdoret kur vepra penale ka ndodhur në vend të hapur. Ajo përdoret nga një person i vetëm. Në procesin e punës personi lëviz gjithmonë ngadalë në rrathë të vegjël koncentrikë duke filluar nga kufiri më i largët në drejtim të qendrës. Kjo formë nuk duhet të realizohet në të kundërtën, d.m.th. të fillohet nga qendra në drejtim të periferisë së vendit të krimit, për arsye se ekziston rreziku i vërtetë që ndonjë provë materiale të dëmtohet.

Metoda brezore: Kjo metodë përfshin kalimin e personit ose të personave në shumë rrugë. Si rregull kjo metodë bëhet me pjesëmarrjen e shumë njerëzve.

Metoda rrjetore: Kjo metodë përdoret pas mbarimit të ekzaminimit brezor. Personi ose personat lëvizin në drejtim të kundërt dhe e dyfishojnë kërkimin. Megjithëse këqyrja përsëritet, metoda rrjetore ka përparësi, pasi kur vendi këqyret hollësisht në dy drejtime, kërkimi bëhet më i efektshëm.

Metoda katrore: Kjo metodë kërkon që vendi i ngjarjes të ndahet në katër katrorë të mëdhenj. Secili nga katrorët këqyret sipas metodave që u përshkruan më lart.

Metoda e rrumbullakët: Kjo metodë përdoret kur vendi që do të këqyret për të kërkuar prova materiale është shumë i madh dhe për këtë arsye ndahet në disa pjesë konike, gjë që lejon një vëzhgim më të thellë për të kërkuar prova materiale. (Ademaj, 2010: 249-251).

Autorë të ndryshëm këqyrjen e vendngjarjes e ndajnë në faza: faza orientuese apo informuese, faza statike, faza dinamike, faza kontrolluese dhe faza përfundimtare apo përmbyllëse.

### **3.4. Dokumenti që hartohet për këqyrjen e vendit të ngjarjes**

Në praktikë ndodh që të bëhet një këqyrje e përkryer e vendit të ngjarjes, por kjo mund të mos jetë e mjaftueshme për të zbuluar kryerësin apo kryerësit e veprës penale. Përkundër përpjekjeve të hetuesve të vendit të ngjarjes për të gjetur, për të fiksuar dhe për të marrë të gjitha provat materiale nga vendi i ngjarjes, në disa rrethana në praktikë ndodh që e tërë kjo punë të mos dokumentohet saktë dhe në tërësi. Dokumentimi i vendit të ngjarjes është një çështje shumë e rëndësishme e tërësisë së veprimeve proceduralo-hetimore. Vetëm me një dokumentim të mirë mund të paraqesim punën dhe rezultatet tona nga ekzaminimi i vendit të ngjarjes. Mund të bëjmë

një punë të madhe, shumë profesionale, por nëse nuk bëjmë një dokumentim të mirë, atëherë pa asnjë dyshim rezultatet nuk do të jenë aspak të kënaqshme.

Metodat klasike të dokumentimit të vendit të ngjarjes përfshijnë:

-Shënimet (procesverbalin)

- Fotografimin dhe

- Skicën

**Shënimet (procesverbali)** – Procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes është akti i parë i dokumentimit të vendit të ngjarjes. Varësisht nga praktika e një vendi edhe llojet e procesverbaleve të këqyrjes së vendit të ngjarjes ndryshojnë. Në disa shtete aplikohet ai lloj procesverbali, i cili përpilohet në vendin e ngjarjes dhe si i tillë u prezantohet organeve të ndjekjes dhe atyre gjyqësore. Ky lloj procesverbali nga disa autorë konsiderohet si ``origjinal`` i cili nuk lejon ndërhyrje të mëvonshme në të, por në fakt përpilimi i një procesverbali në vendin e ngjarjes deri sa është duke u zhvilluar këqyrja është mjaft i vështirë, sepse gjatë këqyrjes njëkohësisht mund të zhvillohen disa veprime nga hetuesit dhe ngadalësimi i punës së tyre për shkak të përpilimit të procesverbalit do të ishte shumë i pakuptimtë. Për këtë arsye disa shtete të tjera, përfshirë edhe Kosovën, aplikojnë një formë tjetër të procesverbalit, i cili më tepër ka të bëjë me marrjen e shënimeve nga vendi i ngjarjes, të cilat shënime do të shërbejnë për përpilimin e raportit (procesverbalit) të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Në këtë rast kemi një procesverbal i cili përmban shënimet kryesore nga vendi i ngjarjes si: kohën e pranimit të thirrjes; kohën e arritjes në vendin e ngjarjes dhe lokacionin e tij; oficerët e parë në vendin e ngjarjes; përshkrimin e vendit të ngjarjes dhe të provave të gjetura; veprimet kryesore të ndërmarra gjatë këqyrjes; kushtet atmosferike dhe ato të ndriçimit; pjesëmarrësit e tjerë në këqyrjen e vendit të ngjarjes; kohën e përfundimit të këqyrjes, etj. Nga këto shënime, pastaj në zyrën e organit që ka bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes, përpilohet raporti i detajuar, profesional i cili përmban të gjitha informatat për veprimet dhe gjetjet nga vendi i ngjarjes. Për shënimet e vendit të ngjarjes vlejnë dispozitat e përgjithshme të Kodit mbi Procedurën Penale (në vazhdim të tekstit KPP) mbi procesverbalet të cilat hartohen me rastin e ndërmarrjes së aktiviteteve procedurale. Me dispozitat e KPP është zgjidhur çështja e kësaj forme, përmbajtja, afatet dhe rezultatet e procesverbalit mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes. Për shkak të pasaktësisë së dispozitave të KPP, përmbajtjet e procesverbaleve mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes ndryshojnë prej një organi te tjetri, gjë që shprehet negativisht në punën e organeve të

procedurës, sidomos në punën e gjykatave. Procesverbalet shpesh janë jo të plota dhe të pasakta, kështu që nganjëherë ato sjellin në pyetje edhe vlefshmërinë procedurale, më tepër për shkak të mangësive të karakterit përmbajtjesor se sa për shkak të mangësive të karakterit formal - ligjor. Praktika gjyqësore tregon se ky ndryshim në pikëpamje të formës dhe të përmbajtjes së procesverbalit, pa dyshim, ka një reflektim negativ në rrjedhën e mëvonshme të mbarëvajtjes së procedurës penale. Modly në revistën për kriminalistikë, kriminologji dhe studime të sigurisë, rëndësinë e procesverbalit e ndërlidhë me elementë të tjerë, siç janë regjistrimet teknike, mënyrat grafike, mullazhimi, përpunimi i maketeve etj. “Meqenëse gjendja faktike e konstatuar në vendin e ngjarjes fiksohet me përshkrimin me fjalë, duhet pasur parasysh që situata faktike në kuptimin e strukturës së saj, zakonisht e përshkruar në mënyrë të përafërt adekuate, sepse është vështirë të arrihet përshkrimi absolutisht adekuat me fjalë i gjendjes faktike. Për këtë shkak, organet e hetuesisë kërkojnë mënyra të tjera të fiksimit të gjendjes faktike, siç janë regjistrimet teknike, mënyrat grafike, mullazhimi, përpunimi i maketave, etj.” (Modly, 2007: 78). Sipas karakterit ligjor procesverbali i vendit të ngjarjes është dokument i shkruar, në të cilin organi procedues e paraqet një përmbajtje të caktuar lidhur me konstatimin e gjendjes faktike gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes. Në aspektin e argumentimit, procesverbali mbi vendin e ngjarjes është dokument argumentues, i cili duhet të përmbajë përshkrimet e sakta mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes për shkak të karakterit të dokumentit publik dhe ai vetvetiu nuk ka ndonjë forcë të posaçme argumentuese në procedurën penale, por as përmbajtja e tij nuk përjashtohet nga procedura e rregullt e vlerësimit të provave nga ana e organit të procedurës. Karakteri i dokumentit publik dhe zyrtar i procesverbalit të vendit të ngjarjes supozon përmbajtjen e tillë që e bën atë të pamohueshëm, i cili si i tillë me një siguri të madhe argumenton atë që është shkruar në përmbajtjen e tij, me ç ‘rast rol të madh luan përmbajtja metodologjike kriminalistike.

Procesverbalet mbahen në të gjitha ato raste kur duam të evidencojmë një veprim hetimor apo veprim tjetër rutinë në veprimtarinë e përditshme. E rëndësishme është evidencimi dhe nxjerrja në pah e elementeve kryesor që duhet të përmbajë një procesverbal si:

- Këqyrja e vendit të ngjarjes;
- Kontrolli i sendeve;
- Kontrolli i personit;
- Identifikimi i personit;
- Identifikimi i sendeve;

- Kryerja e eksperimentit hetimor;
- Sekuestrimi i sendeve.

Të gjitha këto në vetvete krahas karakterit të mirëfilltë procedural, kanë elemente fiksuese kriminalistike. Marrja e shënimeve duhet të jetë një veprim i vazhdueshëm gjatë gjithë përpunimit të vendit të ngjarjes. Këto shënime duhet të përfshijnë një përshkrim të detajuar të vendngjarjes, me pozicionin e sendeve apo provës fizike të zbuluar. Ata gjithashtu duhet të identifikojnë kohën kur u zbulua sendi i provës fizike, si dhe nga kush u paketua dhe u shënua, po edhe vendosja e sendeve pasi të mblidhen.

**Fotografimi** - Fotografimi është një hap tjetër shumë i rëndësishëm i dokumentimit të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Përmes fotografimit, në mënyrë të detajuar pasqyrohet vendi i ngjarjes në përgjithësi dhe provat e gjetura në veçanti. Fotografimi i ndihmon palët, të cilat nuk kanë qenë në vendin e ngjarjes, që të krijojnë një ide më të qartë se si ka qenë ai vend në të cilin është kryer një vepër penale. Me fotografim shpeshherë nënkuptohet edhe video-incizimi i vendit të ngjarjes. Edhe pse video-incizimi e paraqet shumë më mirë situatën, por për shkak të mungesave teknike video-incizimi nuk është i mundur çdoherë. Sidoqoftë, qëllimi është i njëjtë, sikurse tek fotografimi po ashtu edhe tek video-incizimi, krim tekniku merr pamje të dokumentuar të vendit të ngjarjes dhe të provave relevante. Arifi për rëndësinë e fotografimit të vendit të ngjarjes në librin e tij thekson: “Është detyrë e çdo hetuesi të vendit të ngjarjes që sapo të arrijë aty pas marrjes së informatave fillestare, të fillojë me fotografimin e përgjithshëm orientues të vendit të ngjarjes. Hetuesi pastaj duhet të vazhdojë me fokusimin nëpër pikat e rëndësishme, të bëjë lidhjen e gjurmëve apo provave materiale me anë të fotografisë, të fotografisë vazhduese etj.” (Arifi, 2012: 80). Fotografimi i vendit të ngjarjes është një proces i gjatë i cili fillon me arritjen në vendin e ngjarjes dhe vazhdon gjatë tërë kohës sa zhvillohet këqyrja e deri në përfundim të tij. Përveç fotografive të përgjithshme të vendit të ngjarjes, bëhen edhe fotografi të veçanta, qëllimi i të cilave është lidhja e vendit të ngjarjes së veprës penale me objekte të tjera në mënyrë që të kemi një pamje më të gjerë të zonës ku ka ndodhur krimi. Pra, në këtë fazë fotografohet edhe vendi i ngjarjes por edhe zona për rreth tij. Ky lloj fotografimi mund të ketë edhe një vlerë tjetër, sepse në disa raste nga fotografitë e tilla identifikohen dëshmitarët, por ndonjëherë edhe të dyshuarit.

Në përgjithësi kemi tri lloje të fotografisë së vendit të ngjarjes:



Fotografia orientuese: përfshinë tërë vendin e ngjarjes apo një pjesë të madhe të vendit të ngjarjes. Kjo fotografi merret nga një distancë e largët. Vendi i ngjarjes fotografohet nga të katër këndet e vendngjarjes. Kjo fotografi merret në fokusin e syrit, në një distancë rreth gjashtë metrash e sipër.

Fotografia e mesme: përfshinë lidhjen e zonave të vendit të ngjarjes me zonat e fotografuara. Kjo fotografi mundëson edhe lidhjen e provave materiale midis njëra-tjetrës. Kjo fotografi merret në distancë nga tre deri në gjashtë metra.

Fotografia e afërt (e detajuar): Është fotografia më e rëndësishme e vendit të ngjarjes, e cila merret nga një distancë e afërt. Kjo fotografi merret në këndin prej 90 shkallësh, d.m.th. fotoaparati me rastin e fotografimit vendoset në kënd të drejtë në raport me provën materiale që fotografohet. Kjo fotografi, me qëllim të qartësimit të saj, zakonisht merret me ndriçim anësor (llambë elektrike), varësisht prej llojit të provës materiale.

Një çështje, e cila shpeshherë diskutohet nga autorë të ndryshëm, është numri i fotografive që duhet të bëhen për një dokumentim të mirë të vendit të ngjarjes. Nuk ka ndonjë rregull të caktuar, por gjithsesi preferohet që të merren sa më shumë fotografi nga kënde të ndryshme. Të gjitha fotografitë e marra nga vendi i ngjarjes duhet të procedohen në albumin e fotografisë kriminalistike. Fotoalbumi kriminalistik duhet të ketë renditje kronologjike, përshkrim të fotografive, sqarim të domethënies dhe indeksim të fotografive. Të gjitha fotografitë e marra nga vendi i ngjarjes nuk paraqiten në fotoalbum, përveç fotografive të përzgjedhura nga hetuesi apo nga krim tekniku, e sidomos ato të cilat janë të qarta, domethënëse dhe gjithëpërfshirëse.

**Skicimi** - Është element i thjeshtë, por mjaft i domosdoshëm për ta bërë sa më të plotë procesin e këqyrjes së vendit të ngjarjes. Nëse në procesverbal, përshkruhen me hollësi të gjitha elementet e vendit të ngjarjes, provat dhe çdo gjë tjetër që gjykohet se është e domosdoshme për t'u fiksuar, dhe të gjitha hapat e kësaj këqyrjeje shoqërohen me fotografi. Skica jep detaje të domosdoshme teknike. Skica e vendit të ngjarjes ka për qëllim përshkrimin e saktë të vendit të ngjarjes, qartësimin dhe kuptimin më të lehtë të vendit të ngjarjes, mundësimin e rivendosjes së vendit të ngjarjes (rikonstrukcionin), orientimin gjeografik dhe pozicionin e vendit të ngjarjes në raport me objekte të tjera orientuese. Saferstein skicën e ndanë në skicën e shpejtë dhe skicën përfundimtare: Skica e shpejtë është një projekt prezantues i të gjithë informacionit dhe

matjet në një skenë krimi. Skica përfundimtare është renditja e saktë e skenës së krimit, zakonisht renditet pas matjeve.” (Saferstein 2014: 42).

Në parim ekzistojnë dy lloje të skicës së vendit të ngjarjes: Skica me dorë të lirë apo siç quhet në zhargonin kriminalistik kroki skica dhe skica profesionale.

Skica me dorë të lirë: Është skicë e cila vizatohet me dorë të lirë në vendin e ngjarjes. Në këtë skicë paraqiten të gjitha provat relevante të vendit të ngjarjes. Te kjo skicë nuk aplikohet shkalla e përpjesëtimit. Orientimi i polit të veriut duhet të paraqitet në skicë.

Skica profesionale: Është skica finale e cila vizatohet në kabinetin e kriminalistikës. Eksperti kriminalistik përmes softuerit kompjuterik apo me vizatim teknik, paraqet të dhënat e vendit të ngjarjes në shkallë përpjesëtimore. Kjo skicë mund të bëhet me anë të vizatimit teknik, por mund të bëhet edhe me anë të programeve të avancuara kompjuterike, siç është “AUTOCAD”. Të dy këto skica duhet patjetër të jenë pjesë e dosjes së krim teknikës. “Vetëm fotografia nuk është e mjaftueshme për fiksimin (dokumentimin) e vendit të ngjarjes. Që vendi i ngjarjes të paraqitet sa më mirë dhe më saktë, ai duhet të ketë edhe skicën . Pra, skica dhe fotografia plotësojnë njëra-tjetrën dhe të dyja paraqesin vendin e ngjarjes në mënyrë të saktë dhe adekuate. Skica qartëson pamjen e vendit të ngjarjes dhe e bënë atë më lehtë të kuptueshëm. Prandaj është e rëndësishme që hetuesi i vendit të ngjarjes të bëjë një skicë të mirë dhe që kuptohet lehtë”. (Arifi, 2012: 75)

Skica, njëjtë sikur edhe procesverbali dhe fotografimi, paraqet vendin e ngjarjes. Skica, varësisht se e cilit lloj është, ajo duhet të jetë e lexueshme dhe e qartë, sepse atë mund ta shikojnë apo ta vlerësojnë persona që nuk kanë qenë në vendin e ngjarjes dhe persona të cilët nuk kanë shumë njohuri lidhur me këtë fushë. Nuk është e domosdoshme që skica të jetë vepër arti, pra të jetë e bukur në aspektin artistik, por së paku duhet të jetë e lexueshme, e qartë dhe t’i përmbajë informatat kryesore lidhur me rastin konkret.

Skica e vendit të ngjarjes duhet të përmbajë së paku këto informacione:

- Emrin, mbiemrin dhe detyra e ekspertit;
- Datën, kohën, klasifikimin e veprës penale, dhe numrin e raportit;
- Emrin e plotë të çdo personi që asiston në matje;
- Adresën e vendit të ngjarjes, pozitën e saj në ndërtesë, pikë- referimet (piketat), dhe drejtimin hapësinor;
- Shkallën e vizatimit, nëse është bërë vizatimi shkallëzues;
- Gjërat kryesore të dallueshme të dëshmive fizike dhe karakteristikat kritike të

vendit të ngjarjes;

- Vendndodhjen e gjërave të tilla që ndikohen me anë të matjeve të sakta prej së paku dy pikave fikse apo me metoda të tjera që do të diskutohen më poshtë.

- Legjendën apo një çelës për simbolet që janë përdorur për t'i identifikuar objektet me interes në skicë.

Në praktikat e sotme ndërkombëtare zakonisht aplikohen tri metoda për matjen dhe përpilimin e skicës së vendit të ngjarjes dhe përzgjedhja e njërës nga tri skicat varet nga rrethanat dhe konfiguracioni i vendit të ngjarjes.

Metodat kryesore matëse të vendit të ngjarjes janë metoda koordinatave, metoda trekëndëshe dhe metoda e kryqëzuar.

Metoda koordinatave: përfshin matjen e distancave të një objekti nga një pikë e caktuar e palëvizshme, duke i lidhur me një vijë bazë që bashkon të dy pikat e njohura. Kjo metodë bazohet në konceptin e matjes së koordinatave X dhe Y, ku matjet bëhen në kënd të drejtë (90 shkallë). Për aplikimin e kësaj metode të matjes duhet së paku dy metra shiritor.

Metoda koordinatave gjen zbatim në vende të ngjarjes me sipërfaqe të rrafshët ku matja e provave bëhet duke e shtrirë metrin shiritor karshi provave materiale në vendin e ngjarjes.

Metoda trekëndëshe: bazohet në konceptin e matjeve trekëndëshe, të bazuara në dy e më tepër pika të palëvizshme. Matja bëhet duke fiksuar metrin në pikën A deri në provë dhe nga pika tjetër fikse B deri në provë, duke formuar trekëndëshin.

Metoda trekëndëshe, gjen zbatim në vende të ngjarjes me sipërfaqe jo të rrafshët ku matja mund të bëhet duke ngritur metrin shiritor 1 m. mbi sipërfaqe të tokës.

Metoda e kryqëzuar: gjen zbatim në rastet ku vendi i ngjarjes gjendet në ambiente të mbyllura si shtëpi, lokale, apartamente apo të ngjashme. Matjet mund të bëhen duke aplikuar njërën nga metodat koordinatave apo trekëndëshe. Kjo metodë aplikohet kur provat materiale apo gjurmët, siç janë spërkatjet e gjakut, sperma, ngjyra, dëmtimet nga predha, rikoshetet etj., gjenden në mure anësore apo në tavanin e objektit. Kjo metodë me rastin e paraqitjes së të dhënave në skicë profesionale bazohen në “shpërndarjen e mureve”.

Pikat e palëvizshme për matje të provave në vendin e ngjarjes mund të jenë: këndet e ndërtesave, këndet e kthesave të rrugës, këndet e urave, nyjat e kanalizimit, shenjat e trafikut, shtyllat elektrike (rrugore), shtyllat telefonike, shtyllat e tjera të metalta, të betonit apo të drurit etj. E rëndësishme është që pika orientuese e zgjedhur për matje të vendit të ngjarjes të jetë pikë e

palëvizshme dhe e qëndrueshme për një kohë të gjatë, së paku dy vjet nga koha e kryerjes së veprës penale. Ndërsa sa i përket përshkallëzimit të skicës, autorët të cilët janë marrë me çështjet e këqyrjes së vendit të ngjarjes kanë paraqitur pikëpamje të ndryshme. Shumica prej tyre e sidomos krim tekniket e këqyrjes së vendit të ngjarjes preferojnë skicën e pa shkallëzuar, në të cilën nuk është e domosdoshme që me saktësi të plotë të paraqiten objektet në shkallë përpjesëtimorë.

Në mënyrë që skica e vendit të ngjarjes të paraqet të dhëna të sakta të vendit të ngjarjes, duhet të përpjesëtohet (përshkallëzohet), varësisht nga hapësira e vendit të ngjarjes dhe madhësia e letres në të cilën paraqitet skica.

Zgjedhja e shkallës së drejtë të përpjesëtimit mund të bëhet nëse i referohemi të dhënave si në vijim:

| Përpjesëtimi | Sipërfaqja e vendit të ngjarjes |
|--------------|---------------------------------|
| 1 : 25       | 4.5 x 5.75m                     |
| 1 : 50       | 9.0 x 11.5m                     |
| 1 : 100      | 18 x 23 m                       |
| 1 : 200      | 36 x 46 m                       |
| 1 : 500      | 90 x 115m                       |

Shndërrimi i njësisë matëse të vendit të ngjarjes në njësi matëse të skicës mund të bëhet si në vijim:

$$L(v. ngj.) \times 100$$

$$L(cm) = \frac{\text{shp}}{\text{shp}}$$

ku:

L(cm) - gjatësia e objekteve të paraqitura në skicë në cm

L (v. ngj.) – distanca midis objekteve dhe provave materiale në vendin e ngjarjes

shp - shkalla e përpjesëtimit

100 - konstantë

### 3.5. Rindërtimi i vendit të ngjarjes dhe eksperimenti

Shpeshherë gjatë procedurës penale, në fazat e shqyrtimit të provave materiale, shtrohet e nevojshme, rivendosja e vendit të ngjarjes me qëllim të sqarimit të rrethanave, të vërtetimit të

deklaratës së të dyshimit, të dëshmitarit, të viktimës, apo çështje të tjera të rëndësishme për procedurën. Në procedurën penale të Kosovës janë paraparë rrethanat, situatat dhe kushtet për kryerjen e rivendosjes së vendit të ngjarjes: “Rikonstruksioni kryhet me rikrijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura. Nëse faktet ose situatat paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkretë, në parim, rikonstruksioni i ngjarjes zbatohet veçmas me secilin dëshmitar” (Procedura Penale e Kosovës, 2013: 89). Disa autorë rindërtimin e vendit të ngjarjes e klasifikojnë si “eksperiment hetimor”: “Rindërtimi i vendit të ngjarjes në pamje procedurale, klasifikohet “eksperiment hetimor”, por për disa specifika që paraqiten ndonjëherë, si veprim që kryhet po nga grupi hetimor që ka zhvilluar këqyrjen e vendit të ngjarjes. Kryesisht bazuar në kodin e procedurës penale të Kosovës, prokurori publik urdhëron rikonstruksionin pasi të ketë pranuar dhe të ketë shqyrtuar të gjitha faktet dhe provat materiale lidhur me vendin e ngjarjes: raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, raportet e ekspertizave laboratorike, raportet mjekoligjore etj. Shpesh herë për rindërtimin e vendit të ngjarjes është e nevojshme prezenca dhe ndihma e specialistëve të ndryshëm kriminalistikë, mjekoligjorë, inxhinierikë etj. Prokurori apo trupi gjykues mund të kërkojë kontributin dhe prezencën e tyre gjatë rindërtimit . Natyra e vetë ngjarjes, pyetjet në të cilat duhet përgjigjur, ngjarjet që kanë ndodhur, të gjitha këto janë fakte që duhet marrë parasysh me rastin e klasifikimit të rindërtimit. Në përgjithësi dallojmë dy lloje të rindërtimit të vendit të ngjarjes: rindërtimi i ngjarjes së caktuar dhe rindërtimi i rrjedhës së ngjarjes:

*Rindërtimi i ngjarjes së caktuar:* Ky lloj rindërtimi i vendit të ngjarjes përfshinë: rindërtimin e fatkeqësive, rindërtimin e aksidenteve të qarkullimit rrugor, rindërtimin e aksidenteve të tjera të qarkullimit, siç janë fatkeqësitë e aeroplanëve, të atyre hekurudhore dhe të atyre të anijeve, rindërtimin e fatkeqësive në kantiere, shembjen e ndërtesave etj., rindërtimin e ngjarjeve të caktuara kriminale, rindërtimin e vrasjeve, rindërtimin e zjarreve, rindërtimin e dhunimeve, rindërtimin e kriminalitetit “të jakave të bardha”, dhe rindërtimin e ngjarjeve të tjera kriminale.

*Rindërtimi i rrjedhës së ngjarjes:* Ky lloj rindërtimi përfshinë: përcaktimin e gjurmëve të ngjarjeve, përcaktimin e kohës së ndodhjes së veprës penale, përcaktimin e pozitës së vendit të ngjarjes, të trupit të viktimës, të provave materiale, përcaktimin e raportit, përcaktimin e rrethanave, përcaktimin e identitetit të viktimës etj.

Disa autorë, llojet e rindërtimi të vendit të ngjarjes i klasifikojnë sipas rastit:

- Rindërtimi i tërë rastit,

- Rindërtimi i përsëritshëm i rastit,
- Rindërtimi i përkufizuar në disa ngjarje.

Lee në librin e tij llojet e rindërtimi të vendit të ngjarjes i radhitë: “rindërtimi i gjurmëve të gjakut dhe i sekrecioneve trupore, rindërtimi i gjurmëve të armëve të zjarrit dhe të armëve të tjera gjuajtëse me municion, rindërtimi i dorëshkrimeve ose i dokumenteve (dokumenteve legjitime), rindërtimi i pamjes së gjurmëve të blazës së barutit, përcaktimi i pamjes së lëndimeve dhe rindërtimi i tyre, rindërtimi i pozitës së gjurmëve të linjave papilare, rindërtimi i gjurmëve të këmbëve ose të gjurmëve të këpucëve dhe rindërtimi i gjurmëve të gomave të automjetit (Lee, 2010: 171).

**Eksperimenti** - Gjatë procedurës penale shpesh lind nevoja për verifikimin e ngjarjeve që lidhen me veprën penale, për të vërtetuar nëse një fakt ka ndodhur dhe mënyrën si ka ndodhur ai. Eksperimenti ka për qëllim riprodhimin e rrethanave, përshtatjen e tyre në vendin ku ka ndodhur vepra penale. Eksperimenti kryhet për të provuar nëse ngjarja mund të shihet nga një vend i caktuar, nëse mund të dëgjohet biseda apo ndonjë zhurmë nga një distancë e caktuar, nëse gjurmët e frenimit të lëna në vendin e ngjarjes janë te automjetit që dyshohet dhe se çfarë shpejtësie ka pasur automjeti etj. Në kodin e procedurës penale të Shqipërisë: “Eksperimenti është riprodhimi, për aq sa është e mundur, i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur, duke përsëritur mënyrat e zhvillimit të vetë faktit.” (Kodi i procedurës penale i Shqipërisë, 2011: 49).

Islami, Hoxha dhe Panda në librin e tyre për procedurën penale shënojnë masat që duhet të ndërmerren për zbatimin e vendimit të eksperimentit.

Lexo me vëmendje argumentin e tyre: “Për zbatimin e vendimit të eksperimentit merren disa masa paraprake dhe konkretisht:

- *Përcaktohet qëllimi i eksperimentit, fakti që do të verifikohet;*
- *Tregohet dita, ora dhe vendi ku do të kryhet eksperimenti;*
- *Caktohet specialisti i nevojshëm, i cili i përandit dhe i kryen veprimet e nevojshme, e fikson rezultatin e eksperimentit;*
- *Merren masa të nevojshme për fotografime dhe për filmime;*
- *Merren masa për të mos rrezikuar sigurinë e personave të pranishëm;*
- *Përgatiten provat materiale dhe sendet që do të përdoren gjatë eksperimentit;*

- *Rivendoset gjendja e mëparshme, kur ajo ka ndryshuar;*
- *Njoftohen të pranishmit për qëllimin e eksperimentit dhe udhëzohen për veprimet që do të kryejnë, për vendin ku do të qëndrojnë, për të drejtat dhe për detyrat që kanë në bazë të ligjit etj. (Islami, Hoxha dhe Panda, 2003, 229-230).*

Ndërsa të njëjtit autorë, ndër rregullat kryesore për eksperimentin parashohin:

- *Eksperimenti zhvillohet ne vendin ku ka ndodhur ngjarja që verifikohet;*
- *Koha e zhvillimit të eksperimentit duhet të jetë e afërt me atë që verifikohet;*
- *Eksperimenti zhvillohet në kushte të ngjashme me ato të rrethanave që verifikohen;*
- *Kur është e nevojshme veprimet e eksperimentit përsëriten për të nxjerrë rezultate të sakta;*
- *Gjatë eksperimentit nuk duhet të kryhen veprime që cenojnë dinjitetin, moralin, shëndetin e njerëzve ose që e dëmtojnë pasurinë. (Islami, Hoxha dhe Panda, 2003, 238-239).*

Pra, “Eksperimenti është provë që vërteton mundësin e një ndodhie ose të një ngjarjeje, që është objekt i procesit penal. Me kryerjen e eksperimentit tentohet të përsëritet ngjarja për të cilën procedohet penalisht, duke riprodhuar, deri në atë masë që është e mundur, situatën origjinale të gjendjes në të cilën ka ndodhur fakti ose që mendohet që ka ndodhur në atë mënyrë.” (Latifi, 2011: 241). Kur është nevoja caktohet një specialist për kryerjen e veprimeve që lidhen me eksperimentin. Veprimet e kryera gjatë eksperimentit pasqyrohen në procesverbal dhe kur është rasti fotografohen ose filmohen. Eksperimenti ndryshon nga këqyrja e vendit të ngjarjes si nga përmbajtja ashtu edhe nga metodologjia. Këqyrja e vendit të ngjarjes ka për qëllim studimin e mjedisit ku ka ndodhur vepra penale, zbulimin e shenjave materiale që ka lënë kjo vepër dhe fiksimin e vendit të ngjarjes ashtu siç e shikon grupi hetimor në momentin e këqyrjes. Të tjera janë metoda taktike të fiksimit të vendit të ngjarjes dhe të tjera janë ato të riprodhimit të rrethanave, pavarësisht se disa prej tyre janë edhe të përbashkëta. Këqyrja e vendit të ngjarjes ka për qëllim studimin e hapësirës ku ka ndodhur vepra penale, ndërsa eksperimenti ka për qëllim riprodhimin e situatës dhe paraqitjen e saj në vendin ku ka ndodhur vepra penale. Eksperimenti kryhet me vendim të organit që posedon, i cili duhet të përmbajë një njoftim përmbledhës për objektin e eksperimentit dhe të tregojë ditën, orën dhe vendin ku do të kryhet veprimi.

## **Kapitulli IV: Ekspertiza forenzike**

### **4.1. Ekspertiza si nocion**

Në kuptimin e përgjithshëm ekspertiza është dhënia e mendimit apo konstatimi profesional nga një specialist i kualifikuar lidhur me një çështje, provë apo materie që ka të bëjë me çështje ekonomike, sociale, kulturore, statistikore, trashëgimore, sportive, shkencore, teknologjike, gjeografike, klimatike, astronomike etj. Në kuptimin proceduralo-kriminalistik ekspertiza është dhënia e mendimit apo konstatimi profesional nga një specialist i kualifikuar lidhur me një çështje, provë, dëshmi apo material që ka apo mund të ketë lidhshmëri me një vepër penale. Në procedurë penale ekspertiza urdhërohet për vërtetimin e fakteve apo çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me veprën e caktuar penale. Mandro në librin e tij, për ekspertizën thotë: Ekspertiza është një veprimtari e kërkimit shkencor, mbi provat e administruara në bazë të kërkesave ligjore, rezultatet e të cilës marrin një formë procedurale ligjore“ (Mandro, 2011: 34). Ndërsa, Ademaj ekspertizën e definon kështu: “Ekspertiza kriminalistike është veprim me të cilin vërtetohen ose sqarohen faktet në bazë të njohurisë së veçantë të ekspertit, të përvojës apo të aftësisë së tij. Ky është një veprim brenda të cilit gjithmonë nxirret interpretimi shkencor, ekspertiza e fakteve materiale, e rrethanave etj.” (Ademaj, 2010: 25). Ndërsa Hajdari në librin e tij thotë: „Ekspertiza është një provë e rëndësishme që synon të konstatojë, të sqarojë dhe të vërtetojë faktet që kanë rëndësi për çështjen penale, nëpërmjet mendimit dhe konstatimit të dhënë nga specialistë që kanë njohuri të posaçme nga lëmi i teknikës, i shkencës dhe i kulturës“. (Hajdari, 2010: 453). Pra, ekspertiza është varrim hulumtimi, hetimi, gjurmimi, vlerësimi apo studimi i provuar, përfshirë edhe raportet nga këto veprime, konstatimet dhe rezultatet që kërkojnë njohuri të veçanta. Ekspertizën e kryen eksperti i kualifikuar dhe me përvojë të dëshmuar. Në parim, ekspertizën e kryen eksperti i përcaktuar nga gjykata kompetente, e nëse ekziston instituti profesional apo organi publik, atëherë ekspertiza i besohet institucionit profesional apo organit publik, i cili e cakton ekspertin apo grupin e eksperteve, varësisht nga natyra e dëshmive dhe vlera forenzike e saj .

Standardet ndërkombëtare siç janë ai ISO 17025 përcaktojnë kushtet që duhet zbatuar në mënyrë që të realizohet për akreditimin e metodologjisë shkencore në kuptimin e testimit, dokumentimit, gjurmimit, verifikimit, aplikimit të pajisjeve të standardizuara dhe të kalibruara, kushteve të punës, sigurisë së personelit, kualifikimit dhe trajnimit të personelit, veprimit korrigjues, testit



të zotësisë, krahasimit ndër laboratorike, auditimit, rishikimit të menaxhimit, seleksionimit, validimit, zgjedhjes së metodave shkencore-testuese etj.

Ekspertizat mund të klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme. Kështu, sipas llojeve të lëndëve të ekspertizës, pra të karakterit të fakteve që konstatohen me ekspertizë dallohen: a) kontrollimi dhe obduksioni i trupit të vdekur, të embrionit, të trupit të foshnjës; b) substancat e gjetura në trup apo në ndonjë vend tjetër për të cilat dyshohet se janë helme; c) ekspertiza e lëndimeve trupore ; ç) ekspertiza me kontrollim psikiatrik ; d) kontrollimi trupor, marrja e gjakut dhe veprime të tjera mjekësore; dh) analiza e materialit themelor gjenetik; e) ekspertiza e librave afariste. Sipas llojeve të njohurive profesionale të ekspertit dallohen ekspertizat gjyqësore-medicinale, psikiatrike, psikologjike, teknike, mjekësore, kontabiliste, biologjike, kimike, fizike e shumë të tjera. Ekspertizat kriminalistike ekskluzivisht janë të lidhura me procedurën ndëshkimore, ndërsa ato jo kriminalistike ndërmerren edhe jashtë kësaj. Duke pasur parasysh kohën kur ndërmerren dallohen ekspertizat procedurale dhe jashtë procedurale. Sipas raporteve reciproke ekspertizat në procedurën ndëshkimore mund të jenë themelore, plotësuese dhe të përsëritura. Ekspertiza mund të bëhet si veprim kontradiktor ose jo kontradiktor. Posaçërisht janë të rëndësishme çështjet e vlerave argumentuese të ekspertizës dhe të kuptimit të deklaratës së ekspertit si argument shkencor.

#### **4.2. Ekspertiza traseologjike**

Traseologjia është disiplinë e shkencës së forenzikës e cila merret me studimin, përcaktimin dhe identifikimin e mjeteve në bazë të gjurmëve të lëna nga objektet e ndryshme, si gjurmët e këpucëve, gomave, mjeteve (vegla për thyerje), ngjyrës, xhamit, dheut, fibrave, gjakut etj. Termi “traseologji” e ka prejardhjen nga gjuha frënge, “la trasse” që do të thotë gjurmë dhe “logos” nga gjuha greke që do të thotë studim, pra studim mbi gjurmën. Mandro lidhur me detyrat e traseologjisë thekson: “Tarseologjia ka për detyrë:

1. Të identifikojë personin dhe sendet në bazë të gjurmëve të lëna prej tyre në vendngjarje;
2. Të përcaktojë objektin gjurmëlënës në bazë të pjesëve të fiksuara në vendin e ngjarjes;
3. Në bazë të vlerësimit të provave, të objekteve të lëvizura nga autorët, të përcaktojë mekanizimin e formimit të gjurmëve mbi këto prova. (Mandro, 211: 67)

Ndërsa Olluri dhe Ademaj në botimin e tyre shkencorë “Importance, Tasks and Principles of Criminal Traseology” parashohin parimet kryesore në të cilat mbështetet traseologjia:

*“Traseologjia mbështetet mbi këto parime kryesore:*

- *Çdo objekt i botës materiale ka një strukturë të jashtme individuale. Objektet e të njëjtit lloj midis tyre kanë strukturë të jashtme të përgjithshme e të përbashkët, gjë që i bën të jenë të ngjashme midis tyre. Por, secili prej tyre në strukturën e jashtme ka shenja individuale. Nuk ekziston asnjë objekt krejt i lëmuar. Çdo objekt, ka një relief me të ngritura e të thelluara, të cilin e pasqyron në gjurmë në çastin e kontaktit me një objekt tjetër të përshtatshëm. Në mjaft raste ky relief është kaq i imët (mikroreliev) sa për kërkimin, këqyrjen dhe ekzaminimin e tij nevojiten mjete të posaçme.*
- *Individualizimi i objektit bëhet në bazë të një tërësie shenjash të lidhura e të varura nga njëra-tjetra. Për të dalluar këtë tërësi shenjash individuale në strukturën e jashtme të objektit duhet njohur natyra e objektit, d.m.th., proceset e formimit të strukturës së jashtme në kohën e lindjes së objektit, kushtet e përpunimit dhe të përgatitjes së tij, të përdorimit, të ndreqjes, etj.*
- *Kështu, mjetit që përdoret nga fajtori si vegël thyerje, kur përgatitet, i jepet një formë e jashtme e caktuar me shenja të përgjithshme e individuale. Më vonë, në kushtet e ruajtjes, të përdorimit, të ndreqjes, struktura e jashtme e mjetit merr disa shenja të reja dhe i humb disa nga të parat. (Olluri, Ademaj, 2014:12182)*

Korajlić dhe Muharremi në librin e tyre gjurmën e definojnë si ndryshim material në realitetin objektiv: “Më gjurmë në aspektin kriminalistik sot nënkuptohen ndryshimet materiale në realitetin objektiv, të cilat janë të njohura dhe të cilat janë krijuar në lidhje ose me rastin e kryerjes ose të përgatitjes së veprës penale dhe të cilat kanë një vlerë të caktuar dëshmuese në procedurën e identifikimit kriminalistik (Korajlić dhe Muharremi, 2009: 431). Gjurmët mund të krijohen ose të shkatërrohen me veprimin e njerëzve, kafshëve dhe të gjësendeve. Të gjitha gjurmët e krijuara nga objektet e ndryshme në vendin e ngjarjes pasqyrojnë strukturën e jashtme të tyre. Këto objekte varësisht prej formës dhe strukturës që kanë, krijojnë gjurmë mbi sipërfaqet e objekteve të tjera si rezultat i forcës që ushtrojnë mbi to. “Në vendin e ngjarjes, metodat e traseologjisë ndihmojnë në zbulimin dhe studimin e gjurmëve, në sqarimin e mekanizmit të

kryerjes së veprës penale, në përcaktimin e numrin e autorëve dhe të dhëna fizike për ta, në drejtimin nga kanë ardhur e për ku janë larguar, mjetet që kanë përdorur etj.

Në laborator, detyra e traseologjisë është identifikimi i objektit që ka lënë gjurmën. Identifikimi traseologjik ka si detyrë edhe identifikimin e së tërës në bazë të pjesëve, d.m.th. përcaktimin e objektit, pjesët e të cilit më parë i përkitnin një të tërë..”(Myftari, 2008: 240). Latifi gjurmët i ndanë në gjurmë në kuptimin e ngushtë dhe gjurmë në kuptimin e gjerë: “Në kriminalistikë fjala “gjurmë” ka dy kuptime. Në kuptimin e gjerë ajo përfshinë ndryshimet që ka pësuar vendi ku është kryer vepra penale. Në kuptimin e ngushtë fjala gjurmë përfshinë ndryshimet e atilla në vendin e ngjarjes së veprës penale, ku pasqyrohet struktura e jashtme e objektit që ka lënë aty.” (Latifi, 2006, 368).

**Mikro dhe makro gjurmët** - Mikrogjurmët janë të gjitha gjurmët e mbetura në vendin e ngjarjes, të cilat nuk mund të vërehen nga shqisat njerëzore siç janë shikimi, nuhatja, shija, prekje etj. Këto gjurmë janë gjurmë të cilat krijohen nga përdorimi i forcës, i presionit të objektit mbi sipërfaqe, transferimi nga kontakti etj. Janë aq të vogla sa që nuk mund të vërehen apo identifikohen përmes shqisave të njeriut. Këto gjurmë mund të quhen edhe gjurmë mikroskopike, sepse mund të vërehen vetëm përmes zmadhimit mikroskopik apo zmadhuesve të tjerë.

Korajlić dhe Muharremi mikrogjurmët në aspektin natyrorë-shkencor mbi “teorinë e kontaktit” theksojnë: “Bazën natyrore-shkencore të teorisë kontaktuese të mikrogjurmëve e përbëjnë dukuritë si vijon:

- 1) shpëputja, thyerja, thërrmimi,
- 2) adezioni, dhe
- 3) difuzioni” (Korajlić, Muharremi, 2009: 433)

Makro gjurmët kanë rëndësinë dhe vlerën e tyre dëshmuuese në procedurë. Ato kanë rëndësi për faktin se kryerësi i veprës penale shumë vështirë mund t’i shkatërrojë apo zhdukë ato, për shkak të nivelit të tyre mikroskopik. d.m.th kryerësi i veprës penale nuk mund lehtë t’i vërejë ato. Këto gjurmë kanë vlerë të rëndësishme argumentuese në procedurë për faktin se e shtyjnë kryerësin të pranojë veprën penale, por edhe nëse kryerësi nuk e pranon atë, gjykata mund të vendosë bazuar në mikrogjurmën, por patjetër që ekspertiza traseologjike duhet të mbështetet në mendimin prej eksperti për lidhjen e kryerësit me mikrogjurmën. Ndërsa makro gjurmët janë të gjitha gjurmët e mbetura në vendin e ngjarjes, të cilat mund të vërehen nga shqisat njerëzore, siç janë shikimi,

nuhatja, shija, prekja etj. Këto gjurmë po ashtu janë gjurmë të cilat krijohen nga përdorimi i forcës, të presionit të objektit mbi sipërfaqe, të transferimit apo të kontaktit etj. Por, për dallim nga mikrogjurmët, këto gjurmë janë gjurmë të mëdha, të cilat lehtë vërehen pa pasur nevojë për përdorimin e mjeteve zmadhuese apo të mjeteve të ndriçimit.

Korajlić dhe Muharremi konsiderojnë se makro gjurmët fare lehtë mund të fiksohen: “Pasi që këto gjurmë lehtë vërehen, për fiksimin e tyre zbatohen rregullat e të vrojtuarit, të shënimit, të përshkrimit, të fotografimit, të skicimit, dhe të aservimit” (Korajlić dhe Muharremi, 2009: 434).

Varësisht prej llojit dhe strukturës së gjurmës zbatohet edhe metoda për fiksimin dhe procedimin e saj. Kështu, nëse kemi makro gjurmë të këpucëve në sipërfaqe të butë, aplikohet metoda e mullazhimit përmes materialit të caktuar siç është guri dental apo sulfuri. Gjurmët po ashtu varësisht prej sipërfaqes ku mbeshin dhe strukturës së objektit që i shkakton ato, ndahen në gjurmë dy dimensionale dhe tri dimensionale. Gjurmët dy dimensionale kanë dy dimensione gjatësinë dhe gjerësinë, paraqiten në sipërfaqe të fortë si p.sh. asfalt, beton, pllaka qeramike, metal, plastikë etj. Disa autorë ato i quajnë gjurmë sipërfaqësore. Ndërsa gjurmët tredimensionale kanë tri dimensione: gjatësi, gjerësi dhe thellësi, paraqiten në sipërfaqe të buta si p.sh. baltë, dhe, rërë, pluhur, borë etj. Disa autorë këtë lloj të gjurmëve i quajnë gjurmë relievore.

Në aspektin e krahasimit kriminalistik për identifikim, gjurmët ndahen në gjurmë klasore dhe gjurmë individuale. Gjurmë klasore janë të gjitha karakteristikat që posedon objekti të vendosura nga kompania prodhuese apo të vendosura gjatë prodhimit në fabrikë. Ndërsa gjurmët individuale janë karakteristika të veçanta (unike) si qarjet, prerjet, dëmtimet, gërvishtjet etj. të cilat paraqiten pas prodhimit si rezultat i kontaktit të objektit me objekte apo materiale të tjera.

**Llojet e gjurmëve** - Në vendin e ngjarjes varësisht nga objekti apo vegla që përdorët për kryerjen e veprës penale (armë zjarri, mjete të mprehta, thikë, kaçavidë, dara, shufër, apo ndonjë mjet tjetër) mbeshin gjurmët në formën dhe strukturën e tyre që pasqyrojnë mjetin e përdorur apo që paraqiten si rezultat i kontaktit apo i transferimit. Kështu në vendin e ngjarjes mund të hasen gjurmët e këpucëve, gjurmët e gomave të automjetit, gjurmët e veglave, gjurmët e xhamit, gjurmët e gjakut, gjurmët e dheut, fibra të ndryshme, fije floku, ngjyrë etj.

**Gjurmët e veglave** -Gjurmët e veglave janë gjurmë, të cilat krijohen si rezultat i presionit të forcës që ushtron një objekt mbi objektin tjetër. Zakonisht objekti që ushtron presionin e forcës është objekt më i fortë dhe i mbrehtë, për arsye të depërtimit apo thyerjes së objektit tjetër. Fjala është kur kryerësi i veprës penale përdorë mjetin e caktuar për shkaktimin e lëndimeve apo të thyerjeve me qëllim të kryerjes së veprës penale. Në këto rrethana si rezultatet e kontaktit të objektit me objekt nën ndikimin e presionit të forcës krijohen dëmtime, gërvishtje, apo shkëputje (prerje) relievore. I quajmë gjurmë relievore sepse edhe përkundër pamundësisë që ndonjëherë të mos vërehet sipërfaqja relievore, me rastin e shikimit të saj nën mikroskop vërehet qartë gjurma relievore. Pikërisht, ky element relievor ka rëndësinë e vetë shkencore me rastin e ekzaminimit të gjurmëve të veglave.

Tilstone, Savage, and Clark në librin e tyre gjurmët e veglave i ndajnë në dy grupe: “gjurmët nga presioni dhe gjurmët nga fërkimi”

Lexo me vëmendje argumentimin e tyre:

“Ekzistojnë dy lloje të gjurmëve të veglave: gjurmët nga ngjeshja dhe gjurmët nga fërkimi. Gjurmët nga presioni krijohen kur vegla shtypet mbi sipërfaqen e objektit, duke lënë gjurmë negative. Gjurmët nga fërkimi krijohen nga rrëshqitja, nga skrapimi apo nga lëmimi i veglës si leva, ose nga prerja, qethja apo copëzimi”. (Tilstone, Savage, and Clark, 2006: 274-275). Gjurmët nga ngjeshja e veglës krijohen nga shtypja apo nga presioni, të cilat në aspektin e krahasimit laboratorik nuk kanë karakteristika të mjaftueshme individuale. Këto gjurmë kanë një pasqyrim më të mirë të veglës nëse sipërfaqja kontaktuese është e butë siç janë llaqet, dylli, druri i butë, sapuni, plastika, plastelina etj. Ndërsa tek lloji i gjurmës nga gërvishtjet krijohen karakteristika të mjaftueshme individuale për krahasim laboratorik. Gjurmët e veglave kanë rëndësinë e pakontestueshme në identifikimin dhe në individualizimin e veglës së përdorur për kryerjen e veprës penale. Laboratorët e forenzikës përdorin metoda të njohura shkencore për ekzaminimin e tyre. Fillimisht ekspertit sigurohet se ka në posedim të gjitha objektet e nevojshme për kryerje të ekspertizës, siç janë: vegla e përdorur, objekti mbi të cilin është ushtruar presioni apo gërvishtja. Për krahasim laboratorik të gjurmës zakonisht përdoret mikroskopi stereo krahasues.

**Gjurmët e këpucëve** - Gjurmët e këpucëve krijohen si rezultat i presionit të forcës që ushtron këpuca mbi sipërfaqe. Gjurmët e këmbëve në vendin e ngjarjes flasin për kryerësin në vendin e

ngjarjes, drejtimin e ardhjes dhe të ikjes së tij. Në disa raste, gjurmët e këmbëve mund të na çojnë deri tek vendimi se a është provë që e lidh kryerësin me vendin e ngjarjes: “ Por, këto gjurmë mund të na sjellin informata të mjaftueshme për numrin e kryerëse në vendin e ngjarjes, për mënyrën e ardhjes në vendin e ngjarjes si dhe për drejtimin e ikjes etj.”( Jackson, 2008: 102).

Sipas kriminalistit të njohur francez Alfons Bartijonit i cili ka përpiluar tabelën sipas të cilës gjatësia e matur e gjurmës së këmbës së zbathur shumëzohet me numrin korrespondues dhe fitohet gjatësia e përafërt e trupit dhe kjo vlen për gjurmën e zbathur të këmbës.

| Gjatësia e gjurmës në mm | Koeficienti me të cilin shumëzohet |
|--------------------------|------------------------------------|
| Deri 219 mm              | 7.179                              |
| 220-229 mm               | 6.840                              |
| 230-239                  | 6.610                              |
| 240-249                  | 6.505                              |
| 250-259                  | 6.407                              |
| 260-269                  | 6.328                              |
| 270-279                  | 6.254                              |
| 280-289                  | 6.120                              |
| 290-299                  | 6.080                              |

**Gjurmët e gomave** - Ngjashëm sikurse gjurmët e veglave dhe gjurmët e këpucëve, edhe gjurmët e gomave janë gjurmë të cilat krijohen si rezultat i presionit të forcës që ushtron një objekt mbi objektin tjetër, përkatësisht goma mbi sipërfaqe. Gjurmët e gomave kanë rëndësi argumentuese në rastet kur autori për kryerjen e veprës penale përdor automjetin si mjet për kryerjen e saj. Rastet më të shpeshta paraqiten në komunikacion si vepra penale kundër sigurisë në komunikacion, siç janë aksidentet fatale, aksidentet “godit dhe ik”, aksidentet me të lënduar apo me dëme të konsiderueshme materiale. Në rrethana të tilla gjurma e gomës ka rëndësi argumentuese nëse zbulohet dhe procedohet sipas rregullave shkencore forenzike.

Nga gjurmët e gomave mund të përcaktohen elemente të rëndësishme, si:

- Drejtimi i lëvizjes së automjetit
- Pika goditëse në mes automjeteve apo në mes automjetit dhe këmbësorit
- Shpejtësia e lëvizjes së automjetit

- Koeficienti i rrugës
- Distanca e ndaljes së automjetit

Drejtimi i lëvizjes së automjetit: Mund të përcaktohet duke ekzaminuar profilin e luleve të gomës së automjetit. Dihet se secili lloj i gomës ka karakteristikat e veçanta, të cilat me rastin e kontaktit me sipërfaqe të ndryshme pasqyrohen në të. Këto karakteristika vendosen nga fabrika prodhuese e gomave. Lulet e gomës kanë rëndësi të veçantë në përcaktimin e drejtimit të lëvizjes së mjetit transportues. Eksperti me rastin e ekzaminimit të tyre krahason lulen e mbetur të gomës si gjurmë me modelin e njëjtë të gomës. Ky veprim ia mundëson atij të përcaktoj drejtimin e lëvizjes së automjetit.

Pika goditëse në mes automjeteve apo në mes automjetit dhe këmbësorit: Dimë se me rastin e aksidenteve në komunikacion shkaktohen pasoja njerëzore dhe materiale. Në mënyrë që të zbardhen rrethanat e aksidentit në komunikacion, kërkohet të gjendet pika goditëse midis automjeteve apo pika goditëse e automjetit me këmbësorin. Kur automjeti goditet me automjetin tjetër dëmtohen të dy automjetet, për pasojë pjesët e automjetit siç janë dritat, mbrojtësi apo ngjyra, apo dheu nën goma zhvendosen dhe bien mbi sipërfaqe, po ashtu pika më largët e gjurmëve të frenimit. Pikërisht këto gjurmë të krijuara dhe të mbetura në vendin e ngjarjes janë gjurmë, të cilat ndihmojnë ekspertin në përcaktimin e pikës goditëse. d.m.th nëse eksperti, në vendin e ngjarjes, gjen gjurmë të tilla, ato do të shërbejnë në krijimin e idesë dhe dhënien e mendimit për pikën goditëse. Pika goditëse midis automjeteve ndihmon organin e procedurës që të vendosë mbi fajësinë apo pa fajësinë e ndonjërit nga shoferët e automjeteve me rastin e shqyrtimit gjyqësor të fakteve dhe të rrethanave të aksidentit në komunikacion.

Shpejtësia e lëvizjes së automjetit: Një element tjetër i rëndësishëm në procedurë është përcaktimi i shpejtësisë së lëvizjes së automjetit në komunikacion. Shpejtësia e lëvizjes së automjetit para aksidentit në komunikacion ka rëndësi të veçantë në përcaktimin e fajësisë. Në shumicën e aksidenteve në komunikacion mbasin e gjurmët e frenimit. Gjurmët e frenimit paraqiten me rastin e kontaktit të gomës me sipërfaqen e rrugës. Për përcaktimin e shpejtësisë reale është me rëndësi që gjurma e frenimit të jetë e plotë dhe pa ndërprerje.

Ekipi i ekspertëve të komunikacionit me rastin e ekzaminimit të vendit të ngjarjes ndër të tjera për përcaktimin e shpejtësisë ndërmerr këta hapa:

-Gjurma e frenimit të rrotës së majtë dhe të rrotës së djathtë maten nga pika fillestare e gjurmës së frenimit e deri tek pika përfundimtare e saj. Nëse njëra nga gjurmët është më e gjatë se tjetra, nxirret mesatarja e tyre:  $a+b/2$ .

- Përcaktohet koeficienti i fërkimit të rrugës apo merret nga katalogu zyrtar.

- Të dhënat zbatohen në formulën:

$$V = \sqrt{2 S g \mu}$$

Ku:

v-shpejtësia

s-distanca e gjurmëve të frenimit

g-gravitacioni i tokës;  $g=9.81\text{m/s}^2$

$\mu$ -koeficienti i rrugës

2-konstant

Koeficienti i rrugës: Me koeficient të rrugës kuptojmë nivelin e rrëshqitjes së gomave të automjetit në shtresën e rrugës. Koeficienti i rrugës ndryshon varësisht nga kushtet e rrugës dhe gjendja teknike e gomave. Kështu asfalti i terur mirë me standard të lartë dhe gjendja e mirë teknike e gomave (goma të reja me lule të theksuara) përcaktojnë koeficient të lartë, drejt 1. Ndërsa asfalti i ngrirë dhe gjendja jo e mirë teknike e gomave (goma të vjetra me lule të patheksuara) përcaktojnë koeficient të ulët, drejt 0. d.m.th varësisht nga kushtet e lartshënuara koeficienti i rrugës ndryshon nga 03-09.

Koeficienti i rrugës, praktikisht mund të përcaktohet në këtë mënyrë: Automjeti zyrtar në gjendje të mirë teknike drejtohet me shpejtësi konstante deri në vendin e ngjarjes, me të arritur aty frenohet fuqishëm duke krijuar gjurmët e frenimit. Këto gjurmë maten dhe shënohen. Tani duke ditur gjatësinë e gjurmëve të frenimit dhe shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, koeficienti i rrugës mund të gjendet përmes formulës:

$$\mu = v^2/2gs$$

ku:

$\mu$ -koeficienti i rrugës

v-shpejtësia

s-distanca e gjurmëve të frenimit

g-gravitacioni i tokës;  $g=9.81\text{m/s}^2$

2-konstant



Distanca e ndaljes së automjetit: Me distancë të ndaljes kuptojmë distancën që i duhet automjetit për ndalje të plotë, duke përfshirë distancën për kohën e reagimit të shoferit dhe distancën e frenimit. Me kohë të reagimit të shoferit kuptojmë kohën që i duhet shoferit për të aktivizuar (shtypur padalën e frenimit). Kjo kohë ndryshon varësisht nga mosha dhe gjendja psiko-fizike e shoferit, e cila ndryshon nga 0.5-2 s. Kështu shoferët profesionistë konsiderohet se kanë kohë më të shkurtër të reagimit, ndërsa shoferët e moshuar apo nën ndikim të drogës apo të alkoolit kanë kohë më të gjatë të reagimit.

Distanca e ndaljes së automjetit mund të përcaktohet në këtë mënyrë: Duke ditur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit në kohën e reagimit të shoferit dhe duke i zëvendësuar në formulën:

$$S_{nd} + S_1 = S_2$$

$$S_1 = \frac{v^2}{2g\mu}$$

$$S_2 = t \cdot v$$

Ku:

$S_{nd}$ -Distanca e ndaljes së mjetit transportues

$S_1$ -distanca e gjurmëve të frenimit të mjetit transportues

$S_2$ -distanca që kalon automjeti për kohën e reagimit të shoferit

$v$ -shpejtësia

$\mu$ -koeficienti i rrugës

$g$ -gravitacioni i tokës;  $g=9.81\text{m/s}^2$

2-konstant

***Ekzaminimi laboratorik i gjurmës së veglës, të këpucës e të gomës*** - Gjurmët e zbuluara në vendin e ngjarjes dërgohen në laboratorin forenzik për ekspertim. Tek gjurmët e veglave dërgohet vegla e përdorur dhe objekti i thyer apo i dëmtuar. Në pamundësi të dërgimit të objektit, krijohet mullazhimi përmes mikrosilit. Ky pasqyrim i objektit në mikrosil dërgohet në laborator. Ndërsa tek gjurmët e këpucëve dërgohet këpuca e dyshimtë dhe gjurma e marr nga vendi i ngjarjes përmes mullazhimit. Mullazhimi është proces teknik i krijimit të pasqyrimin të gjurmës së këpucës në vendin e ngjarjes, i cili realizohet përmes gurit dental apo sulfurit. Nëse gjurma e këpucës është tri dimensionale zbatohet kjo procedurë: Mbi gjurmë vendoset kallëpi mullazhues, i cili duhet të prekë skajet e sipërfaqes së gjurmës, por jo gjurmën. Kallëpi mullazhues shërben për fiksimin e gurit dental apo të sulfurit mbi gjurmë. Përgatitet guri dental apo sulfuri në formë të

solucionit dhe hidhet mbi gjurmë. Hedhja duhet të jetë e ngadaltë dhe sistematike në të gjithë sipërfaqen e gjurmës deri në nivelin e kallëpit. Preferohet që në nivelin e mesëm të hedhjes së materialit të vendosen ca shkopinj të vegjël, të cilët rrisin fortësinë e solucionit. Pritet 10-15 minuta deri sa materiali të formësohet, hiqet ngadalë nga gjurma, largohen mbeturinat dhe dheu përmes pastrimit me ujë me brushë të butë, mullazhi dërgohet në laborator. Po e njëjta procedurë e mullazhimit përdoret edhe për gjurmët e gomave, vetëm se këtu për shkak të madhësisë së gomës, mullazhi është më masiv. Gjurmët e veglave ekzaminohen me mikroskopin stereo krahasues. Eksperti në këtë mikroskop krahason objektin me modelin në nivel të karakteristikave individuale. “Softuerët e rinj të kompjuterëve janë në gjendje të ndihmojnë shkencëtarët mjekoligjorë për të bërë krahasimin e gjurmëve të këpucëve. Për shembull një sistem identifikimi i automatizuar i gjurmëve të këpucëve i zhvilluar në Angli, i quajtur (SICAR)”. (Saferstein 2014: 491). Gjurmët e gomave dhe gjurmët e këpucëve ekzaminohen edhe në komperatorë apo përmes shikimit vizual. Janë dy metoda krahasimeve që mund të zbatojë eksperti gjatë ekzaminimit të tyre:

*Krahasimi transparent objekt-model:* aplikohet duke vendosur objektin (gjurmën e këpucës) dhe modelin (standardin e marrë nga këpuca e njohur) në shikimin transparent përmes materialit transparent-të tejdukshëm siç janë format standarde transparente për gjurmë këpuce.

*Krahasimi paralel objekt-model:* aplikohet duke vendosur objektin (gjurmën e këpucës) dhe modelin (standardin e marrë nga këpuca e njohur) paralel njëra me tjetrën për të krahasuar secilën gjurmë klasore apo individuale veç e veç.

Në të dy metodat eksperti fillimisht kërkon karakteristika klasore. Identifikimi i karakteristikave klasore i jep orientim atij për të vazhduar kërkimin për karakteristika individuale, e nëse nuk i gjen ato nuk vazhdon me ekzaminim, sepse mungesa e karakteristikave klasore nënkupton mospërputhje midis modelit dhe objektit. Kërkimi krahasimor për gjurmë individuale kërkon analizë të thellë të të gjithë sipërfaqes së modelit dhe objektit. Disa ekspertë preferojnë që kërkimin për karakteristika individuale të bëhet veç e veç, kështu duke shikuar fillimisht modelin e pastaj objektin. Në momentin e identifikimit të karakteristikave individuale eksperti shënon dhe indeksin pikën identifikuese me numër apo shkronjë apo diçka të ngjashme. Një pyetje e cila ngritet dhe diskutohet shpeshherë nga njohës të mirë të kësaj disipline është se sa duhet të jetë numri i karakteristikave të ngjashme individuale midis objektit dhe modelit në mënyrë që të quhet identifikim pozitiv. Përgjigja nga shumica e tyre është se nuk ka një limit të caktuar se sa

duhet të jetë ky numër, sigurisht thonë ata se sa më i madh të jetë numri i karakteristikave individuale aq më i argumentuar është konkluzioni, por se nuk ka ndonjë kufi të caktuar. D.m.th. çështja mbetet nën vlerësimin dhe argumentimin e ekspertit.

Eksperti i njohur botëror i forenzikës Henry Lee në librin e tij lidhur me ekspertizën laboratorike të gjurmëve të veglave thekson: Ekspertiza e gjurmëve të veglave në laborator për të bërë një ekspertizë të detajuar të gjurmëve të veglave, duhet pasur gjurmët nga vendi i ngjarjes dhe ato të lëna nga vegla”. (Lee, 1998: 196). Ndërsa Autori me famë botërore nga SHBA Bodziak në librin e tij thotë se në shumicën e rasteve, rezultatet janë të ndara në:

- (1) identifikime pozitive,
- (2) Identifikime jo pozitive (përgjashtimet-eliminimet), ose
- (3) Ekzaminimet jo përfundimtare. (Bodziak, 2000: 372).

Ekspertizën e gjurmëve të gomave në laborator e kanë trajtuar edhe autoret Myftari, Shishani dhe Kotri në librin e tyre ku cekin:

*Për ekzaminimin e gjurmëve të automjetit në laboratorin e kriminalistikës dërgohen kopjet e gjurmëve të nxjerra me kallëp (për gjurmën e thelluar) dhe fotografia e shkallëzuar (për gjurmën e sipërfaqshme), si dhe goma që dyshohet se ka lënë gjurmën. Në laborator, kur janë mundësitë, dërgohen edhe vetë objektet gjurme mbajtëse: teshat e viktimës, objektet e tjera të zbuluara gjatë këqyrjes, si: copa xhami, cifla ngjyre, materiale të rëna nga ngarkesa, etj. Ekspertiza traseologjike ka detyrë përcaktimin e tipit e të markës së automjetit dhe më tej identifikimin e automjetit konkret në bazë të gjurmëve dhe të karakteristikave të përgjithshme dhe individuale. (Miftari, Shishani dhe Kotri, 2010: 347)*

#### **4.3. Ekspertiza daktiloskopike**

Daktiloskopia është shkencë e cila merret me studimin e vijave papilare (gjurmëve të gishtërinjve) me qëllim të identifikimit të personit ose të përgjashtimit të personit si autor i mundshëm i veprës penale.. Daktiloskopia mbështet parimin se gjurmët e gishtërinjve, të pëllëmbëve të dorës dhe të shputave të këmbëve janë unike dhe individuale te çdo person. Këto parime janë përforcuar nëpërmes shkencës së anatomisë, të embriologjisë dhe të gjenetikës. Këto tipare anatomike të veçanta, të cilat formohen para lindjes janë të përhershme gjatë tërë jetës së

njeriut dhe nganjëherë edhe pas vdekjes. Gjurmët e vijave papilare janë përdorur në të gjitha vendet për identifikimin dhe për eliminimin e gjurmëve të vijave papilare nga rastet kriminale e civile nga komuniteti shkencor për më shumë se një shekull. Sistemi automatik i identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve (AFIS) siguron mbështetje shitesë për natyrën unike dhe detajet e gjurmëve të vijave papilare. Që nga zbulimi i këtij sistemi para më se 30 vjetësh, qindra apo mijëra kompjuterë kanë kërkuar në data baza të gjurmëve të gishtërinjve dhe vazhdojnë të kontrollojnë për 24 orë në 7 ditë të javës. Deri tash, dy gishta nga persona të ndryshëm nuk janë gjetur të jenë të njëjtë. Është e njohur se gishtërinjtë mund të jenë të gjatë apo të shkurtë, të trashë apo të hollë. Ata përdoren për kruarje, për mbajtje, për ledhatim dhe për ndijim. Po ashtu ata janë të ndjeshëm në nxehtësi dhe në ftohtësi. Ata i përkasin të pasurve, të varfërve, të talentuarve dhe lypsarëve. Kur ne i shtrëngojmë duart, ata simbolizojnë miqësi. “Identifikimi në bazë të gjurmëve të vijave papilare shpeshherë është çelës në zgjidhjen e një krimi. Eksperti i daktiloskopisë është i veçantë në kuadër të ekspertëve të tjerë të forenzikës, sepse daktiloskopia është shkencë objektive dhe ekzakte, konkluzionet e arritura nga ekspertët janë të rëndësishme dhe finale.

Collins në librin e tij konsideron se gishtërinjtë mund të përdoren edhe për kryerjen e krimeve.

*Lexo me vëmendje argumentin e tij: “Gishtërinjtë gjithashtu përdoren edhe në kryerjen e krimeve, dhe tani, në vend që të përdoren për gjërat që i cekëm më lartë, ata bëhen instrument të vrasjeve, të vjedhjeve, të djegieve dhe të veprave penale të ndryshme. Megjithatë, ata të gjithë lënë „kodin e tyre për thirrje,, në formën e një gjurme. Për vite me radhë, hetuesit kanë njohur këto gjurmë, po kurrë nuk kanë ditur si t’i përdorin, sepse ato janë dukur të njëjta për syrin e pa trajnuar për observim të këtyre detajeve. Gjyqi Suprem në Kaliforni në vitin 1946 deklaroi se „ gjurmët e gishtërinjve janë dëshmia më e fortë, për të provuar identitetin e personit,,. Gjurmët e gishtërinjve konsiderohen të jenë dëshmi direkte, dhe janë dëshmi më e mirë , të cilat mund të përdoren në ato raste kur identifikimi pozitiv është i domosdoshëm” (Collins, 2001: 4-5).*

Gjurmët e vijave papilare rezultojnë nga riprodhimi i vijave papilare që gjenden në gishtërinj, në pëllëmbë të duarve dhe në shputa të këmbëve. Këto gjurmë konsistojnë nga kombinimi i disa materieve që kanë origjinë nga sekrecionet natyrale, nga gjaku dhe nga kontaminimet.

Në udhëzuesin për gjurmë të vijave papilare të SHBA-së, përshkruhet përmbajtja e këtyre materieve. Në këtë udhëzues argumentohet:

*Sekrecionet natyrale kanë prejardhje nga gjëndrat e djersës dhe nga gjëndrat dhjamore dhe përmbajnë kamponim kimik të njohur. Sekretimet nga gjëndrat e djersës prej gishtërinjve, prej pëllëmbëve të duarve dhe prej shputave të këmbëve janë organike dhe joorganike, ndërsa prej gjëndrave dhjamore sekretohen vetëm materie organike. Të tjera materie që mund të gjenden në gjurmë të vijave papilare janë rezultat nga kontakti me materiale dhe mjedise të ndryshme. Gjurmët e vijave papilare mund të gjenden në të gjitha llojet e sipërfaqeve (USA, FBI. Laboratory Division, 2000:4).*

Shenjat e gishtërinjve janë ndër llojet më të vjetra dhe më të rëndësishme të provave të përdorura për identifikimin e njeriut. Individualiteti i shenjave të gishtërinjve është aq impresionues në vetëdijen e publikut.

Përdorimi i gjurmëve të vijave papilare në maje të gishtërinjve si mjet identifikimi personal daton shumë shekuj mbrapa. Një identifikim bindës i gjurmëve të gishtërinjve është pranuar botërisht si dëshmi e caktuar që identifikon një person të caktuar. Shenjat e gishtërinjve janë shpesh në thelb dy dimensionale (mbetjet e gjurmëve), por ato mund të jenë në sipërfaqe të buta pranuese dhe të jenë tre dimensionale (plastike).

Ne shpesh mendojmë për shenjat e gishtërinjve se ato përdoren kryesisht për të gjetur, për të identifikuar dhe për të eliminuar të dyshuar në rastet penale. Gjëja fillestare lëvizëse për zhvillimin e shenjave të gishtërinjve nuk është zgjidhja e rastit në tërësi, por identifikimi i qartë i individëve. Shenjat e gishtërinjve, së bashku me modelet e dhëmbëve, janë gjithashtu të rëndësishme në marrjen dhe identifikimin e qartë të mbetjeve të njeriut, kur metodat më konvencionale të identifikimit postmortum nuk mund të përdoren. Shenjat e gishtërinjve gjithashtu mund të mendohet se janë një anëtar i një klase të identifikuesve biometrikë që përfshin retinën ose modelet e irisit të syrit, të përballet termografia e fytyrës, gjeometria e dorës, dhe të tjerat. Si teknologji për skanim të shpejtë dhe ruajtjen e këtyre modeleve biometrike janë zhvilluar, ato janë bërë më të rëndësishme si bazë për sistemet e sigurimit, informacion të qasjes dhe sigurim të zonave të sigurta, dhe për të parandaluar identifikime të gabuara.

Është e rëndësishme për të kuptuar diçka rreth natyrës së shenjave të gishtërinjve, dhe bazat që kontribuojnë për të bërë ato individuale. Ne gjithashtu shohim se si përdorimi i shenjave të gishtërinjve u bënë kaq të rëndësishme në të dhënat dhe hetimet kriminale . Zhvillimi i shenjave të gishtërinjve si mjet identifikimi personal është një fije e madhe në zhvillimin e shkencave të mjekësisë ligjore në fund të shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20.

**Përdorimi i gjurmëve të gishtërinjve ndër vite** - Në gishtërinj, në pëllëmbë dhe në shputa të çdo njeriu gjenden elemente (tipare), të cilat nuk janë të njëjta me asnjë person tjetër në botë. Ky fakt i rëndësishëm ndër vite, është përshkruar në literatura të ndryshme profesionale. Disa fakte të rëndësishme janë përshkruar edhe në librin e nxjerr nga National Institute of Justice, lexo më poshtë:

*Këto elemente janë prezent në vijat papilare, të cilat kanë format e tyre në kontakt me ndonjë objekt apo sipërfaqe. Përdorimi i gjurmëve të gishtërinjve për identifikimin e personave është bërë i rëndomtë. Gjurmët e gishtërinjve janë përdorur ndër shekuj në disa kultura. Qysh para erës sonë në Kinën e lashtë janë përdorur gjurmët e gishtërinjve gjatë shitblerjes, të cilat kanë pasur më shumë rol mistik, duke e lidhur personin me mallin, por jo edhe rol identifikues.*

*Një enë prej argjile e vjetër 6000 vjet është zbuluar nga arkeologët në veriperëndim të Kinës në të cilën qartë dallohen gjurmët e vijave papilare. Këto gjurmë konsiderohen të jenë gjurmët më të vjetra të gjendura në ndonjë artefakt historik. Sidoqoftë këto gjurmë në objekt janë vendosur për ndonjë qëllim ose për dekorim të simboleve ose të formave. Në shekullin e 17 shkencëtarët evropian filluan të publikonin observimet në lëkurën e njeriut. Lëkura me vija papilare është përshkruar për herë të parë në detaje nga Dr. Nehemiah Grew. Marcelo Malpighi po ashtu dha kontribut të veçantë në këtë drejtim, sepse bëri zbulimin inventiv të mikroskopit të parë, duke i përshkruar vijat papilare të dobishme për ecje dhe kapje. Përgjithësisht është e njohur se Sir William Herchell është i pari mbi studimin e gjurmëve të vijave papilare. Henry Faulds ishte i pari që publikoi në një revistë shkencore, vlerën e gjurmëve të vijave papilare për identifikim e veçanërisht si dëshmi. Ndërsa Sir Francis Galton është i pari që ka botuar librin „Gjurmët e gishtërinjve” në vitin 1892 i cili dëshmoi se gjurmët e gishtërinjve janë unike dhe të përhershme. (National Insitute of Justice 2002:18).*

Një kërkues shkencor tjetër me rëndësi ishte Juan Vuchetich. Ky ishte i punësuar në departamentin e policisë në La Plata të Argjentinës, i cili u caktua si udhëheqës i zyrës identifikuese të antropometrisë. Vuchetich kishte studiuar kërkimet e Galtonit dhe filloi të eksperimentoi me gjurmët në vitin 1891, dhe filloi të daktiloskopoi personat në rastet kriminale dhe krijoi sistemin e tij të klasifikimit. Klasifikimi dhe identifikimi i gjurmëve të gishtërinjve sipas Vuchetich i aplikuar te të burgosurit ishte përdorimi i parë zyrtar i gjurmëve të gishtërinjve nga personeli i zbatimit të ligjit.

**Anatomia dhe fiziologjia e gjurmëve të vijave papilare** - Për të kuptuar rëndësinë dhe veçoritë identifikuese të gishtërinjve, përkatësisht gjurmëve të vijave papilare, duhet të kuptojmë edhe anatominë dhe fiziologjinë e tyre. Chambod, Lennard, Margot dhe Stoilović në librin e tyre japin shpjegim të hollësishëm lidhur me këtë, lexo me vëmendje:

*“Ana e brendshme e sipërfaqes së dorës nga maja e gishtërinjve e deri te llëra e dorës dhe shputat e këmbëve janë unike nga pjesa tjetër e lëkurës. Kjo është për faktin se kjo pjesë e lëkurës përmban kreshta fërkuese (vija papilare) dhe lugje ndërmjet tyre. Kreshtat fërkuese kanë pore në tërë gjatësinë e tyre dhe kullojnë djersë, e cila në kontakt me sipërfaqen (objektin) lënë një imazh ekzakt të vijave papilare si vula në letër. Kreshtat fërkuese përveç funksionit të lirimit të djersës kanë edhe funksionin e kapjes dhe të mbajtjes së gjësendeve” (Chambod, Lennard, Margot dhe Stoilovic, 2004:17).*

Dy premiset kryesore të gjurmëve të gishtërinjve që lidhen me identifikimin personal janë: qëndrueshmëria (të vazhdueshme dhe jetëgjata) dhe unike (ndryshojnë nga të tjerat). Të dy këto themele janë sfiduar dhe njëkohësisht janë verifikuar për 100 vjet të praktikës në identifikimin e gjurmëve të vijave papilare, por studimet shkencore mbetën brenda kërkimeve shkencore. Pra, fakti që janë unike dhe të përhershme e bënë të mundshëm identifikimin individual. Çdoherë kur prekni një gjësend varet edhe nga rrethanat, mirëpo është e mundshme që ju të leni aty një nënshkrim unik. Lëkura është organ themelor i trupit të njeriut. Gjurmët e vijave papilare nga gishtërinjtë, nga pëllëmbët e dorës, dhe nga shputat e këmbës paraqesin apo marrin formë të ndryshme të formave dhe të trajtave. Pra varësisht nga sipërfaqja ku paraqiten në përgjithësi ju referohemi si gjurmë të gishtërinjve, gjurmë shuplakore (nga pëllëmba e dorës) dhe gjurmë nga shputat e këmbëve. Është e njohur se funksioni thelbësor i lëkurës me kreshta fërkuese është

rritja e efikasitetit për kapjen dhe mbajtjen e gjërave. Chambod, Lennard, Margot dhe Stoilović në librin e tyre, përshkruajnë ndërtimin e lëkurës fërkuese:

*Lëkura zakonisht ndahet në dy shtresa kryesore. Shtresa e jashtme, e quajtur epiderma, është një epiteli i shtresuar nga pesë nënshtresa, të listuar si më poshtë (nga shtresa e mëposhtme) :*

- *Stratum germanitvum (shtresa gjenerative bazale).*
- *Stratum spinosum (shtresa spinose).*
- *Stratum granulosum (shtresa granulare).*
- *Stratum lucidum (shtresa e tejdukshme) .*
- *Stratum corneum (shtresa brinore).*

*Shtresa nën epidermë quhet dermë dhe është 15-40 më e trashë se epiderma dhe konsiston në masën kryesore të lëkurës. Shtresa brinore ( stratum corneum) është e ekspozuar ndaj mjedisit të jashtëm, dhe e përbërë nga 15-20 shtresa të qelizave të vdekura të cilat rregullisht dëmtohen (zhveshën) nga gërryerja. Të gjitha këto qeliza kanë origjinë nga qelizat në formë kubi të shtresës bazale (stratum germanitvum) të cilat migrojnë nëpërmjet shtresave epidermale drejt shtresës brinore. Morfogjeneza e lëkurës me kreshta fërkuese fillon gjatë javëve të para të shtatzënisë. Duart fillojnë të zhvillohen prej javës 5-6 të zhvillimit embrional. Gishtërinjtë e parë fillojnë të paraqitën rreth javës 6 dhe 7. Në këtë kohë të ashtuquajturat jastuqe volare fillojnë të paraqitën në pëllëmbë të dorës (zona tenare dhe hipotenare). Ndërsa në javën e 7 dhe 8 paraqitën jastëkët volare në mollëzat e gishtërinjve. Këto jastëk (mbushje) bëhen të qarta rreth javës 10, kur rritja e duarve e kalon këtë fazë dhe i bënë të padukshme rreth javës 16 të zhvillimit embrional. Ky fenomen shpesh është i përshkruar si faza e tërheqjes (regressive) e jastëkëve volare. Nga java e 11 deri 20 ndodhë zhvillim i madh i vijave papilare në lëkurë. Në javën e 24 të zhvillimit embrional zhvillimi në shtresën e dermës është finalizuar. Epiderma tani gradualisht formohet nga qelizat e shtresës dermale. Forma kryesore e modelit të gjurmës së vijave papilare është imazh projektues i strukturës së dermës (Chambod, Lennard, Margot dhe Stoilovic 2004:17).*



**Regjistrimi (daktiloskopimi) i shenjave të gishtërinjve** -Regjistrimi (daktiloskopimi) i personave të dyshimtë dhe për eliminim të gjurmëve nga vendi i ngjarjes bëhet në mënyrë fizike dhe me anë të pajisjeve elektronike si live ID apo live skaner. Pajisja themelore që përdoret për marrjen e gjurmëve të gishtërinjve përbehet nga pllakëza me ngjyrë, mbajtësi i kartelës, ngjyra e shtypësit (printerit), (ngjyrë e zezë e mbyllët) dhe një cilindër.

Kjo pajisje është e thjeshtë dhe jo e shtrenjtë (jastëku me ngjyrë, ngjyra për shtypje, ngjyra e zakonshme për shkrim apo ngjyra tjera nuk janë të përshtatshme për përdorim në punën e gjurmëve të gishtërinjve për derisa janë shumë të lehta apo të holla dhe nuk tërë shpejt). Këtë teknikë për marrjen e shenjave të gishtërinjve, Collins për regjistrim të personave rekomandon këtë procedurë:

*Për të marrë gjurmë të qarta dhe të dallueshme është e nevojshme që të shpërndahet ngjyra e shtypësit në një shtresë të hollë në një pllakë të vogël me ngjyrë, cilindri përafërsisht 9 cm. i gjatë, dhe 3 cm. në diametër. Pllakëza me ngjyrë mund të jetë e përbërë nga një pllakë metali të fortë dhe të ngurtë, rezistent ndaj gërvishtjes me dimension 18 cm i gjerë dhe 42 cm i gjatë. Qelqi po ashtu mund të përdoret për këtë qëllim. Pllakëza me ngjyrë duhet të jetë e vendosur në skaj të tavolinës dhe të sigurohet që të mos lëvizë. Lartësia e tavolinës duhet të jetë e ngritur në një lartësi të mjaftueshme, që të mundësoj që dora e personit të mbajë një pozitë horizontale përderisa gishtërinjtë ngjyrosen. Në të djathtë të pllakës është vendi ku vendoset kartela standarde e gjurmëve ose në mbajtësin e kartelës ose e siguruar në sipërfaqe me shirit. Zona e kartelës që përdoret duhet të izohet nga zonat e tjera kështu që ato të mos njollosen. Dhjet (10) gjurmët e sipërme duhet të merren në mënyrë individuale, gishti i madh, treguesi, i mesëm, i unazës dhe gishtërinjtë e vegjël të secilës dorë, të përmendura me radhë. Këto quhen gjurmë të 'rrotulluara', gishtërinjtë rrokullisen nga njëra anë në anën tjetër (nga thoni në thonë) që të merren të gjitha detajet e kreshtës. Gjurmët e vogla në pjesën e poshtme të kartelës merren përnjëherë nga gishtat e secilës dorë, pastaj gishtat e mëdhenj pa u rrokullisur (Collins:93).*

Problemet që shfaqen gjatë marrjes së gjurmëve të ngjyrosura, mund të ndahen në katër faza: operacioni mekanik; mangësitë e përkohshme; mangësitë e përhershme. Sfidë dhe punë e veçantë për ekspertët e daktiloskopisë është edhe marrja e shenjave të gishtërinjve nga personat e

vdekur, në faza të ndryshme të dekompozimit trupor. Në disa raste kur trupi është në fazat e hershme të dekompozimit daktiloskopimi bëhet gjatë autopsisë, ndërsa në disa faza të mëvonshme bëhet amputimi i duarve dhe punohet në kushte laboratorike për nxjerrjen e shenjave të vijave papilare nga gishtërinjtë. Në këto raste kujdes të veçantë i kushtohet sigurisë dhe shëndetit të ekspertëve që merren me këtë proces. Daktiloskopimi i personave apo regjistrimi i shenjave të gishtërinjve bëhet edhe duke përdorur live ID apo stacione të digjitalizuara për marrjen e shenjave të shuplakave të duarve përmes skanimit me rezolucion të lartë, dhe si rrjedhojë insertimin e tyre në sistemin AFIS në formate të caktuara varësisht prej sistemit kompjuterik që përdoret .

**Klasifikimi i gjurmëve papilare** - Përdorimi i gjurmëve të gishtërinjve për qëllime identifikimi është i bazuar në kreshtat e ndryshme të cilat duken në pjesën e brendshme në fundin e nyjave të gishtërinjve të dorës dhe të këmbës. Këto kreshta kanë kontura të qarta që shfaqen në modele të ndryshme, ku secila ka luhajtje të ndryshme në varësi nga forma dhe marrëdhëniet e kreshtave. Kufizimet e kreshtave duken shumë më qartë kur gjurma e ngjyrosur merret në letër, kështu që kreshtat janë të zeza në një prapavijë të bardhe. Ngjyra që ngjitet në lëkurën me kreshta fërkuese e arrin këtë rezultat. Haxhiu dhe Eshtrefi, në librin e tyre theksojnë:

*Njëherë kur të dhjetë gishtërinjtë regjistrohen në kartelën e gjurmëve, atëherë ato mund të klasifikohen për qëllime të kërkimeve të mëtutjeshme. Me fillimin e Sistemit Automatik të Identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve, sistemi i cili përdor metodën matematikore të kërkimit, klasifikimi i gjurmëve të gishtërinjve është duke u bërë një zanat i zhytur në mesin e ekzaminuesve të gjurmëve latente. Figurat që formojnë vijat papilare në mollëzat e gishtave janë shumë të shprehura, prandaj edhe studiohen në mënyrë të veçantë në kriminalistikë. Figurat papilare të gishtave të para në kompleksin e shenjave të përgjithshme e të veçanta të tyre, paraqesin variacione pa fund. Nga studimet dhe krahasimet e shumta që janë bërë në këtë fushë është arritur në konkluzionin se nuk mund të ketë dy gjurmë gishtash identike në të gjithë njerëzit e botës. Baza biologjike e këtij individualiteti është në vetë prirjet e zhvillimit natyror për ndryshim të vazhdueshëm dhe krijimin e llojeve të tjera. Pikërisht në llojshmërinë e pafund të*

*kombinacioneve që formojnë karakteristikat e vijave papilare buron një nga cilësitë themelore të tyre , individualiteti i plotë (Haxhiu dhe Miftari 2004:26).*

Gjurmët e gishtërinjve ndahen në tre grupe të përgjithshme të modeleve: në harkore; në lakore dhe në rrethore, të cilat janë të ndara në 9 nëngrupe për qëllime klasifikimi. Është e rëndësishme që të kuptohen disa terme teknike që përdoren në punën me gjurmë të gishtërinjve para se të kuptohet përkufizimi i modelit. Zona ku gjendet modeli është pjesa e vetme e gjurmës së gishtit që është një çështje kur bëhet përcaktimi i llojit të modelit dhe klasifikimi i mëtutjeshme. Është prezent tek secili model, mirëpo tek shumë harkore dhe harkore në formë tende është e pamundur të definohet. Kjo nuk është edhe aq e rëndësishme, sepse modelet e vetme tek të cilat duhet të definojmë zonën e modelit janë lakoret dhe rrethoret. Këto terme të gjurmëve të gishtërinjve Jones në librin e tij i përkufizon kështu:

*Tek këto dy modele zona e modelit mund të definohet si ne vijim:*

*Zona e modelit është ajo pjesë e modelit lakor apo rrethor tek e cila duket bërthama, delta dhe kreshtat që përdoren për klasifikim. Vijat e llojit përmbyllin zonat e modelit të lakores dhe rrethores. Vijat e llojit mund të definohen si dy kreshtat më të thella, të cilat fillojnë paralel, degëzohen dhe rrethojnë apo priren për të rrethuar zonën e modelit.*

*Vijat kufizuese nuk janë gjithherë dy kreshta të vazhdueshme. Në të vërtetë të shumtën e rasteve ato gjenden të ndara me njëra- tjetrën. Kur ka një hapësirë të caktuar tek vija kufizuese, kreshta që gjendet në pjesën e jashtme të saj konsiderohet si vazhdimësi e saj. Kur gjendet lokacioni i vijave kufizuese është shumë e rëndësishme që të dihet dallimi në mes të divergjencës dhe të bifurkacionit (degëzimit).*

*Bifurkacioni është degëzimi apo ndarja e një vije në dy apo më shumë.*

*Divergjenca është shpërndarja e dy vijave të cilat shkojnë paralel apo përafërsisht paralel me njëra tjetrën. Përbrenda modelit lakor apo harkor gjenden pikat fokale, të cilat përdoren për t'i klasifikuar ato. Këto pika quhen delta dhe bërthama. Delta është ajo pikë që gjendet në apo përballë qendrës më të afërt të divergjencës së vijave kufizuese. Bërthama, ashtu siç e shpjegon edhe emri vetë është qendra më e përafërt e gjurmës së gishtit. Do të jetë e nevojshme që të përqendrohemi me bërthamën e llojit lakore vetëm. Bërthama është e*

*vendosur në apo përbrenda pikës më të thellë te ri përkuljes. Numri i kreshtave që kalon në mes të deltës dhe të bërthamës njihet si kreshtë e numërueshme. Secila kreshtë që kalon apo e prek vijën imagjinare që shkon prej deltës tek bërthama numërohet. As delta e as bërthama nuk numërohen si kreshta. Karakteristikat e vijave papilare janë të njohura edhe me termat, pika, pika të identifikimit, detaje të Galtonit, minucione etj. (Jones, 2004: 38).*

Një shenjë e gishtit të daktiloskopuar apo të skanuar në live ID, mundë të përmbajë rreth 75-150 karakteristika individuale, ndërsa një pëllëmbë e dorës rreth 1000 sosh.

Në shumë juridiksione të shteteve të ndryshme nuk ka ndonjë standard të pikave që kërkohen për identifikim, por vlerësohet mendimi i ekspertit. Identifikimi i gjurmëve të vijave papilare nuk bazohet vetëm në numrin e karakteristikave individuale, por edhe në faktorë (elemente) të tjerë, siç janë skajet e strukturës së vijave papilare, lokacioni i poreve etj.

***Parimet themelore për ekzaminimin e gjurmëve të vijave papilare*** - Tre karakteristikat e shenjave të gishtërinjve që qëndrojnë në përdorimin e tyre si mjet për identifikime personale janë:

1. Çdo gjurmë gishti është unike për një individ.
2. Shenjat e gishtërinjve nuk ndryshojnë gjatë gjithë jetës, përveç nëse ka disa dëmtime të theksuara në shtresën dermale të lëkurës.
3. Ato mund të klasifikohen si të përshtatshme për kërkim në baza të dhënave.

Brenda një modeli të gjurmëve të gishtërinjve ka një numër të elementeve që quhen minucione. Në krahasimet për gjurmë të gishtërinjve, këto janë karakteristika të rëndësishme dhe vendimtare për ekspertët e daktiloskopisë, për të vendosur nëse janë apo nuk janë nga i njëjti burim (individ). Kjo metodologji përshkruan procesin e ekzaminimit të gjurmëve të vijave papilare dhe bazën shkencore në të cilën bazohen mendimet e ekspertëve të daktiloskopisë. Kjo ka për qëllim themelimin e parimeve mbi të cilat ekzaminimet janë mbështetur; krijimin e një metode për ekzaminimin e gjurmëve të vijave papilare dhe përshkrimin e konkluzioneve (përfundimeve) që mundë të dalin nga një ekzaminim. Morfologjia e vijave papilare është unike dhe e përhershme. Po ashtu vendosja (rregullimi) e karakteristikave individuale të vijave papilare është unike dhe e përhershme.

Haxhiu dhe Eshtrefi në librin e tyre, parashohin rrethanat në të cilat mund të mbesin (transferohet) gjurmët e vijave papilare.

*Një gjurmë e vijave papilare mund të transferohet gjatë kontaktit me sipërfaqe nga sipërfaqja e lëkurës fërkuese (nga gishtërinjtë; nga pëllëmba e dorës dhe nga shputat e këmbës).*

*Një gjurmë e vijave papilare që përmban cilësi dhe sasi të mjaftueshme të karakteristikave individuale mund të identifikohet, ose të përjashtohet (të eliminohet) nga një burim( nga një person).*

*Sasia e mjaftueshme e karakteristikave dhe e detajeve për identifikim apo për eliminim është mendimi (përcaktimi) i ekspertit i bazuar në detajet dhe në karakteristika unike që rrjedhin nga lëkura me vija papilare. Në procesin e identifikimit apo të individualizimit aplikohet analizimi i gjurmëve në nivelin e parë, të dytë dhe të tretë të detajeve (Haxhiu dhe Eshtrefi, 2004:32).*

Metoda më e mirë, apo protokolli më i sigurt për ekzaminimin e vijave papilare është metoda AKV-V. Akronimi i kësaj metode është AKV-V (Analiza, Krahasimi, Vlerësimi dhe Verifikimi).

Në udhëzuesin SWGFAST, kjo metodë përshkruhet si më poshtë:

*Analiza- është vlerësimi i një gjurme të vijave papilare për të përcaktuar përshtatshmërinë për krahasim. Faktorët që konsiderohen për analizë janë përfshirë në vazhdim:*

*a) Cilësia (qartësia) dhe sasia e detajeve.*

- *Niveli i parë i detajeve (modelet e gjurmëve).*
- *Niveli i dytë i detajeve (karakteristikat individuale).*
- *Niveli i tretë i detajeve (struktura e vijave papilare).*

*b) Burimi anatomik.*

- *Gishti.*
- *Pëllëmba e dorës.*
- *Shputa e këmbës.*

*c) Faktorët që ndikojnë në cilësinë janë:*

- *Teprica e mbetjes.*
- *Depozitimi.*
- *Sipërfaqja/substrati .*

- Mjedisi ku është depozituar gjurma.
- Metoda e nxitjes (zhvillimit).
- Metoda e ruajtjes prezervimi (p.sh. e tërhequr, fotografuar etj.)
- Kushtet e lëkurës me vija papilare.

Krahasimi- është i drejtpërdrejtë ose krah për krah i gjurmës së vijave papilare me shenjën e gishtit për të përcaktuar marrëdhënien reciproke të karakteristikave individuale në rend, në hapësirë dhe në renditje të caktuar.

Vlerësimi- është formulimi i një përfundimi (konkluzioni) të bazuar mbi analizën dhe krahasimin e gjurmëve të vijave papilare. Përfundimet të cilat mund të arrihen janë:

Identifikimi- është rezultat i krahasimit të dy gjurmëve të vijave papilare që përmbajnë:

cilësi të mjaftueshme (qartësi) dhe sasi të detajeve (karakteristikave) të vijave papilare. Identifikimi ndodh kur një ekspert i daktiloskopisë i trajnuar konstaton se dy gjurmët e vijave papilare kanë origjinë nga i njëjti burim (person).

Eliminimi (përrjashtimi)- është rezultat i krahasimit të dy gjurmëve të vijave papilare që përmbajnë cilësi të mjaftueshme (qartësi) dhe sasi të detajeve (karakteristikave) të vijave papilare. Eliminimi (përrjashtimi) ndodh kur një ekspert i daktiloskopisë i trajnuar konstaton se dy gjurmët e vijave papilare nuk kanë origjinë nga i njëjti burim (person).

Rezultatet jo bindëse (jo përfundimtare) - të vlerësimit është kur një ekspert i daktiloskopisë i trajnuar nuk mund të identifikojë ose të eliminojë (përrjashtojë) gjurmën e vijave papilare nga burimi anatomik (personi).

Rezultatet jo- përfundimtare të vlerësimit nuk duhet të interpretohen si një konkluzion i probabilitetit. Konkluzionet (mendimet) e ekspertit të daktiloskopisë si: e mundshme, apo ka gjasa të jetë e mundur (identifikimi) nuk janë të pranueshme në shkencën e daktiloskopisë.

Verifikimi- është ekzaminimi i pavarur i gjurmëve të vijave papilare (identifikimit apo eliminimit) nga një tjetër ekspert i daktiloskopisë i kualifikuar (SWGFAST 2002: 2).

Të gjitha identifikimet duhet të verifikohen. Po ashtu edhe eliminimet ose rezultatet jo- bindëse (jo përfundimtare) mund të verifikohen.

**Sistemi AFIS** - Sistemi automatik për identifikimin e gjurmëve të gishtërinjve - Ruajtja e të dhënave biometrike në kompjuter dhe sistemet për rikthim (ri kërkim) për shenjat e gishtërinjve janë zhvilluar dhe janë aplikuar fillimisht nga organet e zbatimit të ligjit. Sistemet bazë të zbatimit të ligjit të automatizuara janë quajtur zakonisht AFIS (Automated Fingerprint Identification System), ose në gjuhën shqipe (Sistemi Automatik i Identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve). Janë të njohura dy parime kryesore të aplikimit: e para është kërkimi në bazën e të dhënave dhjetë gishtore (të marra nga një person) dhe e dyta është kërkimi në bazën e të dhënave për gjurmët e zhvilluara nga vendi i ngjarjes. Që nga viti 1980 kanë qenë katër operatorë të sistemit AFIS, katër prej tyre janë komercializuar. Shumica e shteteve të mëdha që nga viti 1990 kishin sistemet e veta të instaluar.

AFIS është një sistem i lehtë për t'u përdorur për identifikim automatik të gjurmëve të gishtërinjve. Në këtë sistem mund të kryhen shpejt dhe saktë shumë detyra rutinë, mund të krijohen baza të të dhënave që përmbajnë dosje dhjetë gishtërinjve, gjurmë latente (të panjohura), shuplakë të dorës dhe gjurmë latente të shuplakës së dorës (të panjohura), dhe pastaj të përputhen gjurmët që futën me secilën nga këto baza të dhënash. Sistemi AFIS ka ndryshuar thellësisht mënyrën e operimit të hetimeve kriminale, duke i lejuar më pak kohë në krijimin e listave të personave të dyshimtë, po ju mundëson më shumë që të merren me listën e gjeneruar nga sistemi kompjuterik. Është me rëndësi të kuptohet se programi softuerik AFIS nuk ka për qëllim të zëvendësoj punën e ekspertëve të gjurmëve të gishtërinjve, por ka për qëllim të plotësojë punën e tyre. Megjithëse softueri automatikisht mund të zbulojë shumë detaje dhe tipare të tjera që bëjnë një gjurmë të gishtërinjve unike (të vetme), softueri llogaritë që ekspertët e gjurmëve të gishtërinjve të ri verifikojnë “vendimet” e tij, dhe kur është e nevojshme, të shtohet informacioni që përdor softueri për ta kryer një kërkim.

Për sistemin AFIS do të flasim më gjerësisht në kapitullin e gjashtë të këtij studimi.

**Zhvillimi i gjurmëve të vijave papilare** - Nxitja apo zhvillimi i gjurmëve papilare, për t'u bërë të përshtatshme për krahasim, është një aspekt i rëndësishëm i vendit të ngjarjes po ashtu edhe i procesimit të dëshmive. Para se gjithash ekzistojnë tri lloje të gjurmëve të vijave papilare në

vendin e ngjarjes: të dukshme; plastike dhe të padukshme (latente). Një gjurmë e dukshme nuk ka nevojë për ndonjë zmadhim apo zhvillim (nxitje) për ta njohur qartë se është gjurmë e vijave papilare. Këto gjurmë mund të mbesin nga yndyrat, nga ngjyra, nga vaji i errët, nga gjaku apo nga materiale të tjera me ngjyrë. Këto gjurmë mund të jenë të përshtatshme për krahasim pa ndonjë proces plotësues. Teknikat e zhvillimit të vijave papilare janë bazuar në përdorimin e metodave fizike dhe kimike, me qëllim që të bashkëveprojë me ndonjë komponentë të mbetjes së gjurmëve të vijave papilare. Lëkura me kreshta fërkuese (vija papilare) ka pore, përmes të cilave gjëndra të vogla të djersës nxjerrin përmbajtjen e tyre në sipërfaqen e lëkurës. Këto gjëndra të djersës prodhojnë një lloj të djersës së holluar, përbërja e së cilës formon mbetjet e gjurmës së vijës papilare. Një lloj tjetër i gjëndrave të djersës në sipërfaqe të tjera të lëkurës prodhon shumë djersë yndyrore. Materiali yndyror mund të jetë pjesë përbërëse e mbetjes së gjurmës së vijave papilare, nga personi i cili prek pjesë të ballit apo të flokëve, të cilat kanë këso lloj përbërje dhe ky material-djersitje me yndyrë transferohet në duar. Në mbetjet e gjurmëve të vijave papilare mund të gjenden një numër i pa limituar i përbërësve. Metodat për zhvillimin e gjurmëve të vijave papilare janë ndarë në bazë të njohurisë që kemi për përbërjen e gjurmës së vijave papilare. Me qëllim që aplikimi i metodave të jetë i suksesshëm, ekspertët forenzikë duhet të njohin sipërfaqet ku mund të nxirret gjurma, pa e dëmtuar integritetin e gjurmës. Këto metoda të nxitjes zakonisht ndahen në tri grupe: fizike, kimike, dhe kombinimi i metodave speciale të ndriçimit (e cila përfshin laserët dhe brezin e ngushtë të valëve që kalon nga burimi i dritës alternative deri te rrezet laser).

Hueske, në librin e tij thekson se nxitja e gjurmëve bëhet edhe në vend të ngjarjes, lexo më poshtë :

*Kur mendohet së potencialisht gjurmët e vijave papilare janë prezentë në vendin e ngjarjes, hetuesit dhe teknikët e vendit të ngjarjes kanë një zgjedhje: të aplikojnë metodën e zhvillimit të gjurmëve të vijave papilare në vend të ngjarjes ose të mbledhin dëshmitë relevante apo objektet dhe t'i dërgojnë në laboratorin e gjurmëve të gishtërinjve. Çdo dëshmi, objekt, apo sipërfaqe , që mendohet se ka gjurmë të vijave papilare duhet të dokumentohet duke u fotografuar dhe skicuar. Preferohet që objektet që mund të bartën lehtë , duhet të dërgohen në laborator. Në qoftë se është e pamundur apo jopraktike të largohet ndonjë sipërfaqe apo objekt, hetuesit mund të aplikojnë metodën e zhvillimit në vendin e ngjarjes.*



*Varësisht nga përvoja dhe trajnimi, hetuesit dhe teknikët në vendin e ngjarjes mundë të thirrin për këshill dhe asistencë ndonjë ekspertë të gjurmëve të gishtërinjve nga laboratorit i forenzikës ( Hueske, 2009: 117).*

Ndonjë gjurmë e nxitur në vendin e ngjarjes duhet të fotografohet dhe të tërhiqet, nëse është e mundur. Kur kjo nuk është e mundur atëherë patjetër duhet të fotografohet nga afër.

Metodat kimike, tradicionalisht kanë qenë procesimi me nitratin argjendi, jod, ninhidrinë apo DFO. Njëra nga metodat më të vjetra të zhvillimit kimik është ninhidrina.

Ninhidrina reagon në komponentët kimik të quajtura aminoacide, e cila pas reaksionit formon “Ruhemann’s puple”. Ninhidrina aplikohet me zhytje, spërkatje dhe lyerje. Kjo reagon ngadalë, nëse reaksioni nuk përshpejtohet nga nxehtësia dhe lagështia. Ndoshta metoda më produktive për zhvillimin (nxitjen) e gjurmëve të vijave papilare në letër (sipërfaqe poroze) është procedimi me ninhidrinë.

Në manualin e ENFSI, përshkruhen mënyrat e procesimit me ninhidrinë. Lexo me vëmendje:

*Janë dy metoda të procesimit me ninhidrinë. Metoda më e mirë është me zhytje, sepse me spërkatje grimcat e imëta të ninhidrinës në ajër janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Solucioni më i thjeshtë i ninhidrinës përgatitet me 25 gr kristale të ninhidrinës dhe në katër litra tretës. Tretësi më i zakonshëm për zbërthimin e ninhidrinës është acetoni. Po ashtu edhe metanoli zbërthen shumë mirë. Nëqoftëse dëshmia (dokumenti) është i rëndësishëm , atëherë duhet të fotografohet. Nxitja e zhvillimit të plotë merr disa ditë ose javë. (ENFSI-EFPWG 2007: 68).*

Nganjëherë gjurmët e vijave papilare mundë të bëhen të dukshme duke e ndriçuar nga një kënd i zhdrejtë. Kjo teknikë mundë të jep rezultate me dritë normale apo me dritë siç e quajmë “burim i dritës alternative”. Këto burime janë të veçanta me intensitet të lartë, që shpesh përdoren filtra, për të kontrolluar gjatësinë valore. Burimet e dritës alternative zakonisht përdoren në bashkëveprim me disa kemikate si nitrati i argjendit ( $\text{AgNO}_3$ ), DFO etj. Shpesh, procesimi me këto kemikate rezulton në prodhimin e komponentëve specifike floureshent, kur ndriçohet me dritë të gjatësive të caktuara valore. Ky është parim bazik në përdorimin e dritës alternative dhe të burimeve të tjera laserike. Një laser emiton intensitet të lartë të një gjatësie valore të caktuar. Zhvillimet e fundit në këtë kontekst kanë mundësuar zhvillimin e lumineshencës (ndriçimit) të

nano grimcave për zmadhimin e gjurmëve të vijave papilare. Në web faqën e IAI (International Association for Identification) përshkruan mënyrën e aplikimit të këtij reagjenti:

*Nitrati argjendi përdoret për t'i zhvilluar gjurmët e vijave papilare në sipërfaqet absorbuese. Ai reagon me sodium chloride (kripë) e cila gjendet në përbërjen e mbetjes së gjurmëve. Nitrati argjendi mund të përgatitet me dy komponentë të ndryshëm-ujë dhe alkool. Një solucion me bazë alkooli mundë të përgatitet për t'i procesuar mostrat ( p.sh. letrën e parafinuar, karton ) e cila mund ta zmbars (ndaloj) përzierjen me bazë uji (www.cbdi.ai.org).*

Gjurmët latente të zhvilluara me anë të metodës së nitrati argjendit në disa lloje të letrës së shkëlqyer, shpesh zhduken brenda orëve. Këto gjurmë të vijave papilare duhet fotografuar sa më shpejtë që është e mundur.

Një nga reagjentët kimikë të rëndësishëm është edhe 1,8 diazafluorene-9-one- ose DFO e cila reagon me aminoacide në gjurmën latente në sipërfaqe poroze (letër), e cila na jep ngjyrën dhe fluoreshencën. Me aminoacide ajo jep pigmente të kuqe të njohura si “Ruhemann’s purple”.

Seferstein në librin e tij argumenton se:

“Dëshmitë e trajtuara me DFO për kërkimin e gjurmëve të vijave papilare, japin një rezultat të shpejtë dhe kualitativ, kjo e bënë që DFO të konsiderohet si një ndër reagjentët më të mirë për kërkimin e gjurmëve në letër apo sipërfaqe poroze . DFO përdoret e para në nxitjen e gjurmëve, para se të shkohet me ninhidrinë apo me reagjent të tjerë.

Dëshmitë me DFO mund të zhyten apo spërkaten.

Gjurmët e gishtërinjve të kontaminuara me gjak kanë një vlerë speciale, sepse ia mundësojnë ekspertëve të përcaktojnë edhe kohën kur gjurmët janë bërë. Një nga kufizimet e gjurmëve të vijave papilare është ajo, që një individ i cili ka qasje normale në vendin ku është kryer vepra penale, është bërë në kohën kur është kryer vepra penale, para se të kryhet vepra penale ose pak pasi që është kryer vepra penale. Gjurmët e vijave papilare me gjak duhet lënë (mbesin) në kohën e gjakderdhjes dhe para se të thahet gjaku. Në rrethanat në të cilat gjurma e vijave papilare me gjak duhet të nxitet me reagjent kimik, për t’u bërë më e dukshme për krahasim, ekspertët e vendit të ngjarjes duhet të mendojnë nëse duhet të marrin mostër për profilin e ADN-së. Botimet e konsiderueshme lidhur me studimin e dëshmive, tregojnë se shumica e metodave për zhvillimin e gjurmëve të vijave papilare, përfshirë edhe këto të dizajnuara për gjurmë të gjakut nuk ndërhyjnë në sekuencat e profilizimit të ADN-së. Por, kjo situatë është një nga ato kur

diskutimet në mes ekspertëve të gjurmëve të gishtërinjve, të ekspertëve të ADN-së, dhe të hetuesve janë të rëndësishme. Gjurmët e vijave papilare të depozituara në shirita, veçanërisht në sipërfaqe ngjitëse, paraqet një rast tjetër special. Metodatat për bërjen e tyre të dukshme përfshijnë ngjyrosjen me reagjentin kimik “kristal violet” dhe “sticky side powder”.

Metoda e super ngjitësit (cianokrilati) e avullimit dhe e zhvillimit të gjurmëve latente të gishtërinjve është vërtetuar të jetë një mjet efektiv për ekspertët profesional, dhe kualiteti i rezultateve të saj e ka bërë atë të popullarizuar. Çdo agjenci që punon me gjurmët latente të gishtërinjve dhe që ende nuk e përdor metodën e avullimit të super ngjitësit duhet që seriozisht të mendojë për adoptimin e saj. Super ngjitësi reagon në aminoacide, acide yndyrore, dhe proteina, në gjurmët latente të gishtërinjve dhe në lagështinë e ajrit për të prodhuar materiale ngjitëse të bardha të dukshme që formohen për gjatë brazdave të gjurmëve të gishtërinjve. Rezultati përfundimtar është një pamje e tërësishme e gjurmës latente të gishtërinjve. Kjo pamje mund të fotografohet drejtpërsëdrejti, ose pasi të jeto zmadhuar, por edhe mund të procedohet me pluhur magnetik apo jo magnetik.

Një rast tjetër i veçantë për nxitjen e gjurmëve të vijave papilare është zhvillimi i gjurmëve të vijave papilare në lëkurën e njeriut, në rastet pothuajse kur trupi është i dekompozuar. Qëllimi është që të nxjerrën gjurmët e gishtërinjve të atyre që e kanë prekur trupin e personit. Në rastin e vrasjeve, posaçërisht në rastin e mbytjeve manuale (shtrëngim me duar), gjurmët e gishtërinjve të personit mund të nxitën në trupin e viktimës. Një varietet i metodave të ndryshme është provuar për këtë qëllim, për disa vite.

#### **4.4. Ekspertiza balistike**

Armët e zjarrit janë përdorur me qindra vite gjatë historisë njerëzore, dhe në kryerjen e veprave penale zënë një vend të posaçëm për hetim. “Arma më e vjetër është gjetur nga arkeologët në Kinë, në Manxhuri më 1288. Nga vitet 1600, armët e zjarrit po bëheshin pajisje esenciale për ushtritë e kombeve evropiane, anembanë globit, në të dy Amerikat, Afrikë, Azi dhe Australi” (King, 2009: 17). Balistika studion: “metodat e mjetet tekniko-shkencore për zbulimin, fiksimin dhe ekzaminimin e gjurmëve të lëna nga armët e zjarrit, nga municionet, për identifikimin e armës së zjarrit, për përcaktimin e gjendjes teknike të armës së zjarrit, për hetimin dhe gjykimin e çështjes penale” (Begeja, 2004: 193).

“Balistika është e ndarë në balistikë të brëndshme, balistikë të jashtme dhe balistikë terminale.” (DiMaio, 1999: 71).

*Balistika e brendshme*: Balistika e brëndshme mbaron aty ku predha lë tytën. “Arma mund të vazhdojë për të ndikuar në ikjen e predhës edhe pas kësaj pike, përmes oscilacioneve ose nëpërmjet gazrave që pasojnë dhe arrijnë predhën.” (Warlow, 2003: 65). Ekzistojnë tre faktorë që e diktojnë shpejtësinë me të cilën plumbi del nga arma:” sasia e materialit eksplodues, masa (apo pesha) e plumbit dhe gjatësia e tytës”.(Begeja, 2004: 195)

“Kur gjilpëra goditëse e armës së zjarrit godet kapsollën e gëzhgjës, përbërja e kapsollës ndizet duke dërguar zjarr në gëzhgjë. Baruti në gëzhgjë fillon të ndizet duke e ndryshuar (shndërruar) atë prej materialit të ngurtë në një gjendje të gaztë.”(Ademaj, 2010: 348).

*Balistika e jashtme (fluturimi i predhës)*: Merret me fluturimin e predhës nga tyta e armës deri të caku. “Kjo është e ndërlikuar dhe përfshin parametra të tilla si formë predhe, presion atmosferik dhe madje më të madhe kalibri i armës dhe rrotullimi i vjaskave”.(Heard, 2008: 111)

“Pika fillestare – distanca ku trajektorja e plumbit së pari e kryqëzon vijën e shënjestrës. Kjo zakonisht ndodh në distancë prej 22. 86 m”. (Ademaj, 2010: 348)

*Balistika përfundimtare (ndeshja me cakun)* -Kështu balistika terminale studion efektin e predhës në cak.” Efekti në cak është i kushtëzuar në masën dhe shpejtësinë, edhe pse nuk mund të lihen anash faktorët si: forma e predhës, lloji i cakut, lokacioni i goditjes etj. ”(Carlucci, 2008: 352). Pra, mbas shtënies me armë zjarri, mbesin gjurmë të ndryshme në vendin e ngjarjes, në trupin dhe rrobat e viktimës, në objekte dhe te vetë kryerësi. “Me anë të interpretimit të marrëdhënieve të ndërsjella të gjurmëve të ndryshme relative, mund të konstatohet shkaku i vdekjes (vrasjes, vetëvrasjes apo rastit aksidental)” (Ademaj, 2010: 350).

***Llojet e armëve të zjarrit dhe të municionit*** - Me armë zjarri kuptojmë mjetet të cilat mund të hedhin predha nën presionin e gazrave të barutit. Ekzistojnë klasifikime të ndryshme të armëve të zjarrit: “Sipas destinacionit: armë ushtarake, të gjuetisë dhe sportive; Sipas gjatësisë së tytës: armë me tyta të gjata (ushtarake dhe të gjuetisë) dhe me tyta të shkurtra (revolverë dhe pistoletë)” (Sipas prodhimit: “Armë të fabrikuara, të punuara me dorë dhe të ripunuara. Për kriminalistët më shumë interes paraqesin armët e zjarrit të punuara me dorë, në radhë të parë pistoletat dhe pushkët, ndonjëherë edhe revolverët, përdorimi i të cilëve te ne është relativisht i

rrallë.”(Gregor, 1999: 117-118). Sipas kalibrit: “Moment tjetër i rëndësishëm që duhet shfrytëzuar për zbulimin e llojit, modelit të armës nëpërmjet predhës është edhe përcaktimi i kalibrit të armës nëpërmjet peshës së predhës së fiksuar në vendin e ngjarjes”.(Mandro, 2000: 32). Kalibri paraqet: “diametrin e brendësisë së tytës që matet me një të qindtën e inç-it (.01) (ku një (1) inç është 2.54 cm). Përcaktimi i kalibrit është vetëm një zbulim i përafërt me diametrin e brendësisë së tytës dhe është përafërsisht diçka i ngjashme me diametrin e gravurave (vjaskave)”. (Mandro, 2000:27). “Ky përcaktim mundëson mënyrën fillestare grupore siç është identifikimi i kalibrit 38 me 9 mm. Diametri i vrimës është kalibri” (Seferstein,2014: 461). Sipas fushave dhe vjaskave: “Gjatë prodhimit, fabrikantë të ndryshëm, sipas mundësive dhe preferencave, kanë prodhuar armë me 2-3 vjaska dhe janë armë jashtë serie. Ka armë me 4 vjaska, që janë më tepër të përhapura, por edhe me 6 e më tepër vjaska.” (Mandro, 2000: 27).

**Municionet** – Ashtu sikur që ka një shumëllojshmëri të armëve nuk ekzistojnë lloje të ndryshme të municioneve. Po një ndarje me reale do të ishte në municione të armeve të gjata dhe municione të armëve të shkurta. Ekziston një diferencë e madhe në mes të municionit të pistoletës dhe të pushkës: “Municioni për pistoletë është projektuar të jetë i saktë në një varg prej rreth 40 metra, ndërsa të pushkëve duhet të jenë të aftë për të goditur një objektiv deri në 1000 apo më shumë metra larg. Municioni për pistoletë zakonisht është me gëzhgjë të drejtë. Municioni i pushkës shpesh është " qafë shishe ", kështu që ajo mund të përmbajë një sasi të madhe të barutit.”(Mahoney dhe tjeret, 2005: 39) Karakteristikë e cila i dallon municionet e armeve të gjata janë ato në mes të pushkëve dhe të armëve të gjuetisë, sepse armët e gjuetisë tytën e kanë të lëmuar, prandaj kanë edhe një ndërtim të ndryshëm fishekët e këtyre armëve. “Një armë e gjahut nuk është në gjendje të rrotulloj predhën. Si rezultat, predha teke duhet të jetë e aftë për fluturim të qëndrueshme pa rrotullim. Forma më e zakonshme e fishekut të armëve të gjahut përmban saçma të bëra nga plumbi, ose nga hekuri i butë. Numri i saçmave shkon nga një e vetme e deri në disa qindra, varësisht në diametër të tyre”.(Beat, dhe tjerët, 2011: 48). Fisheku kryesisht përbëhet nga kapsolla, baruti, gëzhgoja dhe predhat.

**Gjurmët në gëzhgjë dhe në predhë** - “Shenjat karakteristike për gëzhgjë dhe predhën e një fisheku që është qëlluar nga një armë mund të njihet si “gjurmë gishtash” për identifikimin e armës së zjarrit.”(Chen, 2009: 141). “Ekzaminimi i një gëzhgoje të fishekut që është shtënë mund

të bëjë të mundur identifikimin e një arme në drejtim të llojit dhe të modelit. Prania e shenjave të foles së fishekut, madhësia, forma, dhe vëndndodhja e hjekësit dhe jashtëqitësit janë të rëndësishme në bërjen e idenifikimeve të tilla. “(DiMaio, 1999: 60). Predha që del nga tyta mban shenjat e sipërfaqes së brendshme të prodhimit, “këto shenja pasqyrojnë karakteristikat e tytës, sepse aty nuk ka asnjë mënyrë praktike për të bërë një krahasim të drejtpërdrejtë ndërmjet shenjave në predhë që qëlloi dhe ato që gjenden brenda një tyte. Eksperti duhet marrë si provë predhën që u qëllua nëpër tytë të dyshuarit për krahasim”(Sapp: 65). Sikurse predhat edhe gëzhgojat gjatë shkrepjës së armës, për shkak të kontaktit të predhës me vijaska dhe kapsollës nga gjilpëra goditëse, gëzhjojës gjatë qëndrimit në fole dhe gjatë daljese pas shkrepjes krijohen karakteristika të veçanta idnividuale. Këto karakteristika janë unike dhe të papërsëritshme. Ky fakt i rëndësishëm bën që eksperti i balistikës gjatë ekzaminimit mikroskopik të modelit me objektin të zbuloj përputhshmërinë midis tyre. Shiqimi krahasimorë behet me mikroskopin stereo krahasues të llojit Leica FS C apo Meiji EMZ-5TR.

***Përcaktimi i modelit dhe i llojit të armës në bazë të gëzhjojës apo të predhës*** - Përcaktimi i modelit dhe i llojit të armës në bazë të predhës mund të bëhet në bazë të “gjurmëve që lë kanali i tytës në predhë si drejtimi, numri, gjerësia, dhe këndi i vjaskave, sepse llojet dhe modelet e armëve kanë drejtim, numër, gjerësi, dhe kënd të ndryshëm të vjaskave.” Në vendin e ngjarjes, “ku janë përdorur armët e zjarrit, ku janë lënë gjurmë, gëzhgoja, predha, mund të përcaktohen shumë rrethana për zbulimin e veprës penale dhe të fajtorit. Ndër këto rrethana më të rëndësishme janë: koha, largësia, drejtimi dhe vendi i qitjes” (Begeja, 2004: 216).

***Përcaktimi i kalibrit të armës së zjarrit*** - “Informacioni më themelor në lidhje me një armë është “kalibri i saj. "Kalibër" është një term konfuz i artit. Në teori, kalibër është diametri i tytës së armës së zjarrit, duke mos përfshirë thellësinë e vjaskave. Kalibër është dhënë zakonisht në 1/100 e një inç (0,22, 0,45) (ang. (.22, .45), në milimetra (9mm, 40mm).9” (Steele: 10). Janë të njohura dy metodat për përcaktimin e kalibrit të armës: E para është metoda e matjes me nonius të pjesës së brendshme të tytës në lartësinë e brigjeve të vjaskave dhe e dyta është metoda përmes leximit të të dhënave në bazën e fishekut, ku varësisht nga prodhuesi shënohet kalibri, lloji, prodhuesi, viti i prodhimit. etj.

**Përcaktimi i distancës së gjuajtjes me armë zjarri** - Largësia nga e cila është bërë qitja, në disa raste, mund të caktohet në bazë të thellësisë së depertimit të predhës, i cili ka mbetur në objektin e goditur.” Veprimi i qitjes varet jo vetëm nga lloji i armës, kualiteti i municionit dhe distanca, por edhe nga një sërë rrethanash të paparapara, siç janë drejtimi i erës, këndi i rënies, rezistenca e rrobave ose e ndonjë objekti, pozita dhe lëvizjet e të goditurit etj. Me lartësi qitëse kuptojmë largësinë midis tytës së armës (grykës) dhe (vrimes së hyrjes së predhës në objekt, viktimë, send). (Latfi, 2014:5 68). Përcaktimi i lartësisë së qitjes ka një rëndësi të madhe pasi ndihmon në qartësimin e rastit nëse kemi të bëjmë me një vrasje, vetëvrasje apo aksident. “Një ndihmë të madhe në këtë drejtim jep ekzaminimi i të ashtuquajturve faktorë plotësues të qitjes, mbasi sa herë që një armë zjarri shkrepet, dalja e predhës shoqërohet nga këta faktor, të cilët shpërndahen në trajtën e një koni me bazë të kthyer në drejtim të fluturimit të predhës.”(Xasanov, dhe tjeret, 2013: 366).

Faktorët plotësues të qitjes janë:

- “Një rrymë flake që shkon 2 deri në 5 cm largësi, duke krijuar një temperaturë prej 3000 °C, për shkak të djegies së kokrrizave të barutit në kontakt me oksigjenin e ajrit;
- Një re gazi që lëviz me shpejtësinë e predhës me mekanizmin e një kompresori rrethor që arrin deri në 20 cm;
- Karbon ose blozë nga baruti i djegur që arrin deri në 30 cm;
- Grimca të padjegura të barutit që arrijnë deri në 1 m.”(Meksi, Blakaj, 2010: 62)

Nga pikëpamja mjekoligjore dhe kriminalistike, “në varësi të largësisë midis tytës së armës dhe sipërfaqës së trupit, predha dhe faktorët plotësues influencojnë në pamjen dhe formimin e plagëve të vrimes së hyrjes së predhës nëpërmjet katër distancave të qitjes: qitje me puthitje të plotë; qitje me puthitje të pjesshme; qitje nga afër; qitje në largësi.”(Meksi, Blakaj, 2010: 63).

**Përcaktimi i mbetjeve-grimcave të barutit GCR** - Kur një fishek është gjuajtur (qitur) nga një armë, kapsulla dhe baruti do të çlirohen në të njëjtën kohë. Edhe pse nitroceluloza është relativisht një material i zakonshëm, i përdorur shpesh në “ngjyra dhe llaqe”, gjetja e gjurmëve të këtij materiali në lidhje me nitroglicerinen dhe ndoshta dinitrotoluenin në dorë, në flokë apo në rrobat e një të dyshuari, do të mbështesë gjasat që ai e kishte pasur një armë zjarri kohët e fundit, apo kishte qenë në afërsi të njërit që kishte gjuajtur, duke përdorur një fishek të ngarkuar me një pluhur të dyfishtë-bazë.”(Warlov, 2003:71)

Prania e disa ose të gjitha komponenteve “lejon një ekspert për të bërë deklarata të caktuara lidhur me probabilitetin e qitjes me një armë, prania në afërsi të një arme e cila u shkarkua ose trajtimin e një arme.”(Hueske, 2006: 135)

“Bariumi, antimoni, ose substanca të tjera që gjenden në duar, tregojnë se një armë është shkarkuar kohët e fundit”. (Fisher, 2004: 284). Aftësia për të përcaktuar nëse një person ka gjuajtur me armë zjarri është i rëndësishëm së madhe në hetimin e vrasjeve dhe të vetëvrasjeve. Kështu, me kalimin e viteve një numër i testeve janë zhvilluar në një përpjekje për të mbushur këtë nevojë. “Testi i parë i tillë ishte "test parafine" e njohur edhe si "nitrat i lëkurës apo" test difenilamine. Ajo u prezantua në Shtetet e Bashkuara në vitin 1933 nga Teodoro Gonzalez. Testi me parafinë është në të vërtetë jo specifik dhe i padobishëm shkencërisht.”(DiMaio, 1999: 342). Testi “cal” ndihmon në zbulimin e pranisë së bariumit dhe të antimonit në duart e individëve, të cilët kanë shkrepur me armë zjarri. “Këto metale, të cilat burojnë nga kapsolla e një fisheku në shkarkimin e një arme, janë depozituar në anën e pasme të dorës së qitjes si grimca, për këtë është ndoshta paraprakisht më i rëndësishmi në fushën e ekzaminimit forenzik të armëve të zjarrit që nga zbulimi i krahasimit mikroskopik.”(Heard, 2008: 241).

Sot metoda e cila gjen aplikim të gjerë në përcaktimin e mbetjeve të barutit pas qitjes me armë është testi përmes SEM (Scanning elektronik Microscope-Mikroskop i elektorn skanues), e cila në mënyrë të saktë përcakton elementet kimike në mostrën e caktuar që ndërlidhen me përbërjen e barutit nga fisheku i shkrepur nga arma e zjarrit..

#### **4.5. Ekspertiza e dokumenteve**

Ndryshe nga gjurmët traseologjike e balistike që formohen nga veprimi mekanik reciprok i sendeve të botës materiale, gjurmët e shkrimit formohen nga kombinimi i mendjes, sistemit nervor dhe muskolor. (Begeja, 2007: 234). Ekspertiza e dokumenteve është një nga degët me të rëndësishme e me të ndërlikuara të shkencës së forenzikës. Çdo send që përmban shënime të shkruara me dorë ose me makinë, burimi ose vërtetësia e të cilave është e dyshimtë, mund të konsiderohet si dokument i dyshimtë. “Me fjalën dokumente, nënkuptohen të gjitha objektet që përmbajnë shenja dorëshkrimi apo shtypshkrimi, prej të cilave bëhen objekte të kriminalistikës, autenticiteti dhe origjinaliteti i të cilave dyshohet.”(Myftari, Shishani dhe Kotri, 2010: 334). Pra dokument është çdo letër e shkruar ose material tjetër që përmban shkrime, printime,



nënshkrime, fotografi, vula, simbole të ndryshme dhe që jep informacion për shërbim të caktuar deri sa është origjinal.

**Llojet e dokumenteve** - Në përgjithësi dallohen dy lloje të dokumenteve: dokumentet identifikues dhe dokumentet legjitimues. Dokumentet identifikues janë të gjithë dokumentet, të cilat përmbajnë mbiemrin, emrin, datën e lindjes, vendin e lindjes, nacionalitetin, fotografinë, nënshkrimin, vlefshmërinë dhe të dhënat biometrike. Në këtë kategori bëjnë pjesë: pasaporta normale, pasaporta diplomatike, pasaporta e shërbimit dhe kartelat e identitetit. Ndërsa dokumente legjitimuese janë të gjitha dokumentet, të cilat mund të mos përmbajnë të gjitha informacionet e lartshënuara, por mund të kenë vetëm mbiemrin, emrin, datën e lindjes, vendin e lindjes, nacionalitetin, fotografinë dhe nënshkrimin. Në këtë kategori bëjnë pjesë: lejet e ndryshme të gjuetisë, lejet e anëtarësimit në ndonjë organizatë, parti, shoqatë etj. “Nisur nga destinacioni i prodhimit e i përdorimit të tyre, dokumentet klasifikohen në: dokumente identiteti, siç janë: letërnjoftimet, pasaportat, certifikatat e ndryshme të gjendjes civile etj.; dokumente ekonomike financiare, si: fletë-hyrjet e fletë-daljet, mandate arkëtimet e mandat pagesat, listë pagesat, letrat e kreditit, dhe vetë kartëmonedhat etj.: dokumente personale, si: dëshmitë e aftësimit, patentat, dëftesat shkollore, deklaratat, librezat e letrat e korrespondencës etj.” (Myftari, 2008: 338). Begeja, në librin e tij dokumentet nga pikëpamja kriminalistike i klasifikon në dokumente që përdoren si mjet për kryerjen e veprës penale, dokumente që përdoren si mjet për zbulimin e veprimeve kriminale të fajtorit dhe dokumente që shërbejnë për mbulimin e veprimeve kriminale të fajtorit.

Lexo me vëmendje argumentin e tij:

Së pari, dokumentet e falsifikuara: monedhat, letrat me vlerë, dokumentet shkollore, shëndetësore, vizat, stampa apo gjurma e stampës, akte të gjendjes civile, dokumente identiteti si: letërnjoftime, librezat ushtarake, librezat e kursimeve, faturat, fletëpagesat, fletëhyrjet, fletëdaljet, etj. Së dyti ato që përdoren si mjet për mbulimin e veprimeve kriminale të fajtorit. Këtu hyjnë letrat e shkruara nga fajtori që përmbajnë të dhëna të rreme siç janë letrat gjoja për vetëvrasje, letrat e shkruara nga fajtorët se gjoja viktimat e tyre ndodhet gjallë në një vend tjetër, letrat e shkruara (me dorë ose makina shkrimi) nga fajtorët, me qëllim që hetimi të marrë kahjen e dëshiruar, letrat që janë mbuluar me njolla të ndryshme, që janë grisur, djegur, me qëllim të zhdukjes së përmbajtjes së tyre. Se treti, ato që shërbejnë për përcaktimin e rrethanave të çështjes

penale për hetimin dhe gjykimin e saj. Këtu hyjnë letrat anonime (me dorë ose me makinë shkrimi etj.), letrat me përmbajtje shpifëse, kërcënuese, testamentet, shenjat e shkruara në sendet e vjedhura etj. (Begeja, 2007: 229).

***Elementet e sigurisë së dokumentit*** - Me elemente të sigurisë së dokumentit kuptojmë elementet apo karakteret që vendosen në letër gjatë prodhimit apo pas prodhimit me qëllim të mbrojtjes së dokumentit nga falsifikimi apo keqpërdorimi i tij. Elementet e sigurisë përbëhen nga elementet e sigurisë së letrës, ngjyrës dhe shtypjes. Në elementet e sigurisë së letrës, filigrani është një figurë tredimensionale në formë portreti, simboli, apo gjeometrike, figura këto të cilat janë të futur në brendinë e letrës. Në vartësi të dokumenteve, ajo vendoset në një vend të caktuar dhe ka një nuancë në gri. Filigrani si element i sigurisë nuk mund të vërehet me rreze ultra violete, por me dritë transmetuese. Në kartëmonedhat e falsifikuara, peri i sigurisë vendoset duke stampuar atë në një kohë me pamje grafike të kartëmonedhave vetëm në njërën anë të saj si dhe duke e futur atë midis dy shtresave të letrës. Kjo metodë haset më shumë në kartëmonedha me prerje 50, 100 dhe 200 euro. (Ademaj, 2010: 378). Ngjyrat që përdoren për shtypjen e dokumenteve (kartëmonedhave e pasaportave) kanë përbërës kimik të caktuar dhe në përgjithësi në përbërjen e tyre futet një përqindje e caktuar fluoreshente. Më shpesh kjo ndeshet në numrat e serisë së kartëmonedhave, pasaportave etj. Edhe në dokumente të falsifikuara evidencohet fakti i përdorimit të ngjyrës fluoreshente nën veprimin e rrezeve ultra violete, por intensiteti i ngjyrës ndryshon (Ademaj, 2010: 379). Elementet e sigurisë në shtypjen e dokumenteve kanë të bëjnë me radhën e shtypit që përdoret si shtyp topografik, ofset, gravurë (shtypje me relief), i thatë dhe i kombinuar. Në shtypjen e kartëmonedhave aplikohen tre llojet e shtypit dhe pastaj në varësi të letrës së kartëmonedhës aplikohet shtypi i thatë. Në dokumentet e falsifikuara, elementi i sigurisë në formë vijash është i shtypur me defekte (ndërprerje). Dokumentet e falsifikuara me metodën e fotokopjimit me ngjyra nuk pasqyrojnë asnjë element sigurie të letrës, të ngjyrës dhe të shtypit.

***Falsifikimi i dokumenteve*** - Në këtë kategori përfshihen dokumente të tilla si: kartëmonedhat, dokumentet bankare (çeqe, mandat arkëtime), deklarata doganore, pulla fiskale, kontrata të sigurimeve, bileta lotarie etj. Në këtë kategori dokumentesh paraqitet falsifikimi i plotë, duke aplikuar metodat tradicionale të falsifikimit, si shtypja me makina shtypi të tipit offset, skanim kompjuterik apo fotokopjim me ngjyra. Këto metoda realizojnë shtypjen e dokumenteve në sasi

të mëdha me një pamje të përafërt me dokumentin origjinal, duke realizuar në disa raste edhe imitimimin e elementeve të sigurisë. Në Kosovë, nga kjo kategori dokumentesh më të falsifikuara janë kartëmonedhat, dokumentet dhe kontratat. Falsifikimi i kartëmonedhës euro dhe qarkullimi i saj i madh në treg është shfaqur pas vitit 2001, për kundër niveli të lartë të sigurisë që kishte. Gjithashtu në rastin e dokumenteve bankare, megjithëse ato janë dokumente shumë të rëndësishme dhe me to operohet në shumë nivele të sistemit bankar, niveli i sigurisë së tyre është shumë i ulët. Në këtë kontekst, falsifikimi i plotë i tyre është fare i thjeshtë dhe pak e kontrollueshme, gjithmonë nga ana formale e dokumentit, pasi ka një pamje të përafërt me dokumentin origjinal.

***Metodat e falsifikimit të dokumenteve*** - Me paraqitjen e teknologjisë digjitale janë paraqitur edhe një sërë makinash të reja, të cilat janë në gjendje të prodhojnë dokumente që mund të ndryshohen ose të përdoren për qëllime mashtrimi. Në praktiken e ekzaminimeve të dokumenteve rezulton se falsifikatorët apo manipuluesit praktikojnë falsifikimin pjesërisht të falsifikuar dhe total të falsifikuar. Për t'u kryer këto falsifikime përdoren metoda të ndryshme. Metodat më të përhapura të falsifikimit të pjesshëm janë: fshirjet mekanike, kimike, shtesat, mbulimet, korrigjimet dhe përpilimi i dokumentit nga pjesët e ndryshme.

***Fshirjet:*** Një nga mënyrat më të rëndomta për të ndryshuar një dokument është përpjekja për të fshirë pjesë të tij me gomë, rërë, brisk rroje ose thikë, për të hequr një pjesë të shkruar me dorë ose me makinë, duke gërryer ose gërrisur sipërfaqen e letrës (Saferstein, 2014: 504). Fshirja është prishja e elementeve grafike ose të pjesëve të tjera të tekstit të dokumentit me qëllim që të ndryshohet përmbajtja fillestare. Fshirjet në varësi nga mjetet e përdorura, ndahen në fshirje mekanike dhe fshirje kimike (Begeja, 2007:256).

***Fshirja mekanike:*** Fshirjet mekanike realizohen me mjete të buta (gomë e mjete të tjera të përshtatshme), ose me mjete të mprehta (bisturi etj.). Veprimi i këtyre mjeteve konsiston në dëmtimin e ngjyrës së tekstit fillestar të dokumentit. Si rezultat i këtij veprimi gërryes ndryshon gjendja fizike e sipërfaqes së dokumentit, kreshpërohen dhe ngrihen fijet e celulozës përbërëse të letrës etj. Shenjat kryesore në rastet e fshirjeve mekanike janë: prishja e strukturës së letrës dhe humbja e shkëlqimit të sipërfaqes së saj; zvogëlimi i trashësisë së letrës dhe rritja e tejdukshmërisë së saj; mbetje nga ngjyra ose lapsi i tekstit të vjetër; prania e gjurmëve të relievit

të tekstit të vjetër; përhapja e ngjyrës në tekstin e ri të pashkruar; dëmtimi i rrjetit mbrojtës dhe të shenjave të tjera në afërsi të vendit të fshirë (Myftari, 2010: 370).

Fshirja kimike: Fshirjet kimike realizohen me reagjentë të fortë oksidues, të cilët prodhojnë një produkt reaksion pa ngjyrë. Edhe pse kjo përpjekje mund të mos jetë e dallueshme me sy të lire, shikimi me mikroskop zbulon një çngjyrosje të zonës së trajtuar të letrës. Fshirjet kimike zakonisht kryhen me acide të forta siç janë acidi oksalik ( $C_2H_2O_4$ ), acidi sulfurik ( $H_2SO_4$ ) etj. Fshirjet me trajtim kimik të një dokumenti munde të detektohen me anë të rrezeve ultraviolete apo infra të kuqe në pajisjen VSC 5000 apo VSC 6000. Disa lloje të ngjyrës, kur ekspozohen ndaj dritës blu-të gjelbër, e përthithin rrezatimin dhe rrezatojnë dritë infra të kuqe. Kjo dukuri njihet me emrin lumineshenca infra e kuqe (Saferstein, 2014: 504).

Mbulimet dhe shtesat: Mbulimet e mundshme në dokumentet e ndryshme me akte kriminale apo jo, vendosen për ti mbuluar gjurmët e ndryshme për të maskuar një shifër, një vlerë apo një datë në kontratë më qëllim të përfitimeve individuale apo kolektive. “Shtesa është veprimi që kryhet për të futur në një hapësirë të bardhë të dokumentit vija, shenja, shifra, shkronja, fjalë dhe fjali. Korrigjimi është ndryshimi i shkronjave, shifrave, fjalëve të shkruara më parë. Shtesa dhe korrigjimi shpeshherë kombinohen me fshirjen mekanike e kimike” (Begeja, 2007: 261). Shtesa fjalish ose fjalësh midis rreshtave ose në vazhdim të rreshtit. Në këto raste kërkohen këto shenja: bëhet analiza e shkrimit të vjetër dhe e shkrimit të ri (shtesës); kërkohet nëse ngjyra në tekstin e parë ndryshon nga ajo e tekstit shtesë; studiohen anomalitë që ka shkrimi i shtuar (i dyshuar) në raport me tekstin e parë; këqyren vijat e tekstit në palosjet e dokumentit (Begeja, 2007: 261).

Shndërrimi i një fjale në një fjalë tjetër me anë të shtesës së disa vijave apo numrave: Shndërrimi i një fjale në një fjalë tjetër, duke shtuar disa vija, jep këto shenja: shkrimi i vjetër dhe vijat e shtuara nuk përputhen plotësisht dhe në mënyrë të rregullt, në fjalën e shndërruar duken shtesat pavend; vijat e shtuara, duke takuar në disa vija të shkrimit të vjetër, kanë një trashësi ngjyre më të madhe, e cila ndryshon shumë nga intensiteti i vijave të paprekura të tekstit të mëparshëm; në rast se ka shtesa vijash para ose pas fjalës, hapësira e shkrimit ndërmjet fjalëve nuk është e rregullt dhe normale (Begeja, 2007: 263). Është e mundshme për ngjyra të ndryshme të reagojë ngjashëm kur të ekzaminohet, duke përdorur teknikat jodestruktive me rreze të ndryshme. Në këto raste analizat me metoda destruktive duke përdorur teknikat e quajtura kromatografi në shtresën e hollë (TLC) ose teknikë më e avancuar si kromatografia e lëngët me masë

spektrometër të dyfishtë LC-MS/MS mund të jenë adekuate për zgjidhjen e rasteve të tilla (Kelly, 2006:154).

Përpilimi i dokumentit nga pjesë të ndryshme: Në praktikë ka raste kur nga dokumenti origjinal shkruesi falsifikatorë pret pjesën që përmban të dhëna të përgjithshme si nënshkrimi, vula apo të dhëna tjera. Pjesën e prerë e fikson në hapësirën e dëshiruar. Po të njëjtin veprim ai kryen edhe kur ndryshon shenjat, shifrat ose fotografinë p.sh. në pasaportë, letërnjoftim etj. Ky falsifikim kryhet në dy faza. Në fazën e parë krijohet teksti me pjesë të prera nga dokumente të ndryshme origjinale, si shifrat, shkronjat, fjalët etj. Në fazën e dytë nga dokumenti bazë hiqet ajo pjesë që falsifikatori ka vendosur ta ndryshojë dhe zëvendësohet me pjesën e krijuar në fazën e parë. Meqenëse pjesa shtesë nuk futet plotësisht në vendin e përgatitur dhe nuk ka ndërtim të njëjtë grafik me pjesët e tjera të dokumentit, falsifikatori kryen veprime të tjera, me qëllim që të ngushtohet sa më shumë dallimi midis pjesës origjinale dhe asaj të shtuar (Begeja, 2007: 263, 264). “Në këtë kategori përfshihen dokumente të tilla si: kartëmonedhat, dokumentet bankare (çeqe, mandate arkëtime, urdhërxhirime), deklarata doganore, pulla fiskale, kontrata sigurimesh, bileta lotarie etj. Në këtë kategori dokumentesh, ndeshet falsifikimi i plotë i tyre, duke aplikuar metodat tradicionale të falsifikimit, si shtypja me makina të shtypit të tipit ofset, ashtu edhe metoda digjitale si skanimi kompjuterik apo fotokopjimi me ngjyra i tyre.” (Ademaj, 210: 377). Pra, në aspektin kriminalistik, dokumentet e falsifikimet realizohen në dy metoda klasike: duke i krijuar tërësisht të reja – falsifikimi i plotë, ose në dokumente autentike bëhen ndryshime të të dhënave me qëllim që t’iu “përmirësohet” vlera në dobi të autorit të falsifikimit - falsifikim i pjesshëm. “Dokumentet e falsifikuara plotësisht përgatiten të reja, duke imituar një dokument origjinal standard, ashtu siç veprohet edhe me monedhat, me kartëmonedha te letrat me vlerë, p.sh. falsifikohen letërnjoftimet, pasaportat, certifikatat, patentat, dokumente të tjera që përgatiten me letër të posaçme (prodhuar posaçërisht për atë lloj dokumenti), dhe përmbajnë elemente sigurie.” (Myftari, 2009: 367).

Autorë të ndryshëm mendojnë se ndër metodat më të shpeshta të falsifikimit të dorëshkrimeve dhe të nënshkrimeve janë:

Falsifikim i thjeshtë: Në këtë lloj falsifikimi shkruesi falsifikatorë mundohet t’iu përmbahet disa rregullave, si: shkruesi nuk provon të maskojë shkrimin e vet natyral, shkruesi përdor të shkruarit e tij, një tentim i vogël për të maskuar karakteristikat e dorëshkrimit të tyre, i pavetëdijshëm se si duket nënshkrimi i vërtet i viktimës;

Simulimi ose imitimi: Në këtë lloj falsifikimi shkruesi falsifikatorë kopjon nënshkrimin e vërtetë (nënshkrimi model për t'u kopjuar).

Ellen në librin e sajë lidhur me këtë lloj falsifikimi thekson. “Nëse falsifikatori është i aftë: falsifikuesi do të vendosë karakteristika të rëndësishme të modelit nënshkrim. Përdërisa nuk evitohen shprehitë e tij natyrale të shkrimit nuk mund të identifikohet shkruesi falsifikatorë”. (Ellen, 2006: 68). Nëse falsifikuesi është më pak i aftë /i pakujdesshëm: duke kujtuar disa nga karakteristikat e dorëshkrimit; shkruesi mund të identifikohet. Nëse falsifikuesi është duke imituar nga memoria: falsifikuesi mund të identifikohet. Gabimi mund të ndodhë sepse falsifikuesi nuk posedon aftësi të mjaftueshme për të imituar nënshkrimin model (Ellen, 2006: 44);

Falsifikimi i kopjuar: Kur të shkruarit është përgatitur drejtpërdrejt nga nënshkrimi model, karakteristikat e mundshme të gjetjes së manipulimit janë: ekspozim i ngadalshëm i matjes së vizave, dridhjet, ndaljet dhe fillimet në pika të shquara.

Metoda tjera të kopjimit janë:

Kopjimi gjysmë-transparentë: letra e mbishkrimit të vërtetë, letra karbon e nënshkrimit të vërtetë,

Kopjimi me transferim: shirit apo teknika tjera të tërheqjes të shkrimit të vërtetë,

Vendosja e kemikateve: të vendosura në letër për të bërë letrën transparente,

Drita transmetuese: nënshkrimi i vërtetë i vendosur nën një copë letër të zbrazët.

Dallojmë edhe:

Vetë falsifikimin: Shkruesi kopjon apo simulon nënshkrimin e vet.

Manipulimin: Shkruesi manipulon një dokument të vërtetë duke prerë dhe bartur ose përdorimin e fotokopjes. Në përgjithësi shkatërron dokumentin origjinal.

Mashtrimin: Shkruesi siguron të shkruarit e vërtetë nën pretendim të falsifikuar. Duke u bazuar në prerje, bartje ose shlyerje të shkrimit të vërtetë nga dokumenti i pranueshëm dhe vendosja në dokumentin mashtrues. Mund të përfshijë skaner, fotokopje, etj.

Ndryshimet: p.sh. shtesat apo fshirjet.

***Falsifikimi i kartëmonedhës euro*** - Falsifikimi kartëmonedhës së eurove është bërë tashmë një realitet shqetësues, jo vetëm për organizmat bankare dhe strukturat e luftës kundër krimit ekonomik, por edhe për konsumatorin e thjeshtë. Për të limituar pasojat shqetësuese të kësaj situate është e rëndësishme për të gjithë të njohin me lehtësi bankënotat false duke u bazuar në

elementet e sigurisë që janë të pranishme në të gjitha prerjet e bankënotave dhe ndihmojnë verifikimin e menjëhershëm të autenticitetit të tyre. Disa verifikime të thjeshta mund të ndihmojnë në evitimin e situatave të papëlqyeshme dhe në evitimin e humbjeve ekonomike të konsiderueshme. Këto verifikime mund të kryen me anë të prerjes, të vrojtimit, të fërkimit dhe të lëvizjes së bankënotave përkundër dritës.

***Ekzaminimi i letrës së grisur, të djegur dhe të lagur*** - Me rastin e mbledhjes së copave krim tekniku duhet të përdorë pincetën dhe copat e gjetura t'i futë në kuti, qese letre etj. Në qoftë se ka fryrë era në kohën e grisjes dhe të gjuajtjes së letrës, krim tekniku duhet të kërkojë në një sipërfaqe më të gjerë. Gjatë ekzaminimit laboratorik, copat e ndyta apo të lagura teren dhe pastaj prej tyre hiqen ndyrësit me brushë të vogël. Copat e lexueshme dhe të pastra vendosen në tavolinë të mbuluar me letër të bardhë, secila copë letre të jetë e shtrirë. Në qoftë se janë grisur letra të ndryshme, ato ndahen në disa grupe. Së pari bëhet klasifikimi i secilës copë sipas ngjyrës, pastaj bashkohen copat e të njëjtës renditje ose dorëshkrimi. Në këtë mënyrë materiali i shumtë shpërndahet në disa grupe të vogla. Mandej të gjitha copat vendosen në atë mënyrë që njëra anë e tyre të jetë e kthyer në shikim të ekspertit. Tani mund të fillohet me restaurimin. Së pari me grupin më të vogël të copave të letrës, duke shkuar kah grupet gjithnjë më të mëdha. Eksperti i cili merr pjesë në restaurim, së pari në vendin e ngjarjes bën ekzaminimin vizuel të mbeturinave të letrës së djegur vetëm me sy me anë të thjerrëzës në kushte të ndryshme të dritës. Në qoftë se ky veprim nuk jep rezultat, eksperti bën fotografimin me dritën infra të kuqe, po qe se as kjo tentativë nuk jep rezultat, atëherë mbeturinat e letrës së djegur lyhen me 5% tretësirë nitratargjendi. Ngacmimi i tekstit në letrën e djegur me anë të filtrit me llambën kuarc nuk jep rezultate. Kjo metodë nuk është e përshtatshme, sepse sipërfaqja e mbeturinës së letrës paraqitet në ngjyrë kafe në të zezë. Dokumentet e djegura të shkruara me makinë ose me ngjyrë, të cilat përmbajnë ngjyra minerale mund të lexohen në dritë të zakonshme. Në letrat e djegura teksti i të cilave është shkruar me ngjyrë vjollce ose të kaltër me tretësirë uji, me përbërje të ngjyrës nga anilina mund të zhduket për shkak të karbonizimit. Dokumentet që nuk janë të karbonizuara plotësisht reagojnë mirë në fotografinë infra të kuqe. Kjo vlen posaçërisht për tekste që janë shkruar me laps, ndërsa ato me makinë shkrimi ose me ngjyrë nuk riprodhohen lehtë. Nëse letra është karbonizuar krejtësisht rezultatet janë negative. “Dokumenti i djegur, pas përpunimit me metodat e lartpërmendura, mund të konservohet me metoda kimike për t’u paraqitur në gjykatë si

provë materiale. Një nga këto metoda është përdorimi i solucionit të xhelatinës së bardhë të tretur në ujë të distiluar (10 gr. Xhelatinë në 100 ml ujë të vluar të distiluar)” (Begeja, 2001: 25).

***Ekspertiza e dorëshkrimeve*** - Ekspertët e dokumenteve dhe të dorëshkrimeve në vazhdimësi i përkujtojnë rregullat e arta: dy individë asnjëherë nuk shkruajnë njëlloj, asnjëherë një individ nuk shkruan në mënyrë identike dy herë dhe asnjë individ nuk e kalon nivelin e aftësive të tij apo të saj. Kjo nuk do të thotë se nuk ka asnjë ngjashmëri në dorëshkrimin e dy individëve, sepse ka shumë faktorë që përbëjnë karakterin e përgjithshëm të shkrimit të një njeriu. Kur jemi fëmijë, ne mësojmë të shkruajmë, duke kopjuar atë që na tregojnë mësuesit tanë (Saferstein, 2014: 498-499). Në bazë të këtyre rregullave të arta, të cilat janë të mbështetura në hulumtimet e shumta shkencore, e sidomos edhe te binjaket, japin mbështetje të fortë për të bërë identifikimin apo eliminimin e personit në konteste të ndryshme dhe në zgjidhjen e problematikave në raste komplekse kriminale. Metoda e krahasimit direkt në mes të materialit të dyshimtë dhe materialit të njohur është funksionale duke u mbështetur edhe te instrumentet ndihmëse.

Shumë autorë dhe ekspertë të dorëshkrimeve pajtohen se ekspertiza e dorëshkrimeve kalon nëpër stadet si në vijim:

*Studimi paraprak i rastit:* Fillimisht shikohet urdhëresa e gjykatës se në çka është kërkuar të bëhet ekspertiza. Shikimi i provave (shkrimi kontestues që është objekt ekspertize) bëhet për të përcaktuar nëse është shkruar lirshëm në kushte normale me mjete të përshtatshme apo se shkrimi është i falsifikuar. Studimi paraprak i shkrimit kontestues është i rëndësishëm, ku pastaj metodika e ekspertizës ka specifikat e veta për ekzaminimin e shkrimit. E rëndësishme është studimi i karakteristikave të përgjithshme dhe të veçanta me qëllim të konstatimit se shkrimi a është shkruar në kushte të me mjete të përshtatshme apo jo, a ka qenë nën ndikimin e faktorëve patologjikë apo psikikë (mosha, sëmundjet, ndikimi i alkoolit) dhe a është tentuar që shkrimi të maskohet apo jo. Ky është balancimi i fundit i madhësisë së vargut dhe të formës, i cili është kritik në krahasimet e nënshkrimit, jo vetëm thjesht përputhja e elementeve individuale (Slyter, 1995: 10). Pra, duhet të vijmë deri te një konstatim se shkrimi është i shkruar në mënyrë natyrale (të lirë) apo jo.

*Ekzaminimi i dorëshkrimit të kontestuar:* Pas studimit të shkrimit se është shkruar lirshëm (natyral) apo se është ndryshuar, bëhet analiza e shkronjave në tërë dorëshkrimin, duke filluar me karakteristikat grupore, e pastaj ato individuale. Evidencimi i karakteristikave bëhet direkt në



kopjen e origjinalit apo mund të bëhet edhe në një flet punimi, duke evidencuar karakteristikat individuale me shenja identifikuese.

Ekspertiza e dorëshkrimit të njohur: Edhe te shkrimet e njohura duhet të bëhet një studim i shkrimit se personi i dyshuar i ka dhënë shkrimet eksperimentale në mënyrë natyrale apo jo, duke bërë një krahasim me shkrimet e lira të marruar më parë (Kelly and Lindblom, 2006: 133). Po edhe këtu evidencimi bëhet në kopje origjinale të shkrimeve të njohura me shenjat e njëjta.

Krahasimi i karakteristikave grupore dhe individuale në mes dorëshkrimit kontestues dhe dorëshkrimit të njohur: Vlerësimet e rezultateve në krahasim paraqesin momentin më me përgjegjësi dhe më të ndërlikuar të ekspertizës. Në këtë proces analizohen si ndryshimet ashtu edhe përputhjet.

Krahasimi në mes të shkrimit kontestues dhe atij të njohur duhet të përfshijë të gjitha aspektet, si: karakteristikat e përgjithshme dhe ato individuale. Kur është e mundur eksperti duhet të analizojë edhe shenjat tipografike, shprehitë e të shkruarit dhe të gjitha ato që ndihmojnë në përforcimin e konkluzionit të arritur.

Sidoqoftë, pas krahasimit të karakteristikave individuale është e nevojshme të bëhet edhe njëherë vlerësimi dhe krahasimi i të gjitha rezultateve të ekzaminimeve paraprake, të kontrollohen përputhjet dhe mospërputhjet me njëra tjetrën (shkrimi kontestuese me atë të njohur) dhe të merret vendimi përfundimtar. Po ashtu edhe te ekspertimet e nënshkrimeve bëhet vlerësimi përfundimtar i të dhënave preliminare, i rezultateve të hulumtimit gjatë ekzekutimit të nënshkrimit dhe krahasimi i karakteristikave të përgjithshme dhe atyre individuale.

***Pajisjet dhe sistemet informative krahasuese për dokumente*** - Procesi i ekzaminimit shkencor të dokumenteve ka rezultate, jo në masë të vogla, si rezultat i aplikimit të pajisjeve shkencore dhe të zhvillimit të pajisjeve speciale forenzike, që shërbejnë në zbulimin e vërtetësisë së dokumenteve. Laboratori i dokumenteve dhe i dorëshkrimeve gjatë ekspertizave të dokumenteve të ndryshme bazohet në mostrat referente. Nevoja dhe leverdia kanë shtyrë kompani të ndryshme të krijojnë baza të dhënash apo sisteme të dhënash për përshkrim shumë të detajuar për tiparet e sigurisë. Pajisjet bazike që shërbejnë për ekzaminimin e dokumenteve janë: pajisjet optike (mikroskopët), mjetet për matje, pajisjet speciale me drita si (VSC), makinat kopjuese, kamerat digjitale, skanimi kompjuterik, aparatet për detektimin e shkrimit latent (ESDA) dhe pajisja për

krahasimin e ngjyrave (Spektroskopia Raman). Teknologjia e fundit për laboratorin e dokumenteve dhe të dorëshkrimeve është VSC 8000. Kjo pajisje ka sistem informativ të instaluar dhe mund të bëhet krahasimi direkt gjatë analizimit të rastit më anë të rrezeve me gjatësi valore të ndryshme deri në 1000 nm. Burimet e dritës që aplikon kjo pajisje janë drita IR-infra e kuqe, UV-Ultra violete dhe drita normale transparente. E veçanta e teknologjisë VSC-8000 është posedimi i një spektri të gjerë të mostrave referente. Në disa instrumente mundë të krijohen data baza nga vetë ekspertët dhe pastaj të krahasohen me rastet e ardhura për ekspertizë. Me spektroskopin Raman “FORAM-685” mund të krijohet data baza dhe pastaj të bëhen krahasimet për rastet me analizë të ngjyrës së kimikut.

***Raporti i ekspertizës së dokumenteve dhe interpretimi i rezultateve*** - Raporti i ekspertizës së dokumenteve është raport voluminoz dhe gjithëpërfshirës i cili përmban interpretimin e rezultateve, grafikone, skica, fotoalbume etj. Raporti i ekspertizës së dokumenteve dhe të dorëshkrimeve duhet të përmbajë:

1. Të dhënat esenciale të rastit
2. Përshkrimin e dëshmive sipas ekspertit por gjithnjë në koordinim me urdhëresën e gjykatës
3. Metodatat dhe pajisjet e përdorura
4. Rezultatin e ekspertizës
5. Konstatimin përfundimtar.

Interpretimi i rezultateve ka rendësi të madhe, ku secila metodë që përdoret për ekspertizën e rasteve kërkon interpretim të rezultatit apo lexim të spektrit në rrezet me gjatësi vale interpretuese. Interpretimi i rezultateve në laboratorin e dokumenteve është pika kyçe e kualitetit të një eksperti dhe të mbrojtjes së rastit në gjykatë në mënyrë profesionale. Specifika e dorëshkrimeve bazuar edhe në kompletimin e rastit dhe marrja e mostrave të njohura, opinionet klasifikohen në pesë shkallë si opinione individuale:

- Identifikim (është shkruar nga i njëjti shkruar),
- Mund të jetë nënshkruar (me një rezervë është shkruar nga i njëjti shkruar),
- Pa konkludim (kur nuk mund të gjenden karakteristikat individuale të ngjashme apo dalluese. Kjo vjen nëse nuk kemi mostra të njohura të mjaftueshme apo nuk janë marrë mostrat në mënyrë të duhur),
- Mund të mos jetë shkruar (me një rezervë nuk është shkruar nga i njëjti shkruar),

- Nuk është shkruar nga i njëjti shkruar.

#### **4.6. Ekspertiza e drogave dhe e substancave psikotrope**

Bazuar në organizatën botërore të shëndetësisë, drogë mund të quhet çdo “*substancë*” e cila kur futet në organizëm të gjallë mund të modifikojë një ose më shumë funksione (WHO, 1969). Drogat janë substanca të cilat kur futen në organizëm shkaktojnë ndryshime fiziologjike. (Bell, 2006:212). Mënyrat e futjes së drogave në organizëm mund të jenë përmes gëlltitjes (përthypjes), injektimit, inhalimit apo absorbimit përmes lëkurës. Termet “Drogë” dhe “Barëra (Ilaçe)” shpeshherë ngatërrohen ngase në një mënyrë “të gjitha drogat janë barëra dhe të gjitha barërat janë droga”, mirëpo, për qëllime ligjore dhe forenzike termi “Drogë” përdoret për të përkufizuar të gjitha substancat me të cilat mund të abuzohen. Abuzimi me droga nënkupton përdorimin e substancave psiko-aktive, abuzimi me to mund të çojë në sindromin e varësisë, ndryshim në sjellje kognitive dhe fenomene fiziologjike, të cilat zgjojnë dëshirën për të përdorur atë vazhdimisht pavarësisht pasojave të dëmshme (WHO, Nëntor 2011). Megjithatë, ka shumë paqartësi dhe dilema përkufizuese, varësisht nga këndvështrimi. Në terminologjinë e drogave, shpeshherë dëgjohet edhe nocioni apo termi - substancë psikotrope, substanca këto që stimulojnë ose dobësojnë (zvoglojnë) punën e sistemit nervor qendror. Një pjesë e substancave psikotropike krijojnë varësi. Teknikisht, drogat janë substanca kimike, të cilat ndikojnë në funksionimin normal të trupit dhe/ose të trurit të njeriut, d.m.th. shkaktojnë efekte dhe varshmëri fizike dhe psikike.

Drogat natyrore janë përdorur nga njerëz të lashtë të mjekësisë për të shëruar sëmundje pa marrë parasysh efektet anësore. Shkencëtarët dhe mjekët sot konstatojnë se nuk ka asnjë medikament që nuk është i dëmshëm ose helmues, nëse merret në sasi të mëdha, prandaj shumica e punimeve shkencore mbi drogat kanë të bëjnë me përpjekjet për të zgjidhur hendekun mes dozave efektive dhe toksike.

Që nga kohët e lashta drogat janë përgatitur nga bimë të ndryshme dhe janë përdorur për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme. “Sumerians” ishin një nga shoqëritë më të hershme urbane në botë, në jug të Mesopotamisë, më shumë se 5000 vjet më parë, të cilët përdornin Opiumin si qetësues. Meksikanët para Kolumbianëve përdornin shumë substanca nga duhani për qëllim të trajtimeve mjekësore dhe ceremonive fetare. Tobacco, Cannabis, Opium Poppy, Coca bush, Khat dhe droga të tjera me prejardhje bimë janë përdorur në forma të ndryshme në shumë regjione të

botës si zakone tradicionale të asaj kohe (Burger, 1995:1-50). Me fjalë të tjera historia e drogave gjithmonë ka qenë pjesë esenciale e kulturave dhe e religjioneve rituale gjatë historisë. Në shumicën e rasteve, drogat të cilat janë konsideruar të pranueshme nga shoqëria, me vonë janë ndaluar dhe përdorimi i tyre është konsideruar si ilegal. Shembull i këtyre drogave janë Opiatet dhe Kokaina, të cilat në mënyrë të përgjithshme janë konsideruar si substanca të pranueshme deri në shekullin 19, dhe zakonisht janë përdorur si për qëllime mjekësore, po ashtu edhe jo mjekësorë. Sidoqoftë, përdorimi jo mjekësor i këtyre drogave u bë ilegal në shekullin XX.

***Llojet e Drogave, klasifikimi dhe kategoritë*** - Klasifikimi dhe kategorizimi i drogave bëhet varësisht nga këndvështrimi. Në praktikë dhe në literaturë me së shpeshti hasim në klasifikim të drogave sipas efekteve dhe sipas origjinës.

***Klasifikimi i drogave sipas efekteve***- Sipas efekteve që shkaktojnë drogat ndahen në: narkotikë, stimulues, depresantë dhe halucinogjene.

***Narkotikët*** – drogat narkotike janë substanca që lehtësojnë dhimbjen dhe shkaktojnë gjumin. Termi “Narkotik” rrjedh prej fjalës greke “*Narkotikes*” që nënkupton një gjendje letargjie ose amullie. Në kontekstin ligjor fjala narkotik i referohet opiumit (morfinës dhe kodeinës), derivateve të alkaloidëve të opiumit (Heroinës) dhe zëvendësuesit krejtësisht sintetik (Meperidines, Metadonit dhe Fentanilit).

Narkotikët më të njohur janë Opiumi, Morfina, Kodeina dhe Heroina.

***Opiumi:*** Opiumi është produkt natyror i përfituar nga bima *Papaver Somniferum L.* Kjo bimë është rritur në regjionin e Mediteranit qysh 3000 vjet para erës sonë dhe opiumi ishte i njohur për efektin e tij në zvogëlimin e dhimbjeve qysh në atë kohë (United Nations, 1998: 3-18).

Opiumi merret nga prerja e kapsulave të papjekura të lulëkuqeve në formë të qumështit “*latex*” i njohur si opium i papërpunuar. Përbërësit kryesor të opiumit të papërpunuar janë fragmente bimore, rrëshirë, alkoole triterpenoide, acide yndyrore, polisakaride dhe më shumë se tridhjetë alkaloidë. Këto alkaloidë janë të ndara në dy klasa kimike; alkaloid phenanthrene (morfinë, kodeinë dhe tebainë) dhe alkaloid izokinoline (Papaverinë dhe Noskapinë). Papaverina dhe Noskapina nuk kanë efekt signifikant në sistemin qendror nervor, por ato janë gjetur në produktin përfundimtar në Morfinë si papastërti. Prania e sasisë së alkaloidëve në opium varet

nga shumë faktorë si p.sh; klima, lartësia mbidetare, përbërja kimike e tokës, lagështia dhe varieteti i bimës *Papaver Somniferum L.*

**Morfina:** Morfina është alkaloid kryesor i opiumit, pjesëmarrja e së cilës sillet prej 4-21%. Është një nga drogat më të efektshme të njohura për lehtësim të dhimbjeve. Klinikisht ajo përdoret vetëm në raste absolutisht të nevojshme, për shkak të varësisë që mund të krijojë. Zakonisht përdoret në kirurgji për amputime apo gjatë operacioneve kirurgjike me ndërhyrje të thellë. Morfina e papërpunuar në tregun e paligjshëm mund të jetë e cilësisë së lartë ose të ulët, varësisht nga procedurat e pastrimit, qëllimi i synuar, njohuritë dhe aftësitë profesionale të prodhuesit të paligjshëm. Produkti përfundimtar i morfinës që qarkullon në tregun ilegal zakonisht përmban edhe premisa tjera si Kodeinë, Tebainë, Noskapiinë dhe Papaverinë si papastërti.

**Kodeina:** Kodeina e cila ka efekt të njëjtë sikur Morfina, mund të gjendet në mënyrë natyrale në përqendrim prej 0.7-3 %. Prezenca e saj në Morfinën e papërpunuar rezulton në formimin e acetil kodeinës gjatë konvertimit të morfinës në heroin. Kodeina në medicinë zakonisht përshkruhet si analgjetik dhe hipnotik.

**Heroina (Diacetylmorphina):** Heroina përfitohet nga Morfina përmes procesit të acetilimit me anhidër acetik . Heroina e pastër është pluhur i bardhë me shije të hidhur. Pjesa më e madhe e heroinës së paligjshme është në formë pluhuri dhe mund të ndryshoj ngjyrën nga e bardha në ngjyrë kafe të errët. Për shkak të papastërtive (Acetilkodeinë, Monoacetilmorfinë, Noskapiinë dhe Papaverinë) të cilat mbesin gjatë procesit të prodhimit apo nga prania e aditivëve (Kafeinë, Paracetamol etj.) dhe agjentëve hollues si sheqerna, niseshte, qumësht pluhur dhe kininë. Heroina për herë të parë është sintetizuar në vitin 1874 dhe është konsideruar si substancë e sigurtë, e cila mund të zëvendësojë morfinën (United Nations, 1998: 3-18) por më vonë është kuptuar se Heroina është një substancë shumë problematike dhe mund të prodhojë varësi brenda vetëm disa ditësh të përdorimit të rregullt. Heroina është një qetësues dhe shkakton një ndjenjë euforike, të përgjumur dhe të ngrohtë. Ajo gjithashtu heq stresin, duke krijuar një shkëputje të relaksuar nga dhimbjet dhe dëshirat. Përdorimi i Heroinës shkakton probleme serioze anësore në organizëm si: zvogëlim të refleksëve, problem me frymëmarrje dhe sistem kardiovaskular. Marrja e dozave të larta rezulton në humbjen e vetëdijes, gjendje kome dhe shpesh mund të shkaktohet vdekja si rezultat i dështimit të sistemit të frymëmarrjes. Është një prej drogave që shkakton vartësinë më të lartë.

**Stimuluesit** - drogat stimuluese janë substanca të cilat e rrisin vigjilencën dhe aktivitetin.

Më të njohurat në këtë kategori janë Kokaina, Amfetamina, Metamfetamina, etj.

Kokaina: Kokaina është alkaloid natyror i cili gjendet në bimën e quajtur *Erythroxylum* (Familja Erythroxylaceae), ose më preciz në Coca (*Erythroxylum coca*). Si burim i kokainës janë gjetet e bimës Coca të cilat janë përtypur dhe gëlltitur për mijëra vjet nga njerëzit. Cilësitë stimuluese të gjetheve Coca janë të njohura dhe të studiuara mjaftë mirë që nga kohët e lashta. Për herë të parë e izoloi Niemann në vitin 1859, ndërsa Koller-i më 1884 për herë të parë e aplikoi si anestetik lokal në oftalmologji. Në ditët e sotme, kultivimi i bimës coca bëhet gjithandej globit kryesisht rreth 60 % në Peru, 30 % në Bolivi dhe pjesa tjetër në Kolumbi, në Ekuador, në Venezuelë, në Brazil, në Argjentinë dhe në Panama. Kokaina është e njohur si stimulues (nxitës) i fuqishëm që ndikon drejtpërdrejt në tru. Kjo është një nga substancat më të vjetra të njohura psikoaktive dhe një nga drogat më të përdorura në bote. Kryesisht është në formë të pluhurit të bardhë kristalor- Kokaina ose në formë të kristaleve të quajtura “Crack”- Përdoret në mënyrë inhalatore, intravenoze, subkutane, intramuskulare dhe orale. Krijon varësi të jashtzakonshme psikike.

Metamfetamina: Metamfetamina bën pjesë në grupin e drogave që quhen stimulues të llojit të amfetaminës (ATS). Është drogë sintetike, e cila zakonisht prodhohet në laboratorë të paligjshëm (DIB, 2004/2005: 387). Metamfetamina është në formë të pluhurit, të tabletave ose të kristaleve që ngjajnë me copëza qelqi të thyer. Metamfetamina është gjashtë deri në nëntë herë më e fortë se amfetamina.

**Depresantet** - Depresantet (ose hipnotikët-qetësues) janë droga me veprim në sistemin nervor qendror, që kanë një efekt qetësues, ose gjumëdhënës. Grupi i përgjithshëm përmbledh alkoolin, anestetikët (si p.sh, eteri), barbituratet, drogat kundër ankthit dhe qetësuesit (siç janë Librium dhe Valium). Në sasi të vogla, depresantët prodhojnë efekte qetësuese. Në doza të mëdha, ato mund të japin gjumë dhe, në doza akoma më të mëdha, gjendje kome dhe vdekje. Është e rëndësishme të theksohet se depresantët japin efekte shtesë. Tek depresantet përfshihen drogat e grupit të Barbiturateve (Barbital, Amobarbital, Phenobarbital, Secobarbital, etj) dhe Benzodiazepinet (Diazepam, Alprazolam, Midazolam, Lorazepam, Clonazepam, etj).

**Halucinogjenet** - Halucinogjenet janë droga që mund të shkaktojnë ndryshime të dallueshme në humor, në sjellje, në procesin e të menduarit dhe në perceptime (Saferstein, 2007: 254). Me fjalë të tjera përdoruesi i këtyre lloj drogave “sheh”, përjeton dhe beson atë që nuk ekziston. Nga halucinogjenet mund të përmendim: Kanabisi, LSD, Psylocyn, Psylocybin, Ibogaine, Mescaline etj.

Kanabisi: Kanabisi (Marihuana) është bimë njëvjeçare që rritet nga 1-5 metra gjatësi me kërcell të drejtë, i cili mund të ketë diametër deri 5 cm. Nga kërcelli dalin degët, në nyje dhe hapësira në mes njejeve është diku rreth 25 cm. Gjethet e Kanabisit (Marihuanes) janë të tipit pëllëmbor me 5-11 gjethëza ose lobe të tipit buzë sharrëzuar, por zakonisht 5 ose 7 gjethëza (numër tek). Ana e epërme e gjethit ka ngjyrë të gjelbër të mbyllët dhe përmban qime cistolitike, ndërsa ana poshtme e gjethit ka ngjyrë të gjelbër të çelët me qime mbuluese dhe gjëndërore, të cilat prodhojnë rrëshirën. Bima e Kanabisit (Marihuanes) është bimë Dioike që do të thotë me gjini të ndarë (bima femrore – lulet dhe bima mashkullore – polenin). Ky ndryshim dallohet kur bima rritet dhe piqet seksualisht. Kanabisi (Marihuana) rritet pothuajse në të gjitha vendet e botës, por prodhimi më i madh i rrëshirës varet nga faktorët dhe kushtet e ambientit në të cilat rritet, si p.sh; klima, lartësia mbidetare, përbërja kimike e tokës, lagështia dhe varieteti i bimës etj. Varësisht nga regjioni ku rritet e merr edhe emrin (modifikime agronomike) si: *Cannabis indica*, *Cannabis americana* etj., por përfundimisht është vërtetuar se të gjitha këto janë modifikime agronomike të llojit *Cannabis sativa* L. Bima e kanabisit përmban rreth 400 substanca kimike aktive, ku 66 prej tyre janë karakteristike vetëm për bimën e kanabisit. Këto 66 substanca quhen Kanabinoide, ndër to më të njohura janë: Cannabinoli, Cannabidioli, Cannabigeroli dhe substanca psikoaktive të përgjegjshme për cilësitë halucinogjene të Marihuanës të njohur si  $\Delta^9$  Tetrahydrocannabinolo ose THC (DIB, 2004/2005: 347).

Janë të njohura tri nënprodukte të Kanabisit:

- 1) Marihuana - që është përzierje e fletëve dhe të lulës së kanabisit,
- 2) Hashashi - që prodhohet nga ekstrakti i rrëshirës së kanabisit, dhe
- 3) Vaji i Hashashit. Vaji i Hashashit është lëng viskoz me ngjyrë kafe të errët dhe ka përmbajtje të lartë të THC-së.

Kanabis sativa ka nivelin më të lartë të konsumit në botë. Nga përdoruesit marihuana, hashashi dhe ekstraktet e kanabisit merren me pipë, cigare, nargjile. Ato mund të merren prej tyre edhe pas përzierjes me pije ose me ushqim. Përdorimi i tyre shkakton dremitje, shtrembërim të

koncepteve “hapësirë” dhe “kohë”, halucinacione, ndjenjë lumturie e shoqëruar me ëndrra dhe shpërthime gazi. Kjo lloj droge vepron në korteksin e trurit.

**LSD:**LSD paraqet drogën më të njohur dhe më të perdorur të grupit të Halucinogjenëve, ose drogat psikopatike. Janë droga të cilat ia ndryshojnë gjendjen e ndërgjegjes përdoruesit si edhe shkaktojnë lloje të ndryshme halucinacionesh. LSD-ja është një drogë gjysmë sintetike e prodhuar nga acidi lisergjik, i cili gjendet në një kërpudhë që rritet në bimën e thekrës dhe drithëra të tjerë (DIB, 2004/2005:458). LSD-ja, e cila zakonisht quhet edhe “acid”, është një prej drogave halucinogjene më të fuqishme. Në rrugë zakonisht shitet në formën e katrorëve të vegjël prej letre me filluska me kokrra ku brenda përmbahet droga, por shitet edhe në formën e tabletave, kapsulave si edhe në formë të lëngshme. Është një lëndë pa ngjyrë dhe pa erë, me një shije paksa të hidhur. Është droga më e çuditshme dhe te disa njerëz shkakton gjendje panike, ide mahnitëse (paranoide), depresion, madje edhe sjelljen e ngjajshme me atë të shizofrenisë.

**Klasifikimi i drogave sipas origjinës** - Sipas origjinës drogat ndahen në: drogë natyrore, gjysme sintetike dhe sintetike (Bell, 2006: 216).

*Drogat natyrore (Alkaloidet)* – janë droga të cilat merren drejtpërdrejt nga natyra, psh. kanabisi, apo ekstrahohen nga rrënjët, farat apo gjethet e bimëve, psh. rrëshira dhe vaji i kanabisit, kokaina, opiatet (Morfina), etj.

*Drogat gjysmë sintetike* – janë droga të cilat përfitohen duke modifikuar strukturën e substancave (drogave) me origjinë natyrore, psh. heroina përfitohet me acilimin e morfines, etj.

*Drogat sintetike* – janë droga të cilat përfitohen me sinteza laboratorike, psh. metadoni, etj.

**Klasifikimi dhe kategorizimi i drogave sipas legjislacionit** - Për ekspertin e forenzikës klasifikimi dhe kategorizimi i drogave sipas legjislacionit është i rëndësishëm njëjtë sikurse edhe klasifikimi sipas strukturës kimike dhe klasifikimi sipas efekteve fiziologjike që shkaktojnë ato. Termi “Abuzim me Droga” përdoret për drogat dhe komponimet e ngjashme me to, të cilat janë subjekt i ligjit dhe i rregulloreve për shkak të potencialit të lartë të tyre për abuzim/keqpërdorim dhe dëmeve që shkaktojnë në organizëm (Bell, 2006: 223). Kategorizimi dhe klasifikimi i drogave sipas potencialit për abuzim është një sfidë e veçantë në të gjitha vendet dhe shtetet e botës, pasi që trafikimi me droga është një problem ndërkombëtar. Bazuar në të lartëpërmendurat dhe varesisht nga niveli i abuzimit/keqpërdorimit, shtetet e ndryshme të botës kanë nxjerrë



rregullore dhe ligje të veçanta që kanë të bëjnë me trajtimin (kultivimin, transportin, shitblerjen dhe përdorimin) e substancave të kësaj kategorie (Drogave). Kështu psh. në SHBA në nivel federal drogat janë të rregulluara përmes “Aktit për Substanca të Kontrolluara”, 1970/1984. Sipas këtij Akti, varësisht nga përdorimi i tyre për qëllime mjekësore dhe nga potenciali për abuzim, drogat ndahen në pesë (5) kategori apo të ashtuquajtura “Schedules” (Bell, 2006: 223). Në nivel ndërkombëtar trajtimin e drogave (kultivimin, transportin, shitblerjen dhe përdorimin) e rregullojnë Konventat Nderkombetare të Kombeve të Bashkuara:

- a. “Konventa e vetme e Drogave Narkotike”, Neë York, USA 1961 e amandamentuar me 1972 (ST/CND/1/ Add.1).
- b. “Konventa e Substancave Psikotrope”, Vienna, Austria 1971 (ST/CND/1/Add.2).
- c. “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope”, Vienna, Austria 1988 (ST/CND/1/Add.3/Rev.1).

Shtetet antëtare të BE-s i klasifikojnë drogat, duke u bazuar në tri konventa të KB-s të viteve 1961, 1971 dhe 1988. Megjithatë, disa shtete anëtare i klasifikojnë drogat dhe substancat psikotrope jo vetëm sipas përdorimit për nevoja mjekësore dhe potencialit të tyre për abuzim, por edhe sipas asaj se si sanksionohen aktivitetet kriminale që kanë të bëjnë me këto substanca, dhe lidhur me këtë i kanë rregulloret dhe ligjet specifike që kanë të bëjnë ekskluzivisht me trajtimin (kultivimin, transportin, shitblerjen dhe përdorimin) e drogave.

Në Kosovë klasifikimi dhe kategorizimi i drogave është i rregulluar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Nr. 04/L-82, Kapitulli XXIII, Veprat Penale të Narkotikëve, Neni 273 – Neni 282), respektivisht Ligjit Nr. 02/L-128 sipas të cilit (Kapitulli III, Neni 9) varësisht nga potenciali i tyre për abuzim/keqpërdorim dhe përdorimi për qëllime mjekësore dhe veterinarë drogat janë të klasifikuara në katër (4) tabela (I – IV).

***Analiza kimike e drogës-substancës psikotrope*** - Droga si dëshmi, sikurse edhe të gjitha dëshmitë e tjera në shkencën e forenzikës kanë karakteristika, të cilat mund të përdoren për t'i cilësuar dhe për t'i kategorizuar ato. Gjatë trajtimit të drogave në Laboratorin Forenzik, gjëja e parë që duhet të mendohet nga shkencëtari forenzik është përcaktimi i llojit të drogës si dhe metodat që duhet përdorur për procesin e analizës dhe të identifikimit të tyre. Për dëshmitë fizike (tableta, substancë pluhur, substancë bimore, prekursor, etj.), pyetja e parë dhe kryesore është “Cila drogë është prezente”, ndërsa pyetjet e tjera mund të jenë “Sa është sasia e saj dhe çka

tjetër përmban ajo; shtesat, holluesit, kontaminatët, etj.”, (Bell, 2006: 261).Për t’ju përgjigjur këtyre dhe pyetjeve të tjera, aplikohen teste dhe analiza të ndryshme të cilat mund të kategorizohen në tri grupe:

- a) Testet preliminare (të ngjyrës)
- b) Testet jovendimtare dhe
- c) Testet vendimtare

Secili test veç e veç është i pamjaftueshëm për të përcaktuar llojin e një droge. Për të identifikuar saktësisht llojin e drogës duhet përdorur një kombinim testesh që karakterizojnë (konfirmojnë) një dhe vetëm një substancë kimike – drogën nën hetim.

Testi preliminar (i ngjyrës): Mostrat që sillen në laborator për ekspertizë forenzike, zakonisht kanë origjinë dhe përbërje të panjohur dhe mund të jenë një nga mijëra drogat që hasen në terren. Kjo bënë që eksperti (kimisti) forenzik, mostrat e sjellura t’i procedojë në një seri testesh preliminare (të ngjyrës), të cilat prodhojnë ngjyra karakteristike për drogat ilegale me qëllim që të përjashtojnë disa droga nga konsiderata e mëtejshme. Një pjesë e mirë e drogave shfaqin ngjyra karakteristike kur vihen në kontakt me reagjentë kimikë specifikë. Këto teste janë jo vetëm tregues i pranisë së një droge, por përdoren edhe nga hetuesit në terren për të ekzaminuar materialet e dyshuara për përmbajtje të drogës (Saferstein, 2007: 269).

Në vazhdim janë paraqitur gjashtë reagjentët kryesorë që përdoren si teste preliminare për identifikimin e drogave:

Testi Marquis (10 ml  $H_2SO_4$  i koncentruar për 1 ml 37% Formaldehid): është test tregues fillestar, i cili reagon me grupet e veçanta funksionale, duke shkaktuar ndërrimin karakteristik të ngjyrës. Reagjenti shfaq ngjyrë vjollce te Heroinës dhe të Morfinës dhe të drogave të grupit të opiateve dhe ngjyrë të portokalltë- kafe kur është prezentë Amfetamina dhe Metamfetamina (Clarke's, 2004:289).

Testi Kobalt Tiocianati (testi i Scott-it): është test preliminar i ngjyrës dhe përdoret për të identifikuar prezencën e Kokainës HCl. Përgatitet duke përzier 2 gram Kobalt Tiocianati me 100 ml ujë të dejonizuar (Clarke's, 2004:282).

Testi Duquenois/Levine: është test preliminar i ngjyrës dhe përdoret për të identifikuar prezencën e Kanabisit (Marihuanës). Reagensi përbehet prej tri solucioneve: Solucioni A përgatitet duke përzier 2.5 ml Acetaldehid, 2 gram Vanilin 100 ml 95% Etanol; Solucioni B Acid Klorhidrik i

koncentruar dhe Solucioni C Kloroform. Rezultati pozitiv tregohet përmes zhvillimit të ngjyrës vjollcë në shtresën e Kloroformit (Clarke's, 2004: 285).

Testi Sodium Nitroprusside: është test preliminar i ngjyrës që reagon me aminate sekondare, duke i shndërruar në ngjyrë të kaltër. Përgatitet duke përzier 1 gram Sodium Nitroprusside me 100 ml ujë të dejonizuar (Reagensi # 1) dhe 2 gram Karbonat të Natriumit ( $\text{Na}_2\text{CO}_3$ ) me 100 ml ujë të dejonizuar (Reagensi # 2), (Clarke's, 2004: 295).

Testi i Liebermann-it: është test preliminar i ngjyrës dhe përdoret për të identifikuar prezencën e substancave që në strukturën e tyre përmbajnë lidhje mono, di dhe poli ciklike me unazën e Benzenit. Përgatitet duke përzier 1 gram Natrium Nitrit me 10 ml Acid Sulfurik të koncentruar (Clarke's, 2004:287).

Ekzaminimi mikroskopik: është ekzaminim që përdoret gjatë procesit të identifikimit të drogës. Hyn në kategorinë e testeve/technikave jövendimtare. Në laborator për identifikimin e drogave për ekzaminim mikroskopik (vizual) kryesisht përdoret mikroskopi stereoskopik, si mjet mjaft i përshtatshëm për vërtetime të karakteristikave morfologjike të substancës me zmadhim prej 10x deri 125x. Përparësi e këtij mikroskopi është paraqitja e dallueshme tredimensionale e imazhit të objektit. Ekzaminimi mikroskopik (mikroskopi stereoskopik) praktikohet gjatë identifikimit të kanabisit (marihuanes), me ç' rast mostra shikohet për karakteristikat morfologjike të bimës së marihuanes, siç janë: struktura e gjethit, dellëzimi i gjethit, qimet mbuluese, qimet cistolitike, qimet gjëndërorë, karakteristikat morfologjike të farave dhe për vërtetimin e kristaleve gjatë ekzaminimit të ashtuquajtur testi i mikro kristaleve që është karakteristikë dhe specifike për droga të caktuara, p.sh. kristalet e Kokainës, Methamphetamines, etj.

Analiza kromatografike: kromatografia si teknikë është shumë e dobishme për ndarjen, analizimin dhe identifikimin e mostrave të përbëra prej shumë elementeve dhe komponentëve kimik. Më të përdorshme dhe më praktike janë tri procese kromatografike: kromatografia me gaz, kromatografia e lëngshme dhe kromatografia në shtresë të hollë, për shkakë praktike shkurtimisht do t'i paraqesim principet e kromatografisë me gaz.

Kromatografia me gaz (GC): kromatografia e gazrave është analizë instrumentale, e cila i ndan përbërësit organik të avullueshëm me përzierje në bazë të afinitetit të tyre për një fazë të lëngshme e të qëndrueshme dhe një fazë gazi të lëvizshme. Kromatografi i gazrave përbehet nga tri pjesë kryesore: portit injektues, kolonës kromatografike dhe detektorit. Mostra e përgatitur

injektohet në portin injektues, i cili është i nxehtë, ku avullohet. Si avull mostra hyn në kolonën kromatografike dhe udhëton përmes saj, përbërësit e ndryshëm ndahen duke u bazuar në pikën e tyre të vlimit, masën molekulare dhe prirjen (afinitetin) për gjendje të lëngët në kolonë. Kur përbërësit e ndarë të mostrës arrijnë në fundin e kolonës, ata hyjnë në detektorin e flakës së jonizuar, ku ndeshen me flakën e hidrogjenit (H<sub>2</sub>). Flaka i jonizon substancat kimike që dalin (shfaqen), në këtë mënyrë prodhojnë një sinjal elektrik. Sinjali elektrik shndërrohet në sinjal me shifra (digjital), i cili përpunohet, ruhet, dhe shtypet përmes sistemit të të dhënave. Ky regjistrim i shkruar i ndarjes quhet kromatogram. Koha prej injektimit të mostrës derisa detektori prodhon sinjalin quhet koha e qëndrimit (mbajtjes). Koha e qëndrimit të mostrës së panjohur duhet të krahasohet me standardin e njohur (drogës së njohur referente) për të dëshmuar praninë e substancës së dhënë (veçantë). Kromatografia me gaz (GC) si metodë analitike është identifikim jovendimtar për mostra të substancave narkotike, andaj preferohet të vazhdohet me analizën spektrometrike.

Analiza spektrometrike: më lartë shkurtimisht diskutuam për funksionimin e kromatografit me gaz. Ky instrument është një nga mjetet më të rëndësishme në një laborator të forenzikës dhe është i aftë në ndarjen e komponentëve në një përzierje komplekse, megjithatë, kromatografia me gaz e ka një të metë, ajo nuk është e aftë të bëjë një identifikim specifik. Kështu që eksperti forenzik nuk mund të jetë i saktë në identifikimin e një substance, duke u bazuar vetëm në kromatogramin nga një kromatograf me gaz. Fatmirësisht ky problem është evituar duke e kombinuar kromatografin me gaz me një Spektrometër të masës.

Spektrometria e masës: ndarja e komponentëve të një përzierje fillimisht arrihet në kromatografin me gaz. Secili përbërës i mostrës del prej kolonës kromatografike drejtpërdrejt në spektrometër të masës (dhoma me vakum të lartë) ku bombardohet me elektrone dhe fragmentohet. Struktura e fragmenteve është karakteristike për secilin komponim organik. Fragmentet më pastaj kalojnë në filtrin katër polar të masës. Filtri katër polar i masës është i përbërë prej katër elektrodave cilindrike paralele ose shufrave, të cilat janë të vendosura (rreshtuara) saktësisht në kënde të katrorit. Shufrat diagonale janë të lidhura me energji elektrike: rrymë alternative dhe rrymë të vazhduar dhe atë tensioni pozitiv i rrymës së vazhduar dhe alternative aplikohet në njërën palë, dhe tensioni negativ i rrymës alternative me ndërrim fazash prej 180° dhe i rrymës së vazhduar aplikohet në palën tjetër. Fusha e krijuar në hapësirën në mes shufrave do t'u lejoj kalimin prej njëres anë në tjetrën vetëm joneve me vlerë  $m/e$  të

veçantë. Te gjitha jonet e tjera do të pësojnë oscilim me rritje të amplitudës derisa ato ngjiten në një rën nga shufrat, ku ato neutralizohen dhe largohen përmes sistemit të vakumit. Skanimi (hetimi) mund të arrihet me rritjen e të dy rrymave të vazhdueshme dhe alternative, i cili i fokuson jonet në shumëzuesin e elektroneve për detektim. Tipari unik i spektrometrisë së masës është që në kushte shumë të kontrolluara, nuk ka dy substanca që prodhojnë të njëjtin model fragmentimi (Saferstein, 2007: 150). Analizat me kromatograf të gazrave/Spektrometër të masës zakonisht konsiderohen analiza vendimtare (përfundimtare) për të klasifikuar të gjitha komponimet e njohura organike, të cilat mund t'i nënshtrohen kromatografisë.

#### 4.7. Analiza e ADN-së

ADN është shkurtesë e acidit deoksiribonukleik. “ADN është një molekulë e madhe që përmban njësi të quajtura *nucleotide*. Komponentët e nukleotideve janë me bazë organike, pesë-karbon karbohidrati i quajtur riboson dhe fosfate. Në ADN baza mund të jetë një nga katër përbërësit: guaninë, citozinë, adeninë, timinë”. (Gaensslen, Harris, Lee, 2008: 244). Lidhja bëhet ndërmjet A-T dhe G-C duke përcaktuar helikën dublo. Kombinimet A-T dhe G-C njihen me emrin çiftet bazë. Mëse 3 miliardë çifte bazë gjenden në ADN njerëzore. Megjithatë, vetëm pjesë të vogla të këtyre çifteve përcaktojnë trajtat unike ndërmjet personave dhe janë me interes në pikëpamje kriminalistike”. (Myftari, 2008: 331) “Gjeni është njësia bazë e trashëgimisë. Ai udhëzon qelizat e trupit që të prodhojnë proteina, të cilat përcaktojnë çdo gjë që nga ngjyra e flokëve e deri te ndjeshmëria jonë ndaj sëmundjeve.” (Seferstein, 2007: 382).

Analiza e ADN-së është prezantuar për herë të parë kah mesi i viteve të 80-ta të shekullit të kaluar. Që nga atëherë ka bërë një revolucion në shkencën e forenzikës, me ç ‘rast ju ka mundësuar zbatuesve të ligjit ta bëjnë ndriçimin e shumë veprave penale dhe zbulimin dhe kapjen e kryerësve të tyre. Me mijëra raste janë mbyllur në të kaluarën në mungesë të provave biologjike dhe me këtë rast shume kriminelë kanë mbetur të lirë, derisa nuk është zbuluar analiza e ADN-së (Mbrojtësi Vëllimi VII Nr. 1, 2011, 12).

Profilizimi i ADN-së siç është i njohur sot, për herë të parë është përshkruar nga shkencëtari anglez Alec Jeffreys në vitin 1985 (Mbrojtësi, Vëllimi VII Nr. 1, 2011, 12). Ai zbuloi se disa regjione të caktuara të ADN-së përmbajnë sekuenca të përsëritura dhe gjithashtu vërejti se numri i këtyre sekuencave të përsëritura të ADN-së ndryshon nga individ në individ. Me këtë zbulim Dr. Jeffreys mundësoi zhvillimin e analizës së ADN-së për qëllime identifikimi.

Rasti i parë i zbuluar dhe i dënuar në bazë të analizës së ADN-së është rasti i Colin Pitchfork i cili kishte kryer dhunim dhe vrasje të dyfishtë.

Regjionet e përsëritura të ADN-së që janë analizuar në fillim janë quajtur VNTR (Variable Number Tandem Repeat), kurse teknika të cilën e ka përdorur Alec Jeffreys për t'i analizuar këto regjione është quajtur RFLP (Restriction Fragment Length Polymorphism).

Që nga ajo kohë metodat për analizat e ADN-së janë zhvilluar shumë shpejt dhe janë përhapur në mbarë botën.

Sot zbatim të gjerë kanë analizat e regjioneve të ADN-së të ashtuquajtura “Vargjet e Shkurtra të Përsëritura” apo STR (Short Tandem Repeat), e cila realizohet me teknikën e njohur si PCR apo “Polymerase Chain Reaction” (Mbrotjtësi Vëllimi VII Nr. 1, 2011, 13).

ADN -ja është e pranishme në gjak (jo në rruzat e kuqe, sepse qelizat e tyre nuk kanë bërthamë), në lëngjet gjenitale, në lëkurë dhe në indet e buta, në rrënjën e flokëve, në pështymë, në urinë, në indet kockore dhe në kanalet e dhëmbëve”(Myftari, 2008: 331). ADN-ja është e lokalizuar në bërthamë të qelizës dhe mund ta quajmë edhe si ADN e bërthamës, mirëpo ADN-ja mund të haset edhe në mitokondrie të qelizës të cilën mund ta quajmë si ADN mitokondriale. Analizat forenzike të ADN-së më tepër janë të bazuara në analizën e ADN-së nga bërthama, këto analiza janë shumë më të sakta dhe japin më tepër informata, në krahasim me analizat e ADN-së nga mitokondriet. Analizat e ADN-së mitokondriale janë më pak informative, dhe japin vetëm informata nga vija amësore (trashëgimia nga ana e nënës). Këto analiza vetëm janë si analiza mbështetëse dhe nuk mund ta identifikojnë saktë individin. Me anë të analizave të ADN-së së bërthamës, saktësisht mund të bëhet identifikimi i personit të caktuar. Këto analiza me të madhe aplikohen në forenzikë, për qëllime identifikimi. Prandaj, kur përdoret termi “*analiza të ADN-së*” fjala është pikërisht për këto analiza e ADN-së nga bërthama qelizore. Kështu shumicën e kohës kur shkencëtarët forenzikë flasin për ADN-në, fjala është për ADN-në bërthamore. Mund të quhet, po ashtu ADN gjenomike” (Gaensslen, Harris, Lee, 2008: 247). Dëshmitë të cilat hasen në vendin e ngjarjes, mund të jenë të ndryshme, si: armët, rrobat, shtresat e gjësendet e ndryshme. Këto dëshmi mund të jenë të njollosura me njolla të ndryshme biologjike, si p.sh. me: gjak, spermë, pështymë apo me materiale të tjera, si inde, qime, eshtrat apo dhëmb dhe mostrat nga kontakti (qelizat epiteliale, djersa).

**Mbledhja, regjistrimi dhe paketimi i mostrave të ADN-së** - Mbledhja e dëshmimeve në vendin e ngjarjes duhet të bëhet me kujdes dhe duke përdorur mjetet mbrojtëse personale (dorëzat, mantelin, maskën). Dëshmitë apo artikujt e veçantë duhet të pakëtohen në pako të veçanta, duke pasur kujdes që të mos kontaminohen.

Secila dëshmi duhet të shënohet me të dhënat si në vijim: numri i rastit, numri i dëshmisë, përshkrimi i dëshmisë, data dhe inicialet e personit që e ka mbledhur. Dëshmitë duhet të pakëtohen në pako prej letre dhe të mbyllen mirë me shirit sigurues. Nëse dëshmitë janë të lagura ato fillimisht duhet të terë e pastaj të pakëtohen. Dëshmitë me njolla biologjike nuk duhet të pakëtohen në pako plastike. Sugjerohet që dëshmitë që nuk janë shumë të mëdha si p.sh. armët, rrobat etj., pakëtohen komplet si të tilla dhe dërgohen në laborator. Kurse, në rastet e dëshmimeve më të mëdha (si p.sh. tepihët, dyshemeja, tavolina), njollat biologjike duhet të merren me tampon steril, të thahen mire, të pakëtohen, dhe të dërgohen në laborator. Në disa raste (p.sh. njolla e gjakut në mur), mund të aplikohet edhe gërryerja e njollës mbi letër të pastër të bardhë. Të gjitha dëshmitë e mbledhura dërgohen në laborator, ku regjistrohen në sistemin elektronik të menaxhimit të rasteve LIMS, dhe pastaj ndahen te ekspertët përkatës, për kryerjen e ekspertizave të nevojshme të ADN-së (Procedurat e ADN-së, AKF-4, 2015).

**Metodat për analizë të ADN-së** - Procesi i analizës së ADN-së, është i ndarë në disa faza, ndër të cilat më kryesore janë: ekzaminimi i dëshmimeve, ekstrahimi, kuantifikimi, amplifikimi dhe profilizimi i ADN-së. Ekzaminimi i dëshmimeve është si fazë e parë ku dëshmitë kontrollohen për mostra biologjike. Ekstrahimi është fazë gjatë së cilës bëhet izolimi i ADN-së. Kuantifikimi është fazë gjatë së cilës bëhet përcaktimi i sasisë së ADN-së. Amplifikimi i ADN-së është fazë gjatë së cilës bëhet shumëfishimi i molekulës së ADN-së (krijohen kopje të shumëfishta të ADN-së). Profilizimi i ADN-së bëhet përmes Elektroforezës Kapilare. Gjatë kësaj faze, nga secila mostër e analizuar nxirret profili i ADN-së.

**Sistemi informativ për krahasim të profileve të ADN-së** - “Sistemi informativ për krahasim të profilit të ADN-së, ndoshta është vegla më e dobishme hetuese që ofrohet nga një program për përputhjen e ADN -së që mundëson laboratorëve të kriminalistikës krahasimin e llojeve të ADN -së të marra nga provat e vendngjarjes me ato të kriminelëve seksualë dhe kriminelëve të tjerë të dënuar” (Seferstein, 2007: 410). Sot në botë, ekzistojnë lloje të ndryshme të sistemeve

informative apo bazave për të dhënat e ADN-së, siç janë: (Combined DNA Index System, apo baza Amerikane e të dhënave të ADN-së), NDNAD (National DNA Database, apo baza e Mbretërisë së Bashkuar-Britanisë e të dhënave të ADN-së), NCIDD (National Criminal Investigation DNA Database, apo baza Australiane e të dhënave të ADN-së), NDDDB (National DNA Data Bank, apo baza Kanadeze e të dhënave të ADN-së etj. Të gjitha këto sisteme apo baza të të dhënave të ADN-së, shërbejnë për krahasimin e profileve të ADN-së, për qëllime identifikimi, si p.sh. për identifikimin e kryesve të veprave të ndryshme kriminale, për gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur etj. Krahasime mund të bëhen gjithashtu edhe për qëllime të eliminimit të personave të caktuar, p.sh. krahasimi i profileve të ADN-së së familjarëve në ndonjë rast të plaçkitjes (për arsye se në mostrat e vendit të ngjarjes, shpesh mund të ndodh që të fitohen profile të ADN-së së familjarëve. Është baza më e madhe e të dhënave të ADN-së në botë, e cila vetëm në shtetet e bashkuara të Amerikës, ka me miliona profile të ADN-së.

**Sistemi CODIS** - është sistem i sofistikuar, i cili mundëson kërkimin automatik të profileve të caktuara të ADN-së për kohë shumë të shkurtër (për disa sekonda te bazat e vogla, ndërsa për disa minuta te bazat e mëdha të ADN-së). Në rast të përputhjes së profilit të caktuar të ADN-së, me ndonjërin nga profilet e ADN-së të ruajtura në sistem, sistemi në mënyrë automatike paraqet përputhjen dhe vlerën e saj, e cila mund të jetë përputhje e lartë, mesatare ose e ulët. Përveç kësaj sistemi gjeneron raportin e kërkimit, eksperti pastaj mund të vlerësoj vlerën e kësaj përputhje në mënyrë manuale me elektroferogramet nga mostrat përkatëse të ADN-së (FBI-Baza e të Dhënave të ADN-së, v. 7.0, 2013).

Sistemi ka menynë kryesore dhe disa meny të tjera. Pjesët më të rëndësishme të menysë janë: Specimen Manager, Match Manager, Pedigree Manager, Searcher, AutoSearcher, Popstats etj. (7.0 SP2, Training Manual, 2012).

Secila prej këtyre pjesëve të menysë ka funksione të veçanta dhe nëse klikohet mbi to hapen dritare të veçanta me veglat e nevojshme për operim.

Nga menyja kryesore e sistemit, dritarja Specimen Manager, vegla përkatëse e operimit përdoret për t'i futur profilet e ADN-së, po në këtë dritare është i mundur edhe korrigjimi apo fshirja e profilit të caktuar të ADN-së ( 7.0 SP2, Training Manual, 2012)..

Llojet e kërkimit në CODIS: CODIS ka tri mënyra (vegla) të kërkimit: Searcher, Pedigree Searcher dhe AutoSearcher.



Searche - apo kërkuesi i zakonshëm i cili përdoret më së shumti dhe e bënë kërkimin për profilin e caktuar me të gjitha profilet në bazën e të dhënave për të bërë identifikimin e personit të caktuar.

Pedigree Searcher - apo kërkuesi në bazë të trungut farefisnor, për të përcaktuar identitetin e personave të zhdukur apo mbetjeve të paidentifikuara njerëzore pas konflikteve të armatosura. Për këtë lloj kërkimi nevojiten profilet e ADN-së nga familjarët (e posaçërisht mostrat nga prindërit apo fëmijët e personit të zhdukur) dhe nevojitet privilegj i veçantë për kërkim.

Auto Searcher - apo kërkimi automatik i programuar i cili kërkon kategoritë e veçanta (varësisht si programohet), dhe mund të konfigurohet edhe me një orar të caktuar të kërkimit si p.sh. një herë në muaj. Ky i fundit zakonisht programohet që të kërkoj të gjitha kategoritë kundrejt të gjitha kategorive që kanë kuptim (p.sh. kërkimi i një profili të ADN-së së një të dyshuari me të gjitha profilet e ADN-së nga vendi i ngjarjes), me qëllim që të bëhet një kërkim sa më i plotë i të gjitha profileve të ADN-së ( 7.0 SP2, Training Manual, 2012).

Sistemi po ashtu mundëson edhe kalkulime statistikore të ndryshme si p.sh. kalkulimin statistikor të shpeshësisë së paraqitjes së një profili të caktuar, kalkulimet statistikore të përputhjeve të profileve të ADN-së te trungjet farefisnore – Pedigree, kalkulimet e studimit të popullacionit – Popstats etj. Sistemi , mund të lidhet në rrjet me sistemet e tjera të bazave të të dhënave të ADN-së, qoftë brenda vendit (nëse ekzistojnë më shumë baza të tilla) apo me bazat e të dhënave të ADN-së të shteteve tjera (7.0 SP2, Training Manual, 2012).

**Raporti i ekspertizës së ADN-së** - Në fund të analizave të ADN-së, për një rast të veçantë hartohet raporti zyrtar. Raporti i ADN-së përmban të gjitha informatat e nevojshme rreth analizave të kryera, të kërkuara nga institucionet e zbatimit të ligjit, gjykatat, prokuroritë, apo institucionet e tjera të zbatimit të ligjit. Në faqen e parë të raportit, në pjesën lartë gjendet logo e institucionit, në mes emri i institucionit dhe emri i institucionit që ka bërë kërkesën për analiza të ADN-së, kurse poshtë të dhënat e rastit, siç janë numri i rastit i laboratorit, numri i hetuesisë, numri i gjykatës, data kur është pranuar rasti dhe data e përfundimit. Në faqen e dytë gjendet pjesa përshkrimi i dëshmive, ku bëhet përshkrimi detaj i dëshmive të pranura për analiza. Pas kësaj vijnë metodat dhe pajisjet e përdorura, ku përshkruhen të gjitha metodat dhe pajisjet e përdorura gjatë analizave të ADN-së. Në vijim janë rezultatet e ekspertizës, ku përshkruhen rezultatet e testeve të përdorura dhe në formë tabelare paraqiten profilet e fituara të ADN-së. Në

fund vjen pjesa e konkluzioneve ku në bazë të rezultateve të fituara, jepen konkluzionet e duhura për të gjitha dëshmitë e analizuara. Raportin e ADN-së, të nënshkruar nga eksperti dhe të vërtetuar nga institucioni, e merr hetuesi i ngarkuar me rastin, i cili ia përcjell personit përgjegjës (gjyqtarit, apo prokurorit) nga institucioni i cili ka kërkuar ekspertizat e ADN-së.

## Kapitulli V: Ekspertiza në procedurë penale

Në kuadër të këtij studimi doktoral janë analizuar dhe krahasuar dispozitat ligjore mbi ekspertizën të procedurës penale të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës.

Në procedurën penale të Shqipërisë: “Ekspertiza lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore” (procedura penale e Shqipërisë, 2011: 50). Në procedurën penale të Kosovës nuk ka ndonjë përkufizim për ekspertizën, por janë mjaft mirë të rregulluara aspektet procedurale, siç janë: përdorimi i ekspertizës nga prokurori i shtetit, vendimi për angazhimin e ekspertit, raporti i ekspertit, urdhrat e nevojshëm për shqyrtimin e provave nga eksperti, deklarata e ekspertit në procedurën paraprake, angazhimi i ekspertit nga i pandehuri, kundërthëniet në mes të ekspertëve, analizat toksikologjike, ekzaminimi i lëndimeve trupore dhe ekzaminimi fizik, analizat molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-së, analizat psikologjike, analizat kompjuterike, analizat financiare. Në Ligjin për Ekspertizë të Republikës së Maqedonisë: “Ekspertiza është përgatitja e konstatimit dhe e mendimit profesional, të përgatitur në bazë të zbatimit të metodave shkencore dhe profesionale, të arritjeve teknike, të njohurive dhe të përvojave profesionale në sferat që janë të definuara në të gjitha rastet e përcaktuara me ligj, ose me kërkesë të personit të interesuar-porositës”. (ligji për ekspertizë i republikës së Maqedonisë, 2013: neni 2). Në ligjin për agjencinë e Kosovës për forenzikë: “Ekspertiza është hulumtimi, hetimi, gjurmimi, vlerësimi apo studimi i provuar, përfshirë edhe raportet nga këto aktivitete, konstatimet dhe rezultatet që kërkojnë njohuri specifike dhe të cilat kryhen nga ekspertë për të vërtetuar dhe për të dhënë mendimin mbi faktet e caktuara” (ligji për agjencinë e Kosovës për forenzikë, 2011: 2). Siç mund të shihet në dispozitat e kodit të procedurës penale është përcaktuar ana procedurale e ekspertizës si veprim procedural. Por, ekspertiza sipas natyrës dhe përmbajtjes ka edhe anën tjetër, e cila është e lidhur me aplikimin e njohurive shkencore ose aftësive profesionale. Ky aspekt nuk është dhe nuk mund të përcaktohet me norma juridike. Veprimtaria shkencore (ekspertiza) e ekspertit zhvillohet sipas rregullave të profesionit të caktuar shkencor dhe aftësisë së tij. Në raport me këto metoda, një rol të madh luan dëshmimi i fakteve të rregullave shkencore. Eksperti duhet të kombinojë të menduarit sipas rregullave të shkencës me mendimin normativ, juridik dhe kriminalistik.

Mendimi shkencorë ndihmon që gjendja faktike të vërtetohet përmes proceseve të ndryshme njohëse. Njohja e mirë e rregullave të ekspertizës forenzike është më se e nevojshme, sepse bëhet fjalë për vërtetimin e fakteve, të cilat janë me rëndësi të veçantë për të vërtetën para drejtësisë.

Eksperti është personi të cilin organi procedues e ka caktuar, që duke zbatuar njohuritë ose shkathtësitë profesionale, të jep deklaratë në procedurën ndëshkimore. Eksperti është pjesëmarrës i zëvendësueshëm në procedurën ndëshkimore. Për një ekspert është me rëndësi të posedojë njohuri ose shkathtësi profesionale në kuptimin e vërtetë dhe urdhëresa e organit procedural si premisë formale e emërimit të tij. Ekspertët dallohen duke u bazuar në atë se a është fjala për ekspertin e përhershëm gjyqësor ose për ekspertin, i cili emërtohet për një rast të caktuar. Në disa raste ekspertiza është e detyrueshme, d.m.th. ligji e përcakton që argumenti i qëndrueshëm mund të konstatohet ose të sqarohet vetëm në bazë të dëshmisë së ekspertit. Jashtë këtyre rasteve zbatimi i ekspertizës varet nga vendimi i gjykatës apo i prokurorit, e posaçërisht në rastet kur ekziston organi apo institucioni i specializuar për ekspertizë, sidomos atyre më të ndërlikuara, ekspertiza i besohet atij organi apo institucionit. Kjo është rregulluar në kodin e procedurës penale të Kosovës, kështu në nenin 137, paragrafin 1 parashihet: *“Nëse ndonjë lloj i caktuar i ekspertizës i përgjigjet fushës së ndonjë institucioni profesional apo ekspertiza mund të bëhet brenda një organi publik të caktuar, kjo detyrë, posaçërisht nëse është detyrë e ndërlikuar, si rregull i besohet institucionit të tillë profesional apo organit publik. Institucioni profesional apo organi publik cakton një apo disa ekspertë për të kryer ekspertizën . Po qe se është e mundur dhe nëse nuk krijohet konflikt interesi, ekspertët caktohen nga institucionet profesionale ose organet publike, të cilat ofrojnë ekspertët e tyre kur një gjë e tillë kërkohet nga to”* (Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, 2011: 80).

Kodi i procedurës penale i Shqipërisë nuk ka ndonjë dispozitë ligjore të veçantë që përcakton “kryerjen e ekspertizës sipas ndërlikshmërisë” së saj, apo në rastet kur ekspertiza i besohet organit të caktuar publik apo institucionit profesional. Megjithatë, kodi i procedurës penale i Shqipërisë përmes dispozitave të veçanta ligjore, në përgjithësi, rregullon ekspertizën në procedurë penale si: objekti i ekspertizës, caktimi i ekspertit, papajtueshmëria me detyrën e ekspertit, përjashtimi i ekspertit, disponimet e organit të procedurës, caktimi i detyrës, veprimet e ekspertit, akti i ekspertizës dhe zëvendësimi i ekspertit.

Rezultat i ekspertizës është dëshmia e ekspertit, i cili manifestohet përmes aktit të ekspertizës dhe të dëshmimit në cilësinë e ekspertit. Ky argument është rezultat i përdorimit të njohurive profesionale ose të aftësive të veçanta, të cilat gjykata nuk i ka në dispozicion. Forma e zhvilluar përbëhet nga përcaktimi (zbulimi, identifikimi, analiza) i fakteve, d.m.th. i mendimeve dhe i konstatimeve të caktuara, bazuar në fakte. Në disa raste, që për dallim nga ekspertiza e plotë ose e zhvilluar mund të konsiderohet si ekspertiza me dimensione të kufizuara, kërkohet vetëm konstatimi ose vetëm mendimi i ekspertit.

Sa i përket ndryshimeve në procedurën penale të Kosovës Sahiti, Murati dhe Elshani në komnetarin e tyre konsiderojnë se ndër ndryshimet më domethënëse në kodin e ri të procedurës penale të Kosovës është fusha e ekspertizës.

Lexo me vëmendje argumentimin e tyre:

*Mund të thuhet se, ndër fushat ku kodi i procedurës penale është ndryshuar në mënyrë domethënëse është fusha e ekspertizës. Gjyqtari më nuk është “sponsorizuesi” i ekspertit. I pandehuri dhe pala e dëmtuar kanë më shumë mundësi për t’i sfiduar ekspertët. Kodi i procedurës penale në fuqi autorizon prokurorin e shtetit të caktojë ekspertizën (neni 136, 137, 139 paragrafi 1). I pandehuri, mbrojtësi, viktimave ose mbrojtësi i viktimave mund të kundërshtojnë zgjedhjen e ekspertit, bazuar në kualifikimet e tij, konfliktin potencial të interesit, duke paraqitur kundërshtim tek gjyqtari i procedurës paraprake.”(Sahiti, Murati, Elshani, 2014: 380)*

### **5.1. Objekti i ekspertizës**

Objekt i ekspertizës janë gjurmët dhe provat materiale, të cilat zakonisht gjenden në vendin e ngjarjes gjatë këqyrjes apo gjatë kontrollimit që kryhet nga organi hetimorë. Objekt i ekspertizës mund të jetë edhe një material i dorëzuar nga një qytetar apo një i interesuar. Është kjo arsyeja për të cilën sot shtrohet veçanërisht rëndësia e zbulimit dhe e marrjes së gjurmëve dhe provave materiale, prova që nuk ndryshojnë dhe kanë vlerë përcaktuese për gjetjen e së vërtetës. Ekspertiza caktohet për vërtetimin ose vlerësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm me qëllim të sigurimit të konstatimit dhe të mendimit nga personi i cili posedon njohuri dhe shkathtësi të nevojshme profesionale. Islami, Hoxha dhe Panda në librin e tyre

theksojnë se “qëllimi i ekspertizës penale është vërtetimi i fakteve që lidhen me veprën penale, rindërtimi i ngjarjes kriminale dhe identifikimi i personit që dyshohet për kryerjen e saj”. (Islami, Hoxha dhe Panda, 2012: 239). Ndërsa sa i përket shkaqeve për ekspertizë Pavišić dhe Modly në librin e tyre theksojnë se: "kryesisht ekzistojnë tri grupe shkaqesh për ekspertizë:

- a) që janë të orientuara në kumtimin e qëndrimeve të përgjithshme të diturisë dhe të shkathtësisë,
  - b) të atilla që janë orientuar në faktet konkrete procedurale,
  - c) të tjerat që janë të orientuara në kumtimin në bazë të njohurive të veçanta të çështjeve".
- (Pavišić dhe Modly, 1999: 212)

Në procedurën penale të Kosovës, ndër shkaqet kryesore për caktimin e ekspertizës janë: fajësia apo pafajësia e të pandehurit apo shkalla e dëmit të shkaktuar me veprën penale. Në këto rrethana është prokurori ai që merr aktvendimin për caktimin e ekspertizës dhe të ekspertit. Kështu në nenin 137, paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës parashihet se “Për përdorimin e ekspertizës nga prokurori i shtetit duhet të jetë fjala për fajësi ose për pafajësi të të pandehurit ose për shkallën e dëmit të shkaktuar me veprën penale” (kodi i procedurës penale i Kosovës, 2011: 79). Ndërsa në procedurën penale të Shqipërisë shkaku ndërlidhet me nevojën e zhvillimit ose të marrjes së të dhënave: “Ekspertiza lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore” (procedura penale e Shqipërisë, 2011: 50). Një përkufizim i njëjtë për ekspertizën është dhënë edhe në kodin e procedurës Penale të Italisë: “Ekspertiza ndërmerret atëherë kur është e nevojshme të bëhen hulumtime ose të grumbullohen të dhënat ose vlerësimet, të cilat kërkojnë njohuri të nevojshme teknike ose artistike”.

## **5.2. Caktimi i ekspertit**

Ndonëse në shikim të parë duket si një çështje e thjeshtë teknike, në fakt nuk është e tillë. Kjo do të thotë se caktimi i ekspertit përfaqëson një çështje të rëndësishme. Çmohet e tillë, jo vetëm nga fakti se konstatimi dhe mendimi i ekspertit është një provë që në raste të caktuara ka vlerë imediate për sqarimin e çështjes penale, por edhe për faktin që ndërlidhet me përzgjedhjen e personave ose të institucioneve të cilat do t’u besohet përgatitja e ekspertizës, e cila, në çdo rast, duhet synuar të jetë e karakterit thjesht profesional.

Islami, Hoxha dhe Panda në librin e tyre parashohin kompetencën e prokurorit për caktimin e ekspertit, kur procedon në veprim.

Lexoni me vëmendje argumentin e tyre bazuar në Procedurën Penale të Shqipërisë:

“Në nenin 314 është parashikuar e drejta e prokurorit për të caktuar ekspertë, kur procedon në veprime, për të cilat kërkohen njohuri teknike, duke i dhënë atij (ekspertit) detyra dhe duke e lejuar të marrë pjesë në veprime të veçanta hetimore...eksperti i caktuar nga prokurori nuk ka të drejtë të refuzojë detyrën pa shkaqe të arsyeshme”(Islami, Hoxha dhe Panda, 2012: 240).

Një risi që haset në kodin e ri të procedurës penale të Kosovës, lidhur me caktimin e ekspertit, është zgjerimi i kompetencës së prokurorit të shtetit në caktimin e ekspertizës dhe të ekspertit. Kështu prokurori i shtetit merr vendim për të gjitha llojet e ekspertizave, përveç rasteve kur kërkohet ndërhyrje trupore në të pandehurin për marrjen e gjakut, indit trupor apo mostrave të tjera mjeko-ligjore ose mjekësore, pra në raste të tilla duhet urdhëri i gjyqtarit të procedurës paraprake, përveç rasteve kur i pandehuri vullnetarisht pranon marrjen e mostrave në fjalë. Prokurori i shtetit mund të angazhojë ekspertë. Eksperti kryen ekspertizën e tij të cilën e paraqet si raport me shkrim. Eksperti duhet t'i përgjigjet pyetjeve të parashtruara si dhe të tregojë me hollësi kualifikimin dhe përvojën e tij në të cilën mbështetet emërimi i tij si ekspert. Eksperti gjithashtu duhet të përshkruajë provat e shfrytëzuara për realizimin e ekspertizës, teknikat e përdorura për zbatimin e ekspertizës, si dhe të shpjegojë se teknikat e përdorura janë përgjithësisht të pranuar në fushën e ekspertizës. Ndryshim thelbësor në kodin e ri të procedurës penale të Kosovës është edhe dhënia e së drejtës të pandehurit dhe palës së dëmtuar për caktimin e ekspertit si dhe kundërshtimin e ekspertit të caktuar nga prokurori. Ndërsa një prej ndryshimeve më radikale në kodin e ri të procedurës penale të Kosovës, në procesin e të provuarit, konsiderohet dhënia e së drejtës të pandehurit për angazhimin me pagësë të ekspertit.

Lexo me vëmendje nenin 141, paragrafët 1 dhe 2:

*I pandehuri mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të paraqes kërkesë për ekspertizë që është relevante për mbrojtjen e tij. Nëse prokurori i shtetit refuzon, i pandehuri mund të kundërshtojë këtë vendim tek gjyqtari i procedurës paraprake.*

*I pandehuri mund të marrë dhe të paguajë vetë për ekspertizë. Eksperti duhet të veprojë në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi dhe prokurori i shtetit duhet të pranojë kopjen e raportit të ekspertit të mbrojtjes brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga përfundimi i saj. “(kodi i procedurës penale i Kosovës, 2013:83)*

Lexo me vëmendje edhe nenin 144, paragrafët 4 dhe 6 të kodi të procedurës penale të Kosovës:

*Paragrafi 4*

*“Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë marrjen e mostrave të gjakut ose të indeve apo mostra të tjera mjeko-ligjore ose mjekësore nga një i pandehur, vetëm nëse ka gjasa reale që i pandehuri ka kryer veprën penale dhe ka shkak të bazuar për të besuar se mostrat do të sigurojnë prova për veprën penale ose për identitetin e kryerësit, apo ekzistojnë prova të tjera mjeko-ligjore që mund të krahasohen me mostrat e urdhëruara që të merren. Integriteti personal i të pandehurit do të respektohet gjatë ekzekutimit të urdhrit nga ky paragraf. Institucioni profesional, mjeku ose mjekët do të nxjerrin një raport të ekspertizës me gjetjet e tyre në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi.”*

*Paragrafi 6*

*“ Ekzaminimi fizik që ndërlidhet me ndërhyrjet trupore, siç është marrja e mostrave të gjakut gjatë ekzaminimit fizik, mund të bëhet vetëm me urdhër të gjykatës ose me pëlqimin e vullnetshëm të personit në fjalë. “(kodi i procedurës penale i Kosovës, 2011:84)*

Në kodin penal të Shqipërisë, neni 182, caktimi i ekspertit bëhet nga organi i procedurës: “Organi procedues disponon ekspertizën me vendim të motivuar, i cili përmban caktimin e ekspertit, paraqitjen e përmbledhur të çështjes, tregimin e ditës, të orës dhe të vendit të caktuar për paraqitjen e ekspertit”. (kodi i procedurës penale i Shqipërisë, 2010: 51)

Për ekspert mundë të caktohet personi fizik si ekspert i vetëm, ndërsa ekspertiza mundë t’i besohet edhe institucionit të caktuar profesional, veçmas te ekspertizat e ndërlikuara, (personi juridik). Gjykata mundet, nëse konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme, për ekspert të emërojë personin i cili nuk është ekspert gjyqësor, ndërsa posedon njohuri të nevojshme për çështjen konkrete.

### **5.3. Mendimi dhe konstatimi i ekspertit**

Përfundimisht, eksperti, bazuar në procedurat shkencore e analitike, duhet të japë mendimin me shkrim përmes raportit të ekspertizës apo aktit të ekspertizës. Konstatimi dhe mendimi i ekspertit i nënshtrohen vlerësimit të provave, sikurse çdo provë tjetër, me ç ‘rast edhe për të



sikurse për të gjitha provat tjera vlen rregulli i të ashtuquajturit vlerësim i lirë i provave. Pikërisht vlerësimi i rëndësisë argumentuese të kësaj prove, në teorinë e procedurës penale dhe në teorinë e provave, sot paraqet një nga çështjet më të rëndësishme, duke pasur parasysh përparimin e përhershëm të shkencës dhe të teknologjisë dhe të mundësisë gjithnjë e më të madhe me të cilën ekspertiza bashkëkohore shkencore dhe profesionale ofron me një saktësi dhe precizitet shumë të madh e me këtë edhe rezultate gjithnjë e më autentike, dhe me shumë më pak gjasa për gabime.

Kështu, në pikëpamje të rëndësisë argumentuese të ekspertit konsiderohet se mundësia e gjyqtarit për vlerësimin e mendimit dhe të konstatimit të ekspertit është e kufizuar dhe diç më pak në raport me mundësinë e tij për t'i vlerësuar rrethanat dhe faktet e përcaktuara me ndihmën e provave të tjera. Është theksuar pasoja logjike e faktit se ekspertiza pikërisht edhe caktohet për shkak se gjykata nuk disponon me njohuri dhe dije shkencore për konstatimin dhe për vlerësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm, prandaj për këtë shkak e urdhëron personin i cili zotëron dije dhe njohuri të tilla, që ta kryej ekspertizën.

Islami, Hoxha dhe Panda, në librin e tyre lidhur me mendimin në raportin e ekspertizës theksojnë: “Akti i ekspertizës duhet të jetë i saktë, i argumentuar dhe i plotë, duke u dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve të shtruara.”(Islami, Hoxha dhe Panda, 2012: 250).

Në Kodin Penal të Shqipërisë, neni 185, eksperti mendimin e vetë e jep përmes aktit të ekspertizës : “Mendimi i ekspertit jepet me shkrim”. Ndërsa Kodi i Procedurës Penale i Kosovës e rregullon në mënyrë më të detajuar raportin e ekspertizës me dispozitë të veçantë në nenin 138.

Lexo me vëmendje nenin 138 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës:

*“ Raporti i ekspertit përmban:*

- 1. të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;*
- 2. pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me veprën penale;*
- 3. përvojat dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;*
- 4. përshkrimin e provave që janë analizuar;*

5. përshkrimin e ekspertizës, përfshirë fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat e tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
6. shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuar në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike;
7. përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet në paragrafin 2. të këtij neni, ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje;
8. Eksperti nuk shpreh në raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit;
9. Raporti i ekspertit i cili nuk është në pajtim me këtë nen nuk është i pranueshëm;
10. Raporti i ekspertit i bashkëngjitet shkresave të lëndë dhe
11. Raporti i ekspertit i zbulohet të pandehurit apo mbrojtësit të tij dhe të dëmtuarit jo më pak se pesë (5) ditë para fillimit të seancës për deklaratë në procedurën paraprake nga eksperti, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi prokurori i shtetit ta ketë pranuar raportin e ekspertit.” (Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, 2011: 81)

Pothuaj se njëjtë edhe në Procedurën Penale të Maqedonisë në nenin 237, paragrafin 2 përcaktohen kushtet e raportimit të ekspertizës nga eksperti i caktuar, ku eksperti obligohet t’ia dorëzojë raportin organit që ka urdhëruar ekspertizën .

Lexo me vëmendje neonin 237 të Kodit të Procedurës Penale të Maqedonisë:

*“ Eksperti është i obliguar që te organi që e ka urdhëruar ekspertizën nga neni 236 paragrafi (3) të këtij ligji, të dorëzojë raport i cili i përmban: provat që i ka kontrolluar, testet e realizuara, konstatimin dhe mendimin te të cilët ka ardhur dhe të gjitha të dhënat tjera relevante që eksperti konsideron se janë të nevojshme për analizë të drejtë dhe objektive. Eksperti do të arsyetoj si ka ardhur te mendimi i caktuar”.(Kodi i Procedurës Penale i Maqedonisë, 20 : )*

Pra, eksperti është i obliguar që organit që e ka urdhëruar ekspertizën, gjyqtarit apo prokurorit, t’ua dorëzojë raportin, i cili i përmban: provat që i ka kontrolluar, testet e realizuara, konstatimin dhe mendimin te të cilët ka ardhur dhe të gjitha të argumentet dhe të dhënat e tjera që eksperti konsideron se janë të nevojshme për analizë të drejtë dhe objektive. Eksperti do të arsyetojë si ka ardhur deri te mendimi i caktuar. Raporti i ekspertit mund të jetë i mjaftueshëm për gjykatën ose

eksperti mund të thirret në seancë dëgjimore ku mund t'i kërkohet që të jep deklaratë në procedurën paraprake.

#### **5.4. Afati i kryerjes së ekspertizës**

Në procedurë penale të gjitha veprimet e organit të procedurës, të prokurorit, të gjyqësorit, të mbrojtjes, si dhe ekspertizat duhet të kryhen në kohën sa më të shpejtë të mundur. Kjo për faktin se palët, e veçanërisht i pandehuri, gëzojnë të drejtën e tyre të paraparë në procedurë penale për procedim të shpejtë, pa vonesë dhe të drejtë të çështjes së tyre penale. Po ashtu edhe ekspertiza kërkohet që të ketë një afat të arsyeshëm të kompletimit të saj. Numri i provave materiale dhe ana komplekse e lëndës për ekspertizë sigurisht që përcaktojnë kohën që nevojitet për kryerjen e një ekspertize.

Në procedurën penale të Kosovës nuk është paraparë afat për kryerjen e ekspertizës, por se parashihet se eksperti pa vonesë duhet të kryej ekspertizën dhe t'ia dorëzojë atë prokurorit. “Eksperti zbaton ekspertizën pa vonesë dhe ia dërgon prokurorit të shtetit me shkrim raportin e ekspertizës në pajtim me nenin 138 të këtij Kodi” (kodi i procedurës penale i Kosovës, 2011: 80) Ndërsa në Kodin e Procedurës Penale të Shqipërisë, për rastet komplekse për ekspertizë është përcaktuar koha shtesë prej 60 ditësh me mundësi vazhdimi në periudha prej 30 ditësh, por jo më gjatë se 9 muaj.

Lexo me vëmendje nenin 185, paragrafin 3, kodi i procedurës penale i Shqipërisë:

*“Kur faktet janë komplekse dhe eksperti nuk mund të jep përgjigje menjëherë, organi procedues i jep atij një afat jo më të gjatë se gjashtëdhjetë ditë. Kur ka nevojë për verifikime veçanërisht komplekse ky afat mund të zgjatet edhe më shumë se një herë për periudha jo më të gjata se tridhjetë ditë, por pa kaluar afatin maksimal prej gjashtë muajsh”. (Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë, 2010: 51)*

Ndërsa në kodin e procedurës penale të Maqedonisë, neni 237, kryerja e ekspertizës afatizohet në urdhëresën e organit procedues: “Personi i cili është i thirrur si ekspert është i obliguar që të lajmërohet në thirrje dhe të japë konstatimin dhe mendimin e vet në afatin e përcaktuar në urdhëresë. Afati i përcaktuar në urdhëresë, nga shkaqe të arsyeshme, mund të vazhdohet”. (Kodi i Procedurës Penale i Maqedonisë, 2010).

## 5.5. Përfjashtimi i ekspertit

Për ekspert nuk mund të angazhohet personi i cili nuk mund të pyetet si dëshmitar ose personi i cili është liruar nga detyrimi që të dëshmojë, si dhe as personi kundrejt të cilit është kryer vepra penale, e po qe se është emëruar, vendimi gjyqësor nuk mund të bazohet në konstatimin dhe mendimin e tij. Më tutje shkaqet për përfjashtimin e gjyqtarit nëse paraqiten te ekspertit, sjellin edhe deri te përfjashtimi i tij. Përveç kësaj si shkak për përfjashtimin e ekspertit ekziston edhe kur personi, i cili së bashku me të pandehurin ose me të dëmtuarin janë të punësuar te i njëjti punëdhënës dhe për personat e punësuar nga i dëmtuari ose i pandehuri.

Sipas kodit të procedurës penale të Shqipërisë janë palët ato të cilat kanë të drejtë të kërkojnë përfjashtimin e ekspertit në rastet e parapara për përfjashtim të gjyqtarit. d.m.th kushtet për përfjashtim të ekspertit janë të ngjashme me ato për përfjashtim të gjyqtarit.

Lexo nenin 181 të kodit e procedurës penale të Shqipërisë:

*Palët mund të kërkojnë përfjashtimin e ekspertit në rastet e parashikuara nga ky Kod për përfjashtimin e gjyqtarit. Kur ekziston një shkak përfjashtimi, eksperti është i detyruar ta deklarojë. Deklarimi i shkakut të përfjashtimit nga vetë eksperti ose kërkimi i përfjashtimit nga palët mund të paraqiten derisa të mos jetë bërë caktimi i detyrës dhe, kur shkaqet kanë lindur aty për aty ose janë njohur më pas, para se eksperti të ketë dhënë mendimin e tij. Mbi deklarin e ekspertit për përfjashtim ose të kërkesës për përfjashtimin e tij vendos, me urdhër, organi procedues që ka caktuar ekspertizën. (kodi i procedurës penale i Shqipërisë, 2010: 50).*

Në kodin e procedurës penale të Kosovës për përfjashtimin e ekspertit vendos kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i kolegjit shqyrtues apo kolegjit ankimor, neni 45, paragrafi 1: “Kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i kolegjit shqyrtues apo i kolegjit ankimor vendos për përfjashtimin e procesmbajtësit, përkthyesit, specialistit, ekspertit dhe mbrojtësit të viktimave.” (kodi i procedurës penale i Kosovës, 2011: 25)

Ndërsa kodi i procedurës penale i Maqedonisë e ka të rregulluar në mënyrë më të detajuar përfjashtimin e ekspertit. Janë katër situata kur personi nuk mund të angazhohet për ekspert:

- a) Personi që nuk mund të merret në pyetje si dëshmitar
- b) Personi i cili është i liruar nga detyra që të dëshmojë
- c) Personi kundër të cilit është kryer vepër penale

- d) Personi i cili bashkë me të akuzuarin ose me të dëmtuarin është në marrëdhënie pune në organin e njëjtë ose person tjetër juridik, si dhe në lidhje me personin i cili është në marrëdhënie pune tek i dëmtuari ose i akuzuari dhe
- e) Personi i cili është marrë në pyetje si dëshmitar.

Lexo me vëmendje nenin 238, kodi i procedurës penale i Maqedonisë:

*“ Për ekspert nuk mund të merret personi i cili nuk mund të merret në pyetje si dëshmitar (neni 213 i këtij ligji) ose personi i cili është i liruar nga detyra që të dëshmojë (neni 214 i këtij ligji), si dhe personi kundër të cilit është kryer vepër penale, e nëse është marrë, në konstatimin dhe mendimin e tij nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor.*

*Arsyeja për përjashtimin e ekspertit ekziston edhe në lidhje me personin i cili bashkë me të akuzuarin ose me të dëmtuarin është në marrëdhënie pune në organin e njëjtë ose person tjetër juridik, si dhe në lidhje me personin i cili është në marrëdhënie pune tek i dëmtuari ose i akuzuari. Për ekspert nuk mund të merret personi i cili është marrë në pyetje si dëshmitar.*

*Kur lejohet ankesë e veçantë kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa për përjashtimin e ekspertit (neni 36 paragrafi (7) nga ky ligj), ankesa e shtyn zbatimin e ekspertizës, nëse nuk ekziston rrezik nga shlyrja. .” (kodi i procedurës penale i Maqedonisë, 2010).*

## **5.6. Super ekspertiza**

Në rastet kur mendimi apo konstatimi i ekspertëve është i paqarte, jo i plotë apo në kundërshtim me vetveten apo me rrethanat e shqyrtuara, organi procedues mund të kërkojë përsëritjen e ekspertizës nga eksperti i njëjtë, eksperti tjetër apo grupi i ekspertëve të tjerë.

Në kodin e procedurës penale të Kosovës rregullohen rrethanat e përsëritjes së ekspertizës në rast të kundërthënieve në mes të ekspertëve:

Lexo nenin 142 të kodit të procedurës penale të Kosovës:

*“ Në qoftë se të dhënat në konstatimin e ekspertëve ndryshojnë thelbësisht, ose kur konstatimet e tyre janë të paqarta, jo të plota apo në kontradiktë me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara, e në rast se këto të meta nuk mund të mënjanojnë me marrjen*

*e serishme në pyetje të ekspertëve, mund të kërkohet mendimi i ekspertëve të tjerë.*

(kodi i procedurës penale i Kosovës, 2011: 83)

Ndërsa në kodin e procedurës penale të Maqedonisë për mënjanimin e kontradiktave në mendimet dhe konstatimet e ekspertëve, gjykata mund të caktojë përsëritjen e ekspertizës apo super ekspertizë.

Lexo me vëmendje nenin 394, paragrafin 2 të kodit të procedurës penale të Maqedonisë:

*Për mënjanimin e kundërshtimeve në konstatimet dhe mendimet e personave ekspertë ose profesionalë, gjykata sipas propozimit të palëve ose sipas detyrës zyrtare mund të përcaktojë edhe super ekspertizë. Super ekspertizën gjykata e përcakton në mënyrë elektronike me zbatimin e rregullës së zgjedhjes së rastësishme nga regjistri i ekspertëve, në prani të dyja palëve, përkatësisht të paditësit dhe mbrojtësit.*

Në kodin e Procedurës Penale të Shqipërisë nuk ekziston ndonjë dispozitë ligjore që i rregullon rrethanat për përsëritjen e ekspertizës.

Nëse ekspertiza kryhet nga një grup i caktuar ekspertësh, mendimi dhe konstatimi i tyre duhet të jetë unik. Mirëpo, dilema shtrohet në rastet kur ekspertët nuk pajtohen në mes veti dhe kanë mendime të kundërta. Kjo çështje është rregulluar në kodin e procedurës penale të Shqipërisë, por jo në kodin e procedurës penale të Kosovës dhe atë të Maqedonisë. Për mendimin tim kjo çështje është një çështje mjaft e rëndësishme dhe duhet të rregullohet në procedurën penale. Fjala është për rastet kur ekspertët kanë mendime të kundërta dhe detyrohen që secili prej tyre të dorëzojë veç e veç raportin me mendimin dhe konstatimin e tyre. Kështu në nenin 185 të kodit të procedurës penale të Shqipërisë është përcaktuar se: “Kur ekspertët e caktuar janë më shumë se një dhe kanë mendime të ndryshme, secili parashton me akt të veçantë mendimin e tij”. (kodi i procedurës penale i Shqipërisë, 2010).

### **5.7. Rastet kur ekspertiza është e detyrueshme**

Në ato raste ku ekspertiza me ligj është e obliguar, për gjykatën nuk ka dilema se duhet apo nuk duhet caktuar ekspertiza, mirëpo nëse ekspertiza nuk është obligatore, gjykata do ti shfrytëzojë ekspertët kur gjen se për vërtetimin e ndonjë fakti relevant është e nevojshme dije dhe shkathtësi specifike, e me të cilën gjykata nuk disponon.

Ekspertiza është e obliguar atëherë:

- Kur ekziston dyshimi ose është e dukshme se vdekja është shkaktuar me veprën penale;
- Kur ekziston dyshimi se vdekja është shkaktuar nga helmimi;
- Kur është e nevojshme ekspertiza për lëndime trupore;
- Kur paraqitet dyshimi përkitazi me llogaritsh mërinë e kryesit.

## **5.8. Analizat molekulare e gjenetike, analiza e ADN-së**

Në kodin e procedurës penale të Shqipërisë dhe kodin e procedurës penale të Maqedonisë nuk ka ndonjë dispozitë ligjore që rregullon në mënyrë të veçantë analizat molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-së. Ndërsa në kodin e procedurës penale të Kosovës, neni 145, ligjvënësi ka paraparë dispozitë të veçantë ligjore për rregullimin e analizave molekulare e gjenetike dhe analiza të AND-së.

Lexo me vëmendje nenin 145, të kodit të procedurës penale të Kosovës:

*Analizat molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-së*

- 1. Çdo ekzaminim ose analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.*
- 2. Gjykata mund të urdhërojë që materiali i siguruar me masat nga neni 144 i këtij Kodi t'i nënshtrohet ekzaminimeve molekulare dhe gjenetike për aq sa masat e tilla janë të nevojshme për të përcaktuar prejardhjen ose për të vërtetuar nëse gjurmët e gjetura i përkasin të pandehurit apo të dëmtuarit.*
- 3. Me qëllim të përcaktimit të identitetit në procedurë penale, indet qelizore mund të merren nga personi i pandehur për identifikimin e ADN-së në pajtim me nenin 144 të këtij Kodi.*
- 4. Indi i marrur qelizor mund të përdoret vetëm për identifikimin e ADN-së, siç është paraparë në paragrafin 1. ose 2. të këtij neni; ai shkatërrohet pa vonesë kur më nuk është i nevojshëm për atë qëllim. Informacionet tjera, përveç atyre që kërkohen për të përcaktuar kodin e ADN-së, nuk përcaktohen gjatë ekzaminimit dhe janë të papranueshme.*
- 5. Provat e gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale mund të ekzaminohen dhe mostrat mund t'i nënshtrohen ekzaminimit molekular dhe gjenetik sipas urdhrit të prokurorit të shtetit.*

*6. Rezultatet nga ekzaminimi molekular dhe gjenetik i mostrave të siguruara sipas paragrafit 5. të këtij neni të cilat nuk përputhen me të dyshuarin apo të pandehurin mund të ruhen nga Ministria e Drejtësisë deri në një kohë të tillë kur ato të përputhen me të dyshuarin apo të pandehurin dhe derisa ai i dyshuar apo i pandehur të lirohet apo të shpallet fajtor. Ministria e Drejtësisë lëshon rregullore mbi ruajtjen e rezultateve të ekzaminimit molekular dhe gjenetik sipas këtij paragrafi.*

Siç mund të shihet në këtë dispozitë ligjore ligjvënësi ka rregulluar kushtet e marrjes, analizës, asgjësimit të mostrës dhe ruajtjes së rezultatit të ADN-së nga i pandehuri. Nëse i bëjmë një analizë kësaj dispozite ligjore mund të komentojmë dy çështje: E para ka të bëjë me rëndësinë që i kushton ligjvënësi procedimit me të pandehurin në kumtimin e marrjes dhe trajtimit të mostrës së ADN-së dhe e dyta me ruajtjen e rezultateve, gjegjësisht profilit të ADN-së. Ruajtja e profilit të AND-së është çështje e cila është identifikuar si çështje problematike, për shkak të paqartësisë ligjore të kompetencës se kush është institucioni ligjorë përgjegjës për ruajtjen, mbajtjen dhe kontrollin e të dhënave të AND-së në kudër të institucioneve të republikës së Kosovës.

Siç pamë më lartë, kodi i procedurës penale i Kosovës, në nenin 145, paragrafi 6, i jep të drejtë ministrisë së drejtësisë që me urdhër të prokurorit provat e gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale mund të ekzaminohen dhe mostrat mund t'i nënshtrohen ekzaminimit molekular e gjenetik.

Në bazë të hulumtimit që kamë bërë në kuadër të këtij studimi doktorat, por edhe në bazë të informacioneve zyrtare që posedoj kam konstatuar se ministria e drejtësisë, nuk ka zhvilluar apo vendosur ndonjë regjistër të dhënash për mbajtjen apo ruajtjen e provave të gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale. Për më shumë Ministria e drejtësisë, duke u thirrur në kodin e procedurës penale, në vitin 2014 kishte nxjerrë një udhëzim administrativë, MD - nr. 11/20141 për ruajtjen e rezultateve të ekzaminimit molekular e gjenetik. Ky udhëzim administrativë, thirrur në kodin e procedurës penale të Kosovës i jep të drejtë departamentit të mjekësisë ligjore ruajtjen rezultateve të ekzaminimit molekular e gjenetik. Në anën tjetër ministria e punëve të brendshme, respektivisht Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ka zhvilluar dhe vendosur regjistrin për mbajtjen, ruajtjen dhe kontrollin, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale. Kështu në ligjin nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, në nenin 18, veprimtaria e AKF-së, paragrafi 6 dhe 7, është paraparë se:



6. “AKF në sisteme manuale apo sisteme të digjitalizuara, mban dhe mirëmban të dhëna relevante për qëllime krahasimore.

7. Administrimi i të dhënave relevante dhe shkëmbimi i tyre me agjenci apo institucione tjera

brenda vendit si dhe aspekte tjera lidhur me të dhënat e personave do të rregullohen me

udhëzim administrativ nga kryeshefi i AKF-së, i cili duhet të jetë në përputhshmëri me Ligjin

për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rrjedhimisht, bazuar në paragrafin 7 të këtij neni, është nxjerrë udhëzimi administrativë nr. 02/2012-AKF për procedurën e administrimit të të dhënave dhe shkëmbimin e tyre me agjencitë apo institucionet tjera Brenda vendit si dhe aspekte tjera lidhur me të dhënat relevante. Me këtë udhëzim është rregulluar emërtimi dhe kushtet e shkëmbimit të të dhënave duke përfshirë edhe të dhënat për ADN përmes sistemit CODIS (Sistem i kombinuar tregues i ADN-së), donacion i FBI. Për funksionimin teknik të këtij sistemi do të flasim më gjerësisht në kapitullin e gjashtë.

Siç mund të shihet legjislacioni i Kosovës nuk ka përcaktuar çartë kompetencën për regjistrin e të dhënave për ADN, për pasojë është paraqitur një “konflikt ligjorë” në legjislacionin e Kosovës në lidhje me kompetencën për të dhënat e ADN-së. Në njëërën anë, procedura penale përcakton të drejtën (**de-juro**) e Ministrisë së Drejtësisë për mbajtjen apo ruajtjen e provave të gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale. Ndërsa në anën tjetër Agjencia e Kosovës për Forenzikë **de fakto** dhe **de-juro** bazuar në ligjin nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, mbanë dhe ruan rezultatet e provave të gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale, respektivisht profilizimin e ADN-së në sistemin e kompjuterizuar-CODIS.

## Kapitulli VI: Forenzika në Kosovë

Në të kaluarën, shkenca e forenzikës në Kosovë nuk kishte shënuar ndonjë zhvillim të dukshëm. Pas lufte, gjatë viteve 2000-2005 forenzika ishte konsoliduar në kuadër të administratës së UNMIK-ut, e organizuar në nivel qendror dhe lokal, kryesisht e udhëhequr nga policia e UNMIK-ut. Njësia e Forenzikës e policisë së UNMIK-ut përbëhej nga njësia për këqyrjen e vendit të ngjarjes, njësia e daktiloskopisë, njësia e balistikës, njësia e dokumenteve kontestuese dhe njësia kimiko-biologjike. Të gjitha këto njësi përbëheshin nga personeli i ndryshëm ndërkombëtar, kryesisht nga SHBA, Rusia, Turqia, Bullgaria etj. Njësia e Forenzikës kishte edhe njësitë rajonale në kuadër të komandave rajonale policore, të cilët kryenin këqyrjen e vendit të ngjarjes, ndërsa provat fizike për ekspertizë dërgoheshin në njësinë e Forenzikës së shtabit qendrorë të policisë së UNMIK-ut. Llojet e ekspertizave që kryheshin në atë kohë ishin ekspertiza e dokumenteve, ekspertiza e gjurmëve të gishtërinjve dhe ekspertiza balistike. Provat fizike për analizë kimiko-biologjike të ADN-së dhe drogave dërgoheshin në institutin e forenzikës të Bullgarisë në Sofje.

Qeveria Amerikane, duke parë të rëndësishme përkrahjen e Kosovës në ngritjen e kapaciteteve forenzike në luftimin dhe parandalimin e krimit, vendosi që përmes ICITAP-it të investojë në Kosovë një shumë të konsiderueshme mjetesh për ndërtimin e një laboratorit modern të Forenzikës. Kështu në Tetor, 2003 Qeveria Amerikane-ICITAP-i vendosi gur themelin e objektit të Laboratorit të Forenzikës. Ky vit, padyshim, konsiderohet viti i themelimit të forenzikës në Kosovë. “Viti 2003, është simbolizuar edhe në amblerën e AKF-së që nënkupton vitin e themelimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë” (udhëzim administrativ nr. 40/2012-mpb për stemën identifikuese të agjencisë së Kosovës për forenzikë: 2012: 3). Ndërsa gjatë viteve 2005-2007 laboratorit i forenzikës nën udhëheqjen e përbashkët të ICITAP dhe të policisë së Kosovës kalon një etapë të rëndësishme të zhvillimit. Gjatë kësaj kohe ndër zhvillimet më të rëndësishme konsiderohet zhvillimi i metodave shkencore forenzike për ekspertizë të drogave, analizë të ADN -së, ekzaminim të dokumenteve, ekzaminim balistik, ekzaminim të gjurmëve të gishtërinjve, krijimi i sistemit për sigurim të cilësisë dhe trajnimi i personelit brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2005 fillon të funksionojë laboratorit i forenzikës në kuadër të policisë së Kosovës. Disiplina e parë që filloj me ekspertizë ishte ekspertiza e drogave. Ky vit konsiderohet jo vetëm viti i fillimit të ekspertizave forenzike bashkohore, por njëherit edhe viti i fillimit të

zhvillimit të shkencës moderne të forenzikës në Kosovë. Pranim-dorezimi zyrtar i laboratorit të forenzikës nga ambasada Amerikane-ICITAP-i u bë më datë 05.07.2008. Ambasadorja e SHBA-së në Kosovë, Tina Kajdanova, në mënyrë solemne ia dorëzoi çelsat ish-ministrit të Punëve të Brendshme z. Zenun Pajaziti, përkatësisht ish-drejtorit të Laboratorit të Forenzikës, Nënkolonel Policor z. Blerim Olluri. Nga kjo datë Laboratori i Forenzikës pavarësohet dhe udhëhiqet nga ekspertë vendorë. Ndërsa në vitin 2010 forenzika e Kosovës përjeton një ndryshim thelbësor, laboratori i forenzikës i Policisë së Kosovës shndërrohet në Agjenci të pavarur ekzekutive në kuadër të ministrisë së punëve të brendshme, përcjellur me hartimin e infrastrukturës ligjore për agjencinë e Kosovës për forenzikë (në tekstin e mëtejme AKF). Kjo legjislaturë, përkatësisht ligji për AKF-në miratohet nga parlamenti i Kosovës dhe hyn në fuqi më datë 28.11.2011. Ndërsa ky vit pa dyshim, në aspektin juridik, konsiderohet viti i zhvillimit dhe i konsolidimit ligjor i forenzikës së Kosovës. Agjencia e Kosovës për forenzikë në janar të vitit 2013 anëtarësohet në asociacionin ndërkombëtar të instituteve të forenzikës (IAFI), me të drejta të barabarta. Në këtë organizëm momentalisht janë të anëtarësuar 36 shtete nga Evropa, nga Azia, nga Amerika dhe nga Afrika ([www.interforensic.org](http://www.interforensic.org), parë më datë 21.05.2016).

### **6.1. Aspekte ligjore: themelimi, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi**

Ashtu siç theksuam më lartë, ligjërisht përgjegjës për kryerjen e ekspertizave forenzike në Kosovë është AKF. Kjo agjenci ka infrastrukture ligjore, metoda shkencore bashkëkohore, personel të kualifikuar dhe të specializuar në nivel ndërkombëtar, me teknologji bashkëkohore. AKF kryen ekspertizat forenzike si në vijim:

1. ekspertiza balistike (armët e zjarrit),
2. ekspertiza të numrave identifikues të automjeteve,
3. ekspertiza daktiloskopike, ekspertiza të dokumenteve,
4. ekspertiza grafologjike të nënshkrimeve dhe të dorëshkrimeve,
5. ekspertiza të substancave narkotike,
6. ekzaminim të kompjuterëve dhe të telefonave celularë,
7. asistencë në shikimin dhe rikonstruksionin e vendit të ngjarjes për krime të rënda,
8. procesim, përgatitje dhe dërgim-pranim të dëshmive për ekspertizë jashtë vendit,
9. koordinim dhe bashkëpunim me laboratorë vendore dhe ndërkombëtare,
10. informata operative njësive hetimore,

#### 11. dëshmime në gjykatë në cilësinë e ekspertit.

Prokuroria, gjykata, personat juridikë dhe fizikë dërgojnë aty vendimin ose kërkesën për kryerjen e ekspertizës forenzike. Ky vendim i bën ekspertët e forenzikës të gëzojnë pavarësi në punën e tyre dhe të japin mendim objektiv, të paanshëm e të bazuar në procedurat shkencore të AKF-së.

AKF është e organizuar dhe e strukturuar në sistem piramidal të funksionimit dhe të veprimtarisë së saj. Në krye ka kryeshefin ekzekutiv, në vartësi të tij janë udhëheqësit e departamenteve, të cilët i udhëheqin shëfat e divizioneve (specialist i lartë mbikëqyrës). Aktualisht ekspertizat që kryhen nga AKF përjetojnë një ngritje cilësore. Kjo është e lidhur si me përgatitjen e gjithanshme profesionale, me njohuritë më bashkëkohore e po ashtu me metodat dhe mjetet shkencore moderne gjatë procesit të këqyrjes dhe të ekzaminimit të gjurmëve dhe të provave të ndryshme, të cilat bëhen objekt ekspertimi, duke i dhënë përparësi automatizmit të shumë proceseve ekzaminuese, e cila ka rritur dukshëm shpejtësinë e kryerjes së ekspertizave.

Ligji për AKF nr. 04/l-064 është një prej arritjeve më të rëndësishme për forenzikën e Kosovës. Ky ligj organik rregullon përkufizimet shkencore, administrative dhe procedurale; themelimin e agjencisë së Kosovës për forenzikë me elementet përcjellëse; organizimin dhe funksionet; kompetencat dhe përgjegjësitë; të drejtat e personelit dhe disiplina. Në koncept ky ligj rregullon themelimin dhe funksionimin e agjencisë ndërsa me akte të tjera nënligjore rregullohet veprimtaria shkencore. Ligji parasheh nxjerrjen e akteve nënligjore për rregullimin administrativ të AKF-së, akte të cilat miratohen nga ministri i punëve të brendshme apo kryeshefi ekzekutiv i AKF-së. Ajo që mund të konsiderohet element shumë i rëndësishme është se ky ligj garanton të drejtën e veprimtarisë dhe të aktivitetit shkencor të AKF-së. Si model me rastin e hartimit të këtij ligji janë marrë ligji i inspektoratit policor të Kosovës, ligji i agjencisë së Kosovës për inteligjencë, ligji i policisë së Kosovës, ligji i mjekësisë ligjore etj. Para hyrjes në fuqi të këtij ligji ekspertizat forenzike rregulloheshin me parime dhe me procedura të policisë së Kosovës. Kjo mënyre e rregullimit të një çështjeje kaq të rëndësishme, siç është ekspertiza forenzike, nuk gjykohej e drejtë, për faktin se mungonte baza ligjore për veprim, ku shpeshherë nga mbrojtja apo nga prokuroria ngriteshin dilema për bazën ligjore për kryerje të ekspertizave. Andaj zhvillimi i infrastrukturës ligjore për shkencën e forenzikës përkatësisht AKF ishte tejet i rëndësishëm.

**Parimet themelore** - Marrë në përgjithësi parimet themelore paraqesin rregullat bazike për themelimin, misionin, organizmin, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe për financimin e AKF. Në nenin 1 të Ligjit për AKF-në është paraparë se: “Ky ligj rregullon themelimin, misionin, organizimin, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e agjencisë së Kosovës për forenzikë”. Siç mund të shihet ligji e rregullon aspektin administrativ, siç janë themelimi, misioni, organizimi, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe financimi dhe pak lëshohet në aspektin shkencor, duke lënë mundësi që kjo çështje të rregullohet përmes dispozitave të tjera nënligjore, siç janë udhëzimet administrative apo rregulloret e brendshme shkencore. Në nenin 5 është definuar misioni i AKF-së ku është paraparë: “Misioni i AKF-së është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së saj, të ofroj shërbime forenzike cilësore në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare”. Ndërsa në ndërlidhje me këtë nen në nenin 10 është paraparë akreditimi, përkatësisht standardizimi mandator i laboratorëve të AKF-së. Në kuadër të këtij neni janë paraparë dy paragrafë. Në paragrafin e parë është paraparë : “Laboratorët e AKF-së duhet të akreditohen dhe të mirëmbahen sipas standardeve ndërkombëtare”, ndërsa në paragrafin e dytë është paraparë: “Procedurat për akreditim sipas standardeve ndërkombëtare dhe afatet për akreditim do të rregullohen me udhëzim administrativ nga kryeshefi ekzekutiv i AKF-së”. Gjatë analizës së këtyre dispozitave ligjore mund të komentojmë dy çështje të rëndësishme. E para është çështja që ka të bëjë me shërbimin cilësor. Në këtë pikë ligjvënësi vë në pah rëndësinë e cilësisë së shërbimeve forenzike, duke mandatuar kështu akreditimin, përkatësisht standardizimin dhe mirëmbajtjen e metodave shkencore. E dyta është çështja që rrjedhimisht ndërlidhet me të parën, ku shërbimet cilësore duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me standardet vendore dhe ato ndërkombëtare. Ligjvënësi në këtë pikë vendos kriter apo kusht që shërbimet forenzike që ofron AKF-ja duhet të jenë në harmoni me legjislacion vendor (kodi i procedurës penale dhe kodi penal), me standardet vendore (ligji për standardizim dhe konformitete), me standardet ndërkombëtare (ISO 17025: 2007). Si autoritet për nxjerrjen e procedurave për akreditim, ligjvënësi parasheh udhëheqësin e AKF-së, përkatësisht Kryeshefin Ekzekutiv.

Si parim bazë është respektimi dhe zbatimi i kodit të etikës së AKF-së nga ana e punonjësve të AKF-së, andaj në nenin 7 janë paraparë dy paragrafë që rregullojnë këtë çështje. Në paragrafin e parë është paraparë: “Punonjësit e AKF-së duhet të respektojnë kodin e etikës së AKF-së dhe parimet që parashihen në kodin e mirësjelljes për punonjësit civil”. Në paragrafin e dytë është

paraparë: “Punonjësit e AKF-së, në përmbushje të detyrave të tyre, do të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi”. Përmes këtyre dy paragrafëve ligjvënësi vendos detyrimin e punonjësit të AKF-së për respektimin dhe zbatimin e parimeve bazë të kushtetutës siç janë të drejtat dhe liritë e njeriut, kodin e etikës së AKF-së dhe kodin e mirësjelljes për nëpunësit civilë. Në nenin 7 është paraparë: AKF ka stemën e vetë e cila propozohet nga kryeshefi i AKF-së dhe miratohet nga ministri”. Neni 8 është ndarë në dy paragrafë, të cilët janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin. Në paragrafin e parë është paraparë: “Punonjësit e AKF-së janë të pajisur me kartelë identifikimi që shërben si autorizim për veprim në AKF”. Ndërsa në paragrafin 2 është paraparë: forma, pajisja dhe mënyra e përdorimit të dokumentit të identifikimit rregullohen me një akt normative që nxirret nga kryeshefi ekzekutiv i AKF-së”. Në nenin 9 është rregulluar financimi i AKF-së ku është paraparë se: “AKF-ja është zë i veçantë buxhetor në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Buxheti i AKF-së duhet të shqyrtohet dhe të miratohet në procesin e rregullt buxhetor, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë”. Sipas zgjedhjes së dhënë në këtë dispozitë ligjore AKF-së i është dhënë e drejta e qasjes në buxhetin publik të Republikës së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ligjvënësi shprehimisht parashihet që buxheti i AKF-së të shqyrtohet dhe të miratohet në procesin e rregullt buxhetor e në pajtim me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë. Me nenin 11 është rregulluar pavarësia e AKF-së në kuptimin e ekspertizave forenzike dhe informacioneve operative hetimore. Kështu në paragrafin e parë është paraparë: “Kryeshefi i AKF-së i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e AKF-së. Kryeshefi i AKF-së bashkëpunon me ministrin dhe i ofron atij informatat dhe raportet e nevojshme për administrimin dhe menaxhimin e AKF-së”. Në paragrafin e dytë është paraparë: Në lidhshmëri me paragrafin 1 të këtij neni, informata që ka të bëjë me çështje hetimore apo ndonjë ekspertizë, mund të ofrohet vetëm me urdhër të gjykatës kompetente apo të prokurorisë”. Ndërsa në paragrafin e tretë është paraparë: “Ministri mund të kërkojë raporte, informacione dhe dokumente të tjera, që lidhen me detyrat e AKF-së lidhur me administrimin dhe menaxhimin e AKF-së, duke mos ndërhyrë në veprimtarinë e AKF-së siç është paraparë në paragrafin 2 të këtij neni”. Sipas zgjedhjes së dhënë në këtë dispozitë ligjore kryeshefi i AKF-së ka për detyrë të raportojë dhe informoj ministrin për administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të AKF-së, por nuk ka për detyrë apo më mirë të themi nuk ka të drejtë t’i raportoj ministrit për çështjet që

kanë të bëjnë me ekspertizë forenzike apo hetime penale, përveç rasteve kur urdhërohet nga gjykata apo prokuroria kompetente. Ligjvënësi përmes kësaj dispozite zgjidh çështjen e pavarësisë së ekspertizave forenzike dhe të informatave të tjera hetimorë ku askujt madje as ministrit si autoritet i lartë nuk i lejohet qasja në këto informacione pa urdhër të gjykatës apo të prokurorisë kompetente.

**Themelimi** - Duke parë të domosdoshme krijimin e një institucioni të pavarur, të paanshëm dhe objektiv, i cili veprimtarinë dhe aktivitetet e tij do t'i ushtrojë, duke u bazuar në rregullat shkencore, ligjvënësi parasheh themelimin e një agjencie të pavarur ekzekutive. Së këndejmi në nenin 4, në paragrafin e parë është paraparë: “agjencia e Kosovës për forenzikë themelohet si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të ministrisë së punëve të brendshme”. Përmes këtij paragrafi ligjvënësi rregullon pavarësinë e plotë të AKF-së në vendimmarrje dhe në kryerje të veprimtarisë në kuadër të ministrisë së punëve të brendshme. Në paragrafin e dytë është paraparë: “agjencia e Kosovës për forenzikë është person juridik”, ndërsa në paragrafin e tretë është paraparë: “agjencisë së Kosovës për forenzikë i garantohet e drejta për veprimtari objektive dhe të paanshme”.

Gjatë analizës që mund t'i bëhet këtyre dispozitave ligjore shtrohet e nevojshme të komentohen tri çështje. Çështja e parë është ajo që ka të bëjë me themelimin e agjencisë apo të institucionit të pavarur ekzekutiv. Çështja e dytë është ajo që ka të bëjë me njohjen e së drejtës së personit juridik dhe çështja e tretë dhe më e rëndësishmja është ajo që ka të bëjë me garantimin e së drejtës për veprimtari objektive dhe të paanshme.

**Fushë veprimtaria** – Fushë veprimtaria dhe objekti i veprimtarisë së AKF-së janë rregulluar në nenin 2. Kjo çështje është trajtuar në kuadër të tri paragrafëve të veçanta. Kështu në paragrafin e parë është paraparë se: “AKF-ja është institucion përgjegjës për ofrim të paanshëm të analizave objektive shkencore forenzike”. Ku fillimisht ligjvënësi parasheh që AKF-ja të trajtohet si institucion, së dyti AKF-në e ngarkon me përgjegjësi për ofrim të paanshëm të analizave objektive shkencore forenzike, ku me analiza objektive shkencore forenzike nënkuptohet ofrimi i shërbimeve forenzike të paanshme, të bazuara në fakte të vërtetuara shkencërisht. Në paragrafin e dytë është paraparë: “AKF-ja i kryen veprimet me urdhër të gjykatës, të prokurorisë apo me kërkesë të agjencive të zbatimit të ligjit”. Ligjvënësi përmes këtij paragrafi zgjidh çështjen apo

dilemën se kush mund të urdhërojë ekspertizën forenzike. Dilemë kjo e shprehur midis prokurorive dhe gjykatave të Kosovës, ku shpeshherë gjyqtari i procedurës paraprake kundërshtonte prokurorin për lëshimin e urdhëresës për ekspertizë me arsyetimin se sipas procedurës penale nuk janë plotësuar bazat ligjore për urdhëresë për ekspertizë, sepse çështja ende është në procedurë parapenale, përkatësisht hetimore. Pra, ky paragraf ligjor parasheh të drejtën e dhënies së urdhëresës për ekspertizë nga gjykata apo prokuroria.

Element tjetër i rëndësishëm i këtij paragrafi që ndërlidhet me paragrafin 3 ku është paraparë se: “AKF-ja ofron shërbime edhe për organet shtetërore sipas ligjit përkatës në fuqi” dhe se AKF-së i lejohet kryerja e veprimtarisë vetëm me kërkesë të agjencive për zbatim të ligjit, d.m.th pa e dërguar çështjen në prokurori apo në gjykatë, agjencitë e zbatimit të ligjit siç janë policia e Kosovës, doganat e Kosovës, agjencia e Kosovës për inteligjencë, inspektorati policorë i Kosovës, apo organe të tjera shtetërore mund të kërkojnë ekspertizën forenzike. Mirëpo, jo të gjitha agjencitë mund të kërkojnë shërbim nga AKF-ja sepse siç është paraparë në këtë paragraf “organet shtetërore sipas ligjit në fuqi” dhe nenit 3 paragrafit 1, nën paragrafit 1.5: “Agjencitë për zbatimin e ligjit janë të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të themeluara me ligj”, pra kërkohet që agjencitë për zbatimin e ligjit dhe organet shtetërore të jenë institucione të themeluara me ligj apo shprehimisht me ligj të kanë të rregulluar të drejtën për kërkim të ekspertizës forenzike apo të ngjashme.

Për fushëveprimin e AKF-së në mënyrë më të detajuar flitet në kreun III-të të ligjit për AKF, ku gama e veprimtarisë rritet edhe për një segment. Rrjedhimisht në kuadër të këtij kreu në nenin 18, në paragrafin 5 është paraparë: “AKF-ja përkrah dhe ndihmon hetimin e incidenteve në bazë të kërkesës së institucioneve shtetërore”. Nëse e analizojmë këtë paragraf vërejmë se ligjvënësi ka zgjeruar veprimtarinë e AKF-së në shërbim të institucioneve të tjera shtetërore në rast të incidenteve të ndryshme siç janë katastrofat, zjarret, dëmet apo aksidentet e tjera, ku kërkohet ndihma apo përkrahja profesionale e AKF-së. Për më shumë lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e AKF-së do të flasim tek “përgjegjësitë dhe kompetencat e AKF-së” në kuadër të këtij kapitulli..

**Organizimi dhe funksionet** - Struktura e brendshme organizative e AKF-së paraqet organizimin e brendshëm të organizatës në nivel të departamentit dhe të divizionit. Në kuadër të organizmit të brendshëm të AKF-së paraqitet numri i personelit dhe pozitat e tyre. Kështu në nenin 12 është



paraparë : “Struktura e brendshme organizative e AKF-së propozohet nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së dhe miratohet nga ministri”. Përmes kësaj dispozite ligjore ligjvënësi parasheh kompetencë të gjerë për kryeshefin dhe ministrin për strukturimin dhe sistemimin e brendshme organizativ të personelit të AKF-së, ku kryeshefi propozon strukturën e organizimit dhe sistemimit, ndërsa ministri aprovon atë.

**Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së** - Në kuadër të strukturës udhëheqëse të AKF-së, e vetmja pozitë e cila rregullohet me dispozitë ligjore është pozita e kryeshefit ekzekutiv. Kështu, neni 13 i cili flet për përgjegjësinë dhe detyrat e kryeshefit ekzekutiv është ndarë në 2 paragrafëve. Në paragrafin e parë është paraparë: “Kryeshefi ekzekutiv i AKF-së është autoriteti ekzekutiv apolitik në kuadër të AKF-së dhe autoriteti më i lartë administrativë, teknik dhe operacional i AKF-së”. Gjatë analizës që mund t’i bëjmë kësaj dispozite ligjore shtrohet e nevojshme të komentojmë dy çështje. Çështja e parë ka të bëjë me pavarësinë dhe paanshmërinë politike të kryeshefit. Termi “apolitik” i përdorur në këtë dispozitë ligjore ka kuptimin se Kryeshefi i AKF-së është autoritet që nuk duhet të jetë i inkuadruar në politikë dhe që nuk duhet të merret me politikë. Ligjvënësi përmes kësaj dispozite ligjore ndalon autoritetin kryesor të AKF-së që të merret me politikë. Çështja e dytë është ajo që ka të bëjë me kompetencat dhe autoritetin për udhëheqje të AKF-së ku kryeshefi ekzekutiv parashihet si autoriteti më i lartë administrativë, teknik dhe operacional. Në paragrafin e dytë të këtij neni janë caktuar përgjegjësitë e kryeshefit ekzekutiv. Rrjedhimisht në këtë paragraf është paraparë: “Kryeshefi ekzekutiv i AKF-së është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të AKF-së; për organizimin dhe për punësimin e personelit, për nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe për marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të AKF-së; për menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar AKF-së. Përmes zgjedhjes së dhënë në këtë dispozitë ligjore ligjvënësi ka paraparë kryeshefin ekzekutiv si autoritet kryesor vendimmarrës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me administrimin, organizimin dhe me menaxhimin e AKF-së, duke përfshirë këtu edhe organizimin dhe punësimin e personelit. Kriteret për emërim dhe përzgjedhja e kryeshefit ekzekutiv të AKF-së janë rregulluar me nenin 14 të ligjit për AKF, dhe atë përmes 4 paragrafëve të veçanta. Rrjedhimisht paragrafi i parë është ndarë në 6 nën paragrafë. Ky paragraf zgjedh çështjen e kriterëve bazë për emërim ku është paraparë se: “Kriteret për emërim të Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së janë:

- a) të jetë shtetas i republikës së Kosovës;
- b) të ketë diplomuar në një nga universitetet e pranuar dhe të akredituara në fushat që kanë të bëjnë me shkencën e forenzikës;
- c) të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në pozitë menaxheriale lë në fushat që kanë të bëjnë me shkencën e forenzikës; të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
- d) të mos jetë ndëshkuar për shkelje të rëndë disiplinore ekuivalente me shkeljet që përcaktohen në rregulloren e disiplinës së AKF-së, brenda dhjetë vjetëve të fundit, gjatë të cilave ka punuar në institucione shtetërore;
- e) të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo siç parashihet me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.”

Me zgjedhjen e dhënë në nën paragrafin 1 të kësaj dispozite ligjore ligjvënësi vendos kriteret bazë për emërim, siç janë: të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të ketë diplomuar në ndonjë nga universitetet e pranuar dhe të akredituara në fushën e shkencës së forenzikës. Në ndërlidhje me këtë nën paragraf është neni 3 ku është paraparë se: “Shkenca e Forenzikës nënkupton aplikimin e shkencave (kimi, biologji, fizikë, matematikë, inxhinieri, makineri, kriminalistikë, etj.)”. Siç mund të shihet në këtë dispozitë ligjore ligjvënësi si kriter të shkollimit për pozitën e kryeshefit ekzekutiv parasheh shkencat bazë për forenzikë, por duke mos e kufizuar vetëm me to, por duke e vendosur prapashtesën “etj.” me të cilën nënkuptohet që edhe shkencat e tjera të cilat nuk janë përmendur nuk përjashtohen, siç janë shkencat mjekësore, juridike, ekonomike. Mirëpo si shkenca esenciale konsiderohen ato që shprehimisht janë paraparë me këtë dispozitë ligjore. Ndërsa sipas zgjedhjes së dhënë në nën paragrafin 2 të kësaj dispozite ligjore ligjvënësi cakton kohën e përvojës së domosdoshme menaxheriale në fushën e forenzikës prej 3 vjetësh. Kjo përvojë duhet të jetë përvojë në menaxhim apo përvojë si menaxher, por që nuk kufizohet se në cilën disiplinë forenzike. Mjafton që kandidati për kryeshef ekzekutiv të dëshmojë përvojën si menaxher e që mund të jetë mbikëqyrës, shef apo drejtorë në shkencat forenzike në arsim, mjekësi, polici, ndërmarrje private etj.. Sipas zgjedhjes së dhënë në nën paragrafin 4 të kësaj dispozite ligjore ligjvënësi kushtëzon emërimin e kryeshefit që të mos jetë i dënuar me vepër penale me vendim të formës së prerë. Rrjedhimisht nënkuptohet se kryeshefi nuk duhet të jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë. Sipas kodit të procedurës penale të Kosovës “i dënuar”

është personi për të cilin me vendim të formës së prerë është vërtetuar se është fajtor për kryerjen e veprës penale.

Hajdari në librin e tij për procedurën penale, aktgjykimin e formës së prerë e përkufizon në këtë mënyrë: “si rregull, aktgjykimi i formës së prerë e ka forcën e ligjit për çështjen konkrete juridike penale dhe përmes tij shprehet masa e reagimit të shoqërisë kundër kryerësit të veprës penale (Hajdari, 2010: 219)

Sipas zgjedhjes së dhënë në nën paragrafin 5 të kësaj dispozite ligjore ligjvënësi kushtëzon emërimin e kryeshefit që të mos jetë i dënuar me shkelje të rëndë disiplinore. Periudha kohore që llogaritet në këtë dispozitë ligjore është 10 vjetët e fundit të punës në institucione shtetërore. Shkelje të rënda disiplinore konsiderohen të gjitha ato shkelje që shprehimisht janë paraparë me akte nënligjore të Institucionit të AKF-së. Gjatë analizës që mund t’i bëhet kësaj dispozite ligjore vërejmë se këtu është bërë një lëshim procedural sepse:

Së pari akti nënligjorë përmes të cilit rregullohet çështja e shkeljeve, të masave dhe të procedimit të tyre nxirret pas hyrjes në fuqi të Ligjit për AKF.

Së dyti sipas Ligjit për AKF nuk është e obligueshme që kryeshefi ekzekutiv të emërohet pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore, përkatësisht të udhëzimit administrativ për shkelje, për masa dhe për procedurë të masave disiplinore. Andaj, rrjedhimisht mund të konstatojmë se me rastin e përzgjedhjes së kryeshefit akti nënligjorë për shkelje disiplinore mund të mos jetë në fuqi.

Sipas zgjedhjes së dhënë në nën paragrafin 6 të kësaj dispozite ligjore ligjvënësi kushtëzon emërimin e kryeshefit që të mos jetë në konflikt interesi me detyrën që ushtron sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në praktikën forenzike konflikti i interesit konsiderohet:

- ushtrimi i detyrës së njëjtë nga punonjësi i AKF-së (ekspert forenzik) në sektorin privat;
- marrja me aktivitete private që ndërlidhen me shërbimet forenzike të AKF dhe/apo ndihma për kompanitë private për çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet forenzike
- konsulenca për kompanitë private për çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet forenzike të AKF-së

Nuk konsiderohet konflikt interesi dhënia e ligjëratave, të ushtrimeve forenzike për institucionet e licencuara arsimore publike apo private.

Paragrafët 2, 3 dhe 4 të kësaj dispozite ligjore trajtojnë administrimin dhe procedimin e përzgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv. Së këndejmi paragrafi 1 përcakton kriterin e themelimit të

komisionit, i cili duhet të përbëhet nga 5 anëtarë, ku autoritet për themelimin të komisionit caktohet ministri i punëve të brendshme. Në paragrafin 2 në lidhshmëri me paragrafin 1 ligjvënësi përcakton kriterin e numrit prej 3 kandidatësh për emërim në pozitën e Kryeshefit ekzekutiv që komisioni duhet t'i rekomandojë ministrit. Nga tre kandidatët e propozuar ministri zgjedh njërin prej tyre për emërim në pozitë.

Ashtu siç është definuar në paragrafin 4 të kësaj dispozite ligjore, ligjvënësi parasheh kompetencë të plotë për ministrin e punëve të brendshme për caktimin e anëtareve të komisionit dhe zgjedhjen e procedurave për përzgjedhjes e kryeshefit ekzekutiv si dhe zgjedhjen e njërit nga kandidatët e propozuar nga komisioni.

Mandati i kryeshefit ekzekutiv është rregulluar me nenin 15 të këtij ligji. Kjo çështje është trajtuar me dy paragrafë të veçanta. Në paragrafin e parë është paraparë : “Kryeshefi ekzekutiv i AKF-së emërohet për një periudhë kohore prej pesë (5) vjetësh, me mundësi vazhdimi pas skadimit të afatit (5) vjeçar.”

Gjatë analizës që mund t'i bëjmë kësaj dispozite ligjore mund të komentojmë dy çështje. Çështja e parë ka të bëjë me përcaktimin e kohëzgjatjes së emërimit ku ligjvënësi parasheh maksimumin e mandatit për kryeshefin prej 5 vjetësh dhe çështja e dytë që ka të bëjë mundësinë e vazhimit të emërimit pa konkurs paraprak, por me automatizëm pas çdo pesë vjetësh pa kufizim në kohëzgjatje. Autoriteti për riemërimin e Kryeshefit Ekzekutiv është prapë ministri i punëve të brendshme. Në mënyrë që kryeshefi të riemërohet duhet të ketë rezultate të mira të performancës profesionale dhe menaxheriale dhe të mos jetë i ndëshkuar me masë disiplinore. Siç mund të shihet në këtë paragraf ligjvënësi po ashtu parasheh kompetencë të plotë ministrit për riemërim të kryeshefit ekzekutiv.

Lirimi dhe shkarkimi nga detyra e kryeshefit ekzekutiv është rregulluar me nenin 16 të Ligjit për AKF dhe atë përmes 4 paragrafëve të veçantë.

Me paragrafin e parë janë paraparë rastet kur kryeshefi lirohet apo shkarkohet nga detyra. Autoritet për lirim apo shkarkim është ministri i punëve të brendshme. Rrjedhimisht në këtë paragraf është paraparë :

“Kryeshefi ekzekutiv i AKF-së lirohet apo shkarkohet nga detyra nga ministri për njërin nga arsyet e mëposhtme:

1. është dënuar për vepër penale; me vendim gjyqësor të formës së prerë;

2. arrin moshën për pension;
3. jep dorëheqje;
4. për shkak të vdekjes apo pamundësisë për ushtrimin e detyrës për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj;

Sipas zgjedhjes së dhënë në këtë dispozitë ligjore ligjvënësi cakton autoritetin vendimmarrës për shkarkim apo lirim të kryeshefit ekzekutiv. Në rastet kur kryeshefi ekzekutiv dënohet për vepër penale me aktgjykim të formës së prerë, atëherë ministri duhet të merr vendim për shkarkim, ndërsa në rastet kur kryeshefi për shkaqe personale si p.sh. arrin moshën për pension, jep dorëheqje apo për shkak të pamundësisë së ushtrimit të detyrës (probleme shëndetësore, probleme familjare, problem sociale, probleme ekonomike) më gjatë se 6 muaj.

Në paragrafin e dytë janë paraparë rastet kur kryeshefi ndëshkohet me masë disiplinore. Autoritet për lirim apo shkarkim është ministri i punëve të brendshme. Rrjedhimisht me këtë paragraf është paraparë : “Ministri i shqipton kryeshefit ekzekutiv të AKF-së, masat disiplinore vërejtje me shkrim apo shkarkim nga detyra, për njërën nga arsyet e mëposhtme:

1. kryerja e një shkelje të rëndë të disiplinës, siç është paraparë me rregulloren e disiplinës;
2. pas një vlerësimi negativ të dokumentuar të punës, për ndonjë shkelje të rregullave të integritetit apo mosrespektim i akteve nënligjore për disiplinën dhe për personelin;
3. ka shfaqur mungesë të theksuar angazhimi, të argumentuar, në përmbushjen e objektivave strategjike dhe në kryerjen e detyrave sipas nenit 13 të këtij ligji.

Siç mund të shihet ligjvënësi këtë paragraf e ndanë me 3 nën paragrafë në kuadër të të cilave janë vendosur 2 lloje të përgjithshme të asaj që mund të konsiderohet shkelje apo kryerje jo e mirë e punës si në vijim:

a) Shkelje disiplinore;

- shkeljet e rënda të parapara shprehimisht me rregulloren e disiplinës dhe
- shkeljet e rënda apo të lehta të rregullave të integritetit apo mosrespektimit të akteve nënligjore për disiplinën e personelit

b) Kryerje jo e mirë e punës;

- mungesë të theksuar dhe të argumentuar të angazhimit në përmbushjen e objektivave strategjike dhe
- mungesë të theksuar dhe të argumentuar të angazhimit në kryerjen e detyrave për administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të AKF-së; në organizimin dhe në punësimin e

personelit, në nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe në marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të AKF-së; në menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar AKF-së.

Gjatë analizës që mund t'i bëhet kësaj dispozite ligjore vërejmë se këtu është bërë një lëshim procedural, sepse në nën paragrafin 1 të kësaj dispozite ligjore nuk është përcaktuar shprehimisht se cila është rregullorja disiplinore në bazë të së cilës cilësohet shkelja e rëndë disiplinore.

Në nën paragrafin 1 të paragrafit 1 të nenit 16 të vendoset termi “rregulloren e disiplinës së AKF-së”.

Në paragrafin e tretë janë paraparë rastet kur kryeshefi suspendohet. Autoritet për suspendim është prapë ministri i punëve të brendshme-së. Në këtë paragraf është paraparë : Kur ekziston dyshim i arsyeshëm për të besuar se kryeshefi ekzekutiv i AKF-së, ka kryer vepër penale apo për ndonjëherë nga arsyet e parapara në paragrafin 2 të këtij neni, ministri mund të suspendojë menjëherë kryeshefin ekzekutiv të AKF-së.

Rrjedhimisht në paragrafin 4 është paraparë detyrimi i ministrit që menjëherë pas shkarkimit të kryeshefit të emëroj njërin nga drejtorët e departamenteve si ushtrues detyre, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj. Në këtë paragraf është paraparë : Në rastet e lirimit, të shkarkimit apo të suspendimit të kryeshefit ekzekutiv të AKF-së, ministri menjëherë emëron njërin nga drejtorët e departamenteve të AKF-së, si ushtrues detyrë të kryeshefit deri në përzgjedhjen e tij, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj.

**Gradat dhe funksionet** - Gradat, pozitat dhe funksionet e personalit të AKF-së janë paraparë në nenin 17. Ligjvënësi për shkak të natyrës specifike të veprimtarisë së AKF-së në paragrafin 1 të këtij neni ka paraparë 3 nivele të punonjësve:

1. personeli i specializuar- shkencor;
2. personeli mbështetës;
3. pozitat ekzekutive.

Rrjedhimisht procedurat dhe kushtet e gradimit për personelin e AKF-së, ligjvënësi i parasheh që të rregullohen me një akt të veçantë nënligjor, të cilin e nxjerr ministri me propozimin e Kryeshefit Ekzekutiv. Gjatë analizës që mund t'i bëjmë kësaj dispozite ligjore mund t'i komentojmë 3 çështje: E para është çështja që ka të bëjë me personelin e specializuar shkencor, personel ky që duhet të jetë me kualifikime të larta në disiplina të veçanta shkencore, e i

autorizuar për kryerje të ekspertizave forenzike. E dyta është çështja që ka të bëjë me shërbimin mbështetës, personel ky që nuk kërkohet të ketë kualifikim të lartë shkencor, por i autorizuar për kryerje të shërbimeve mbështetëse (logjistikë, personel, administratë, etj.) dhe e treta është çështja që ka të bëjë me personelin ekzekutiv, personel ky që duhet të ketë kualifikim të lartë shkencor dhe përvojë menaxheriale forenzike, i autorizuar për menaxhim operacional, administrativ dhe verifikim të ekspertizave.

***Veprimtaria e AKF-së*** - Veprimtaria e AKF-së është e rregulluar në kuadër të kreut të III-të të këtij ligji, ku flitet për kompetencat dhe përgjegjësitë e AKF-së, neni 18 dhe 19. Në përgjithësi ligjvënësi në kuadër të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi të AKF-së i referohet kodit të procedurës penale, kështu paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni i referohen shprehimisht kodit të procedurës penale. Neni 18 është i ndarë në 13 paragrafë. Në paragrafin 1 është paraparë: “AKF kryen ekspertiza të dëshmive, sipas kodit të procedurës penale dhe legjislacionit në fuqi”. Në këtë paragraf ligjvënësi përpos kodit të procedurës penale si bazë ligjore për veprimtarinë e AKF-së vendosë edhe legjislacionin në fuqi. Gjatë analizës që mund t’i bëjmë kësaj dispozite mund të konstatojmë se ligjvënësi nuk parasheh ndonjë përkufizim se cilin legjislacion të përdorët, përpos kodit të procedurës penale, duke lënë kështu të hapur dhe duke përgjithësuar legjislacionin në fuqi. Në paragrafin e dytë është paraparë: “AKF dëshmon në gjykatë apo në prokurori ashtu siç është paraparë në kodin e procedurës penale dhe legjislacionit në fuqi”. Po ashtu edhe në këtë paragraf ligjvënësi duke iu referuar kodit të procedurës penale dhe legjislacionit në fuqi parasheh detyrën e AKF-së për të dëshmuar në gjykatën apo në prokurorinë kompetente lidhur me ekspertizën e kryer, në cilësinë e dëshmitarit ekspert. Në paragrafin e tretë dhe të katërt të këtij neni është paraparë: “AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale del në vend të ngjarjes për asistencë në shikimin e vendit të ngjarjes” dhe “AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale do të asistojë në rikonstruksionin e vendit të ngjarjes”. Gjatë analizës që mund t’i bëjmë këtyre dy paragrafëve mund të komentojmë dy çështje. E para është çështja që ka të bëjë me asistencën në këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe dyta në asistencën në rikonstruksionin e vendit të ngjarjes. Përmes këtyre paragrafëve, e duke u bazuar në kodin e procedurës penale, ligjvënësi përcakton detyrën e AKF-së që të ndihmojë në këqyrjen apo rikonstruksionin e vendit të ngjarjes.

Në paragrafin 5 është paraparë: “AKF-ja përkrah ose ndihmon në hetimin e incidenteve në bazë të kërkesës së institucioneve shtetërore”. Sipas zgjedhjes së dhënë në këtë dispozitë, ligjvënësi zgjeron kompetencën e AKF-së për përkrahje dhe ndihmë me kërkesën e organit shtetëror në hetimin e incidenteve të ndryshme, siç mund të jenë: avaritë e ndryshme, zjarret, tërmetet, vërshimet, shkarkimet e larta elektrike, katastrofat e ndryshme etj.

Në paragrafët 6, 7 dhe 8 është paraparë: “AKF në sisteme manuale apo sisteme të digjitalizuara, mban dhe mirëmban të dhëna relevante për qëllime krahasimore”, “Administrimi i të dhënave relevante dhe shkëmbimi i tyre me agjenci apo institucione të tjera brenda vendit si dhe aspekte të tjera lidhur me të dhënat e personave do të rregullohen me udhëzim administrativ nga kryeshefi i AKF-së, i cili duhet të jetë në përputhshmëri me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe “Shkëmbimi i të dhënave të AKF-së me vendet e tjera do të rregullohet përmes marrëveshjes ndërkombëtare në mes të MPB-së dhe autoriteteve të huaja shtetërore, apo organizatave të tjera të huaja”. Ligjvënësi përmes zgjedhjes së dhënë në këtë dispozitë ligjore parasheh të drejtën e AKF-së për posedimin dhe për mirëmbajtjen (pasurimin me të dhëna) e të dhënave personale qoftë në sisteme të regjistrimit manual apo të regjistrimit të digjitalizuar me qëllim të krahasimit të këtyre të dhënave. Rrjedhimisht në paragrafin e dytë ligjvënësi parasheh që përmes një akti nënligjorë, të nxjerra nga kryeshefi ekzekutiv, të rregullohet administrimi i këtyre të dhënave, shkëmbimi i tyre me agjenci apo institucione brenda vendit si dhe aspekte të tjera lidhur me të dhënat e personave, mirëpo me kusht që ky akt nënligjor të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Sa i përket shkëmbimit të të dhënave me vende të huaja, ligjvënësi parasheh që kjo çështje të rregullohet përmes marrëveshjeve ndërshtetërore në mes MPB-së dhe autoriteteve të huaja shtetërore, apo të organizatave të tjera të huaja.

Në paragrafin 9 është paraparë : “AKF do të mbajë koleksion të armëve për qëllim të kryerjes së veprimtarisë së saj. Koleksioni i armëve do mbahet në përputhshmëri me ligjin për armët”. Ligjvënësi përmes zgjedhjes së dhënë në këtë dispozitë ligjore përcakton të drejtën e AKF-së për mbajtjen e një koleksioni të armëve në funksion të kryerjeve të detyrave dhe të aktiviteteve të saj. Në këtë paragraf ligjvënësi, duke ditur nevojën e AKF-së për kryerje të ekspertizave balistike të armëve të zjarrit, duke përfshirë, por jo duke kufizuar me përcaktimin e funksionalitetit të armës, përcaktimin e origjinës së gëzhgojës apo të predhës, përcaktimin e trajektores së lëvizjes së predhës, përcaktimin e kalibrit të armës etj. ka paraparë koleksionin e armëve e që mundëson



kryerjen e aktiviteteve ekspertuese si më lart, p.sh. në mungesë të armës së sjelluar nga vendi i ngjarjes apo të armës së sekuestruar nga bastisja e personit apo e shtëpisë, eksperti do të zgjedhë armën përkatëse për krijimin e modeleve nga gjuajtjet eksperimentale me armë.

Në paragrafin 10 është paraparë “AKF përmes këshillit për cilësi, për kualifikim dhe për rikualifikim autorizon punonjësit shkencorë për fillim dhe vazhdim të kryerjeve të ekspertizave. Ky këshill merr vendime për cilësinë e shërbimeve shkencore në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e AKF-së”. Gjatë analizës që mund t’i bëjmë këtyre dy paragrafëve mund të komentojmë dy çështje. E para është çështja që ka të bëjë me përbërjen e këshillit, ku ligjvënësi përcakton përbërjen e këshillit tek përkufizimet, neni 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.19. “këshilli për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim- këshilli në nivel të AKF-së në përbërje të kryeshefit ekzekutiv, drejtorëve të departamenteve dhe të menaxherit të cilësisë”. Në këtë pikë ligjvënësi duke paraparë rëndësinë e cilësisë së ekspertizave forenzike përcakton përbërjen e këtij këshilli, duke vendosur kështu autoritetet kryesore vendimmarrëse në përbërjen e tij siç janë kryeshefi ekzekutiv, drejtorët e departamenteve dhe menaxheri i cilësisë. E dyta është çështja që ka të bëjë me detyrat, me përgjegjësitë dhe me rolin e këshillit. Në këtë pikë ligjvënësi përcakton detyrën e këshillit për autorizimin dhe për vazhdimin e kryerjeve të ekspertizave forenzike përmes aktvendimeve bazuar në legjislacionin në fuqi dhe procedurat e AKF-së. Rrjedhimisht në paragrafin 11 të këtij neni është përcaktuar se “procedura dhe kushtet e funksionimit të këshillit për cilësi, për kualifikim dhe për rikualifikim do të rregullohen më një udhëzim administrativ që do ta nxjerrë kryeshefi ekzekutiv i AKF-së.

Në paragrafin 12 është paraparë se “AKF do të kryej hulumtime shkencore forenzike”. Përmes kësaj dispozite ligjore ligjvënësi zgjeron veprimtarinë e AKF-së edhe me hulumtime shkencore, duke i dhënë kështu mundësinë që AKF-ja të krijojë kushtet dhe procedurat për zhvillimin e hulumtimeve shkencore forenzike përmes një instituti shkencor të ngritur në kuadër të AKF-së. Rrjedhimisht në paragrafin 13 është përcaktuar se “Procedurat dhe kushtet e hulumtimit, të trajnimit dhe të bashkëpunimit në fushën e forenzikës do të rregullohen me një udhëzim administrativ, të cilin do ta nxjerrë Kryeshefi Ekzekutiv”.

**Administrimi i provave** - Administrimi i provave është i rregulluar në kuadër të kreut III-të të këtij ligji, ku flitet për kompetencat dhe për përgjegjësitë e AKF-së, përkatësisht administrimin e provave, neni 13. Ky nen është i ndarë në 4 paragrafë. Në paragrafin 1 është paraparë se

“Dëshmitë, përkatësisht lëndët të cilat dërgohen për ekspertizë në AKF, duhet të jenë të kompletuara. Lënda e kompletuar duhet të përmbajë urdhëresën për ekspertizë, formularin/kërkesën e plotësuar të AKF-së për ekspertizë, dëshmitë fizike që duhet ekzaminuar dhe zinxhirin e ruajtjes”. Gjatë analizës që mund t’i bëjmë kësaj dispozite ligjore mund të komentojmë së paku dy çështje. E para është çështja që ka të bëjë me kompletimin e lëndëve. Në këtë pikë ligjvënësi obligon palët kërkuese për ekspertizë që lëndët, përkatësisht kërkesat për ekspertizë të jenë të kompletuara. E dyta është çështja që ka të bëjë me përbërjen e lëndës, përkatësisht të kërkesës. Në këtë pikë ligjvënësi udhëzon detyrimisht palën kërkuese që pranë AKF-së të paraqes:

1. Urdhëresën për ekspertizë; urdhër vendimin e prokurorit, urdhër vendimin e gjykatës, kërkesën e organeve të zbatimit të ligjit apo kërkesën e organit publik bazuar në legjislacionin në fuqi;
2. Formalin/kërkesën e plotësuar të AKF-së për ekspertizë;
3. Dëshmitë fizike që duhet ekzaminuar dhe
4. Zi ngjirin e ruajtjes.

Në paragrafin 2 është paraparë se “AKF është e obliguar që të kryejë me kohë ekspertizën e dëshmisë dhe krahas dëshmisë, dosjes t’ia bashkëngjisë raportin gjithëpërfshirës, në të cilin duhet të jepet mendimi profesional lidhur me ekspertizën e kryer”. Gjatë analizës që mund t’i bëjmë kësaj dispozite ligjore mund të komentojmë së paku dy çështje. E para është çështja që ka të bëjë me afatin e kryerjes së ekspertizës. Në këtë pikë ligjvënësi nuk cakton ndonjë afat kohor, por se përcakton që ekspertizat të kryhen me kohë, duke lënë kështu nën kompetencën e AKF-së që ekspertizat të kryhen sipas kohës së nevojshme, varësisht prej numrit të dëshmive dhe ndërlikshmërisë të tyre. E dyta është çështja që ka të bëjë me përbërjen e raportit të ekspertizës. Në këtë pikë ligjvënësi përcakton se AKF-ja duhet të lëshojë raport gjithëpërfshirës në të cilin duhet të jepet mendimi profesional i ekspertit. Raporti gjithëpërfshirës mund të kuptohet si raport që përmban të dhënat si në vijim:

1. Stemën e AKF-së;
2. Laboratori që kryen ekspertizën;
3. Prokuroria, gjykata apo agjencia që ka urdhëruar ekspertizën;
4. Të dhënat e urdhëresës/kërkesës: nr. referues i AKF-së, nr. referues i gjykatës/prokurorisë, nr. referues i hetimeve, data e pranimit të dëshmive në AKF, data e përfundimit të ekspertizave;

5. Drejtori i AKF-së
6. Adresa dhe numrat kontaktues të AKF-së
7. Përshkrimi i dëshmive sipas ekspertit: lloji, numri, sasia dhe përshkrimi ekzakt i dëshmive;
8. Metodatat dhe pajisjet e përdorura: procedurat teknike standarde të operimit me numër referues të procedurës së aplikuar, lloji dhe numri identifikues pajisjet dhe instrumentet e përdorura ; konfirmimin se procedurat e përdorura janë të nxjerra dhe të aprovuara nga AKF-ja;
9. Rezultati i ekspertizës: identifikimet, të gjeturat nga eksperimentimi, nga hulumtimi, nga studimi, nga eksperimentimi apo nga testimi.
10. Konstatimi dhe mendimi përfundimtar: interpretimi, përkatësisht konkludimi përfundimtar i ekspertit bazuar në identifikimet, të gjeturat nga eksperimentimi, nga hulumtimi, nga studimi, nga eksperimentimi apo nga testimi.
11. Të dhënat e ekspertit: emri dhe mbiemri; pozita dhe profesioni si dhe nënshkrimi.

Në paragrafin 3 është paraparë ” AKF në bashkëpunim me policinë e Kosovës dhe agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit, do të përcaktojë procedurën për marrjen, për dokumentimin, për evidencimin, për ruajtjen dhe për transportimin e provave materiale”. Ligjvënësi përmes zgjidhjes së dhënë në këtë dispozitë ligjore përcakton nxjerrjen e një procedure për marrjen, për dokumentimin, për evidencimin, për ruajtjen dhe për transportimin e provave material. Kjo procedurë mund të kuptohet si një rregullore unike në nivel vendi e cila mund të përfshijë, por jo të kufizohet me:

1. Procedura të këqyrjes së vendit të ngjarjes të ndara sipas llojit, kushteve dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale;
2. Procedura të dokumentimit të vendit të ngjarjes dhe të provave material si fotografia, skica dhe procesverbali;
3. Procedura të regjistrimit të vendit të ngjarjes dhe të provave relevante;
4. Procedura të ruajtjes së provave materiale si siguria, kushtet e ruajtjes, vendi i ruajtjes, afati i ruajtjes;
5. Procedura të transportit të provave materiale nga vendi i ngjarjes në dhomat e dëshmive, nga vendi i ngjarjes në AKF, nga vendi i ngjarjes në departament të mjekësisë ligjore, nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore në AKF, nga AKF në dhomat e dëshmive të Policisë së Kosovës, nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore në dhomat dëshmive të Policisë së Kosovës, nga dhomat e dëshmive të Policisë së Kosovës në prokurorinë apo në gjykatën kompetente.

Për nxjerrjen e kësaj procedure ligjvënësi përcakton AKF dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, siq janë policia e Kosovës, inspektorati policorë i Kosovës, doganat e Kosovës, administrata tatimore e Kosovës, departamenti i mjekësisë ligjore, agjencia për menaxhim emergjent, agjencia për regjistrim civil, prokuroria e shtetit, këshilli gjyqësorë i Kosovës, përfaqësues nga ministria e drejtësisë, përfaqësues nga ministria e punëve të brendshme.

Në paragrafin 4 është përcaktuar se “punonjësit e AKF-së janë të obliguar që ta ruajnë fshehtësinë dhe sekretin lidhur me ekspertizën e kryer. Personave të paautorizuar nuk u lejohej të nxjerrin në shesh, të shpallin-publikojnë raportet, dokumentet apo veprimet e tjera lidhur me ekspertizën e kryer, e as të japin deklarata për opinion pa lejen e autoriteteve kompetente”. Gjatë analizës që mund t’i bëjmë kësaj dispozite ligjore mund të komentojmë së paku tri çështje. E para është çështja që ka të bëjë me ruajtjen e informacionit. Në këtë pikë ligjvënësi përcakton detyrimin e punonjësve të AKF-së për ruajtjen e fshehtësisë dhe sekretin e informacioneve lidhur me aktivitetet e AKF-së, përkatësisht me ekspertizën. Çështja e dytë ka të bëjë me publikimin e informacioneve. Në këtë pikë ligjvënësi përcakton mundësinë e dhënies së informacionit lidhur me ekspertizën, por me lejen e autoriteteve kompetente. Me autoritete kompetente mund të kuptojmë udhëheqjen e AKF-së, prokurorët dhe gjyqtarët kompetentë.

## **6.2. Sistemet informative forenzike**

Sistemet e automatizuara bashkëkohore për ekzaminim shkencor të provave dhe teknologjia e informacionit sot luajnë një rol dhe rëndësi të veçantë në procesin e ekspertizës. Ndër të tjera ato mundësojnë proces të shpejtë, cilësor dhe të dokumentuar të ekspertizës.

AKF, aktualisht, posedon sisteme automatike aplikative të fjalës së fundit të teknologjisë informative. Sistemi LIMS, AFIS, IBIS dhe CODIS janë sisteme të cilat funksionojnë dhe operojnë në kuadër të AKF-së

**Sistemi LIMS** -Sistemi LIMS është aplikacion softuerik i modeluar në formatin e rrjetit kompjuterik, me shtrirje të përgjithshme administrative dhe teknike në të gjitha laboratorët e AKF-së. Sistemi në njërën anë mundëson evidencimin, regjistrimin, monitorimin, auditimin, gjenerimin statistikorë të të dhënave dhe kontrollimin e të gjitha të dhënave të ekspertizës forenzike, ndërsa në anën tjetër rritë sigurinë e provave materiale dhe cilësinë e ekspertizave shkencore.

Ky sistem është projektuar dhe është krijuar nga personeli udhëheqës dhe teknik i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, ndërsa është zbatuar nga kompania vendore CREA. Sisteme të ngjashme përdorin laboratorët forenzike në SHBA, Evropë etj.

LIMS është i shtrirë në të gjitha nivelet e menaxhimit të procesit të ekspertizës. Fillon me evidencimin e pranim-dorëzimit të provave materiale në divizionin për administrimin e provave. Zyrtari për administrimin e provave regjistron në sistemin LIMS të dhënat për ekspertizë, në konton e divizionit të caktuar sipas kërkesës së palëve, duke përfshirë urdhëresën për ekspertizë, formularin e plotësuar, provat fizike dhe zinxhirin e ruajtjes. Prioriteti i ekspertizës, sipas procedurës, është përcaktuar në sistem, varësisht nga rasti mund të jetë 1, 2, apo 3. Kompetencën për përcaktimin e tij e ka zyrtari për administrimin e provave.

Pas regjistrimit të të dhënave, zyrtari për administrimin e provave i ruan ato duke klikuar botonin “save”, me automatizëm rasti kalon në përgjegjësi të drejtorit të departamentit, përkatësisht të shefit të divizionit përkatës. Ky i fundit, në kompjuterin e tij, varësisht nga kërkesat, prioriteti dhe ndërlikueshmëria e ekspertizës, cakton ekspertin, ekspertin e dytë verifikues dhe kohën e kryerjes së ekspertizës. Ky proces i caktimit është proces i thjeshtë, i lehtë dhe i shpejtë, sepse realizohet drejtpërdrejt në LIMS. Eksperti i caktuar, duke pasur në dosjen e tij rastet eaktuara për ekspertizë, ka për detyrë të kalojë në divizionin për administrimin e provave për pranimin e rastit për ekspertizë. Në këtë fazë, zyrtari për administrimin e provave ia dorëzon rastin ekspertit të caktuar. Pranim- dorëzimi kryhet përmes skanimit të rastit në kartelën digjitale të ekspertit. Nga ky moment fillon të rrjedhë koha për kryerjen e ekspertizës sipas afatit të caktuar nga mbikëqyrësi.

Procesi i ekspertizës në LIMS kalon nëpër 3 stade:

Stadi I-rë: Ky moment quhet momenti i fillimit të kryerjes së ekspertizës. Eksperti me rastin e pranuar kthehet në ambientet e divizionit (laboratorit), aty ku e kryen ekspertizën. Bazuar në procedurat shkencore të punës, të protokolluara në protokollin e AKF-së, eksperti fillon kryerjen e ekspertizës. Në këtë stad eksperti ka për detyrë të procedoj (të ekzaminojë, të testojë, të krahasojë, të analizojë, të regjistrojë, të fotografojë etj.) provat fizike. Me të kryer të gjitha procedurat tekniko-shkencore të ekspertizës eksperti e shkruan aktin e ekspertizës në kompjuterin e tij në sistemin LIMS, duke i bashkangjitur format teknike të punës. Këtu përfundon stadi i parë i ekspertizës.

Stadi II-të: Pasi eksperti përgjegjës të ketë përfunduar me përpilimin e aktit të ekspertizës dhe të ketë siguruar se janë kryer të gjitha veprimet procedurale të parapara në procedurat e punës, e dërgon rastin për verifikim tek eksperti i lartë apo tek eksperti i lartë mbikëqyrës. Ky moment konsiderohet periudha kohore për të cilën eksperti ka kryer ekspertizën e caktuar. Eksperti i lartë apo eksperti i lartë mbikëqyrës me të pranuar rastin për verifikim të ekspertizës, pa ndonjë vonesë fillon ta kontrollojë përputhshmërinë e aspekteve tekniko-shkencore të ekspertizës me procedurat e punës. Nëse e vlerëson se ekspertiza është kryer sipas të gjitha procedurave të punës e aprovon ekspertizën, e nëse e vlerëson se ndonjëra nga pikat e procedurave të punës nuk është zbatuar, e kthen rastin për përmirësim me vërejtjet dhe komentet përkatëse. Eksperti përgjegjës tani ka për detyrë ta përmirësojë, ta plotësojë apo ta korrigjojë rastin sipas vërejtjeve të dhëna. Këtu përfundon stadi i dytë i ekspertizës.

Stadi III-të: Pasi që eksperti përgjegjës të ketë plotësuar rekomandimet e ekspertit të lartë e dërgon rastin për verifikim të dytë (rishikimi administrativ) nga menaxheri i cilësisë së ekspertizave. Menaxheri i cilësisë me të pranuar rastin për verifikim të ekspertizës, pa ndonjë vonesë fillon ta kontrollojë përputhshmërinë e aspekteve administrative të ekspertizës me procedurat e punës. Nëse e vlerëson se ekspertiza është kryer sipas të gjitha procedurave të punës e aprovon ekspertizën, e nëse e vlerëson se ndonjëra nga pikat e procedurave të punës nuk është zbatuar, e kthen rastin për përmirësim me vërejtjet dhe komentet përkatëse. Eksperti përgjegjës tani ka për detyrë ta përmirësojë, ta plotësojë a ta korrigjojë rastin sipas vërejtjeve të dhëna nga menaxheri i cilësisë, për ta dorëzuar atë me të gjitha format teknike dhe administrative të punës në divizionin për administrim të provave. Prapë pranim-dorëzimi kryhet përmes kartelës digjitale të ekspertit. Ky moment quhet përfundim i ekspertizës. LIMS me automatizëm e dërgon njoftimin mbi përfundimin e ekspertizës në emailin e njësisë hetimore kërkuese. Tani është detyrë e hetuesit përgjegjës që sa më shpejtë të paraqitet në divizionin për administrim të provës për pranimin e aktit të ekspertizës.

*Kompetencat dhe përgjegjësitë në LIMS:* Kompetencat dhe privilegjet në sistemin LIMS janë të renditura sipas detyrave dhe përgjegjësiave të përcaktuara me normat ligjore të AKF. Kështu Kryeshefi Ekzekutiv duke qenë autoritetit më i lartë administrativ, operacional dhe teknik ka qasje dhe ka privilegj të plotë dhe të përgjithshëm, drejtorët e departamenteve kanë qasje në të dhënat e departamentit që udhëheqin, shefat e divizioneve në divizionin që udhëheqin, ndërsa

personeli shkencor në rastet e deleguara për ekspertizë. Siç mund të shihet sistemi funksionon në konceptin e organizmit piramidal (hierarkik).

Përveç mundësive të lartshënuara, LIMS përmes gamës së saj të gjerë të veprimit mundëson regjistrimin e të dhënave për mallra dhe shërbime, për kontroll mjekësorë, për teste profesionale, për statistika të rasteve etj.

***Sistemi AFIS*** - *Sistemi i Identifikimit Automatik të Gjurmëve të gishtërinjve* –Ky sistem është vendosur në funksion në fund të vitit 2002 nga misioni i UNMIK-ut për luftimin e kriminalitetit nga ana e Shërbimit Policor të Kosovës. Sistemi AFIS është administruar nga oficerët ndërkombëtarë policorë të UNMIK-ut deri në fund të vitit 2007 dhe po këtë vit është dhënë donacion për Laboratorin e Forenzikës.

*Procesi i krahasimit automatik në sistemin AFIS:* Identifikimi automatik i gjurmëve të gishtërinjve është proces i krahasimit automatik të një apo më shumë shenjave të gishtërinjve (gjurmëve) të panjohura kundër një baze të dhënash të njohura dhe gjurmëve të panjohura me një algoritëm specifik. Sistemet e identifikimit automatik të gjurmëve të gishtërinjve janë përdorur kryesisht nga agjencitë e zbatimit të ligjit për iniciativat e identifikimit kriminal, dhe më e rëndësishmja është ajo që përfshinë identifikimin e një personi të dyshuar për kryerjen e një krimi, ose lidh një të dyshuar për krime të tjera të pazgjidhura. Në një nivel tekniko-biometrik, sistemet e verifikimit verifikojnë identitetin e pretenduar të subjektit (një përdorues mund të pretendojnë të jetë “Gjoni” duke paraqitur PIN-in e tij ose kartel identitetin dhe të verifikojë identitetin e tij), ndërsa sistemet e identifikimit të përcaktuara në gjurmët e gishtërinjve identitetin e bazojnë vetëm në shenjat e gishtërinjve si edhe sistemi AFIS i cili identifikimet i bazon në nivelin tekniko- biometrik të gjurmëve. Qëllimi kryesor i një sistemi civil me anën e identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve është për të parandaluar regjistrimet e shumëfishta të një subjekti dhe verifikimin e tij biometrik me një saktësi të pazëvendësueshme dhe të pa manipulueshme, apo si në shtetet e ndryshme, edhe për sistemin zgjedhor apo edhe në identifikimin e subjekteve pas një katastrofe natyrore, kurse në rastin tonë përdoret për identifikim të rasteve kriminale. Agjencitë evropiane të policisë tani kërkojnë që përmes një akti të aprovuar nga Këshilli Evropian për të hapur AFIS-et e tyre për njëri-tjetrin dhe për të përmirësuar luftën kundër terrorizmit dhe hetimin e krimit ndërkufitar një sfidë për Kosovën që

edhe ne presim të jemi pjesë e këtij traktati. Akti për traktatin “Pruem” është një nismë mes vendeve si Belgjika, Gjermania, Spanja, Franca, Luksemburgu, Holanda dhe Austria.

Funksioni i AFIS-it - Sistemi qendror i AFIS-it bën ruajtjen, procedimin, analizimin, gjetjen e gjurmëve dhe të shuplakave të duarve të kandidatet e mundshëm të regjistruar në data bazën kriminale. Kur një individ arrestohet ata daktiloskopohen (u merren gjurmët e gishtërinjve – gjurmët dhjetë gishtorë bashke me shënimet demografike) dhe dërgohen në qendrat e procedimit në regionet me të afërta të sistemit AFIS në stacionet policore. Këto informacione futen në sistem nëpërmes futjes së të dhënave me anë të skanimit të gjurmëve me pajisjet më të sofistikuara biometrike nga ekspertët profesionalë, të cilat pastaj i dërgojnë në mënyrë elektronike në bazën e të dhënave qendrore për kërkim identifikimi me të dhënat e grumbulluara nga vendi i ngjarjeve të ndryshme. Pas inicimit të kërkimit të gjurmëve në sistemin AFIS, ku gjurmët kontrollohen për përputhje me gjurmët që janë në bazën kryesore me mbi 70.000 dhjetë gishtorë, 30.000 shuplakore, 1.000 shuplakore latente dhe mbi 12.000 gjurmë latente nga vende të ndryshme të ngjarjeve. Brenda minutave (e që ekspertit do t’i duheshin muaj që një kandidat të kontrollohej kundrejt 70,000 kartelave) sistemi jep rezultat me një numër të caktuar kandidatësh të mundshëm e të përafërt me një precizitet aq të lartë saqë, pothuaj gjithmonë, nëse ka përputhje e jep kandidatin e parë në listë me një mundësi, siç e ka publikuar edhe vet prodhuesi, deri në 99.9%. Por kjo gjithmonë nëse jep rezultat – puna tjetër ose puna kryesore prapë mbetet tek ekspertët, të cilët japin mendimin profesional, bazuar në gjetjet e sistemit apo të mendimit të grupit të ekspertëve për rastin e caktuar, bazuar në kriteret shkencore të identifikimit të gjurmëve. Çdo gjurmë të gishtërinjve, që nuk përmbushë një cilësi të specifikuar të hyrjes, para se ta ruani në bazën e të dhënave, përdorni një lloj të formave për procesim-përpunim special të imazhit, për ta zgjeruar cilësinë e pamjes së një gjurme latente të gishtërinjve apo gjurmëve të shuplakës, për të shënuar imtësira dhe për të filluar kërkimin në një bazë të të dhënave, të shikohen dhe të konfirmohen rezultatet e kërkimit, të krijohen prova materiale për gjyq, duke treguar imtësirat e përdorura për ta vërtetuar identitetin e të dyshuarit, futni shënimet e gjurmëve të shuplakës dhe iniconi një kërkim automatik në një bazë të të dhënave lokale të gjurmëve të shuplakave dhe/apo kryeni një kërkim në një bazë të të dhënave lokale të gjurmëve latente të panjohura të shuplakës. Sistemi AFIS përputhet ekskluzivisht në bazë të tipareve të një gjurme. Softueri nuk ka nevojë të “dijë” për shembull, nëse një tipar në një vendndodhje të veçantë është një degëzim, me një fund të mprehtë, bërthamë; softueri thjesht shënon faktin se diçka ekziston



në atë vendndodhje. Kjo ka implikime me rëndësi për përdoruesit e sistemit AFIS: Sistemi nuk ka nevojë të dijë klasifikimin e një gjurme apo vendin e bërthamës për ta kryer një kërkim të suksesshëm. Sistemi mund ta kërkon një gjurmë të pjesshme që nuk mund të klasifikohet me anë të një modeli (mostre) dhe që nuk ka bërthamë apo delta; sistemit i duhen vetëm një numër adekuat i imtësirave të vërejtura (të zbuluara). Sa më shumë informata që ka AFIS-i për karakteristikat e një gjurme, aq më e madhe është mundësia për identifikim të saktë (përputhje). Në qoftë se në sistem skanohen gjurmë latente me cilësi të dobët apo kartë dhjetë gishtorë të dobët, sistemit duhet t'i "tregohet" imtësira, të cilën nuk ka qenë në gjendje ta vëren (detekton) automatikisht. Kjo mund të thotë dallimin mes një kandidati që paraqitet në krye të listës për përputhje të mundshme, kundër paraqitjes më poshtë në listë. AFIS është i përcaktuar (dizajnuar) që ta krahason shpejt një gjurmë të gishtërinjve me shumë gjurmë dhe të kthen një listë të shkurtër të renditur të gjurmëve në bazën e të dhënave që më së afërmi i përputhet gjurmës së kërkuar. Ato gjurmë me një rezultat të madh të pikëve, të cilat na i jep automatikisht sistemi, janë edhe përputhjet e mundshme.

Organizimi i AFIS-it: Serveri kryesor i AFIS-it që gjendet në AKF në Prishtinë me një centralizim të softuerit në përgjithësi për të gjitha stacionet e tjera në territorin e Kosovës të administruara nga Administratori i sistemit AFIS.

në stacionet rajonale policore me nga dy apo me shume ekspertë, të cilët operojnë në sistemin AFIS në baza ditore. Ndërsa në objektin e AKF-së në Prishtinë është i vendosur stacioni qendror me pesë nënstacione të tjera që gjenden ku operojnë ekspertët e Labororit të Daktiloskopisë. Ndërsa pesë stacione kontrolluese kufitare LiveID nëpër kufijtë e Republikës së Kosovës dhe një ndër ta në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, që shërben për trajnime apo kontrollim të sistemit. Sistemi AFIS gjithashtu është i ndërlidhur edhe me sistemin kufitar BMC (border management control) për kontrollin e vijës kufitare të Republikës së Kosovës. Sistemi BMC merr shërbime nga sistemi AFIS në rastet kur në pikat kufitare ka kontrole për subjekte të ndryshme dhe kërkesa (në këtë rast gjurmët e skanuara me skaner digjital) dërgohet në mënyrë elektronike në sistemin AFIS, i cili pas kërkimit në bazat e të dhënave të veta, gjetjet që përputhen ia kthen sistemit kufitar brenda minutave.

Në Kosovë kemi pesë stacione kufitare të sistemit të LiveID-së, me të cilin sistem bëhet kontrollimi i biografisë kriminale (criminal background check) dhe tri prej tyre gjenden në pika

kufitare, një në Aeroportin e Prishtinës dhe një në laboratorin qendror. (AKF-raporti vjetorë, 2012: 20-25)

**Sistemi IBIS** - Sistemi i Integruar për Identifikim Balistik është donacion nga Komisioni Evropian në vitin 2010. Vlera e donacionit të dhënë nga ky komision është 1.089.512,00 €. Sistemi përbëhet nga shtatë pjesë kryesore dhe shërben për të marrë kopje digjitale të karakteristikave individuale balistike, nga gëzhhojat apo nga plumbat e shkrepur nga arma e zjarrit, ruajtjen e tyre në server për kohë të pacaktuar, krahasimin automatik të tyre dhe dhënien e rezultateve të kërkimit në mënyrë kompjuterike për verifikim dhe validim nga eksperti i balistikës. Sistemi punon në mënyrë të automatizuar, duke përdorur algoritme të avancuara kompjuterike me precizitet dhe saktësi të lartë. Ky sistem përdoret nga shumë institute të forenzikës, agjenci të zbatim të ligjit apo hulumtues shkencorë. Tani sistemi IBIS në laboratorin e balistikës në kuadër të AKF është plotësisht operacional me ndikim të lartë në performancën e njësisë për ekspertimin e armëve të zjarrit, sidomos në rritjen e numrit të ekspertizave kriminalistike, e po ashtu edhe në shkurtimin e afateve kohore për t'u përgjigjur në kërkesat për ekspertizë nga gjykatat, prokuroritë apo njësitet hetimore të policisë. Sistemi IBIS është i centralizuar dhe funksionon vetëm në AKF dhe është në menaxhim direkt nga laboratorin e balistikës. Ai përbëhet nga:

- a. dy njësi për marrjen e kopjeve digjitale të karakteristikave individuale nga gëzhhojat,
- b. një njësi për marrjen e kopjeve digjitale të karakteristikave individuale nga predhat,
- c. serveri për krahasimin dhe ruajtjen e të dhënave,
- d. njësia për përqendrimin e të dhënave dhe
- e. dy njësi për verifikimin dhe validimin e rezultateve të kërkimit automatik.

Në këtë sistem ruhen të dhënat digjitale të armëve të testuara dhe të armëve të regjistruara nga Departamenti për Siguri Publike i MPB-së, të gëzhgojave dhe të plumbave të gjetur në vendet e ngjarjeve, në të cilat janë përdorur armët e zjarrit dhe kur arma e dyshuar nuk është gjetur. (AKF-Raporti vjetorë 2012, 30).

**Sistemi CODIS** - Në AKF në fund të prillit 2013 është instaluar baza e të dhënave të ADN-së (versionin më të ri të softuer-it, përkatësisht versionin 7.0). Ky sistem është donacion i Qeverisë Amerikane, gjegjësisht FBI, realizuar nga marrëveshja midis FBI-së dhe MPB-së. Personeli

vendor, përkatësisht katër ekspertët e ADN-së në Kosovë, janë të trajnuar dhe të certifikuar nga FBI për përdorimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e plotë të të dhënave të ADN-së, të ngarkuara në sistem. (Baza e të Dhënave të ADN-së, v. 7.0, 2013). Baza e të dhënave të ADN-së, në vendin tonë ka një rëndësi shumë të madhe. Në të janë regjistruar dhe po regjistrohen në vazhdimësi, si dhe po ruhen një numër i konsiderueshëm i profileve të ADN-së, të kategorive të ndryshme si profile të panjohura nga vendi i ngjarjes, profile të personave të zhdukur dhe të familjarëve të tyre, profile të personave të dyshuar etj. Me urdhëresë të gjykatës, të prokurorisë apo të institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit, bëhen kërkime për krahasime të profileve të ADN-së, në mënyrë të shpejtë dhe efikase, dhe lëshohen raporte për këto kërkime.

Zyra Ndërlidhëse e Policisë së Kosovës për bashkëpunim ndërkombëtar dërgon shumë kërkesa për krahasim të profileve të ADN-së nga INTERPOL-i. Në këtë sistem të të dhënave, brenda ditës kryhet procesi i kërkimit dhe i raportimit për profilin e ADN-së. Përveç kësaj në sistem mund të ruhen edhe profilet e ADN-së të ekspertëve, kjo për qëllim të menaxhimit më të suksesshëm dhe më efikas të rasteve të kontaminimit. Po ashtu edhe profilet e studimit të popullatës me gjithë statistikën përkatëse mund të vendosen në CODIS. Pra, nga e gjithë kjo që u tha më lartë shihet se baza e të dhënave të ADN-së, ka një rëndësi dhe rol të veçantë për komunitetin forenzik që merret me analiza të ADN-së, ashtu edhe për organet e zbatimit të ligjit.

### **6.3. Standardizimi ndërkombëtar i metodave shkencore**

Në procedurën penale të Kosovës, në nenin 136, në paragrafin 1, në nën paragrafin 1.5 është paraparë që metodat e përdorura për ekspertizë të jenë metoda përgjithësisht të pranuar në fushën përkatëse, ose të kenë bazë shkencore apo teknike. Ndërsa në ligjin për AKF-në, në nenin 10, në paragrafët 1 dhe 2, me dispozitë të veçantë është mandatuar standardizimi, përkatësisht akreditimi i laboratorëve sipas standardeve ndërkombëtare. Siç mund të shihet ligjvënësi i Republikës së Kosovës, përpos vendosjes dhe themelimit të një organi të pavarur shtetëror për kryerje të ekspertizave forenzike vëmendje të posaçme i ka kushtuar edhe standardizimit ndërkombëtar të metodave shkencore që aplikohen nga AKF-ja. Standardi ndërkombëtar që rregullon akreditimin e laboratorëve testues dhe kalibruet është standardi ISO 17025 (ISO/IEC 17025:2005, [www.iec-iso-17025.com](http://www.iec-iso-17025.com)). Ky standard rregullon një spektër të gjerë të kushteve dhe të kërkesave të përgjithshme të kompetencës për laboratorët testues dhe kalibruet, me theks të veçantë sistemin e cilësisë. Kështu në kuadër të këtij dokumenti ndërkombëtar janë paraparë

dy aspekte bazë: Kërkesat menaxheriale dhe kërkesat teknike që duhet të plotësohen. Në kuadër të kërkesave menaxheriale është paraparë: organizimi, sistemi menaxhues, kontrolli i dokumenteve, vlerësimi i kërkesave, nen kontraktimi i testeve dhe i kalibrimeve, blerja e shërbimeve dhe mallrave, shërbimi ndaj konsumatorit, ankesat, kontrolli i testeve, mos përputhjet, përmirësimet, veprimet korigjuese, veprimet preventive, kontrollimi i të dhënave, auditimi i brendshëm, rishikimet e menaxhimit. Ndërsa në kuadër të kërkesave teknike është paraparë: të përgjithshmet, personeli, akomodimi dhe mjedisi, metodat testuese dhe kalibruese, pajisjet, gjurmëshmëria e matjeve, mostrimi, dorëzimi i testeve dhe kalibrimeve, sigurimi i cilësisë së testeve dhe i kalibrimeve, si dhe raportimi i rezultateve.

AKF bazuar në obligimin ligjor dhe standardin ndërkombëtar të lartshënuar ka arritur të akreditojë pesë laboratorë: laboratorin për analiza kimike të narkotikëve, laboratorin e Serologjisë dhe të ADN-së, laboratorin për dorëshkrime dhe nënshkrime, laboratorin e balistikës dhe laboratorin e daktiloskopisë ([www.mpb-ks.org](http://www.mpb-ks.org), p.1,46,1561, parë më datë 23.05.2016). Ekspertët vlerësues u zgjodhën nga Drejtoria për Akreditim e Kosovës, ndërsa u sponsorizua nga OSBE-ja. Njëri nga ekspert vlerësues me përvojë shumëvjeçare në laboratorin AND-së të institutit nacional të forenzikës së Holandës, ndërsa tjetri prof. dr. në departamentin e kimisë të universitetit të Stambollit. Ekspertët për tri ditë radhazi qëndruan në ambientet e laboratorëve të AKF-së ku vrojtuan, regjistruan dhe u informuan me metodat dhe sistemet që aplikon AKF për kryerjen e ekspertizave forenzike. Gjetjet e tyre i raportuan për drejtorin e akreditimit të Kosovës dhe AKF-së. Kjo e fundit të gjeturat e ekspertëve i konsideroi jokonformitete, të cilat duhet të plotësoheshin nga AKF. AKF arriti që në afatin e paraparë nga drejtoria e akreditimit të Kosovës t'i përmbushë jokonformitetet e caktuara. Ky cikël i këtij procesi u përmbyll me një ceremoni, ku në praninë e medimeve kosovare, në ambientet e AKF-së, drejtori i përgjithshëm i drejtorisë së akreditimit të Kosovës Z. Osmani ia dorëzojë certifikatën e akreditimit ministrit të Punëve të Brendshme Z. Hyseni dhe kryeshefit ekzekutiv të AKF-së, Z. Olluri.

Akreditimi ishte një proces mjaft i gjatë dhe sfidues.. Sigurisht që vështirësia kryesore ka qenë mungesa e financave, sepse dihet se akreditimi përveç tjerash bartë edhe një kosto të lartë financiare.

Po cili është roli i akreditimit dhe pse duhet të akreditohen laboratorët e forenzikës? Mbi këtë çështje ka pasur debate dhe diskutime të shumta në platforma, forume, simpoziume e konferenca shkencore në nivel ndërkombëtar. Konkluzionet e nxjerra gjithherë spikatin rëndësinë e

akreditimit në rritjen e cilësisë së ekspertizave, objektivitetin dhe paanshmërinë e ekspertizave, dokumentimin dhe korrigjimin e veprimeve dhe garantimin e ekspertizave forenzike.

Andaj, këto argumente janë bazë e mjaftueshme për nevojën dhe domosdoshmërinë e akreditimit të laboratorëve forenzikë. Në këtë aspekt, nëse i referohemi SHBA-së dhe Evropës gjejmë se shumica e laboratorëve forenzike që operojnë në këto shtete janë akredituar me këtë standard. Po ashtu ENFSI, një prej kushteve për anëtarësim ka akreditimin e metodave sipas këtij standardi apo të paktën duhet një plan i detajuar me afate kohore për akreditimin e tyre.

Ndërsa në rajon, momentalisht këtë standard ndërkombëtar e kanë arritur Kroacia, Bullgaria dhe Rumania. Policia shkencore e Shqipërisë ende nuk ka filluar procedurat për akreditimin e saj.

#### **6.4. Përformanca gjatë viteve 2012-2014 (analizë krahasimore)**


Agjencia e Kosovës për Forenzikë si institucion me juridiksion të plotë për ushtrimin e ekspertizës forenzike në territorin e Kosovës, kishte shënuar rritje të konsiderueshme të kryerjes së ekspertizave nga viti në vit. Ashtu siç kemi cekur më lartë, ngritja profesionale e personalit, zhvillimi i teknologjisë dhe ngritja e cilësisë ndikuan në gjyqësorin dhe prokurorin në vetëdijesim dhe kuptim më të mirë të rolit të ekspertizës forenzike në procedurë penale. Në vazhdim do të paraqesim statistikën e numrit të ekspertizave forenzike të ndara sipas rastit dhe numrit të provave materiale në kuadër të divizioneve përgjegjëse gjatë viteve 2012-2014. (Raportet vjetore të AKF-së, vitet 2012, 2013 dhe 2014).

#### ***Ekspertizat forenzike gjatë vitit 2012***


| Laboratori (Divizioni)                  | Raste të pranuar | Raste të kryera | Nr. i provave |
|-----------------------------------------|------------------|-----------------|---------------|
| Lab. për analiza kimike të narkotikëve  | 282              | 285             | 12629         |
| Lab. i serologjisë dhe ADN-së.          | 69               | 80              | 697           |
| Lab. i balistikës                       | 1613             | 1365            | 19925         |
| Lab. i daktiloskopisë dhe traseologjisë | 1001             | 1011            | 2304          |

|                                      |      |      |       |
|--------------------------------------|------|------|-------|
| Lab. i dokumenteve dhe dorëshkrimeve | 720  | 715  | 18164 |
| Lab. për ekzaminim të kompjuterëve   | 45   | 39   | 1168  |
| TOTAL:                               | 3730 | 3495 | 54887 |

Tabela 1: Rastet dhe dëshmitë e pranuar dhe ekspertuara: 01/01/2012 deri më: 31/12/2012.



Grafiku 1: raste të ekspertuara gjatë vitit 2012.



Grafiku 2: prova të ekspertuara gjatë vitit 2012.

Analizë statistikore : Siç mund të shihet nga tabela dhe garfikonet e mësipërme, AKF gjatë vitit 2012 ka pranuar një numër të konsiderueshëm kërkesash, 3730 raste me 54887 prova, ndërsa ka kryer një numër po ashtu të konsiderueshëm të ekspertizave forenzike, 3495 me 54887 prova.

Laboratori i balistikës ka kryer numrin më të madh të ekspertizave me një numër të madh të provave: 1365 raste (39%) me 19925 prova (37%).

Laboratori i daktiloskopisë dhe i traseologjisë po ashtu ka kryer një numër të konsiderueshëm të ekspertizave sa i përket rasteve, por jo edhe provave: 1011 raste (29%) me 2304 prova (4%).

Laboratori i dokumenteve dhe i dorëshkrimeve po ashtu ka kryer një numër të konsiderueshëm të ekspertizave me një numër të madh të provave: 715 raste (21%) me 18164 prova (33%).

Laboratori për analiza kimike të narkotikëve po ashtu ka kryer një numër të konsiderueshëm të ekspertizave me një numër të madh të provave: 285 raste (8%) me 12629 prova (23%).

Laboratori i Serologjisë & ADN-së ka kryer një numër jo të lartë të ekspertizave: 80 raste (2%) me 697 prova (1%).

Laboratori për ekzaminim të kompjuterëve ka kryer jo një numër të lartë të rasteve, por me një numër të madh të provave: 39 raste (1%) 1168 (2%).


***Ekspertizat forenzike gjatë vitit 2013***

| Laboratori (Divizioni)                  | Raste të pranuara | Raste të kryera | Nr. i provave |
|-----------------------------------------|-------------------|-----------------|---------------|
| Lab. për analiza kimike të narkotikëve  | 356               | 342             | 3920          |
| Lab. i serologjisë dhe ADN-së.          | 120               | 119             | 2101          |
| Lab. i balistikës                       | 1574              | 1565            | 18260         |
| Lab. i daktiloskopisë dhe traseologjisë | 1336              | 1342            | 3033          |
| Lab. i dokumenteve dhe dorëshkrimeve    | 789               | 792             | 5579          |
| Lab. për ekzaminim të kompjuterëve      | 81                | 53              | 427           |
| TOTAL:                                  | 4256              | 4214            | 33320         |

Tabela 2: Rastet dhe dëshmitë e pranuar dhe të ekspertuara: 01/01/2013 deri më: 31/12/2014.




### Raste të ekspertuara gjatë vitit 2013



Grafiku 3: raste të ekspertuara gjatë vitit 2013.

### Prova të ekspertuara gjatë vitit 2013



Grafiku 4: prova të ekspertuara gjatë vitit 2013.

Analizë statistikore : Siç mund të shihet nga tabelat dhe garfikonet e mësipërme, AKF edhe gjatë vitit 2013 po ashtu ka pranuar një numër të konsiderueshëm kërkesash, 4256 raste me 33320 prova, ndërsa ka kryer një numër po ashtu të konsiderueshëm të ekspertizave forenzike, 4214 raste me 33320 prova.

Laboratori i balistikës ka kryer numrin më të madh të ekspertizave me një numër të madh të provave: 1565 raste (37%) me 18260 prova (55%).

Laboratori i daktiloskopisë dhe i traseologjisë po ashtu ka kryer një numër të konsiderueshëm të ekspertizave dhe të provave: 1342 raste (32%) me 3033 prova (9%).

Laboratori i dokumenteve dhe i dorëshkrimeve po ashtu ka kryer një numër të konsiderueshëm të ekspertizave me një numër të madh të provave: 792 raste (19%) me 5579 prova (17%).


Laboratori për analiza kimike të narkotikëve po ashtu ka kryer një numër të konsiderueshëm të ekspertizave me një numër të madh të provave: 342 raste (8%) me 3920 prova (12%).

Laboratori i Serologjisë&AND-së ka kryer një numër jo të lartë të ekspertizave, por ekspertiza të konsiderueshëm të provave: 119 raste (3%) me 2101 prova (6%).


Laboratori për ekzaminim të kompjuterëve ka kryer jo numër të lartë të rasteve dhe provave: 53 raste (1%) 1168 (1%).**Ekspertizat forenzike gjatë vitit 2014**

| Laboratori (Divizioni)                  | Raste të pranuar | Raste të Ekspertuara | Nr. i dëshmimeve për njësi |
|-----------------------------------------|------------------|----------------------|----------------------------|
| Lab. për analiza kimike të narkotikëve  | 548              | 494                  | 4150                       |
| Lab. i serologjisë dhe ADN-së.          | 151              | 127                  | 1828                       |
| Lab. i balistikës                       | 2380             | 2075                 | 35725                      |
| Lab. i daktiloskopisë dhe traseologjisë | 1084             | 1102                 | 4226                       |
| Lab. i dokumenteve dhe dorëshkrimeve    | 847              | 855                  | 3828                       |
| Lab. për ekzaminim të kompjuterëve      | 152              | 151                  | 1937                       |
| TOTAL:                                  | 5162             | 4804                 | 51964                      |

Tabela 3: Rastet dhe dëshmitë e pranuar dhe të ekspertuara: 01/01/2013 deri më: 31/12/2014.



Grafiku 5: raste të ekspertuara gjatë vitit 2014.



Grafiku 6: prova të ekspertuara gjatë vitit 2014.

Analizë statistikore: Siç mund të shihet nga tabelat dhe garfikonet e mësipërme, AKF edhe gjatë vitit 2014 po ashtu ka pranuar një numër të konsiderushëm kërkesash, 5162 raste me 51964 prova, ndërsa ka kryer një numër po ashtu të konsiderueshëm të ekspertizave forenzike, 4804 raste me 51964 prova.

Laboratori i balistikës edhe gjatë këtij viti ka kryer numrin më të madh të ekspertizave me një numër të madhë të provave: 2075 raste (43%) me 35725 prova (69%).

Laboratori i daktiloskopisë dhe i traseologjisë po ashtu ka kryer një numër të konsiderushëm të ekspertizave edhe të provave: 1102 raste (23%) me 4226 prova (8%).

Laboratori i dokumenteve dhe i dorëshkrimeve po ashtu ka kryer një numër të konsiderushëm të ekspertizave me një numër të madhë të provave: 855 raste (18%) me 3828 prova (7%).

Laboratori për analiza kimike të narkotikëve po ashtu ka kryer një numër të konsiderushëm të ekspertizave me një numër të madhë të provave: 494 raste (10%) me 41500 prova (8%).


Laboratori i Serologjisë&AND-së ka kryer një numër jo të lartë të ekspertizave por ekspertiza të konsiderushëm të provave: 127raste (3%) m 1828 prova (4%).

Laboratori për ekzaminim të kompjuterëve, krahasuar me vitet 2012 dhe 2013 ka pasur rritje të kërkesave::151 raste (3%) 1937 (4%).


#### ***Ekspertizat forenzike gjatë viteve 2012-2014***

| Viti                           | 2012  | 2013  | 2014  |
|--------------------------------|-------|-------|-------|
| Numri i rasteve të ekspertuara | 3495  | 4214  | 4804  |
| Numri i provave të ekspertuara | 54887 | 33320 | 51964 |

Tabela 4: Rastet dhe dëshmitë e pranuar dhe të ekspertuara: 01/01/2013 deri më: 31/12/2014.



Grafiku 7: Rastet e ekspertuara të paraqitura në grafik me krahasim në tri vitet e fundit.



Grafiku 8: Dëshmitë e ekspertuara të paraqitura në grafik me krahasim: 2012, 2013, 2014

Analizë e përgjithshme: Në bazë të analizës së përgjithshme të statistikave mund të konstatojmë se AKF shënoi rritje sistematike të kërkesave gjatë viteve 2012, 2013, 2014. Kështu në vitin 2012: 3495, në vitin 2013: 4214 dhe në vitin 2014: 4808 ekspertiza , d.m.th. në vitin 2013 janë kryer 719 raste më shumë se sa në vitin 2012, ndërsa në vitin 2014 janë kryer 590 raste më shumë se sa në vitin 2013. Sa i përket numrit të provave kemi një ndryshim në raport me numrin e rasteve. Kështu viti 2012 shënon numrin më të lartë të provave të ekspertuara: 54888, viti 2014: 51964 dhe viti 2013: 33320.

Siç mund të shihet në bazë të statistikave AKF në bazë vjetore kryen një numër të madh të ekspertizave forenzike, me një rritje sistematike të tyre nga viti në vit. E gjithë kjo gamë e gjerë e ekspertizave kryhet nga 52 punonjës të AKF-së. Në anën tjetër rritja e kërkesave nënkupton rritje të kostos . Po ashtu buxheti i AKF-së, kategoria e mallrave dhe e shërbimeve nga viti i kaluar (2014) është shkurtuar për 14%. Këto sigurisht që janë sfida për udhëheqjen e AKF-së.

## **Kapitulli VII: Përmbledhje me konkluzione dhe rekomandime**

### **7.1. Përmbledhje**

Në përkufizimin e saj të gjerë shkenca e forenzikës është zbatimi i shkencës për çështje ligjore panele apo civile. Shpeshherë në procedurën penale apo civile njohuritë e gjyqtarit, të prokurorit apo të avokatit nuk janë të mjaftueshme për dhënien e përgjigjes për çështje të caktuara shkencore, teknike, medicinale, kulturore, sportive, inxhinierike, etj. Në këto rrethana zbatimi i shkencës së forenzikës paraqitet i nevojshëm dhe shumë i rëndësishëm. Disa autorë mendojnë se shkenca e forenzikës nuk duhet të konsiderohet shkencë në vete, sepse për studimin dhe hulumtimin e saj zbaton shkenca të tjera. Por, shumica e njohësve dhe të praktikientëve të shkencës së forenzikës mendojnë se kjo është shkencë në vete dhe duhet të trajtohet si e tillë. Pra, forenzika është shkencë e cila merret me studimin, analizimin, testimin, krahasimin dhe interpretimin e provave të ndryshme me qëllim të zbulimit, të identifikimit, të individualizimit dhe të vërtetimit të çështjeve të ndryshme në zbatim të ligjit.

Laboratori forenzik është laborator ku kryhen ekspertiza, testime, analiza, krahasime apo kërkime shkencore forenzike të provave fizike për të ndihmuar në zbardhjen e ndonjë çështjeje, të ndonjë kontesti penal apo civil.

Vendi i ngjarjes është vendi ku ka ndodhur një ngjarje, ku ka ndodhur një ndryshim si pasojë e asaj ngjarjeje, në të cilin apo rreth të cilit mund të ketë mundësi të pranisë së gjurmëve, të shenjave apo të ndryshimeve të tjera që kanë lidhje me atë ngjarje. Këqyrja e vendit të ngjarjes ka rëndësi të madhe, sepse aty mund të gjenden gjurmë apo prova materiale që kanë të bëjnë me krimin, mekanizmin e kryerjes së tij, mënyrën e kryerjes, mjetin e kryerjes, autorin apo autorët e mundshëm, prova këto materiale (gjurmë, mjete, instrumente, mekanizma, dokumente etj.), të cilat mund të çojnë drejt dokumentimit ligjor të aktit kriminal apo të zbulimit të autorit. Rëndësi ka ruajtja dhe sigurimi i vendit të ngjarjes, në kushte dhe gjendje të njëjte fizike, ashtu siç e ka lënë kryerësi me rastin e kryerjes së veprës penale. Ruajtjen dhe sigurimin e bënë personeli policor përgjegjës i cili arrin i pari në vendin e ngjarjes. Për këqyrjen e vendit të ngjarjes autorë të ndryshëm rekomandojnë katër metoda të ndryshme: metoda spirale, metoda brezore, metoda rrjetore, metoda katrore dhe metoda e rrumbullakët.

Shpeshherë në procedurë penale, në fazat e shqyrtimit të provave materiale shtrohet e nevojshme rivendosja e vendit të ngjarjes me qëllim të sqarimit të rrethanave, të vërtetimit të deklaratës së të dyshimit, të dëshmitarit, të viktimës, apo të rrethanave të tjera të rëndësishme për procedurën. Ky veprim procedural quhet “rikonstruksion” i vendit të ngjarjes, i cili ka për qëllim rivendosjen e vendit të ngjarjes, duke përfshirë të gjitha provat materiale, gjurmët etj. Një veprim tjetër, që ndërlidhet me rikonstruksionin është “eksperimenti”. Eksperimenti kryhet për të provuar nëse ngjarja mund të shihet nga një vend i caktuar, në mund të dëgjohet biseda apo ndonjë zhurmë nga një distancë e caktuar, nëse gjurmët e frenimit të lëna në vendin e ngjarjes janë te automjeti që dyshohet dhe çfarë shpejtësie ka pasur automjeti etj.

Në kuadër të këtij studimi janë analizuar dhe krahasuar ekspertiza traseologjike, ekspertiza daktiloskopike, ekspertiza balistike, ekspertiza e drogave dhe substancave psikotrope, ekspertiza e AND-së dhe ekspertiza grafologjike. Nga të dhënat e mbledhura nga literatura kryesisht ndërkombëtare është studiuar kryesisht kuptimi, llojet, paraqitja në vendngjarje e veçanërisht është analizuar dhe shtjelluar ekspertiza laboratorike e tyre.

Ekspertiza në kuptimin e përgjithshëm është dhënia e mendimit apo konstatimi profesional nga një specialist i kualifikuar lidhur me një çështje, provë apo material lidhur me çështjet ekonomike, sociale, kulturore, statistikore, trashëgimore, sportive, shkencore, teknologjike, gjeografike, klimatike, astronomike etj. Ndërsa në kuptimin proceduralo-kriminalistik ekspertiza është dhënia e mendimit apo konstatimi profesional nga një specialist i kualifikuar lidhur me një çështje, provë, dëshmi apo material që ka apo mund të ketë lidhshmëri me një vepër penale.

Në kuadër të këtij studimi për të kuptuar më mirë ekspertizën dhe rolin e saj në procedurë është analizuar dhe krahasuar Procedura Penale e Shqipërisë, ajo e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë.

Në përgjithësi të tri këto procedura penale, ekspertizën e rregullojnë me dispozita të veçanta ligjore. Procedura Penale e Kosovës është një ndër procedurat më të reja, e cila e rregullon në mënyrë më të detajuar ekspertizën. E veçanta e saj është: zgjerimi i kompetencës së prokurorit dhe të pandehurit në caktimin e ekspertit: dhënia e të drejtës të pandehurit, mbrojtësit, viktimës ose mbrojtësit të viktimave të kundërshtojnë zgjedhjen e ekspertit, bazuar në kualifikimet e tij, konfliktin potencial të interesit, duke paraqitur kundërshtim tek gjyqtari i procedurës paraprake: dhënia e besimit institucionit profesional për caktimin e ekspertit: rregullimi i detajuar i ekspertimit në kuptimin e kushteve të kryerjes, të raportimit të saj dhe të llojeve të saj. Procedura



Penale e Shqipërisë nuk ka dispozitë ligjore të veçantë që rregullon “kryerjen e ekspertizës sipas ndërlukshmërisë” së saj, apo kur ekspertiza i besohet organit të caktuar publik apo ndonjë institucioni profesional. Mirëpo, Procedura Penale e Shqipërisë përmes dispozitave të veçanta ligjore, në përgjithësi, rregullon ekspertizën në procedurë si: objekti i ekspertizës, caktimi i ekspertit, papajtueshmëria me detyrën e ekspertit, përjashtimi i ekspertit, disponimet e organit procedues, caktimi i detyrës, veprimet e ekspertit, akti i ekspertizës dhe zëvendësimi i ekspertit. Ndërsa në Maqedoni ekspertiza është e rregulluar me ligj të veçantë. Konstatimi dhe mendimi i ekspertit i nënshtrohen vlerësimit të provave, sikurse çdo provë tjetër, me ç ‘rast edhe për të sikurse për të gjitha provat tjera vlen rregulli i të ashtuquajturit vlerësim i lirë i provave. Eksperti duhet të veprojë sa më shpejtë që është e mundur, duke analizuar dhe duke ekspertuar të dhënat apo dëshmitë e dorëzuara. Në Procedurën Penale të Kosovës nuk ka afat të përcaktuar për kryerjen e ekspertizës, por parashihet që eksperti pa vonesë duhet të kryejë ekspertizën dhe t’ia dorëzojë atë prokurorit. Në Procedurën Penale të Shqipërisë, për rastet komplekse për ekspertizë është përcaktuar koha shtesë prej 60 ditësh me mundësi vazhdimi në periudha prej 30 ditësh, por jo më gjatë se 9 muaj. Ndërsa në Procedurën Penale të Maqedonisë, kryerja e ekspertizës afatizohet me urdhëresën e organit procedues. Për ekspert nuk mund të angazhohet personi i cili nuk mund të pyetet si dëshmitar ose personi i cili është liruar nga detyrimi që të dëshmojë, si dhe as personi kundrejt të cilit është kryer vepra penale, e po qe se është emëruar, në konstatimin dhe mendimin e tij nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor. Në rastet kur mendimi apo konstatimi i ekspertëve është i paqartë, jo i plotë apo në kundërshtim me vetveten apo me rrethanat e shqyrtuara, organi procedues mund të kërkojë përsëritjen e ekspertizës nga eksperti i njëjtë, eksperti tjetër apo grupi i ekspertëve të tjerë. Ekspertiza është e obliguar: kur ekziston dyshimi ose është e dukshme se vdekja është shkaktuar me veprën penale, kur ekziston dyshimi nga helmimi, kur është e nevojshme ekspertiza për lëndime trupore, kur paraqitet dyshimi përkitazi me llogaritshmërin e kryesit.

Në bazë të këtij hulumtimi doktoral, duke analizuar legjislacionin e Kosovës është gjetur se ka konflikt ligjorë në legjislacionin e Kosovës në lidhje me juridiksionin për të dhënat e ADN-së. Në njëërën anë, procedura penale përcakton të drejtën (**de-juro**) e Ministrisë së Drejtësisë për mbajtjen apo ruajtjen e provave të gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale. Ndërsa në anën tjetër Agjencia e Kosovës për Forenzikë **de fakto** dhe **de-juro** bazuar në ligjin nr. 04/L-064 për Agjencinë e

Kosovës për Forenzikë, në nenin mbanë dhe ruan rezultatet e provave të gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale, respektivisht profilin e ADN-së në sistem të kompjuterizuar-CODIS.

Në Kosovë shkenca e forenzikës, zhvillimet e saja i gjen pas luftës heroike të UÇK-së. Administrata e UNMIK-ut e vendosur në Kosovë si mision i Kombeve të Bashkuara, komponentë e policisë, kishte zhvilluar dhe kishte vendosur disa lloje të ekspertimeve si: ekspertiza e dokumenteve, ekspertiza e gjurmëve të gishtërinjve dhe ekspertiza balistike. Provat fizike për analizë të ADN-së, analizë të drogave dhe analizë toksikologjike dërgoheshin në Laboratorin e Sofjes në Bullgari. Mirëpo, zhvillimi më i rëndësishëm dhe më ia arritur konsiderohet financimi dhe themelimi i laboratorit të forenzikës nga Qeveria Amerikane, programi ICITAP.

Po ashtu arritje shumë e rëndësishme pa mëdyshje konsiderohet nxjerrja dhe hyrja në fuqi e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë. Ky ligj themeloi AKF si agjenci të pavarur ekzekutive me të drejtën e personit juridik për ushtrimin e “ekspertizës forenzike” me juridiksionin në territorin e Kosovës. Ky ligj rregullon përkufizimet shkencore, administrative dhe procedurale; themelimin e agjencisë së Kosovës për forenzikë me elementet përcjellëse; organizimin dhe funksionet; kompetencat dhe përgjegjësitë; të drejtat e personelit dhe disiplina. Ligji parasheh nxjerrjen e akteve nënligjore për rregullimin administrativ të AKF-së, akte të cilat miratohen nga ministri i punëve të brendshme apo kryeshefi ekzekutiv i AKF-së. Ajo që mund të konsiderohet element shumë i rëndësishëm është se ky ligj garanton të drejtën e veprimtarisë dhe aktivitetin shkencorë të AKF-së. Një arritje tjetër shumë e rëndësishme e AKF-së është standardizimi i laboratorit për analizë të narkotikëve dhe e laboratorit e ADN-së, laboratorin e dokumenteve, laboratorin e balistikës dhe laboratorin e daktiloskopisë sipas standardit ndërkombëtar ISO 17025. Ky akreditim ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së ekspertizave, objektivitetin dhe paanshmërinë e ekspertizave, dokumentimin dhe korrigjimin e veprimeve, garantimin e ekspertizave forenzike etj. Ndërsa instituti i policisë shkencore i Shqipërisë nuk ka arritur standardin ndërkombëtarë ISO 17025.

## 7.2. Konkluzione

Bazuar në këtë studim doktoral kemi nxjerrë konkluzionet si në vijim:

1. Forenzika është shkencë e cila merret me studimin, analizimin, testimin, krahasimin dhe interpretimin e provave të ndryshme me qëllim të zbulimit, identifikimit, individualizimit dhe vërtetimit të çështjeve të ndryshme në zbatim të ligjit.
2. Shkenca e forenzikës ka rol shumë të rëndësishëm në zbardhjen e veprave penale, zbulimin e (autorëve) kryerësve të tyre apo përjashtimin dhe vërtetimin e pafajësisë të të dyshuarve si autorë të mundshëm. Por jo vetëm kaq, ajo gjen zbatim edhe në çështje civile si: përcaktimi i atësisë përmes analizës së ADN-së, ekzaminimet grafologjike të dorëshkrimeve etj.
3. Shkenca e Forenzikës ofron prova shkencore, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në procedurë penale me rastin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, rindërtimit të vendit të ngjarjes, ekspertimit të provave balistike, daktiloskopike, traseologjike, biologjike (ADN), kimike (narkotikë), grafologjike etj.
4. Në përgjithësi në procedurë penale, ekspertiza rregullohet me dispozita të veçanta ligjore.
5. Procedura penale e Kosovës rregullon në mënyrë të detajuar ekspertizën. E veçanta e saj është: zgjerimi i kompetencës së prokurorit dhe të pandehurit në caktimin e ekspertit: dhënia e të drejtës të pandehurit, mbrojtësit, viktimës ose mbrojtësit të viktimave të kundërshtojnë zgjedhjen e ekspertit, bazuar në kualifikimet e tij.
6. Procedura penale e Shqipërisë nuk ka dispozitë ligjore të veçantë që rregullon “kryerjen e ekspertizës sipas ndërlukshmërisë” së saj, apo kur ekspertiza i besohet organit të caktuar publik apo ndonjë institucioni profesional.
7. Procedura penale e Kosovës përcakton organin publik apo institucionin profesional për kryerje të ekspertizave të ndërlukuara.
8. Në Maqedoni, përveç procedurës penale, ekspertiza është e rregulluar edhe me ligj të veçantë, “Ligji për ekspertizë”.
9. Në Procedurën Penale të Kosovës nuk është paraparë afat për kryerjen e ekspertizës. Përderisa në procedurën penale të Shqipërisë, për rastet komplekse për ekspertizë është përcaktuar koha shtesë prej 60 ditësh me mundësi vazhdimi në periudha prej 30 ditësh, por jo më gjatë se 9 muaj. Ndërsa në Procedurën Penale të Maqedonisë, kryerja e ekspertizës afatizohet me urdhëresën e organit procedues.

10. Ndryshimi më radikal në kodin e ri të procedurës penale të Kosovës, në procesin e të provuarit, nenin 141, paragrafët 1 dhe 2 është dhënia e së drejtës të pandehurit për angazhimin me pagësë të ekspertit.
11. Në Kosovë ka paqartësi ligjore lidhur me ruajtjen dhe kontrollin e profilit të AND-së.
- Në njërën anë procedura penale e Kosovës**, neni 145, përcakton ministrinë e drejtësisë si organ për mbajtjen apo ruajtjen e provave të gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e ngjarjes. Rezultatet nga ekzaminimi molekular dhe gjenetik që nuk përputhen me të dyshuarin apo të pandehurin mund të ruhen nga Ministria e Drejtësisë deri në një kohë të tillë kur ato të përputhen me të dyshuarin apo të pandehurin dhe derisa ai i dyshuar apo i pandehur të lirohet apo të shpallet fajtor. Ministria e Drejtësisë ka nxjerrë rregullore mbi ruajtjen e rezultateve të ekzaminimit molekular dhe gjenetik. **Në anën tjetër ligji nr. 04/L-064 për agjencinë e Kosovës për forenzikë**, neni 18, përcakton agjencinë e Kosovës për forenzikë në kuadër të ministrisë për punë të brendshme, si organ për ruajtjen dhe krahasimin e rezultateve të provave të gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale, respektivisht krahasimin e profilit të ADN-së në sistemin të kompjuterizuar-CODIS, donacion i FBI-së.
12. Kosova me ligj të veçantë organik (ligji. nr. 04/L-064 për agjencinë e Kosovës për forenzikë) ka themeluar agjenci e pavarur shtetërore me të drejtën e personit juridik për ushtrimin e ekspertizës forenzike me juridiksionin të plotë në të gjithë territorin e Kosovës. Ky ligj rregullon përkufizimet shkencore, administrative dhe procedurale; themelimin e agjencisë së Kosovës për forenzikë; organizimin dhe funksionet; kompetencat dhe përgjegjësitë; të drejtat e personelit dhe disiplina. Ligji parasheh nxjerrjen e akteve nënligjore për rregullimin administrativ të AKF-së, akte të cilat miratohen nga ministri i punëve të brendshme apo kryeshefi ekzekutiv i AKF-së. E veçantë e këtij ligji organik konsiderohet pavarësia dhe garantimi i objektivitetit për ekspertizë shkencore.
13. Agjencia e Kosovës për forenzikë ka arritur standardet ndërkombëtare ISO 17025. Ka akredituar laboratorin për analizë të narkotikëve dhe e laboratorin e ADN-së, laboratorin e dokumenteve, laboratorin e balistikës dhe laboratorin e daktiloskopisë Akreditimi ka ndikuar në rritjen e cilësisë, objektivitetin, paanshmërinë, dokumentimin dhe korrigjimin e veprimeve dhe garantimin e ekspertizave forenzike. Ndërsa instituti i policisë shkencore i Shqipërisë nuk ka arritur standardin ndërkombëtarë ISO 17025.

14. Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka sisteme të avancuara informative: LIMS, AFIS, CODIS dhe IBIS.
15. Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka treguar performancë e lartë gjatë viteve 2012-2014. Gjatë kësaj peridhe kohore AKF ka shënuar një rritje të konsiderueshme kryerjes së rasteve. Kështu në vitin 2012: 3495, vitin 2013: 4214 dhe vitin 2014: 4808 ekspertiza , d.m.th. në vitin 2013 janë kryer 719 raste më shumë se sa në vitin 2012, ndërsa në vitin 2014 janë kryer 590 raste më shumë se sa në vitin 2013. Sa i përket numrit të provave kemi një ndryshim në raport me numrin e rasteve. Kështu viti 2012 shënon numrin më të lartë të provave të ekspertuara: 54888, viti 2014: 51964 dhe viti 2013: 33320. Laboratori i cili ka dominuar me numrin më të madh të ekspertizave është laborator i balistikës, pastaj laborator i daktiloskopisë, laborator i dokumenteve, laborator për analizë të narkotikëve, laborator për ADN dhe laborator për ekzaminim të kompjuterëve.

### **7.3. Rekomandime**

Bazuar në këtë studim doktorat kemi nxjerrë rekomandimet si në vijim:

1. Të organizohen trajnime dhe punëtori për gjyqtarë dhe prokurorë me temë: “shkenca e forenzikës dhe roli i sajë në procedurë penale”.
2. Forenzika të trajtohet si shkencë e veçantë në kuadër të studimeve univeristare.
3. Në procedurën penale të Shqipërisë të rishikohen dispozitat ligjore për ekspertim sepse ka nevojë për ndryshim dhe plotësim, në kuptimin e përkufizimit të të gjitha llojeve të ekspertimit.
4. Në procedurën penale të Shqipërisë të parashihet “kryerja e ekspertizës sipas ndërlikshmërisë”.
5. Në procedurën penale të Shqipërisë të parashihet dhënia e së drejtës të pandehurit për angazhimin me pagësë të ekspertit.
6. Në procedurën penale të Kosovës të parashihet afati kohorë për kryerjen e ekspertizës.
7. Ministria e drejtësisë dhe ministria e punëve të brendshme të Kosovës të iniciojnë ndryshimin dhe plotësimin e kodit të procedurës penale të Kosovës, neni 145, paragrafi 6 dhe ligjit nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, nenin 18, veprimtaria e AKF-së, paragrafi 6 dhe 7 në mënyrë që zgjidhet konflikti ligjorë në mes këtyre dy ligjeve (referencë: konkluzioni nr. 11 i këtij punimi).

8. Agjencia e Kosovës për forenzikë të jetë autoriteti i vetëm në Kosovë me juridiksion të plotë për administrimin e provave për ADN, përfshirë edhe sistemin e kompjuterizuar CODIS.
9. Të ngritët bashkëpunimi midis AKF-së dhe institutit të policisë shkencore të Shqipërisë për përkrahje, shkëmbim përvojash, trajnime etj.
10. Instituti i policisë shkencore i Shqipërisë të ngritët në nivel të agjencisë shtetërore. Për model të merret agjencia e Kosovës për forenzikë.
11. Instituti i policisë shkencore i Shqipërisë të akreditohet sipas standardit ndërkombëtarë ISO 17025.

## **Bibliografia**

### **Literatura**

#### **Burime parësore:**

1. Ademaj Xh. (2010), Ekspertizat kriminalistike, Prishtinë, 25, 251, 357-359.
2. Ademaj Xh., (2013), The Heritage, revistë Shkencore, Strugë, nr.10 /, 93.
3. Barry A. J. Fisher, (2004), Techniques of Crime Scene Investigation, Introduction, 1972 Protocol, New York 58-89.
4. Beat P. Kneubuehl (Ed.) Robin M. Coupland Markus A. Rothschild Michael J. Thali, (2011), Wound Ballistics (Basics and Applications), Berlin Heidelberg, 48.
5. Begeja S., (2004), Kriminalistika, Tiranë, 193, 195, 216.
6. Begeja S., (2007), Kriminalistika, Studimi mbi gjurmët, Tiranë, 193-216, 229-261.
7. Bell S., (2006), Forensic Chemistry, 1st edition, New Jersey, USA, 212-261.
8. Brennon Sapp, Ammunition & Ballistics Analysis,( Brennon Sapp and bsapp.com.) 65.
9. Brian J. Heard., (2008), Handbook of Firearms and Ballistics (Examining and Interpreting Forensic Evidence), botimi II, 241.
10. Burger A, Understanding Medications; What the Label Doesn't Tell You, American Chemical Society, Oxford University Press, New York, 1995, p.1-50.
11. Carlucci, Donald E. Sidney S. Jacobson, (2008), Ballistics (theory and of guns and ammunition), 352.
12. Christophe Champod, Chris J. Lennard, Pierre Margot, Milutin Stoilovic, (2004), Fingerprints and Other Ridge Skin Impressions, 17.
13. Collins G. Clarence, (2001), Fingerprint Science, How to roll Classify, File and Use of Fingerprints. Wadsworth, Thomson 4-5, 93.
14. DiMaio,Vincent J. M. Gunshot Wounds (Practical Aspects of Firearms, Ballistics, and Forensic Techniques), botimi II, (1999), Library of Congress, Boca Raton, 60-71.
15. Drug Identification Bible, 2004/2005edition, Amara-Chem, Inc., Colorado, USA, 2004, p. 347-458.

16. Drug Identification Bible, 2004/2005 edition, Amara-Chem, Inc., Colorado, USA, 2004, p. 347-458.
17. Dusko M., Superina M. & Korajlic N. (2008), Rjecnik Kriminalistike, Zagreb, 115.
18. Ellen D., (2006), "Scientific Examination of Documents", New York, USA, 2006, 44-68
19. ENFSI, (2008), European Fingerprint Working Group Best Practice Manual for Fingerprint Examination, 68.
20. Estref Myftari, (2008), Kriminalistika, Hyrje në Kriminalistikë, Tiranë, 240, 331-370.
21. Gaensslen R. E., Harris A., H. Lee H (2008), introduction to Forensic Science & Criminalistics, New Yourk, 7-10, 244-247.
22. Gregor, Kolaric, (1999), Teknika kriminalistike, Zagreb, 117-118.
23. Hajdari A., (2010), Procedura Penale Komentar, Prishtinë, 453-485.
24. Haxhiu Sh., Myftari E., (2004), Daktiloskopia, Tiranë, 26-32.
25. Henry L., (1998), Provat materiale, Zagreb, 196.
26. Hueske E. Edward, (2006), Practical Analysis and Reconstruction of Shooting Incidents, Taylor & Francis Group, Boca Raton, 2006, 135.
27. Hueske, E Edward, (2009), Firearms and fingerprints, USA, 117
28. Hayden A. Donald, (2005), Crime Scene Processing, Laboratory Manual and Workbook, London, New Yourk & Washington DC.
29. Islami H., Hoxha Artan dhe Panda I. (2003), Procedura Penale, Tiranë, 229-239.
30. Islami H., Hoxha Artan dhe Panda I. (2012), Procedura Penale, Tiranë, 239-250.
31. Jones W. Gary, (2004), Introduction to Fingerprint Comparison, Staggs Publishing, 38.
32. Keith Inman & Norah Rudin, (2001), Principles and Practice of Criminalistics, the Profesiono of Forensic Science, Introduction, CRC Press, Boca Raton London, Washington DC, 3-18.
33. Kelly Seman J. (2006), "Scientific Examination of Questioned Documents", New York, USA, 133.
34. King A. Andrew, (2009), Ballistics, (Crime scene investigations), 17.
35. Korajlić N. & Muharremi D., (2009), Kriminalistika, Prishtinë, 431-434.
36. Latifi V., (2006), Kriminalistika, Prishtinë, 171, 241, 368.
37. Latifi V., (2013), Kriminalistika, botimi i VIII, Prishtinë, 241.
38. Mandro I. (2000) , Kriminalistika mbi identifikim e armëve të zjarrit, Tiranë, 27.



39. Mandro I., (2011), Njohuri për kriminalistiken, Tiranë, 34-36.
40. Moffat, Osselton and Widdop, Clarke's (2004), Analyses of Drugs and Poisons, Third edition, Volume 1, London. Chicago Pharmaceutical Press Lambeth High Street, London, UK, , p. 282-295.
41. Myftari E., Shishani F. dhe Kotri, (2010), Kriminalistika, Prishtinë, 97, 334, 347
42. Myftari, (2008), Kriminalistika,Tiranë,.
43. Olluri B. dhe Ademaj Xh., (2014), Importance, Tasks and Principles of Criminal Traseology, EUROPEAN ACADEMIC RESEARCH, Vol. II, Issue 9/, 12182.
44. Peter F. Mahoney, James M. Ryan, Adam J. Brooks and C. William Schwab, (2005), Ballistic Trauma, botimi II, London, 39.
45. Recommended Methods for Testing Opium, Morphine and Heroin, United Nations, 1998 ST /NAR / 29 / Rev.1, 3-18.
46. Saferstein R., (2007), Criminalistics, An introduction to Forensic Science, 13, 150, 254-269, 499.
47. Saferstein R., Criminalistics, (2014), An Introduction to Forensic Science, 9th edition, për këtë botim në gjuhen shqipe, TABERNAKULL, 133-269.
48. Sahiti E. dhe Murati R., (2013), E drejta e Procedrës Penale, Universiteti i Prishtinës në Prishtinë, 230.
49. Sahiti, Murati, Elshani, Komantar, (2014), botimi I, kodi i procedures penale, Prishtinë, 381.
50. SWGFAST, (2002) friction ridge examination methodology for latent print examiners, versioni 1.01., 2
51. Slyter S. (1995), "Forensic Signature Examination", "Charles C Thomas", Illinois, USA, 10
52. Sokrat M. dhe Blakaj F., (2010), Mjekwsia ligjore, Biblioteka Kombwtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë, 62-63.
53. Suzane Bell, (2004), Dictanary of Forensic Science,
54. T. A.Warlow, Firearms, (2003), the Law and Forensic Ballistics, Taylor & Francis, 65-71.
55. Terrence F. Kiely, Forensic Evidence: Science and the Criminal Low, Science, Forensic Science, and Evidence, 2001., CRC press, Boca Raton London, Washington DC, 14-37.
56. Tom Warlow, Firearms, the Law, and Forensic Ballistics, 2004, 325.
57. Udhëzim administrativ nr. 40/2012-MPB për stemën identifikuese të agjencisë së Kosovës për forenzikë, (2012), Prishtinë, 3.

58. U.S. Department of Justice „National Institute of Justice, (2002) “The Fingerprint” SHBA, 18.
59. USA (2000), FBI Laboratory Division, 4.
60. Warlow, T.A., (2003), Firearms, the Law and Forensic Ballistics, Taylor & Francis, 65.
61. William J. Bodziak, (2000), Footwear Impression Evidence, Detection, Recovery and Examination, second edition, 372.
62. William J. Tilstone, Kathleen A. Savage, and Leigh A. Clark, (2006), Forensic Science, An Encyclopedia of History, Methods, and Techniques 274-275.
63. Xasanov, Sh.X. X.A. Turebbayen, A.D. Xusanov, (2013), Ballistik Ekspertiza, Toshkent, 366.
64. Young-Sheng Chen, (2009), Image Processing, Intech, 141.

#### **Burime dytësore:**

1. Andrew P. Thomas, (2006) The CSI Effect: Fact or Fiction, 115 Yale L.J. Pocket Part 70, The author examines the premise that television programs such as CSI: Crime Scene Investigation affect real-life criminal proceedings.
2. Andrew R. W. Jackson dhe Julie M. Jackson, (2008), FORENSIC SCIENCE, second edition, 102.
3. Barnett D. Peter, (2001) Ethics in Forensic Science, Profesional standards for the Practice of Criminalistics, London, New York.
4. Basaric M. Vejzagic N., (1998), Kriminalistika II (Krimnalisticka tehnika), Fakultet Kriminalistickih nauka, Sarajevo.
5. Beka A. (2015), Krimi i organizuar në urbanizëm dhe qarkullim të pasurive të paluajtshme, Prishtinë.
6. Bergman, R.A., (1988), The impact of technological advancement on forensic science practice.
7. Bicaj K., (1997), Narkomania sot dhe parandalimi i saj, Prishtinë.
8. Black's and C. (2006), Forensic Human Identification, London.
9. Champod Christophe, Lennard Chris, Margot Pierre, and Stoilovic Milutin:,Fingerprints and Other Ridge Skin Impressions'' 2004 by CRC Press LLC.

10. Cowger F. James "Friction Ridge Skin" Comparison and Identification of Fingerprints, 1993 by CRC press LLC.
11. Cuberi B. (1981), Mjekësia Ligjore, Tiranë.
12. Demolli H. (2002), Terrorizmi, Prishtinë.
13. Fausto I., (2002), E drejta e procedurës penale, Përkthim, Tiranë
14. Hajdari A. ((2006), Krimi i organizuar, Prishtinë.
15. Hajdari A., (2004), E drejta e procedurës penale të Maqedonisë, Prishtinë
16. Hysi V. (2010), Kriminologjia, Tiranë.
17. Kirk P. J., (1976), Crime investigation, New York.
18. Korajlić N. Muharremi D. & ,Ademaj Xh., (2016), Fljalori terminologjia krimnalistike, Prishtinë.
19. Korajlić N., (2012), Istrazivanje krivicnih djela, Sarajevo.
20. Lee C. Hanry, Taft M. George, Taylor A. Kimberly & Hancken J., (2009), Forensic Science Today, Arizona.
21. Lee D. Gregory, (2007), Practical Criminal Evidence, New Jersey.
22. Maksimovic, Todorovic, (1995), Teknika krimnalistike, Beograd.
23. Matovski N. (2004), Kazneno procesno pravo, Skopje.
24. Meksi S. Blakaj F. (2010), Mjekësia Ligjore, Prishtinë.
25. Miller, R. L. (2002), The Encyclopedia of Addictive Drugs, USA.
26. Modly D. (2001), Utverdivanje istine putem forenzickih laboratorija, Zagreb.
27. Modly D., (1998), Kriminalisticka metodika, Fakultet kriminalistickih nauka, Sarajevo.
28. Ogle Robert R. (2007), Crime Scene Investigation & reconstruction, New Jersey.
29. Ramljak A., (1999), Medicincka krimnalistika, Universitet u Sarajevo.
30. Saferstein R., (2004) Lab Manual, Crimnalistics, An introduction to Forensic Science, New Jersey.
31. Salihu I., Zhitija H., & Hasani F., (2014), Komentar, kodi penal i republikës së Kosovës, Prishtinë.
32. Sally A. Schehl, (2000) "Firearms and Toolmarks in the FBI Laboratory, Part 1," Forensic Science Communications,. An excellent introduction to the science of firearms and toolmarks identification.
33. Skiba B. ((1986), Kriminalisticka problematika uvidaja mjesta dogadaja.

34. Sullivan T. Willson III, (2007), Crime scene analysis, Practical Procedures and techniques, New Jersey.
35. U.S. Department of Justice, Federal Bureau of Investigation, Laboratory Division, Processing Guide for Developing Latent Prints; revised 2000.
36. UNITED NATIONS “Convention against Illicit Traffic in Narcotic Drugs and Psychotropic Substances” of 1988 (2015), as at 6 October 2014, New York.
37. UNITED NATIONS “Convention on Psychotropic Substances” (2013) of 1971, as at 25 New York.
38. UNITED NATIONS “Single Convention on Narcotic Drugs” (2013), of 1961.
39. WHO (World Health Organization), (1969), Report on 16th session, Expert committee on Drug Dependence, Geneva.
40. WHO (World Health Organization), (2003), Report on Thirty-third session, Expert committee on Drug Dependence, Geneva.

### **Legjislacioni**

1. Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, ISBN 978-9928-01-021-6, Tiranë.
2. Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës nr. 04/L-123, (2013), Gazeta zyrtare, Prishtinë.
3. Ligji i procedurës penale i Republikës së Maqedonisë (2010), Shkup.
4. Ligji për ekspertizë i Republikës së Maqedonisë, (2013), Shkup.
5. Ligji për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë nr. 04/L-064, (2011), Prishtinë.
6. Ligji për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë, Nr. 02/L-128, (2007), Kapitulli III, Neni 9, Prishtinë.

### **Raporte zyrtare**

1. Raporti vjetor i AKF-së, (2012), AKF, Prishtinë
2. Raporti vjetor i AKF-së, (2013), AKF, Prishtinë
3. Raporti vjetor i AKF-së, (2014), AKF, Prishtinë
4. Procedurat e ADN-së, AKF-4, 2015

### **Internet**

1. [www.enfsi.eu](http://www.enfsi.eu)
2. [www.crimine.it](http://www.crimine.it)
3. [www.criminologia.it](http://www.criminologia.it)

4. [www.drugs.com](http://www.drugs.com)
5. [www.cbdi.ai.org](http://www.cbdi.ai.org)
6. [www.iec-iso-17025.com](http://www.iec-iso-17025.com)
7. [www.mpb-ks.org](http://www.mpb-ks.org), p.1,46,1561, parë më datë 23.05.2016
8. [www.interforensic.org](http://www.interforensic.org), parë më datë 21.05.2016